



# Shëtitje në natyrën e egër

Shembuj evropianë të ruajtjes ndërkufitare

Përgatitur për shtyp nga Maja Vasiljević dhe Tomasz Pezold



UNIONI NDËRKOMBËTAR PËR RUAJTJEN E NATYRËS



# Shëtitje në natyrën e egër

Shembuj evropianë të ruajtjes ndërkufitare





## IUCN

IUCN, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, ndihmon botën në gjetjen e zgjidhjeve praktike për disa nga sfidat më të mprehta të zhvillimit dhe mjedisit.

IUCN punon në fushën e biodiversitetit, të ndryshimeve klimatike, energjisë, të mënyrës së jetesës dhe mirëqenies së njerëzve dhe aktivitetit pro-mjedisor në botë përmes mbështetjes së kërkimit shkencor, menaxhimit të projekteve në terren në mbarë botën duke bashkuar forcat me qeveritë, OJFtë, Agjencitë e OKBsë dhe kompanive të ndryshme për zhvillimin e politikave, legjislacionit dhe praktikave më të mira.

IUCN është organizata më e vjetër dhe më e madhe në botë, me më shumë se 1,000 anëtarë nga qeveritë dhe OJFtë dhe me pothuajse 11,000 vullnetarë dhe ekspertë në 160 vende të botës. Puna e IUCNsë mbështetet prej mbi 1,000 punonjës të shpërndarë në 60 zyra dhe qindra partnerë nga publiku i gjerë, OJFtë dhe sektorët privatë nëpër botë.

[www.iucn.org](http://www.iucn.org)



## Komisioni Botëror i Zonave të Mbrojtura (WCPA)

Komisioni Botëror i Zonave të Mbrojtura (*shkurtimi në anglisht: WCPA*) është një rrjet botëror i menaxherëve dhe specialistëve të zonave të mbrojtura me mbi 1,300 anëtarë në 140 vende. WCPA është një nga gjashtë komisionet vullnetare të IUCNsë dhe administrohet nga Programi Global i Zonave të Mbrojtura në zyrat kryesore të IUCNsë në Gland të Zvicrës. Misioni i WCPAsë është që të promovojë krijimin dhe menaxhimin efektiv të një rrjeti botëror që përfaqëson zonat e mbrojtura tokësore dhe detare, si një kontribut integral i misionit të IUCNsë.

[www.iucn.org/wcpa](http://www.iucn.org/wcpa)

## Grupi i Specialistëve të Ruajtjes Ndërkufitare

Grupi i Specialistëve të Ruajtjes Ndërkufitare i IUCN WCPAsë është rrjeti i parë global i specialistëve të ruajtjes ndërkufitare. Misioni i Grupit të Specialistëve të Ruajtjes Ndërkufitare është që të promovojë dhe nxisë ruajtjen ndërkufitare me qëllim që të ruhet natyra së bashku me shërbimet e ekosistemeve dhe vlerat e trashëgimisë kulturore, krahas promovimit të paqes dhe bashkëpunimit mes shteteve, përmes rritjes së shkallës së njohurive dhe të kapacitetit për planifikimin dhe menaxhimin efektiv të zonave ndërkufitare të ruajtjes, në përmbushje edhe të Planit Durban të Veprimit dhe Programit të Punës për Zonat e Mbrojtura në kuadër të Konventës së Shumëllojshmërisë Biologjike.

[www.tbpa.net](http://www.tbpa.net)



## BfN

Agjencia Federale e Gjermanisë për Ruajtjen e Natyrës (BfN) është autoriteti shkencor qendror i Gjermanisë për ruajtjen në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare të natyrës. Agjencia ofron për Qeverinë Gjermane, kryesisht për Ministrinë Federale të Gjermanisë për Mjedisin, Ruajtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore (BMU), asistencë profesionale dhe shkencore për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e peisazheve dhe veprimtaritë ndërkombëtare të bashkëpunimit.

BfN kryen transferimit e njohurive që kanë të bëjnë me ruajtjen e natyrës përmes përgatitjes shkencore dhe përshtatjes së tyre për qëllime praktike zbatimi. Gjithashtu, BfN arrin objektivat e saj përmes zbatimit të kërkimit shkencor në fusha që lidhen me fokusin e saj kryesor dhe është përgjegjëse për disa programe financimi. Për rrjedhojë Agjencia mban një proces të vazhduar dialogu me politikëbërësit, agjencitë e zhvillimit, sektorin e biznesit, komunitetin shkencor, mësime dhënësit dhe mediat duke përshtatur në mënyrë të vazhduar paketën e mjeteve të ruajtjes së natyrës që t'ju përgjigjet ndryshimeve të ndryshme shoqërore.

Aktivitetet ndërkombëtare të BfNsë udhëhiqen nga qëllimet dhe përparësitë e ruajtjes së natyrës të shprehura në konventat dhe marrëveshjet mjedisore shumëpalëshe dhe synojnë të çojnë përpara zbatimin e tyre.

[www.bfn.de](http://www.bfn.de)

# Shëtitje në natyrën e egër

Shembuj evropianë të ruajtjes ndërkufitare

Përgatitur për shtyp nga Maja Vasiljević dhe Tomasz Pezold



Përcaktimi në këtë libër i entiteve gjeografike për sa i përket statusit ligjor të vendeve, territoreve, zonave, apo të autoriteteve përkatëse, të vendosjes së kufijve shtetërore dhe paraqitja e materialit nuk nënkupton shprehjen e opinionit të IUCN-së, BMU-së, UBA apo të BfN-së. Për qëllimet e këtij publikimi, emri Kosovë i referohet territorit nën Misionin e Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara të krijuar në 1999 nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara; dhe emri Maqedoni është përdorur duke iu referuar ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk shprehin domosdoshmërisht ato të IUCN-së, BMU-së ose BfN-së. Ky publikim është bërë i mundur pjesërisht falë mbështetjes së Ministrisë Federale të Gjermanisë për Mjedisin, Ruajtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore (BMU) dhe Agjencisë Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës (BfN) përmes Programit Këshillimor të Asistencës për Mbrojtjen e Mjedisit në Vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore, Kaukaz dhe Azinë Qëndrore. IUCN dhe organizatat e tjera pjesëmarrëse nuk marrin përgjegjësi prej gabimeve ose ndryshimeve që mund të kenë ndodhur gjatë përkthimit të versionit origjinal prej gjuhës Angleze në Shqip.

|                          |  |
|--------------------------|--|
| Botuar nga:              | IUCN dhe organizatat e tjera pjesëmarrëse nuk janë përgjegjëse për çfarëdo lloj gabimi të shkaktuar nga përkthimi i materialit nga gjuha origjinale Anglishte në gjuhën Shqipe.  |
| Copyright:               | © Copyright: c 2011 International Union for Conservation of Nature and Natural Resources<br><br>Riprodhimi i këtij publikimi për qëllime edukuese dhe jofitimprurëse autorizohet pa marrjen me shkrim të lejes nga zotëruesi i të drejtës së botimit, gjë e cila njihet plotësisht nga burimi.<br><br>Riprodhimi i këtij publikimi për qëllime tregëtimi ose fitimi është i ndaluar pa marrjen me shkrim të lejes nga zotëruesi i të drejtës së botimit. |
| Citime:                  | Vasilijević, M., Pezold, T. (eds.). (2011). Shëtitje në natyrën e egër, Shembuj evropianë të ruajtjes ndërkufitare. Gland, Zvicër dhe Beograd, Serbi: Programi i IUCN, Zyra për Evropën Jug Lindore. viii + 72pp.  |
| Bashkëpunëtorët:         | Giorgio Andrian, Robert Brunner, Stanka Dešnik, Katharina Diehl, Gregor Domanjko, Bernhard Harrer, Gjorgji Ivanov, Aleksandar Ivanovski, Hubert Job, Hans Kiener, Zdenka Krenova, Alois Lang, Marius Mayer, Daniel Metzler, Martin Müller, Zbigniew Niewiadomski, Hana Petrikova, Dimitar Popov, Spase Shumka, Annette Spangenberg, Andrea Strauss, Marina Trusova, Manuel Woltering.  |
| ISBN:                    | 978-2-8317-1425-7  |
| Faqosja:                 | Imre Sebestyén, jr. / UNITgraphics.com   |
| Fotografia e kopertinës: | Tomasz Pezold  |
| Përgatitur nga:          | Programi i IUCN-së, Zyra për Evropën JugLindore  |
| Printimi:                | Stojkov, Novi Sad  |
| E disponueshme nga:      | Programi i IUCN-së, Zyra për Evropën JugLindore<br>Dr Ivana Ribara 91<br>11070 Beograd, Serbi<br>see@iucn.org<br>Tel +381 11 2272 411<br>Fax +381 11 2272 531<br>www.iucn.org/publications   |

# Përmbajtja

|   |      |
|---|------|
| Pararendje.....   | vii  |
| Parathënie.....   | viii |
| Falenderime.....  | ix   |
| Shkurtime.....  | x    |
| <br>  |      |
| 1. Hyrje – Projekti dhe sfondi i përgjithshëm .....   | 1    |
| 2. Veprimtaritë Ndërkufitare të Ruajtjes – Konteksti Global .....   | 3    |
| 3. Nisma e Brezit të Gjelbër – një vështrim retrospektiv lidhur me kalimin e kufijve .....  | 8    |
| 4. Nisma e Harkut Dinarik: Një qasje novatore për qeverisjen e bashkëpunimit ndërkombëtar .....   | 13   |
| 5. Liqenet e Prespës – Aty ku fiton Diplomacia e Gjelbër .....  | 18   |
| 6. Bashkëpunimi në Arktik – Parku tre-palësh Pasvik-Inari .....   | 22   |
| 7. Karpatet Lindore: E para Rezervë e Biosferës tre-palëshe në botë, sipas UNESCOs .....  | 26   |
| 8. 8000 Vjet që kalojmë kufijtë – Neusiedler See / Fertő-Tó .....   | 31   |
| 9. Praktikrat e mira të bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërkufitar<br>– Rezerva Biosferike e Krkonoše/Karkonosze .....                    | 35   |
| 10. Zhvillimi përkrah natyrës, me parkun trepalësh: Goričko-Raab-Őrség .....  | 39   |
| 11. Zemra e Egër e Evropës – Përgjegjësi për Evropën.....   | 42   |
| 12. Lumi Thaja– që lidh Parqet Kombëtare Thayatal dhe Podyjí .....  | 46   |
| 13. Bashkëpunimi Ndërsektorial për Ruajtjen e Shpendëve<br>– OJQja “Balkani i Gjelbër” dhe Drejtoria Bullgare e Policisë Kufitare ..... | 50   |
| 14. Jablanica-Shebenik: Duke punuar për krijimin e një zone ndërkufitare të mbrojtur<br>për rrëqebullin në Ballkan.....                 | 55   |
| 15. Ndikimi Ekonomik Rajonal i Parkut Kombëtar të Pyllit Bavarez .....  | 59   |
| 16. Përfitimet e bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e ruajtjes dhe konservimit të natyrës .....  | 66   |
| <br>  |      |
| 17. Referenca.....  | 71   |





## Pararendje

Me një shtrirje nga Deti Barent në Detin Adriatik dhe Detin e Zi, Brezi i Gjellbër Evropian formon shtyllën kryesore të një rrjeti ekologjik në Evropë. Duke krijuar kështu një simbol global për bashkëpunimin ndërkufitar të ruajtjes së natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Duke ndjekur rrugën përgjatë së cilës shtrihet ky brez, një pjesë e mirë gjendet përgjatë ish Perdes së Hekurt, një prej barrierave më të forta ndarëse në histori, duke simbolizuar në ditët e sotme përpjekjet globale për aktivitete të përbashkëta ndërkufitare. Për më tepër nisma shërben për të harmonizuar më mirë aktivitetin njerëzor me mjedisin natyror dhe për të rritur mundësitë për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të komuniteteve vendore. Bazuar në këto parime, Brezi i Gjellbër mund të rrisë shkallën e bashkëpunimit mes vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të atyre që aspirojnë për tu futur në BE. Agjencia Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës (BfN) është krenare të jetë pjesë e kësaj nisme. BfN ka mbështetur për vite me radhë shumë projekte të Brezit të Gjellbër, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Shëtitje në natyrën e egër: ngritje kapacitetesh dhe fuqizimi i bashkëpunimit për promovimin e ruajtjes ndërkufitare të natyrës përgjatë Brezit të Gjellbër të Evropës JugLindore”, të zbatuar nga IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës), në bashkëpunim me BfN dhe partnerët vendorë dhe të financuar nga Ministria Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore (BMU) përmes Agjencisë Federale Gjermane të Mjedisit (UBA).

Pjesa JugPerëndimore e Gadishullit Ballkanik është një pikë e nxehtë e biodiversitetit global. Zonat kufitare në këtë pjesë të Evropës përfaqësojnë disa prej rajoneve natyrore që kanë mbetur të fundit të paprekura. Këto zona janë jo vetëm një e mirë e përbashkët, por edhe një përgjegjësi e përbashkët. Natyra dhe ruajtja e natyrës nuk njihen kufij politikë dhe administrativë. Në ditët e sotme, shumë shembuj na tregojnë për përfitimet që mund të krijojë bashkëpunimi ndërkufitar në ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve vendore, zbutjen e tensioneve dhe rikrijimin e mardhënieve të fqinjësisë së mirë. Ne i mirëpresim rezultatet e projektit që synojnë rritjen e kapaciteteve të aktorëve që punojnë në ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit trepalësh mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Nisur nga këndvështrimi shumë pozitiv i komenteve të aktorëve në lidhje me rezultatet e këtij projekti, ne besojmë me të vërtetë se ky botim do të kontribuojë në promovimin e praktikave më të mira të ruajtjes ndërkufitare të natyrës dhe do të përdoret si mjet mbështetës në veprimtaritë ruajtëse së këtij rajoni të rëndësishëm në të ardhmen.

Prof. Dr. Beate Jessel  
President, Agjencia Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës (BfN)

# Parathënie

nga Maja Vasilijević dhe Tomasz Pezold

Gadishulli Ballkanik dhe veçanërisht pjesa malore jugperëndimore e tij, konsiderohet si qendra e shumëllojshmërisë biologjike dhe endemike për Evropën. Ekosistemet pyjore në shumë raste i kanë 'mbijetuar' ndikimit njerëzor, duke ruajtur disa nga popullatat më të mëdha evropiane të mishngrënësve të mëdhenj (ariu, ujku, rrëqebulli). Një prej zonave të fundit të egra në Evropë është zona e kufirit malor mes Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi, e cila është pjesë e Brezit të Gjelbër Evropian. Përpjekjet për nxitjen e ruajtjes ndërkufitare të natyrës janë mbështetur dhe plotësuar nga partnerët ndërkombëtarë si IUCN, e cila ka zbatuar një numër veprimtarish që synojnë përmirësimin e bashkëpunimit trepalësh si pjesë e projektit "Ecje në natyrën e egër, ngritje kapacitetesh dhe forcim bashkëpunimi për të promovuar ruajtjen e natyrës në Brezin e Gjelbër të Evropës JugLindore". Kapitulli 1 i dedikohet sfondit të projektit dhe shpjegon se disa zona të mbrojtura brenda këtij rajoni trepalësh janë krijuar kohë më parë, ndërsa të tjerat që e bëjmë të plotë 'pamjen' për këtë ekosistem janë ende në proces planifikimi. Përmes këtij botimi synohet të rritet shkalla e ndërgjegjësimit lidhur me vlerat e aktivitetit ndërkufitar të ruajtjes së natyrës, duke e vënë theksin në përfitimet që gjeneron bashkëpunimi duke mos lënë mënjanë sfidat dhe problemet që ndeshin palët, kur përfshihen në nisma të tilla ndërkufitare bashkëpunimi. Partnerët e IUCN-së që kanë marrë pjesë në zhvillimin e këtij bashkëpunimi janë: Komisioni Botëror për Zonat e Mbrojtura – Grupi i Specialistëve të Ruajtjes Ndërkufitare, i cili shpresojmë t'ju shërbejë gjerësisht vendimmarrësve dhe zbatuesve të përfshirë në aktivitetet ndërkufitare të ruajtjes, veçanërisht në zonën trepalëshe Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Kapitulli 2 shpjegon evoluimin e praktikave ndërkufitare të ruajtjes në shkallë të gjerë sipas përkufizimeve dhe tendencave globale. Kapitulli i 3të paraqet një sfond të përgjithshëm të Nismës së Brezit të Gjelbër Evropian, e cila përfshin kontinentin dhe njihet gjerësisht si një prej nismave më të rëndësishme ndërkufitare të ruajtjes së natyrës në nivel rajonal. Kapitujt e tjerë i kushtohen 14 rasteve studimore nga Evropa, një prej të cilave fokusohet specifikisht në vlerën ekonomike të zonave të mbrojtura (Parku Kombëtar i Pyllit të Bavarisë). Në të gjitha rastet studimore paraqitet bashkëpunimi ndërkufitar, pavarësisht nëse është nxitur nga marrëveshjet qeveritare të nivelit të lartë, personelit të zonave të mbrojtura apo organizatave joqeveritare. E përbashkëta mes të gjitha rasteve studimore të paraqitura qëndron në natyrën sfiduese të krijimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit përtej kufijve shtetërorë. Kapërcimi i shumë barrierave që paraqet aktiviteti ndërkufitar i ruajtjes së natyrës kërkon përpjekje mbi dhe përtej veprimtarive 'normale' që zhvillohen brenda kufijve shtetërorë dhe kur eksplorojnë rrugët për bashkëpunim efektiv, zonat e mbrojtura krijojnë përfitime të shumta në sferën ekonomike, sociale dhe politike. Këto përfitime përvijohen më tej në kapitullin 16.

Ky botim është përkthyer në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe për të bërë të mundur përdorimin më të gjerë të tij në vendet ku janë zbatuar projekte të IUCN-së. Rastet studimore të praktikave më të mira nga Evropa, do të shërbejnë për të dhënë shembuj të vlefshëm mbi rrugët që çojnë në nxitjen e aktivitetit ndërkufitar të ruajtjes së natyrës sigurojnë bashkëpunim të mirë dhe, mbi të gjitha, vlerat e një qasjeje të tillë në menaxhimin e natyrës.

# Falenderime

Dëshirojmë të falenderojmë Agjencinë Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës (*BfN*) për mbështetjen bujare që i ka dhënë publikimit të këtij produkti. Financimi që u dha përmes *BfN* dhe Ministrisë Federale Gjermane të Mjedisit, Ruajtjes së Natyrës dhe Sigurisë Atomike dhe Agjencisë Federale Gjermane të Mjedisit, është në kuadër të Programit Këshillimor të Ndihmës për Mbrojtjen Mjedisore në Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, Kaukaz dhe Azinë Qendrore.

Shprehim vlerësimin tonë shumë të madh për punën e gjithë autorëve që kanë zhvilluar rastet studimore, të paraqitura në këtë botim: Giorgio Andrian, Robert Brunner, Stanka Dešnik, Katharina Diehl, Gregor Domanjko, Bernhard Harrer, Gjorgji Ivanov, Aleksandar Ivanovski, Hubert Job, Hans Kiener, Zdenka Krenova, Alois Lang, Marius Mayer, Daniel Metzler, Martin Müller, Zbigniew Niewiadomski, Hana Petrikova, Dimitar Popov, Spase Shumka, Annette Spangenberg, Andrea Strauss, Marina Trusova dhe Manuel Woltering.

Përmbajtja e këtij botimi është shqyrtuar nga Martin Šolar, Drejtor i Parkut Kombëtar, Triglav në Slloveni, Kryetar i Komitetit Vëzhgues dhe Vlerësues të Federatës Ndërkufitare të EUROPARCUT dhe Anëtar i Komisionit Botëror të IUCN-së për Zonat e Mbrojtura – Grup Specialistësh për Ruajtjen Ndërkufitare. Shprehim mirënjohjen tonë të madhe për kontributin e tij në lidhje me këtë botim.

Komente të vlefshme të drafteve të para të këtij materiali dhe mbështetje për zbatimin në tërësi të projektit është dhënë nga Florian Carius, Koordinator Projekti në BfN, Katharina Lenz, Koordinatore Projekti në UBA. Gjithashtu, u jemi mirënjohës partnerëve të projektit me të cilët u bashkëpunua për prodhimin e këtij botimi: REC Shqipëri, Lëvizja e Ekologjistëve Maqedoni dhe REC Kosovë.

Së fundi, do të deshëm të falenderonim Linda Zanella, Igor Stefanoski dhe Edlira Kovaçin, të cilët përkthyen dhe redaktuan materialin me profesionalizëm si dhe Mihallaq Qirjo dhe Eduart Cani për ndihmesën e tyre në redaktimin shkencor të materialit në gjuhën shqipe.

# Shkurtime

|      |  |        |  |
|------|--|--------|--|
| A    | Austria  | NP     | Park Kombëtar  |
| BFNP | Parku Kombëtar i Pyllit të Bavarisë  | OeNB   | Shoqata Austriake për Ruajtjen e Natyrës                             |
| BfN  | Agjencia Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës                                    | PA     | Zonë e Mbrojtur  |
| BMU  | Ministria Federale Gjermane për Mjedisin, Ruajtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore | PEEN   | Rrjeti Ekologjik Pan-Evropian,                                       |
| BR   | Rezervë e Biosferës  | KE     | Këshilli i Evropës   |
| CAP  | Politika e Përbashkët Bujqësore  | PPCC   | Komiteti për Koordinimin e Parkut të Prespës                         |
| CBD  | Konventa për Shumëllojshmërinë Biologjike  | PPNEA  | Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri (OJF)            |
| CBC  | Programi Ndërkufitar i Bashkëpunimit i BEsë  | PL     | Poloni   |
| CEPA | Strategjia e Komunikimit, Edukimit dhe Ndërgjegjësimit Publik                        | PoWPA  | Programi i Punës për Zonat e Mbrojtura                               |
| CIC  | Këshilli Ndërkombëtar për Ruajtjen e Kafshëve të Gjuetisë dhe Botës së Egër          | REC    | Qendra Rajonale e Mjedisit   |
| CZ   | Republika Çeke   | SAC    | Zona të Posaçme të Ruajtjes (Direktiva e Shpendëve)                  |
| DAI  | Nisma e Harkut Dinarik   | SAP    | Plani Strategjik i Veprimit  |
| DEM  | Lëvizja e Ekologëve të Maqedonisë  | SDC    | Agjencia Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim                       |
| DMZ  | Zonë e Demilitarizuar  | SEE    | Evropa JugLindore  |
| EEA  | Zonë Evropiane Ekonomike   | SIDA   | Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim                          |
| EEA  | Agjencia Evropiane e Mjedisit  | SK     | Slovaki  |
| EEC  | Komuniteti Ekonomik Evropian, i ri-emërtuar Komuniteti Evropian (EC) në 1993         | SNV    | Organizata Hollandeze për Zhvillim                                   |
| EC   | Komisioni Evropian   | SPA    | Zona të Posaçme të Mbrojtura (Direktiva e Habitave)                  |
| EC   | Komuniteti Evropian  | SPP    | Shoqata për Mbrojtjen e Prespës                                      |
| ECBC | Fondacioni për Ruajtjen e Biodiversitetit të Karpateve Lindore                       | ŠNP    | Parku Kombëtar Šumava  |
| ECBR | Rezerva e Biosferës e Karpateve Lindore  | TBCA   | Zona Ndërkufitare të Ruajtjes  |
| ECNC | Qendra Evropiane për Ruajtjen e Natyrës  | TBC SG | Grupi i Specialistëve të Ruajtjes Ndërkufitare                       |
| ENPI | Instrumenti i Partneritetit dhe Fqinjësisë në Evropë                                 | TBR    | Rezervë Ndërkufitare e Biosferës                                     |
| EU   | Bashkimi Evropian  | TDA    | Analiza e Diagnozës Ndërkufitare                                     |
| EuGB | Brezi i Gjellbër Evropian  | UA     | Ukrainë  |
| EUR  | Euro, monedha zyrtare e eurozonës  | UBA    | Agjencia Federale e Mjedisit të Gjermanisë                           |
| FAO  | Organizata për Bujqësinë dhe Ushqimin e Kombeve të Bashkuara                         | UN     | Kombet e Bashkuara   |
| GEF  | Fondi Global për Mjedisin  | UNDP   | Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara                        |
| GDR  | Republika Demokratike e Gjermanisë   | UNEP   | Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin                         |
| GIS  | Sistemi Gjeografik i Informacionit   | UNESCO | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën |
| GPS  | Sistemi global i vendodhjes  | VAT    | Taksa mbi vlerën e shtuar  |
| HEP  | Fuqia hidro-elektrike  | WCMC   | Qendra Botërore për Monitorimin e Ruajtjes                           |
| IAPA | Zona të Mbrojtura të Njohura Ndërkombëtarisht  | WCPA   | Komisioni Botëror i Zonave të Mbrojtura                              |
| IBA  | Zonat të Rëndësishme për Shpendët  | WWF    | Fondi Mbarë Botëror për Natyrën                                      |
| IGO  | Organizata Ndërkombëtare Qeveritare  |        |  |
| IPA  | Instrumenti i ndihmës së para-anëtarësimit   |        |  |
| ISCC | Sekretariati i Ndërmjetëm i Konventës së Karpateve                                   |        |  |
| IUCN | Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës   |        |  |
| KfW  | (Kreditanstalt für Wiederaufbau) Instituti i Kredisë për Rindërtim                   |        |  |
| MAB  | Programi „Njeriu dhe Biosfera“ i UNESCOs   |        |  |
| MCWG | Grupi i Punës për Monitorimin e Ruajtjes   |        |  |
| MES  | Shoqata Maqedonase e Ekologëve   |        |  |
| NATO | Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior  |        |  |
| NGO  | Organizatë JoQeveritare  |        |  |

# 1. Hyrje – Projekti dhe sfondi i përgjithshëm

Tomasz Pezold<sup>1</sup>

## Objektivat e projektit

“Shëtitje në natyrën e egër”. Rritja e kapaciteteve dhe forcimi i bashkëpunimit për promovimin e ruajtjes ndërkufitare të natyrës, përgjatë Brezit Evropian Juglindor” është një projekt që zbatohet nga IUCN, në bashkëpunim me Agjencinë Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës (BfN) dhe në bashkëpunim të ngushtë me Lëvizjen Maqedonase të Ekologjistëve (DEM), REC Shqipëri dhe REC Kosovë. Aktivitetet e projektit zbatohen në zonën e kufirit mes tre vendeve, Kosovë<sup>2</sup>, Shqipëri dhe Maqedoni<sup>3</sup>, e cila karakterizohet nga biodiversiteti i pasur dhe vlera të peizazhit në rajonin e maleve

1. Rritje kapacitetesh për aktorët e përfshirë në veprimtaritë për menaxhimin e biodiversitetit në zonën e kufirit mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë;
2. Forcimi i bashkëpunimit ndër-sektorial dhe ndërkombëtar për ruajtjen e biodiversitetit;
3. Ngritja e ndërgjegjësimit të aktorëve kryesorë dhe shoqërisë civile në lidhje me vlerat e ruajtjes së trashëgimisë natyrore.

## Mali i Sharrit në Brezin e Gjelbër Evropian

Pjesa jugperëndimore e Gadishullit Ballkanik është një pikë e nxehtë nga pikëpamja e biodiversitetit. Zonat e larta malore janë të pasura me shumëllojshmëri bimore dhe rajoni është



© IUCN / Tomasz Pezold

të Sharrit/Šar dhe Korabit. Aktorët kryesorë të përfshirë në projekt janë zyrtarë nga qeveritë e tre vendeve, përfaqësues nga OJQ-të, institucionet shkencore, administratorët e zonave të mbrojtura dhe policia e kufirit. Projekti synon forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar të ruajtjes së natyrës, përmes disa objektivash afatshkurtër:

një nga habitatet e fundit të mbetura për mishngrënësit e mëdhenj, si ariu, ujku dhe rriqebuli. Zonat kufitare janë ruajtur rreptësisht për dekada me radhë, duke krijuar në seksione të caktuara një nga barrierat më përçarëse në histori. Sot, këto zona përfaqësojnë disa nga zonat natyrore më të paprekura. (Harta 1).

Mali i Sharrit<sup>4</sup> shtrihet në Kosovën jugore dhe Maqedoninë veriperëndimore deri në verilindje të Shqipërisë. Sistemi malor është rreth 80 kilometra i gjatë dhe 10 deri 30 kilometra i gjerë. Ai përfshin disa maja të larta, ku më e larta është *Titov*

<sup>1</sup> Drejtues i projektit për ekosistemet, Zyra e Programit për Evropën Juglindore, IUCN

<sup>2</sup> Për qëllimet e këtij botimi, emri Kosovë i referohet territorit nën Misionin e përkohshëm administrues të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, krijuar në 1999 nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit e OKBsë.

<sup>3</sup> Emri Maqedoni i referohet Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë

<sup>4</sup> Shqip: Malet e Sharrit. Maqedonisht: Шар Планина, Serbisht: Šar planina .

Vrv, e cila arrin lartësinë 2,747 m. Mali i Sharrit shtrihet deri në malin e Korabit (2,764 m) në jugperëndim, para se të vijojë përtej kufirit Shqipëri/Maqedoni, i njohur si vargmali *Dešat/Deshat*.

Brezi i Gjellbër Evropian<sup>5</sup> (EuGB) është një nismë me rëndësi të veçantë për këtë rajon, që shtrihet në 13,000 km tokë pas ish-Perdes së Hekurt, nga deti Barent në veri deri në Detin e Zi dhe Adriatik në jug. Me vizionin për ta kthyer EuGB në shtyllë të rrjetit ekologjik, ai është simbol i bashkëpunimit ndërkufitar për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Në nivel lokal, Mali i Sharrit është një shembull i vërtetë i asaj që EuGB synon të arrijë. Vlera ekologjike e Malin të Sharrit ka mbatur tepër e vecnate, si pasojë e kontrolleve të rrepta të kufirit në të shkuarën dhe maleve e terrenit malor të pakalueshëm. Objektivat kryesore të punës për vitet e ardhshme do të jenë mbrojtja e kushteve dhe vlerave ekzistuese ekologjike, veçanërisht për mishngrënësit e mëdhenj të rajonit dhe të sigurojë menaxhim të integruar e bashkëpunues, si dhe zbatimin e planeve të zhvillimit përmes kufijve tashmë të hapur.

### Situata e zonave të mbrojtura

Përpjekjet e para për të mbrojtur vlerat natyrore në rajon, filluan në Maqedoni (në kohën e Jugosllavisë) me shpalljen e *Mavrovës*, Park Kombëtar në vitin 1949. Duke mbuluar një sipërfaqe prej 73,088 ha dhe i kufizuar nga Shqipëria dhe Kosova, ky është parku më i madh ndër tre parqet kombëtare të Maqedonisë.

Parku i parë Kombëtar që synonte mbrojtjen e Malit të Sharrit, u krijua në territorin e Kosovës (në kohën e Jugosllavisë) në vitin 1986. Parku kombëtar, i cili mbulon një sipërfaqe rreth 39,000 ha, përfundon në kufirin administrativ me Maqedoninë dhe në kufirin administrativ mes dy komunave në Kosovë.

Megjithëse në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë një progres të dukshëm drejt zhvillimit të rrjetit të zonave të mbrojtura, shpallja e zonës së mbrojtur përgjatë kufirit me Kosovën dhe Maqedoninë mbetet akoma në fazën e planifikimit.

### Perspektiva për të ardhmen – drejt një korridori ndërkufitar ekologjik

Pas realizimit për vite me radhë të veprimtarive të pakoordinuara për ruajtjen e natyrës përtej kufijve, perspektiva për të ardhmen duket premtuese. Së fundi, qeveria e Maqedonisë deklaroi qëllimin e saj për ta shpallur park kombëtar sipërfaqen prej 48,000 ha të Malit të Sharrit. Kjo zonë gjendet pranë Parkut Kombëtar ekzistues të

Mavrovës dhe lidhet me Parkun Kombëtar të Sharrit në Kosovë. Ky është një hap pozitiv përpara, përse i përket ruajtjes ndërkufitare dhe mbrojtjes integrale të ekosistemit të Sharrit.

Një nismë e rëndësishme e Maqedonisë synonte përmirësimin e koherencës të rrjetit të zonave të mbrojtura në kontekstin ndërkufitar me shpalljen e Parkut Kombëtar të *Jablanicës* që kufizohej me Shqipërinë. Në bashkëpunim me partnerët shqiptarë, për shpalljen e zonës park kombëtar, malet Jablanica/Shebenik përbëjnë një zonë tjetër ndërkufitare të rëndësishme në rajon.

Megjithëse Parku Kombëtar i Sharrit në Kosovë po përballlet me shumë sfida lidhur me menaxhimin, financimet dhe presionet e jashtme që ushtrohen në mjedis, ai shihet si bazë e rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm në një rajon të prekur nga varfëria, papunësia e lartë dhe emigracioni i popullsisë vendase. Së fundi, është ndërmarrë një nismë për zgjerimin e parkut ekzistues në komunën e *Dragashit/Dragaš* që është mbështetur gjerësisht nga komunitetet vendore multi-etnike (*Harta 2*).

Ndërsa pjesa maqedonase e maleve të Korabit dhe *Deshatit/Dešat* shtrihet e tëra brenda Parkut Kombëtar të Mavrovës, pjesa shqiptare nuk është akoma e mbrojtur. Megjithatë, qeveria e Shqipërisë ka përgatitur një propozim për emërtimin e zonës së Korabit, "Peizazh të mbrojtur", me një sipërfaqe mbi 30,000 ha të kufizuar nga Kosova dhe Maqedonia. Shpallja zyrtare parashikohet të bëhet deri në vitin 2012.

Nëse gjithë nismat e propozuara që lidhen me krijimin e zonës ndërkufitare të mbrojtur të maleve *Sharrë/Šar* - Korab - *Deshat/Dešat*, mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë do të bëhen realitet, zona do të mbulojë një sipërfaqe më të madhe se 250,000 ha<sup>6</sup> dhe do të kthehet në një nga parqet kombëtare më të mëdha të Evropës. Së bashku me parqet fqinje të Mavrovës dhe Jablanicës dhe të zonave të mbrojtura që pritet të shpallen në trekëndëshin mes Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës, ky rajon do të kthehet në korridorin ekologjik më funksional dhe më të mbrojtur ekologjik të maleve evropiane.

<sup>5</sup> [www.europeangreenbelt.org](http://www.europeangreenbelt.org)

<sup>6</sup> Studimi i leverdisshmërisë për krijimin e një zone ndërkufitare të mbrojtur Sharrë/Šar Planina - Korab - Dešat/Deshat. UNEP Vienië - ISCC, 2010

## 2. Veprimtaritë Ndërkufitare të Ruajtjes – Konteksti Global

Maja Vasiljević<sup>1</sup>

### Hyrje

Plachter reklamoi (në 2005) *“se ideja e kapërcimit të kufijve në zona apo programe të përbashkëta të mbrojtjes është një nga më fisniket dhe më bindëset në ditët e sotme.” Globalizimi është një ndër tiparet më të rëndësishme të botës së sotme, i cili ndodh përmes përhapjes së teknologjisë, tregut, transportit, ideve, komunikimit dhe aspekteve të tjera, të ndryshme. Duke*

botimi i Strategjisë Botërore të Ruajtjes, IUCN, WWF dhe UNEP në 1980 dhe Samiti i Tokës në 1992 në Rio de Janeiro, i cili miratoi edhe Konventën mbi Shumëllojshmërinë Biologjike). Njerëzit janë pjesë e proceseve në ekosistemet dhe kanë një rëndësi të jashtëzakonshme, përsa i përket bashkëveprimit me natyrën. Gjatë këtyre dekadave, duket se kjo gjë ka filluar të reflektohet në rolin që luajnë zonat e mbrojtura, përmes njohjes së vlerave dhe përfitimeve social-ekonomike (Phillips 2003). Periudha nga fundi i viteve 1980, ishte gjithashtu një kohë kur nismat ndërkufitare të ruajtjes në shkallë globale,



© Maja Vasiljević

*ndjekur ecurinë e kësaj tendence globale në lidhje me rritjen e komunikimit dhe rrjetëzimeve, natyra gjithashtu ka gjetur një mënyrë për të lëvizur barrierat mes kufijve shtetërorë ndërkombëtarë, e cila po çon në shkëmbimin e ideve dhe menaxhimin bashkëpunues”.*

Rritja e numrit të zonave, që janë emërtuar zyrtarisht si zona të mbrojtura është e dukshme, veçanërisht në gjysmën e dytë të shekullit të 20të. Megjithëse shqetësimi njerëzor për botën e egër dhe natyrën i ka rrënjët thellë në histori, perceptimi i njerëzve mbi rolin e zonave të mbrojtura ka ndryshuar në mënyrë dramatike dhe ka evoluar paralelisht me ngjarjet e tjera globale (p.sh. Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Zhvillimin dhe Mjedisin në 1972 në Stokholm,

bashkëpunimi përtej kufijve ndërkombëtarë dhe përmirësimi i marrëdhënieve diplomatike filluan të rriten dukshëm (p.sh. IUCN, Federata EUROPARK, Fondacioni i Paqes, Programi Arsimor i Kombeve të Bashkuara, Organizata Shkencore dhe Kulturore (UNESCO), etj.), përfshi edhe agjencitë e tjera financuese që kanë mbështetur krijimin e zonave të reja ndërkufitare të ruajtjes (TBCA)<sup>2</sup>.

Pas Konferencës Ndërkombëtare për Zonat e Mbrojtura Ndërkufitare – Makina lëvizëse për Bashkëpunimin Ndërkufitar (1997, Somerset West, Afrikë e Jugut), gjatë së cilës u bë i njohur kontributi që japin zonat ndërkufitare të ruajtjes në nxitjen e paqes dhe të stabilitetit, u zhvillua

<sup>1</sup> Drejtues i Grupit të Ekspertëve për Mbrojtjen Ndërkufitare të IUCN WPCA, Kroaci.

<sup>2</sup> Në këtë punim, TBCAtë i referohen çdo lloj nisme ndërkufitare të ruajtjes, si: zonat ndërkufitare të mbrojtura, parqet për paqe, zonat e ruajtjes dhe zhvillimit ndërkufitar dhe korridoret ndërkufitare migratore (Sandwith et al. 2006).

Kongresi i V-të i Parqeve Botërore të IUCNs (2003, Durban, Afrikë e Jugut) me temë *Përfitimet Përtej Kufijve, ku nismat ndërkufitare të ruajtjes zunë vendin kryesor*. Prezantimet dhe takimet e ndryshme që u mbajtën në Kongresin e Parqeve Botërore, nga rryma, rreth temave, apo gjatë sesioneve të ndryshme çuan në përfshirjen e konsideratës ndërkufitare të ruajtjes së natyrës, në rezultatet përfundimtare të Kongresit: Marrëveshja e Durbanit, Plani Durban i Veprimit dhe Mesazhi për Konventën e Shumëllojshmërisë Biologjike (CDB).

Konferenca e 7të e Palëve të Konventës për Shumëllojshmërinë Biologjike, që u mbajt në 2004 në Kuala Lumpur, Malajzi, përshtati Programin e Punës për Zonat e Mbrojtura (PoWPA), një udhëzues i plotë mbi qëllimet dhe objektivat e matshme të zonave të mbrojtura<sup>3</sup>. Komisioni Botëror i IUCN për Zonat e Mbrojtura (WCPA) ishte një nga zhvilluesit kryesorë të PoWPA, përmes së cilës Shtetet që janë Palë e CBD nxiten, ndërmjet të tjerash, të bashkëpunojnë për krijimin e Zonave Ndërkufitare të Mbrojtura (TBPA), të caktojnë kufijtë e rinj të zonave detare ndërkufitare, të zhvillojnë politika favorizuese që krijojnë mjedisin e përshtatshëm social-ekonomik për zonat ndërkufitare të mbrojtjes dhe të zhvillojnë standardet udhëzuese dhe kuadrin e nevojshëm për monitorimin e tyre (Konventa për Shumëllojshmërinë Biologjike 2004). Sekretariati i kësaj konvente shqyrtoi ecurinë e zbatimit të PoWPA, duke vënë në dukje se dispozitat lidhur me veprimtaritë ndërkufitare të ruajtjes kishin arritur një shkallë 'të mjaftueshme, deri të mirë' progresi (IUCN WCPA 2010). Vlerësimi u bë duke u bazuar në rritjen e numrit të zonave ndërkufitare të mbrojtura dhe llojet e bashkëpunimit. Rritja e numrit të komplekseve ndërkufitare do të trajtohet më poshtë, më në detaje, por së pari është e rëndësishme të qartësojmë çfarë përfaqëson veprimtaria ndërkufitare e ruajtjes.

### **Përcaktimi i veprimtarisë ndërkufitare të ruajtjes**

Nëpër botë ndeshen terminologji të ndryshme, që përdoren si referencë për praktikën ndërkufitare të ruajtjes. Kjo gjë është çorientuese dhe krijon shpesh konfuzion përse i përket objektivave të një zone të veçantë ndërkufitare. Disa nga termat e përdorur janë 'zona ndërkufitare të mbrojtura' 'zona për menaxhimin e burimeve natyrore ndërkufitare të mbrojtura', 'parqe paqeje', 'parqe për paqe', 'zona ndërkufitare të ruajtjes' dhe emërtime të tjera të ngjashme. IUCN ka udhëhequr punën në mbledhjen/grumbullimin e ekspertëve për të dhënë një terminologji të standardizuar përse i përket praktikave ndërkufitare të ruajtjes. Si rezultat i takimeve që u mbajtën në Bormio, Itali në 1997 dhe në Gland, të Zvicrës në 2000, IUCN botoi një udhëzues të titulluar 'Zonat ndërkufitare të mbrojtura për paqe dhe bashkëpunim', në të cilin jepej përkufizimi për zonën ndërkufitare të mbrojtur dhe sugjeroheshin 'hapat' kryesore të nevojshme për zhvillimin e

nismave ndërkufitare të ruajtjes (Sandwith et al. 2001). Puna ka vazhduar, ndërkohë që nismat ndërkufitare të ruajtjes nëpër botë ndryshojnë dhe evoluojnë vazhdimisht sikundërse rritet edhe kompleksiteti i praktikave zbatuese në TBPA. Për të arritur objektivat ndërkufitare të ruajtjes, nevojiten qartësi dhe udhëzime të mëtejshme, pavarësisht nëse nismat lidhen me ruajtjen e biodiversitetit, shkëmbimin kulturor, integrimin ekonomik rajonal, integrimin ose promovimin e paqes, apo me aspekte të tjera.

Në 2003, IUCN dhe Organizata Ndërkombëtare për Lëndën Drusore të Tropikut (ITTO) organizoi në Tailandë, një takim që synonte zhvillimin e propozimeve mbi tipologjinë ndërkufitare të ruajtjes. Diskutimi i Tailandës u ndoq nga debate të tjera gjatë takimit që u zhvillua në ishullin La Maddalena, Itali në Maj 2004. Më në fund, në 2006 nën drejtimin e IUCN u sugjerua<sup>4</sup> një tipologji e plotë që përfshinte praktikën e ndryshme ndërkufitare të ruajtjes, si vijon<sup>5</sup>:

#### *Zonat Ndërkufitare të Mbrojtura*

Sandwith et al. (2001) e përkufizon TBPA si "një zonë toke dhe/ose deti që shtrihet në një apo disa kufijtë përbashkët mes shteteve, njërive nën-shtetërore, si provincat dhe rajonet, zonave autonome dhe/ose zonave përtej kufijve të sovranitetit apo juridiksionit, palët përbërëse të së cilës i kushtohen veçanërisht mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së shumëllojshmërisë biologjike dhe burimeve natyrore e kulturore shoqëruese, si dhe që menaxhohen në mënyrë bashkëpunuese përmes mjetesh ligjore apo mjetesh të tjera, të efektshme". Kjo lloj praktikë ndërkufitare e ruajtjes është një nga më të përdorshmet në gjithë botën dhe sigurisht është ajo çka ju vjen njerëzve në mendje kur dëgjojnë të flitet për zona ndërkufitare të mbrojtura. Normalisht, këto zona janë të mbrojtura dhe gjenden pranë kufijve kombëtarë (p.sh. Liqeni Fertő-Neusiedler në Hungari dhe Austri). Përkufizimi gjithashtu përfshin kufijtë mes nën-njërive në nivel vendi, për të evidentuar përpjekjet që bëhen në kapërcimin e kufijve administrativë të provincave në marrjen e nismave ndërkufitare të ruajtjes.

#### *Parqet e paqes*

Përkufizohen si "zona ndërkufitare të mbrojtura që i kushtohen mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së shumëllojshmërisë biologjike dhe burimeve natyrore e atyre kulturore shoqëruese, si dhe promovimit të paqes dhe bashkëpunimit". Parqet për Paqe përfshijnë një objektiv të veçantë të nismës, si p.sh promovimin e paqes (Sandwith et al. 2001). Pavarësisht nëse ruhen marrëdhëniet e mira historike (siç është rasti i Parkut Ndërkombëtar të Paqes *Waterton-Glacier*, mes SHBAsë dhe

<sup>3</sup> Afati për arritjen e objektivave të PoWPA ishte 2010 përse i përket zonave tokësore të mbrojtura dhe 2012 për zonat detare.

<sup>4</sup> Zonat Ndërkufitare të Mbrojtura dhe Parqet për Paqe u përkufizuan më herët nga IUCN, në 2001, siç përmendet tek Sandwith et al. (2001). Në 2005 u shtuan dhe dy lloje të tjera, duke e çuar në katër lloje numrin e praktikave ndërkufitare të ruajtjes.

<sup>5</sup> Grupi i Specialistëve Ndërkufitarë të Ruajtjes IUCN WCPA po punon për shtrirjen e përkufizimeve mbi llojet e praktikave ndërkufitare të ruajtjes sipas përcaktimit aktual të IUCN për zonat e mbrojtura (siç përvijohet në Dudley, N. (Ed.) 2008).



© Charles Besançon

Kanadasë) apo sigurohen marrëdhënie të qëndrueshme pas një konflikti të armatosur (p.sh. *Cordillera del Cóndor* mes Ekuadorit dhe Perusë), Parqet për paqe<sup>6</sup> dhe objektivat që mbështesin këtë koncept kontribuojnë në mënyrë të përsosur në ndërtimin e mirëkuptimit, besimit dhe marrëdhënieve të miqësisë mes palëve të përfshira.

#### Zonat ndërkufitare të zhvillimit dhe ruajtjes

Sandwith et al. (2006) e përkufizon këtë lloj nisme ndërkufitare të ruajtjes si *“një zonë toke dhe/ose deti që shtrihet në një apo disa kufij të përbashkët mes shteteve, njërive nën-shtetërore, si provincat dhe rajonet, mes zonave autonome dhe/ose zonave përtej kufijve të sovranitetit apo juridiksionit, palët përbërëse të së cilës formojnë një matricë që kontribuon në mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të burimeve natyrore e atyre kulturore shoqëruese, në promovimin e zhvillimit social ekonomik dhe që menaxhohen në mënyrë bashkëpunuese përmes mjetesh ligjore apo mjetesh të tjera të efektshme”*. Karakteristika kryesore e Zonës Ndërkufitare të Ruajtjes dhe Zhvillimit është kombinimi i praktikës ruajtëse me zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshirja e tyre e integruar brenda kuadrit bashkëpunues. Qëllimi i kësaj lloj nisme është që të sigurojë përfshirjen dhe mbështetjen aktive të komuniteteve vendase në veprimtaritë ruajtëse të një zone specifike, siç është rasti i Zonës së Ruajtjes dhe Zhvillimit Ndërkufitar<sup>7</sup> të *Maloti Drakensbergut* (MD TFCD), përkatësisht në Lesotho dhe Afrikë e Jugut, ku aktorët e përfshirë në programin MD TFCD përgatitën një strategji 20 vjeçare për zonën, që fillonte nga viti 2008. Në strategjinë u integruan aspektete të ndryshme që lidheshin me mënyrën e jetesës në komunitetet vendase, e cila u përkthye në një plan 5 vjeçar pune (Zunckel 2007).

#### Korridoret ndërkufitare të migrimit

Korridoret ndërkufitare të migrimit janë *“zona toke dhe/ose deti në dy apo më shumë vende, të cilat jo domosdoshmërisht janë afër njëra tjetrës, por kërkohet të lidhen me një shteg*

*biologjik, migrator kalimi dhe ku menaxhimi bashkëpunues është siguruar përmes mjetesh ligjore ose mjetesh të tjera të efektshme”* (Sandwith et al. 2006). Si shembuj të mirë të kësaj praktike ndërkufitare të ruajtjes, e cila normalisht përfshin disa vende, janë Brezi i Gjelbër Evropian dhe Korridori Biologjik Meso-Amerikan, i cili mbron shtigjet migratore të llojeve të ndryshme.

Klasifikimi i mësipërm shërben për të ndihmuar ekspertët e ruajtjes dhe specialistët e tjerë në zhvillimin e nismave ndërkufitare. Krahas saj, ekzistojnë edhe përkufizime të tjera, si p.sh TBPA që ofrohet nga Protokollin e Konventës Karpatiane dhe është promovuar nga Federata EUROPARC, në nivel evropian. Sipas këtij përkufizimi, një TBPA konsiderohet zona e mbrojtur në territore që i përkasin dy apo më shumë Palëve, të cilat gjenden në afërsi të kufijve shtetërorë<sup>8</sup>. IUCN e vë theksin qartë në rëndësinë e menaxhimit bashkëpunues (i cili referohet shpesh si menaxhim i përbashkët) në të gjitha llojet e praktikave ndërkufitare të ruajtjes dhe përbën një nga tiparet më të dallueshme të TBPAve, në raport me zonat e mbrojtura që nuk kanë natyrë ndërkufitare. Kështu p.sh një zonë e mbrojtur që i bashkohet fizikisht një zone tjetër të mbrojtur, që është përtej kufirit shtetëror që i ndan të dy territoret, nuk konsiderohet TBPA nëse nuk ekziston një nivel i caktuar bashkëpunimi<sup>9</sup> mes dy zonave të mbrojtura. Bashkë-menaxhimi si proces në të cilin një numër aktorësh diskutojnë në lidhje me përgjegjësitë e menaxhimit të një zone (IUCN 1997), është një nga parakushtet kryesore që duhet përmbushur, me qëllim që zona të mund të konsiderohet ndërkufitare.

Federata EUROPARC krijoi një sistem të vlefshëm për verifikimin dhe certifikimin e *“Parqeve Ndërkufitare që Ndjekin Projektimin e Natyrës”* në Evropë, menjëherë pasi e njoftoi atë publikisht në Kongresin e Vtë të Parqeve Botërore, në 2003. Ky sistem ofron *Kriteret e Standardeve Bazë*, që shërbejnë për të përcaktuar llojin e aktiviteteve të matshme në TBPA-të evropiane, mbi të cilat zbatohen proceset e verifikimit dhe të certifikimit të parqeve. TBPA-të janë një shembull i praktikave të mira ndërkufitare, në të cilat gjejnë vend shumica e *Kritereve të Standardeve Bazë* (p.sh vision i përbashkët, ndërveprim kulturor, monitorim ekologjik, etj)<sup>10</sup>.

#### Tendenca globale

Kornizat ndërkufitare të ruajtjes kanë evoluar krahas ecurisë dhe progresit që ka pësuar riformulimi i mendimit në lidhje me ruajtjen, veçanërisht në lidhje me rolin e zonave të mbrojtura në nivel global. Ne kemi kaluar nga faza fillestare e mbrojtjes së

6 Termi 'Park për paqe' përdoret shpesh për të treguar një zonë të mbrojtur me histori konfliktesh, por nuk ka kuptim ndërkufitar. Kjo është promovuar veçanërisht nga Universiteti për Paqe i Kombeve të Bashkuara, në Kosta Rika.

7 Në Afrikën e Jugut, Fondacioni i Parqeve për Paqe (i krijuar në 1997) përshtati emërtimin Zonë ndërkufitare e ruajtjes, i cili përdoret shpesh në vend të 'Parkut të paqes'.

8 Shiko: Protokollin e „Përdorimit të shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazheve“ në kuadër të Konventës për „Mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Karpateve“, përshtatur në Kiev në 22 Maj 2003, <http://www.carpathianconvention.org>.

9 Për më tepër në lidhje me bashkëpunimin shiko kapitullin 16

10 Për më tepër informacion në lidhje me "Parqet ndërkufitare që ndjekin projektimin e Natyrës" në [www.europarc.org](http://www.europarc.org).

botës së egër në nivel vendor, nëpër ruajtjen e biodiversitetit sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe rëndësisë që kanë vlerat social ekonomike, e deri në krijimin e rrjeteve dhe korridoreve, përmes marrjes në konsideratë të qasjes ndaj ekosistemeve për ruajtjen e natyrës. Një nga konceptet më të fundit që mund të përfshijë ruajtjen ndërkufitare është ruajtja e rrugëve lidhëse, e cila tenton të krijojë lidhje fizike ose të mundësojë vijimin e proceseve dinamike që lidhin mjediset e fragmentuara (Sandwith et al. 2006). Përmes objektivave të tyre të shumëfishtë, TBCAtë luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e biodiversitetit dhe të habitateve, përfshi edhe ato në nivel peizazhi. Gjithashtu ato luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e bashkëpunimit mes vendeve dhe në krijimin e një mjedisi favorizues për përmbushjen e qëllimeve sociale, ekonomike dhe politike.

Disa nga kornizat e përshtatshme për bashkëpunim rajonal janë: Konventa për "Ruajtjen e llojeve migratore dhe kafshëve të egra" (Bon 1979), Konventa e "Shumëllojshmërisë biologjike (CBD)" (Rio de Janeiro 1992), Konventa mbi Ligatinat me rëndësi ndërkombëtare (Ramsar 1971), Konventa për "Mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore" (Paris 1972). E fundit që njihet gjerësisht si Konventa e UNESCOs për "Trashëgiminë botërore", lehtëson deri diku forcimin dhe vazhdimësinë e nismave ndërkufitare të ruajtjes, përmes mekanizmave të saj të raportimit. Megjithatë, ekziston nevoja për përpjekje më të harmonizuara, që angazhojnë procese ndërkufitare bashkëveprimi, para shpalljes së listës me zonat ndërkufitare të trashëgimisë botërore. Në kuadër të programit *Njeriu dhe Biosfera* dhe përmes kuadrit statutor të "Rrjetit botëror të rezervave të biosferës" (BR), UNESCO bëri që BRtë të shihnin përtej objektivave kombëtare duke prezantuar Rezervat ndërkufitare të biosferës. Ekzistojnë edhe korniza të tjera që mbështesin nismat ndërkufitare të ruajtjes (p.sh Konventa e Alpeve). Rëndësia e TBCAve ka tendencë të rritet, sikundërse të njëjtën tendencë ka edhe zmadhimi i sipërfaqes së komplekseve ndërkufitare.

TBCAja e parë, e shpallur zyrtarisht në 1932 është Parku ndërkombëtar i paqes *Waterton-Glacier* (SHBA-Kanada). Inventari i parë i komplekseve ndërkufitare u realizua në 1988 kur IUCN dhe Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara – Qendra Botërore e Monitorimit të Ruajtjes (UNEP WCMC) bashkuan forcat për të bërë një listë të 'parqeve kufitare'. Inventari përfshinte 59 parqe. Që nga vitet 1930, numri i komplekseve ndërkufitare ka pësuar rritje, me një shtim të dukshëm në dy dekadat e fundit (Sandwith et al. 2001). Ndërkohë janë kryer disa vlerësime në nivel global, përkatësisht në vitet 1997, 2001, 2005, dhe më i fundit në 2007<sup>11</sup>. Në metodologjinë

11 Në 1997, vlerësimi ishte pjesë e kërkimit të D. Zbicz dhe M. Green dhe në 2001, D. Zbicz e përditësoi bazën e të dhënave (shih Sandwith et al. (2001). UNEP WCMC bëri edhe vlerësime të tjera. Në vitet 1994 dhe 1999 ato u shtrinë në nivel rajonal (evropian) dhe rezultuan në një listë zonash ndërkufitare.

e secilit prej vlerësimeve kishte ndryshime të vogla. Në 2007, WCMC numëroi 227 TBPA (UNEP WCMC 2007). Në këtë inventar (dhe duke përdorur termin 'TBPA'), WCMC përfshiu zonat e mbrojtura (sipas përcaktimit të IUCN<sup>12</sup>) që ndodheshin pranë kufijve ndërkombëtarë dhe një zone të mbrojtur në vendin fqinj, apo pranë zonave të mbrojtura ndërkombëtarisht (IAPAs). Ky inventar është një mjet dinamik që kërkon përditësim të vazhdueshëm, gjë që nuk është aspak e thjeshtë. Ai gjithashtu kërkon përmirësimin dhe shtrirjen e informacionit sipas standardeve të një baze të dhënash (p.sh nivelet e bashkëpunimit, llojet e marrëveshjeve të bashkëpunimit, etj). IAPAt janë zona të mbrojtura, që gjenden afër TBPave, mes të cilave mungon bashkëpunimi (Mittermeier et al. 2005). Me kalimin e viteve, numri i IAPave është rritur, duke sjellë një zhvillim mjaft pozitiv. Megjithatë, sipas inventarit të 2007, nuk është e mundur të bëhet dallimi mes një TBPaje të 'vërtetë', ku ekziston menaxhimi bashkëpunues dhe IAPave që e kanë mundësinë të përfshihen në TBPA. Ky informacion, krahas disa përshtatjeve të tjera në bazën e të dhënave të TBPave, do të krijonte një mjet akoma më të çmuar për të vlerësuar tendencën globale të rritjes dhe menaxhimit të nismave ndërkufitare të ruajtjes në mbarë botën.

## Perspektiva

Nxjtja e nismave ndërkufitare të ruajtjes dhe krijimi i TBCAve vërehet në të gjithë kontinentet. Ato mund të ndërmerren nga qeveritë, por ka raste kur lehtësohen nga organizatat joqeveritare (OJQtë), organizatat ndërkombëtare dhe/ose personeli dhe menaxherët e zonave të mbrojtura. Ka raste kur grantet dhe asistencat e donatorëve mund të mbështesin zhvillimin e një nisme ndërkufitare. Një numër organizatash në nivel global kanë punuar për hartimin e udhëzimeve për ruajtjen ndërkufitare. Një nga këto organizata është IUCN, veçanërisht *Grupi WPCA i Specialistëve të Ruajtjes Ndërkufitare*<sup>13</sup> (TBC SG), i cili mbështet një rrjet global praktikantësh dhe ekspertësh të ruajtjes ndërkufitare dhe këshillon vendet dhe menaxherët në lidhje me krijimin e TBCAve. UNEP, UNESCO dhe InWent kanë kontribuar që ruajtja ndërkufitare të kuptohet dhe promovohet globalisht. Disa nga organizatat që kanë programe ndërkufitare, në nivel rajonal (ekorajonal) bashkëpunimi janë Federata EUROPARC, WWF, Fondacioni i Parqeve të Paqes, Ruajtja Ndërkombëtare dhe Konservimi i Natyrës (Mittermeier et al. 2005).

12 Përkufizimi i zonës së mbrojtur u përshtat nga Kongresi i IV Botëror për Parqet në Caracas, më 1992, p.sh një zonë e mbrojtur është "një zonë toke dhe/ose deti që i kushtohet në mënyrë të veçantë mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së shumëllojshmërisë biologjike dhe burimeve natyrore e atyre kulturore shoqëruese, si dhe menaxhimin përmes mjeteve ligjore dhe mjeteve të tjera të efektshme"

13 Është krijuar në 1997 si Task Forca e Zonave Ndërkufitare të Ruajtjes, por në 2009 i është ndryshuar emri. Misioni i saj është "të promovojë dhe nxisë praktikant ndërkufitare të ruajtjes për ruajtjen e natyrës, të shërbimeve që ofrojnë ekosistemet dhe të vlerave kulturore, duke promovuar paqen dhe bashkëpunimin mes vendeve, përmes rritjes së nivelit të njohurive dhe kapacitetit për planifikim dhe menaxhim efektiv të zonave ndërkufitare të ruajtjes në përmbushje të Planit Durban të Veprimt dhe Programit CBD të Punës për Zonat e Mbrojtura".

Megjithëse është arritur progres i konsiderueshëm në përvijimin e nismave ndërkufitare të ruajtjes, mbetet ende shumë punë për t'u bërë në promovimin e vlerave dhe përfitimeve dhe në këshillimin e partnerëve kryesorë për menaxhimin e TBCAve. Komunikimi efektiv dhe shkëmbimi i përvojave mundëson përdorimin e praktikave të mira, në kushtet lokale ekzistuese. Lidhja në rrjete e menaxherëve të përfshirë në TBCA duhet përmirësuar me qëllim njohjen dhe shkëmbimin sa më i mirë të përvojave pozitive. Gjithashtu, në kuadër të praktikave ndërkufitare të ruajtjes mbetet nevoja e përcaktimit të përparësive në punën kërkimore. Bazat globale të të dhënave për TBCAtë duhen përditësuar duke përfshirë kategori shtesë, të cilat do t'i lejonin shkencëtarët dhe individët e tjerë të interesuar të bënin krahasime dhe analizonin të dhënat dhe të mësonin nga përvoja botërore. Përkufizimi i IUCN-së për llojet e

praktikave ndërkufitare të ruajtjes ka nevojë 'të përkthehet' në një manual të ri për personelin e zonave të mbrojtura, ku të shpjegohet secila praktikë dhe të plotësohet me udhëzime e sugjerime për krijimin e TBCAve, menaxhimin (p.sh bashkë-menaxhimin) dhe detyrimet ligjore që rrjedhimin prej tyre.

Arritja e momentit dhe miratimi i një vizioni të përbashkët për krijimin e një trashëgimie të përbashkët mes palëve që gjenden në anë të ndryshme të kufijve ndërkombëtarë, kërkon shumë durim, vullnet dhe mirëkuptim. Në kontekstin evropian, *"mundësia për mbrojtjen ndërkufitare të natyrës nuk ka qenë kurrë më e madhe se sot"* (Brunner 1996). Kjo mundësi është kthyer në praktikë, jo vetëm në Evropë, ku BE mundëson komunikim më të lehtë ndërkufitar, por edhe mes shumë vendeve në mbarë botën.



# 3. Nisma e Brezit të Gjelbër – një vështrim retrospektiv lidhur me kalimin e kufijve

Andrea Strauss<sup>1</sup> and Katharina Diehl<sup>2</sup>

## Hyrje

Zonat e mëdha të mbrojtura janë një fenomen i rrallë në Evropën me popullsi të dendur, ku përpjekjet për ruajtjen e tyre përballesh me konflikte për përdorimin e tokës dhe planifikimin e zhvillimit të zonës. Një nga qasjet për ruajtjen e natyrës është krijimi i rrjeteve të zonave të mbrojtura, si parqe kombëtare, rezerva të biosferës, zona të ruajtjes së

përsa i përket hartimit të metodave që kanë të bëjnë me komunikimin, menaxhimin përshtatës të përdorimit të tokës, monitorimin ekologjik dhe social-ekonomik (Lombard et al. 2010). Në kontrast me këtë, Brezi i Gjelbër Evropian është një sistem zonash të ruajtjes që nxitet nga organizata qeveritare dhe joqeveritare (OJQ) dhe kërkues shkencorë, të cilët synojnë zgjedhjen e mënyrave për të vendosur marrëdhënie mes tyre, që siç e quan Engel dhe del Palacio (2009) janë “fije të dobëta, por lidhje të qëndrueshme”. Shtrirja e tyre gjeografike nuk bazohet në aspektet ekologjike, megjithëse



peizazheve dhe korridore ekologjike. Nën frymën e rritjes së ndërgjegjësimit politik dhe të rëndësisë që ka marrë mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit, peizazheve dhe burimeve natyrore me vlerë, numri i zonave të mbrojtura, që janë krijuar në Evropë gjatë 20 viteve të fundit, është i madh.

Përhapja hapësinore e këtyre rrjeteve të mbrojtura bazohet në karakteristikat gjeofizike, siç është rajoni i maleve karstike në Evropën Juglindore (Alpet Dinarike) ose lumi i Danubit (i marrë nën ruajtje me Konventa për Mbrojtjen e Lumit të Danubit), në varësi të ndarjeve administrative dhe mekanizmave rregullatorë. Masat e ruajtjes, pjesëmarrja e aktorëve dhe pranimi i tyre nga popullsia janë shumë të ndryshme dhe janë objekt i një pune të madhe kërkimore,

organizatat që ndjekin Programin e Punës<sup>3</sup>, e reklamojnë si nismën më të mirë për ruajtjen e natyrës në Evropë.

Ky punim synon të shpjegojë rrjetin e zonave të ruajtjes, i cili përbëhet jo vetëm nga disa prej peizazheve kulturore më tradicionale në Evropë, por edhe zona që momentalisht priret të përfshihen në plane intensive zhvillimi. E krijuar në 2003, Nisma e Brezit të Gjelbër Evropian u ngrit mbi trashëgiminë natyrore të Luftës së Ftohtë, por me kalimin e kohës u zhvillua në një nismë aktive ku u përfshinë shumë aktorë dhe më shumë se 400 partnerë. Vizioni i përbashkët është që të ndërtojë shtyllën e rrjetit ekologjik përgjatë ish Perdes së Hekurt, me shtrirje nga deti Barents deri në Detin e Zi dhe atë Adriatik. Kjo nismë është kthyer në një model

<sup>1</sup> Ekolog peisazhi.

<sup>2</sup> Ekolog peisazhi, Qendra për Kërkime të Peisazhit Bujqësor të Leibnicit, Gjermani.

<sup>3</sup> Mund të shkarkohet nga <http://www.europeangreenbelt.org>

pune për bashkëpunimin ndërkuftar për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin rajonal.

Nisma ka qenë objekt i një interesi të madh për mediat në rajon dhe përtej tij, për shkak të historisë unike dhe vizionit të saj. 20 vite pas përmbysjes politike në Evropë, Brezi i Gjelbër Evropian përfaqëson një shembull të shkëlqyer të menaxhimit ndërkuftar dhe bashkëpunimit për mbrojtjen e peizazheve me vlerë. Rëndësia e kësaj nisme qëndron në potencialet politike, sociale dhe ekonomike, siç përshkruhet më në detaje nga Kortelainen (2010).

Objektivi kryesor i këtij punimi është që të japë një pasqyrë të shkurtër të funksioneve dhe strukturës organizative të kësaj nisme, me qëllim që të analizojë disa nga masat e veçanta menaxhuese kundrejt faktorëve të suksesit dhe rreziqeve të dështimit. Punimi diskuton më tej nevojën për avancimin e mëtejshëm të strukturës dhe zbatimit të sipërmarrjeve shumëkombëshe dhe ndërkuftare, në ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin rajonal.

### **Konsolidimi i Nismës së Brezit të Gjelbër**

Kur ish kufiri lindor-perëndimor, një nga barrierat më përçarëse në histori, filloi të shpërbëhej në fund të viteve 1980të, shkëlqja e kufizimeve që pengonte kalimin në zonat e vdekura të kufijve, të cilat kishin shkaktuar dekada të tëra stanjacioni ekonomik, shënoi fundin e këtij procesi. Përveç ndryshimeve politike që ndodhën menjëherë pas kthesës historike, lejimi i kalimit në këto zona shpalsi një trashëgimi, që paraqiste një rast interesant për kërkime ekologjike dhe merrte më tepër rëndësi përse i përket biodiversitetit dhe proceseve rregulluese të natyrës. Ideja për mbështetjen e këtyre zonave me rëndësi të madhe ekologjike ishte njohur nga studiuesit që në vitet 1980, por u shpreh në mënyrë të pavarur në shumë rajone të kufirit lindor-perëndimor dhe në rajonet pranë kufijve, në veri dhe në jug, gjatë periudhës së ndryshimeve në 1989 dhe 1990.

Me mbështetjen e fortë të disa organizatave qeveritare dhe jo qeveritare, u diskutua që ish kufijtë e ngurtë, të shërbenin si bazë për bashkëpunimin ndërkuftar në ruajtjen e natyrës. Kjo çoi në prezantimin e nismës evropiane të Brezit të Gjelbër, në shtator 2004, në Parkun Kombëtar *Fertő-Hanság* të Hungarisë. Në këtë park, ekspertë dhe përfaqësues kombëtarë nga vendet përgjatë Brezit të Gjelbër u takuan për të identifikuar hapat e nevojshëm që duheshin ndërmarrë për ta kthyer nismën në mjet ndërkuftar bashkëpunimi për ruajtjen e natyrës. Rezultatet kryesore të këtij takimi u përfshinë në Programin e Punës (Terry et al. 2006) dhe në marrëveshjen e strukturës bazë të nismës.

Brezi i Gjelbër Evropian si rrjet i zonave të mbrojtura është një trashëgimi e historisë së tanishme politike. Ai shtrihet në 23 vende, përgjatë rreth 12,500 km. Ai fillon nga veriu

i Evropës, nëpër bregun Balltik, kalon nëpër Evropën Qendrore dhe vazhdon deri në Detin e Zi dhe atë Adriatik. Përveç aspekteve të ndryshme ekologjike të këtij korridori, që kalon përmes gjashtë rajoneve<sup>4</sup> biogeografike (Agjencia Evropiane e Mjedisit 2003), çdo rrip karakterizohet nga një situatë e ndryshme kufitare mes vendeve, e krijuar si pasojë e kushteve historike, politike, gjeografike dhe social-ekonomike në rajonet përkatëse.

### **Zbatimi, funksionimi dhe struktura e Brezit të Gjelbër Evropian**

Qëllimi kryesor i nismës është krijimi i Brezit të Gjelbër Evropian si rrjet ekologjik, funksional. Zbatimi i saj mbështetet në angazhimet që kanë marrë Krerët e Shteteve të BE-së dhe Ministrat e Mjedisit të gjithë vendeve të Evropës për të penguar humbjet që po pëson biodiversiteti. Ajo gjithashtu kontribuon në zbatimin e programit të Konventës për Mbrojtjen e Shumëllojshmërisë Biologjike për Zonat e Mbrojtura, të Rrjetit Ekologjik Pan Evropian (PEEN, Këshilli i Evropës) e konventave të tjera ndërkombëtare, dhe të nismave dhe rrjeteve të tjera, si Natura 2000. Bashkëpunimi i suksesshëm ndërkuftar për ruajtjen e natyrës përgjatë Brezit të Gjelbër Evropian mbështet përpjekjet e përcaktuara në Direktivën e BE-së për Ruajtjen e Habiteteve Natyrore dhe Florës e Faunës së Egër (92/43/EEC) (Direktiva e Habiteteve) si Zona të Posaçme të Mbrojtjes (SPA), dhe në Direktivën e BE-së për Ruajtjen e Shpendëve të Egër (79/409/EEC) (Direktiva për Shpendët), si Zona të Posaçme të Ruajtjes (SAC). Bashkëpunimi efektiv mes organizatave anëtare dhe atyre partnere shton përpjekjet e bëra edhe në kuadër të Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore, Kulturore dhe Natyrore (Karivalo and Butorin 2006), Konventës për Lagunat me rëndësi Ndërkombëtare, Programit "Njeriu dhe Biosfera" i UNESCOs, dhe Konventës së Bernës për Ruajtjen e Habiteteve, Natyrës dhe Botës së Egër në Evropë.

Një funksion tjetër me rëndësi për Nismën e Evropiane të Brezit të Gjelbër, qëndron në rolin që ajo luan për disa prej niveleve të shoqërisë, nga ai ndërkombëtar në atë vendor. Konteksti i përbashkët historik dhe politik krijon një mirëkuptim lidhur me problematikat e ruajtjes, i cili rezulton jashtëzakonisht i mirë për të gjithë aktorët e përfshirë. Aktorët e përdorin Brezin e Gjelbër Evropian si një mjet praktik për të dhënë ndihmesën në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve në nivel vendor. Aktivitetet në këtë nivel komunikohen në kuadër të një konteksti më të gjerë ndërkombëtar, përmes shfrytëzimit të kontakteve, faqeve të internetit dhe fletëpalosjeve për këtë nismë. Projektet dhe takimet e ndryshme shërbejnë si mekanizma të ngritur dhe të respektuar për shkëmbimin e njohurive, të përvojave dhe praktikave më të mira të bashkëpunimit ndërkuftar

<sup>4</sup> Rajone biogeografike Arktike, Alpin, Veriore (boreale), Kontinentale, Panonike dhe Mesdhetare.

për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Organizatat dhe autoritetet qeveritare e vlerësojnë Brezin e Gjelbër Evropian si nismë të fortë të vendeve pjesëmarrëse dhe organizatave ndërkombëtare.

Së treti, Brezi i Gjelbër Evropian ju shërben disiplinave të ndryshmetë kërkimit shkencor, si laborator kumund të studiohen peizazhet dhe proceset ekologjike në shkallë kontinenti dhe reagimet e habitateve dhe llojeve ndaj ndryshimeve kryesore ekologjike. Mundësitë që paraqesin veprimtaritë ndërkufitare të kërkimit, pavarësisht nëse kapërcejnë apo ndjekin kufijtë, duhet të njihen dhe shfrytëzohen më tej. Kjo lidhet, ndër të tjera me shkencat natyrore, siç është studimi i efekteve të ndryshimeve klimatike në rajonesh të ndërthurrura dhe me përbërje të ndryshme biogeografike, të ruajtura mirë, që përshkohet nga Brezi i Gjelbër, por edhe nismave shkencore në fushën e veprimtarisë njerëzore.

Shfrytëzimi i Brezit të Gjelbër Evropian si etiketë në sipërmarrjet vendore është funksioni i katërt që përmendet në Programin e Punës. Ai ka si qëllim të ofrojë një mjet që rrit përfitimet e ekonomive vendore përmes zhvillimit të qëndrueshëm të sipërmarrjeve, në nivel vendor dhe rajonal. Tashmë OJQtë dhe organizatat ndërkombëtare e përdorin Brezin e Gjelbër Evropian si etiketë për veprimtaritë e tyre, ndërsa vlerësimi i saj nga ana e bizneseve dhe përdorimi i saj si 'markë' për emrat e produkteve dhe veprimtarive të tyre, mbetet shumë më i ulët.

Qasja ndërkufitare dhe ndërsektoriale e nismës duhet reflektuar edhe në strukturën e saj organizative. Në këtë rast, një strukturë rrjetëzore me qendra më të vogla, të ndryshueshme veprimtarish, që krijohen si rezultat i projekteve provuan të ishin një instrument fleksibël për zbatimin e qëllimeve të tij. Struktura e rrjetit është e veçantë dhe përfshin OJQtë, organizatat qeveritare, politikanët, institucionet dhe individët. Koordinatorët rajonalë, pikat fokale dhe partnerët e nismës që zbatojnë Programin e Punës, vendosin lidhjet, zbatojnë qasjen në veprimtaritë vendore, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

Koordinatorët e nismës kontribuojnë në shumë veprimtari njëherësh, me qëllim që të realizojnë lidhje strategjike të efektshme që rrisin mbështetjen dhe lëvizshmërinë e burimeve. Në të shkuarën, ky rol së bashku me mbajtjen e kontakteve të drejtpërdrejta me nivelet si qeveritare dhe joqeveritare ishte marrë përsipër nga Zyra Rajonale e IUCN-së për Evropën, si pjesë e organizatës më të madhe në botë për ruajtjen e natyrës, me një rrjet mjaft të gjerë specialistësh. Sekretariati i Brezit të Gjelbër është mbledhur dhe ka shkëmbyer informacione me aktorët përgjatë Brezit të Gjelbër, duke mbështetur studime dhe pilotuar projekte dhe duke ofruar ekspertizën e nevojshme. Financimi për projektet e Brezit të Gjelbër Evropian vjen nga buxhetet

shtetërore, buxhetet vendore, burimet ndërkombëtare dhe ato të BE-së.

Ndarja e nismës në tre nën-seksione rajonale, ilustron më tej veçorinë e rrjetit të Brezit të Gjelbër Evropian. Secili seksion, p.sh Feno-Skandinavia dhe vendet Balltike, Evropa Qendrore dhe Evropa Juglindore, kanë një coordinator të vecantë. Shoqata e Zapovedniksit dhe Parqeve Kombëtare të Rusisë VeriPërendimore vepron si coordinator rajonal për Feno-Skandinavinë dhe Shtetet Balltike, BUND (Miqtë e Tokës Gjermani) për Evropën Qendrore dhe EuroNatur për Evropën Juglindore. Koordinatorët rajonalë dhe pikat fokale (të autorizuara nga agjencitë shtetërore përgjegjëse për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin rajonal) sigurojnë zbatimin e Programit të Punës, sipas kushteve natyrore, formave të përdorimit të tokës dhe gjendjes politike. Pikat kombëtare të çdo vendi promovojnë sinergji dhe bashkëpunojnë me veprimtaritë kombëtare dhe ato Pan-Evropiane të Brezit të Gjelbër Evropian. Mes 23 vendeve të nismës, ekzistojnë ndryshime që lidhen jo vetëm me strukturën e peizazhit, por edhe me të drejtat e përdorimit, p.sh prona dhe përdorimi i tokës, të cilat janë shumë të ndryshme. Për rrjedhojë, nisma duhet të zbatohet në mënyra të ndryshme që varen fuqimisht nga parakushtet respektive dhe perceptimi vendor i historisë së regjimit kufitar të çdo seksioni.



Figura 3.1. Harta e Korridorit të Gjelbër Evropian

## Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen – faktorët e suksesit dhe të dështimit të nismave ndërkuftare të ruajtjes, ku marrin pjesë shumë aktorë.

Baza e suksesit të nismës qëndron në kombinimin e vizionit të qartë me qasjen ndërkuftare dhe ndër-sektoriale të zbatimit dhe me karakterin shumë-aktorësh të saj, ku mbështetësit e vazhdueshëm dhe individët e aftë veprojnë si timonierë të nismës. Megjithatë është arritur shumë për krijimin e Brezit të Gjellbër Evropian si një rrjet ekologjik, mbetet akoma mjaft punë për t'u bërë që të hidhen hapat kryesorë për zbatimin e vizionit të nismës. Për zbatimin e mëtejshëm të Programit të Punës, si dhe në suksesin apo ngadalësimin e saj, kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm.

### *Histori e njëjtë – vizion i përbashkët*

Historia e vrojtimit të rreptë të kufirit mes lindjes dhe perëndimit është e njëjtë për shumicën e vendeve në Evropë. Çështja e bashkëpunimit ndërkuftar pas Luftës së Ftohtë ka shkaktuar interes të madh në publik dhe mediatic, duke marrë një shtrirje që tejkalon ruajtjen e natyrës dhe kufijtë e Evropës. Vizioni prek kujtimet e çdo njeriu e publikut të gjerë dhe krijon një lloj interesi që shkon përtej aktivizmit të zakonshëm në veprimtari për ruajtjen e natyrës. Ai lejon përfshirjen e grupeve të synuar, të partnerëve nga sektorë të ndryshëm dhe të publikut në të njëjtin nivel me ato që angazhohen në mbrojtjen e natyrës.

### *Qasja ndër-sektoriale*

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm, siç përshkruhet në Deklaratën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin 1992 (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin 1992), bën thirrje për angazhim të fortë, që të përfshijë partnerë dhe koncepte që tejkalojnë mënyrat tradicionale të ruajtjes. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për Programin e Punës së CBD për zonat e mbrojtura<sup>5</sup>, Protokollin Nagoya (2010) për "Aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që dalin nga shfrytëzimi i tyre"<sup>6</sup>. Ai përmban një koncept themelor që ka të bëjë me çështjet globale të ndryshimeve klimatike dhe humbjeve të biodiversitetit. Brezi i Gjellbër është krijuar që të eksplorojë metoda të përshtatshme dhe masa për bashkëpunimin ndërsektorial. Kjo lloj qasje hapi dyert për sinerji dhe ndarje të përfitimeve, dhe solli aleatë të rinj, ide dhe burime të reja. Projektet përfshinin krijimtari artistike, si p.sh koleksionin/kolanën e muzikës për Brezin me UNESCO-n, trajnime profesionale të gazetarëve, mësuesve dhe autoriteteve dhe bashkëpunimin e civilëve me sektorin ushtarak.

5 Konventa e Shumëllojshmërisë Biologjike (2004). Vendimi VII/28. CBD, Montreal. I disponueshëm në: <http://www.cbd.int/decision/cop/?id=7765> (aksesuar në Dhjetor 2010).

6 Konventa e Shumëllojshmërisë Biologjike. (2010) Vendimi X/1. Protokollin Nagoya për "Aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që dalin nga shfrytëzimi i tyre i Konventës së Shumëllojshmërisë Biologjike. I disponueshëm në: <http://www.cbd.int/doc/notifications/2010/ntf-2010-223-cop10-en.pdf>, faqe 87 (aksesuar në Dhjetor 2010).

### *Qasja me shumë aktorë*

Është provuar se niveli politik luan rolin e timonierit në bashkëpunimin ndërkuftar mes vendeve përgjatë Brezit të Gjellbër. Si shembuj të mirë në lidhje me këtë mund të përmendim, Memorandumin e mirëkuptimit mes Finlandës, Rusisë dhe Norvegjisë, në shkurt 2010, për të bashkëpunuar në krijimin e të ashtuquajturit Brezi i Gjellbër i Feno-Skandinavisë (Ministria e Mjedisit e Republikës së Finlandës, Ministria e Mjedisit në Mbretërinë e Norvegjisë dhe Ministria e Burimeve Natyrore dhe Mjedisit në Federatën Ruse), ose Traktati i koalicionit gjerman, i cili përmend në mënyrë specifike qëllimin për të mbështetur këtë nismë. Sidoqoftë, nisma mbahet nga shumë projekte individuale, të cilat janë një bazë e fortë për zbatimin e mekanizmave të pavarur rregullatorë.

### *Marrëdhëniet me publikun*

Mjetet e komunikimit të bazuara në identitetin shumëpalësh të nismës, ndihmojnë fuqimisht për prezantimin vizual të konceptit, tek publiku i gjerë dhe partnerët e mundshëm. Përdorimi i mjeteve të marketingut, i mjeteve për menaxhimin e njohurive dhe metodave të komunikimit, është shumë i rëndësishëm kur flitet për çështje komplekse të ruajtjes së natyrës, me interes të gjerë. 25 vjetori i përfundimit të Luftës së Ftohtë, në 2014/2015 do të shërbejë si një mundësi tjetër për tju drejtuar publikut të gjerë. Hapi tjetër do të jetë përcaktimi i kriterëve për përdorimin e logos së Brezit të Gjellbër, me qëllim që të sigurohet përdorim më i përhapur i saj nga partnerët e nismës.

### *Pjesëmarrja dhe angazhimi*

Për të mbështetur proceset e ndërmarrjes së një nisme kërkohet angazhim i vazhdueshëm. Koordinatorët e ardhshëm të nismës i kanë mundësitë për të mbështetur partnerët përmes marrëdhënieve me publikun, ndihmesës me projekt propozime, identifikimit të partnerëve për aktivitete të përbashkëta dhe shkëmbimit të përvojave. Kjo strukturë mundëson përdorimin e qasjeve të suksesshme dhe promovimit të tyre në një rrjet më të gjerë partnerësh, që ndajnë mes tyre qëllime të përbashkëta. Elementë të tjerë shumë të rëndësishëm për ndërtimin e kësaj nisme kanë qenë mbështetja qeveritare dhe kontributi afatgjatë i OJQve dhe fondacioneve. Përpjekjet e tyre janë plotësuar nga përfshirjet afatshkurtra të aktorëve të tjerë. Intensiteti i bashkëpunimit me pikat fokale varet shumë nga vazhdimësia dhe motivimi personal. Përfshirja më e fortë e anëtarëve<sup>7</sup> të Komisionit të IUCN-së do ta ndihmojë nismën më tej. Interesi për një qasje të ngjashme me atë të Brezit të Gjellbër në Korenë e Jugut për ruajtjen e Zonës së çmilitarizuar (DMZ) (Ministria e Mjedisit e Republikës së Koresë, 2005) dhe në Amerikën e Veriut

7 IUCN e ka organizuar punën në gjashtë komisione vullnetare ekspertësh. Për më shumë informacion, vizitoni [www.iucn.org](http://www.iucn.org).

janë provë e gjallë e potencialit të nismave të tilla edhe në këndvështrimin social.

### *Individët e kualifikuar*

Individët aktivë dhe të kualifikuar kanë një rëndësi shumë të madhe për nismat me shumë aktorë të ruajtjes së natyrës. Personeli është vendimtar për një rrjet që varet nga komunikimi, kreativiteti dhe bashkëpunimi, si brenda edhe jashtë sektorit të ruajtjes, siç është dhuntia 'për të përkthyer gjuhën që flitet' mes aktorëve të ndryshëm. Me qëllim që të arrihet shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve personale të disponueshme, po diskutohet mundësia e përfshirjes së ekspertëve të tjerë, 'ambasadorëve', etj., p.sh. në komitetin drejtues të koordinatorëve të nismës.

### *Financimi i përhershëm*

Financimi i vazhdueshëm i trupave koordinuese do të evitonte për një kohë të gjatë varësinë e nismës së sapokrijuar nga financimi me bazë projektësh. Ndonëse përfshirja në projekte është padyshim një faktor motivues, ajo dëmton aftësitë e aktorëve që të përmbushin rolin e tyre të koordinimit, rrjetëzimit dhe planifikimit të përbashkët, për shkak të konkurrencës dhe garës që krijohet mes partnerëve.

### *Mekanizmat rregullatorë*

Megjithëse nisma nuk ka status zyrtar si konventat ndërkombëtare, legjislacioni i BE-së, etj., ajo njihet gjerësisht nga publiku. Shpesh është diskutuar nëse profili i saj do të ishte më i lartë, po të kishte status zyrtar, p.sh. atë të një konvente ndërkombëtare, emërtimin apo klasifikimin nga UNESCO, si zone e Trashëgimisë Botërore. Kjo do të rriste shtrirjen e nismës dhe do të krijonte burime shtesë financimi. Duke qenë se është një mjet bashkëpunimi mes komuniteteve vendase dhe atyre ndërkufitare për ruajtjen e natyrës dhe bashkëpunimin rajonal, nisma shërben si instrument me rëndësi për përmbushjen e angazhimeve të dhëna nga vendimmarrësit. Krijimi i zonave të mbrojtura dhe zbatimi i projekteve të ruajtjes mbush hendeqet gjeografike dhe sektoriale mes partnerëve. Në të ardhmen kjo mund të reflektohet në një memorandum mirëkuptimi mes konventave ndërkombëtare përkatëse.

Sot Brezi i Gjelbër Evropian lidh parqet kombëtare, parqet natyrore, rezervat e biosferës dhe zonat ndërkufitare të mbrojtjes, si dhe zonat e pambrojtura përgjatë ose përmes kufijve. Ai është kthyer në një mjet bashkëpunimi përmes kufijve, komuniteteve vendore dhe në një instrument të rëndësishëm për përmbushjen e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të marra nga vendimmarrësit. Faktorët që ndikojnë në ngadalësimin e nismës lidhen me mungesën e financimeve dhe problemet me vazhdimësinë, shkallën

e ndryshme të identifikimit të partnerëve dhe vizionin e përbashkët të saj. Faktorët që nxisin angazhimin kanë cuar në përpjekje të përbashkëta për harmonizimin e metodave menaxhuese në përdorimin e tokës, ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin rajonal përmes punës përtej kufijve administrativë. Harmonizimi i qasjeve, ndonëse pengohet shpesh nga konteksti i ndryshëm administrativ, ligjor dhe politik në secilën anë të kufirit, mund të arrihet përmes qëllimeve të përbashkëta të ruajtjes së natyrës e zhvillimit rajonal të qëndrueshëm dhe të përpjekjeve për realizimin e tyre përmes mjeteve të ndryshme në vende të ndryshme.



Brezi i Gjelbër Evropian nuk është një fortesë. Vizioni i tij mund të zbehet dhe të zëvendësohet nga vizione dhe aktivitete të reja. Për të ardhmen, mbetet nevoja e vazhdueshme për të kryer veprimtari e për mbrojtjen e natyrës dhe zhvillimin rajonal të qëndrueshëm. Përfshirja e popullsisë vendase në planifikimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe në skemat e përdorimit të tokës, është vendimtare. Suksesi do të varet fuqimisht në strategjitë e integritetit të peizazheve kulturore në kuadër të përpjekjeve të ruajtjes së natyrës që bëhen përgjatë dhe përmes kufijve. Këto mund të përfshihen si një rol i mundshëm i Brezit të Gjelbër, si laborator për konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm, parandalimin e krizave, ruajtjen e biodiversitetit, zbutjen e ndryshimeve klimatike ose shërbimet e ekosistemit.

# 4. Nisma e Harkut Dinarik: Një qasje novatore për qeverisjen e bashkëpunimit ndërkombëtar

Dr. Giorgio Andrian<sup>1</sup>

## Hyrje

Përsheptimi i procesit ndërkombëtar të bashkëpunimit që nxitet nga globalizimi kërkon një riorganizim të konsiderueshëm të regjimeve të qeverisjes në fushën e mjedisit. Reforma aktuale e Kombeve të Bashkuara është njëri prej shembujve më domethënës ku slogani

Nisma e Harkut Dinarik (në ang.: IHD/DAI) përfaqëson një prej shembujve më interesantë të sistemeve novatore të qeverisjes mjedisore në Evropë. Në fakt ajo është një “kornizë e gjerë bashkëpunimi”<sup>2</sup> që është themeluar në 2004 dhe që atëherë ka përqafuar një numër gjithnjë e më të madh organizatash ndërkombëtare, duke filluar nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara (si rajonale dhe ato në nivel vendi), deri tek organizatat ndërqeveritare (ONQ) dhe një numër organizatash joqeveritare (OJQ) të mëdha dhe të vogla. E përbashkëta që i lidh



© IUCN / Tomasz Pezold

“funksionim si një grup” sintetizon përpjekjen për t’u dhënë një kuadër më koherent veprimi agjencive të ndryshme dhe veprimtarive programore që zbatohen në nivel vendi. Mungesa e modeleve të qeverisjes në procesin riorganizues po çon gjithnjë e më tepër drejt qasjes “eksperimentoj dhe përshtas”. Organizimi hierarkik me orientim nga lart-poshtë ka provuar se është shumë i kufizuar dhe; nganjëherë, tërësisht jo produktiv në përballjen me ndryshimet e shpejta. Përkundrazi, veprimtaritë elastike dhe të bashkërenduara po demonstrojnë se janë zgjidhjet më të mira gjatë periudhave të reformës.

ato, është fakti se të gjitha punojnë në Evropën Juglindore për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore. Megjithatë, ky ishte thjesht një konsideratë fillestare që bazohej në një varg të gjatë veprimtarish, në përputhje me hapat për krijimin e “një vlere të shtuar në programet dhe aktivitetet që realizojnë partnerët në vazhdimësi”<sup>3</sup>. Broshura që bën një reflektim të mirë mbi procesin, duke udhëhequr përcaktimin e elementeve bazë më të rëndësishëm si: ruajtjen e burimeve natyrore dhe kulturore, të trashëgimisë së rajonit të Harkut Dinarik; promovimin dhe vlerësimin përmes përfshirjes e fuqizimit të komuniteteve vendore dhe koordinimin i politikave sektoriale<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Konsulent. Zyra rajonale e UNESCOs për Shkencën dhe Kulturën në Evropë (BRESCE), Itali. Mendimet e shprehura në këtë material nuk paraqesin qendrimin zyrtar të UNESCO, por vetëm të autorit.

<sup>2</sup> Burimi: Broshura DAI : <http://www.dinaricarc.net/dai.html>.

<sup>3</sup> *Ibid.*

<sup>4</sup> *Ibid.*

Frymëzimi për këtë nismë erdhi nga Zyra Mesdhetare e Programit të WWF<sup>5</sup> në një takim që u organizua në Romë në dhjetor 2004. Takimi u pa të ishte vazhdimi më domethënës i Workshopit të Përbashkët Ndërkombëtar për "Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Rezervat e Biosferës MAB në Rajonin e Evropës Juglindore", që u organizua nga UNESCO-ROSTE<sup>6</sup> dhe IUCN dhe u mbajt në Beograd dhe në Parkun Kombëtar Tara (Serbi) më 13 – 17 korrik 2004.

Që nga ajo veprimtari, grupi IHD vazhdoi të zgjerohej dhe prej takimit të 13të të rregullt, i organizuar nga EuroNatur (Ulqin, Mali i Zi, në nëntor 2010), përbëhet nga 13 anëtarë WWF, UNESCO BRESCE, IUCN<sup>7</sup>, UNDP<sup>8</sup> (zyrat e Kroacisë, Bosnje Hercegovinës, Malit të Zi dhe Shqipërisë), UNEP<sup>9</sup>, FAO<sup>10</sup>, Këshilli i Evropës<sup>11</sup>, ECNC<sup>12</sup>, REC<sup>13</sup>, EuroNatur, SNV<sup>14</sup>, dhe CIC<sup>15</sup>.

Cili është sekreti i bashkëpunimit afatgjatë (relativ), i cili nuk i ka rrënjët as në ndonjë kuadër ligjor detyrues, as në ndonjë mbështetje të veçantë financiare? Në përpjekjet për të gjetur një përgjigje, paragrafët e mëposhtëm risjellin në kujtesë 'hapat kryesorë evolucionarë' që janë marrë pas takimit të Romës.

### Qasja eko-rajonale: si filloi kjo nismë

Gjatë takimit të parë, mbi tryezën e diskutimeve gjendej vetëm një dokument; 'Harta e Harkut Dinarik' siç përcaktohej nga WWF. Mbështetësit sqaruan menjëherë se termi 'eko-rajon' do të thoshte "një njësi e madhe toke ose uji që përmban një përzierje llojesh, komunitetesh natyrore dhe kushtesh mjedisore gjeografikisht të rralla".<sup>16</sup> Supozimi i bazuar mbi nevojën për të identifikuar dhe vepruar në shkallë eko-rajoni u sqarua më tej: "Biodiversiteti nuk është i përhapur në mënyrë të barabartë në tokë, por ndjek kushtet komplekse që përcaktohen nga gjeologjia dhe historia e evolucionit e planetit. Këto modele quhen 'eko-rajone'".<sup>17</sup>

IUCN e kuptoi menjëherë vlerën e kësaj qasjeje dhe duke u mbështetur në punën e saj në rajon identifikoi lidhjet e



Figura 4.1: Harta e parë e DAI

mundshme, ndërkohë që UNESCO cilësoi se do të kufizohej ekskluzivisht në qasjen për ruajtjen e natyrës. Ndaj aspekti kulturor u përfshi në dokumentet e mëtejshme për të bërë një lidhje më të mirë koncepteve të gjera të burimeve dhe trashëgimisë në rajon. Takimi krijoi bazat për bashkëpunim të fortë, i cili do të sillte rezultate interesante në vitet pasardhëse.

### Hartëzimi i sipërmarrjes: një shtrirje gjeografike e zgjeruar

Harta origjinale, që paraqiste 'eko-rajonin e Harkut Dinarik' të propozuar nga WWF, përfaqësonte shtrirjen fillestare gjeografike të vendeve palë të Nismës IHD, ku zona qendrore shënonte pyjet e përzier të maleve Dinarike, pyjet e përzier të një nën-njësie të maleve mesdhetare evropiane, një prej 238 Eko-rajoneve Globale, të identifikura nga WWF.<sup>18</sup> Në këtë kohë, diskutimi në lidhje me kufijtë gjeografikë të IHDsë ishte në fillimet e tij. Në fakt, ai mbeti për vite me radhë njëri prej debateve më të gjallë mes grupit, që reflektonte nevojën për të përshtatur një qasje elastike në 'ndarjen e kufijve'.<sup>19</sup> Shpjegimi shkencor i konceptit eko-rajonal pranon se "kufijtë e një eko-rajoni nuk janë të ngurtë e të palëvizshëm, por përshkojnë një zonë brenda të cilës duhet të ndërveprojnë fuqishëm procese të rëndësishme ekologjike dhe evolucioniste".<sup>20</sup> Në këtë kontekst, kuptim të veçantë morri krahasimi i hartave të përfshira në dy variantet e broshurës IHD/(në angl.: DAI). Në të parën, të botuar më 2005 (figura 4.1), kufijtë e eko-rajonit ishin të mirë përcaktuar, edhe pse shkalla e hartës nuk lejonte që kufijtë territorialë të shquheshin saktë. Në versionin e dytë të vitit 2007 (figura 4.2) shohim një 'zonë të ndërmjetme' që rrethon 'zonën qendrore' fillestare, e cila synon të përcjellë

5 Fondi Botëror për Natyrën (që më parë quhej Fondi Botëror për Kafshët e Egra / WWF (<http://www.panda.org>).

6 Në atë kohë, emri i zyrës së UNESCOs në Venecia ishte Byroja Rajonale për Shkencën dhe Teknologjinë në Evropë (ROSTE). Së fundi, zyra e ndërroi emrin në Zyra Rajonale për Shkencën dhe Kulturën në Evropë (BRESCE) (<http://www.unesco.org/en/venice>).

7 Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (<http://www.iucn.org>).

8 Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (<http://www.undp.org>).

9 Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (<http://www.unep.org>).

10 Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit e Kombeve të Bashkuara (<http://www.fao.org>).

11 <http://www.coe.int/>

12 Qendra Evropiane për Ruajtjen e Natyrës (<http://www.ecnc.org/>).

13 Qendra Rajonale e Mjedisit (<http://www.rec.org/>).

14 Organizata Hollandeze për Zhvillim (<http://www.snvworld.org/>).

15 Këshilli Ndërkombëtar për Ruajtjen e Kafshëve të Egra dhe Gjahut (<http://www.cic-wildlife.org/>).

16 [http://www.panda.org/about\\_wwf/where\\_we\\_work/ecoregions/about/what\\_is\\_an\\_ecoregion/index.cfm](http://www.panda.org/about_wwf/where_we_work/ecoregions/about/what_is_an_ecoregion/index.cfm).

17 *Ibid.*

18 *Ibid.*

19 Për rëndësinë e identifikimit të kufijve në ruajtjen e natyrës, shiko Fall J. (2005). Përcaktimi i kufijve. *Natyrë, hibridizimi dhe politika në hapësirat ndërkufitare*. Farnham (UK): Ashgate.

20 Shih shënimin 6 në fund të faqes 6.



Figura 4.2: Harta e dytë e DAI (2007)

idenë se kufijtë janë më tepër tregues, sesa thjesht riprodhim i kritereve bio-fizike.

Shumë shpejt, anëtarët e IHDsë vijuan të diskutojnë mundësitë e bashkëpunimit në zona të veçanta, brenda kufijve të shtrirjes bio-gjeografike. Rasti i Liqenit ndërkuftar të Shkodrës, mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, ishte e para 'qasje territoriale' dhe ndër më të suksesshmet e kësaj nisme. Takimi i dytë IHD (2005) u mirëprit nga zyra e PNUDit në Mal të Zi dhe u zhvillua në Vranjina (Mal i Zi) dhe Shkodër (Shqipëri) në Tetor 2005. Ai u ndoq nga takime njëditore mes anëtarëve të IHDsë dhe seanca tre ditore trajnimi mbi komunikimin në zonat e mbrojtura, që u organizuan nga IUCN.

Gjatë eksperimentimit të qasjes 'funksionim si një grup', anëtarët e IHDsë u përballën shpesh me një spektër të gjerë organizatash të tjera ndërkombëtare dhe donatorësh që vepronin në të njëjtat territore. Kjo i shtyu anëtarët e IHDsë që të reflektonin lidhur me nevojën për të gjetur rrugën që harmonizonte kornizat e ndryshme të veprimtarisë së tyre, me qëllim që të shmangej mbivendosja dhe përsëritja. Shumë shpejt pas kësaj dhe paralelisht me shtimin e konsultimeve me qeveritë e Malit të Zi dhe Shqipërisë, lindi ideja për zhvillimin e një harte të përbashkët tokësore për Liqenin e Shkodrës. Të dy vendet kuptuan vështirësinë e koordinimit të donatorëve dhe organizatave të ndryshme që vepronin në të njëjtat territore. Ato ishin në kërkim të mundësisë për të siguruar mbështetjen në 'ushtrimin' delikat të përgatitjes së hartës. Harta rendiste një listë paraprake të veprimtarive të secilit prej anëtarëve të IHDsë në rajon, e ndjekur nga lista e fushave të përbashkëta të interesit dhe sinergjisë së mundshme, në përmbushje të vizionit të përbashkët. Kjo qasje u bë shpejt një prej veçorive specifike të partneritetit IHD. Format i hartës u përdor edhe në zona të tjera me interes të përbashkët (p.sh zona Durmitor), si një mënyrë efektive për identifikimin e hendeqeve dhe sinergjisë në gjenerimin e veprimtarive të përbashkëta. Përveç hartave për zona specifike, anëtarët e

IHDsë krijuan edhe një bazë të përbashkët të dhënash, e cila lë të hapur mundësinë e përditësimeve të vazhdueshme të veprimtarive dhe projekteve që janë në proces zbatimi. Ky aktivitet u perceptua si një mekanizëm shumë i dobishëm për harmonizimin e brendshëm të veprimeve si dhe për komunikimin me jashtë.

## Aksionet e përbashkëta për sukses

Takim pas takimi, aktivitet pas aktiviteti, 'koalicioni' IHD është rritur jashtëzakonisht shumë që nga fillimet e tij, duke demonstruar se përbërja e përzier (Agjenci të OKBsë, ONQtë dhe OJQtë) dhe kornizat e veprimit pa karakter shtrëngues ligjor janë elementët kryesorë të një veprimi të konsoliduar dhe të bashkërenduar. Përveç kësaj, promovimi i aktiviteteve të përbashkëta me fokus zona të vecanta (ajo që IHD e quan 'qasje territoriale') ka dhënë prova se është mënyra më efektive e angazhimit në veprimtari të përbashkëta.

Gjatë Konferencës së 6të Ndërmnistrorë për Mjedisin (në kuadër të procesit 'Mjedis për Evropën', që u mbajt në Beograd në tetor 2007) partnerët e IHDsë organizuan një veprimtari të përbashkët. Në këtë ngjarje u paraqitën aktivitetet e IHDsë në tërësi, duke reflektuar nivelin e lartë të 'ndryshimit' në aspekte e të përbërjes dhe atë veprimit. Nga ana tjetër, vënia e fokusit në territore të caktuara (p.sh Liqeni i Shkodrës, Durmitori) dhe zhvillimi i hartave të përbashkëta, provoi të ishte një metodë mjaft efektive pune dhe një mjet i jashtëzakonshëm komunikimi. Të pyetur nga publiku në lidhje me arsyet e anëtarësimit në IHD, individë të organizatave anëtare u përgjigjën duke thënë se zbatimi i platformës efektive dhe jozyrtare ishte mënyra më efektive për të qenë të informuar dhe për të krijuar sinergji në aktivitetet e përbashkëta. Duke punuar në këtë formë, çdonjëri sheh përparësitë e tij konkurruese, sidomos përmes evidentimit që krijon efekti i grupit. Këto vijnë të kombinuara me përfitimet që krijohen si rezultat i organizimit të veprimtarive të përbashkëta dhe shkëmbimit të përvojës së njëri-tjetrit.

Pas prezantimit të përbashkët, anëtarët e IHDsë kuptuan se sa strategjike do të kishte qenë ta sfidonin këtë grupim duke krijuar një nismë krejt të re, me qëllim që të shkriheshin forcat në një të vetme dhe të shumëfishoheshin efektet përfituese. U pa qartë se paraqitja tek donatorët, si një projekt të vetëm të pranuar nga më shumë se një anëtar i IHDsë mund të kishte më tepër shanse për sukses.

## Sfida e të punuarit së bashku

Në vitet pasuese, partnerët patën rastin të promovonin individualisht projekte të caktuara dhe të zbatonin aktivitete në bashkëpunim me partnerët e tjerë të interesuar. Më poshtë jepen shembujt më përfaqësues, në renditje kronologjike.

Zhvillimi rural me bazë komunitetin dhe menaxhimi i burimeve natyrore në zonën e Dinarës. Në prill 2008, një grup shumëdisiplinor i përbërë nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë ndërmorri formulimin e misionit të një projekti të përbashkët, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm në zonën rurale të Livanjsko polje<sup>21</sup> dhe të Sinjsko polje që gjendeshin respektivisht në Bosnje Hercegovinë dhe Kroaci. Grupi organizoi takime me aktorë të zonës, përfshirë edhe ministrat përkatës të bujqësisë dhe mjedisit, ekonomisë, përfaqësues të bordeve të turizmit, shoqata fermerësh dhe OJQ të dy vendeve. U organizuan vizita në territoret e fermave, në komunitetet vendore dhe bizneset turistike. Nëpër takimet e organizuara u diskutuan shumë çështje dhe u përcaktuan nevojat e aktorëve. Bazuar në gjetjet e marra dhe nën udhëheqjen e FAOs, grupi zhvilloi një projekt propozim, të cilin e paraqiti tek donatorët ndërkombëtarë gjatë një konference. Propozimi përqendrohej në nxitjen dhe zhvillimin e zinxhirit të produkteve bujqësore, bazuar në cilësinë e lartë dhe vlerën e shtuar të tyre në rajon. Zhvillimi i turizmit rural do të kontribuonte në diversifikimin e burimeve të të ardhurave për komunitetet vendore. Projekti gjithashtu synonte të promovonte vlerat natyrore dhe kulturore të zonave që lidheshin me fushat e zonave karstike dhe atyre përreth dhe të mbështeste menaxhimin ndërkufitar të basenit lumor dhe menaxhimin e qëndrueshëm të livadheve. Fatkeqësisht propozimi nuk ishte tërheqës sa duhet për pjesën më të madhe të donatorëve të identifikuar dhe nuk mori ndonjë mbështetje financiare. Sidoqoftë, ai mbeti përpjekja e parë e strukturuar në mobilizimin e 'ekspertizës kolektive' të IHDsë për konceptimin dhe formulimin e një projekti të përbashkët, duke ruajtur të dy komponentët si atë të KBsë (Kombeve të Bashkuara) edhe të OJQve. Kjo qasje provoi të ishte e suksesshme edhe në rastet e tjera të mëvonshme.

#### *'Fitore e madhe për Harkun Dinarik'*

*"Më vjen keq që pjesa tjetër e botës nuk është këtu që të shohësh çfarë mund të arrihet në një rajon me barrë të rëndë historike", tha Z. Tamas Marghescu, Drejtori i atëhershëm i Zyrës Rajonale të IUCNsë për Evropën, gjatë fjalës së tij në fund të ceremonisë "Fitore e madhe për Harkun Dinarik". Aktiviteti u organizua nga partnerët e IHDsë, nën kujdesin e WWF më 29 maj 2008, gjatë konferencës së 9<sup>te</sup> të Palëve të Konventës për Shumëllojshmërinë Biologjike në Bon (Gjermani). Në takim ishin të pranishëm pesë ministra dhe një sekretar shteti nga autoritetet përgjegjëse për ruajtjen e natyrës në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Malin e Zi, Serbi dhe Slloveni, të cilët qëndruan përballë njëri tjetrit duke paraqitur angazhimin e tyre të lartë dhe të vendeve përkatëse. Qeveritë*

21 Termi *polje* i referohet një rrafshi të madh (shumë kilometra i gjatë) i mbyllur/në kushte depresioni brenda një terreni karstik. Ai përdoret gjerësisht për qëllime bujqësore. Në këtë artikull, termi origjinal '*polje*' preferohet në vend të përkthimit më të zakonshëm nga Anglishtja ('fushë').



nënshkruan një Marrëveshje të Përbashkët për ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të eko-rajonit të Harkut Dinarik. Kjo veprimtari simbolizonte evolucionin e IHDsë në realizimin e një aksioni të përbashkët me qëllime të mirëpërcaktuara. Me këtë rast, secili prej ministrave shpalli përparësitë kombëtare të ruajtjes së natyrës për zonën Dinarike, zbatimin e cilave do të vijonte në vitet pasuese. Anëtarët e IHDsë e identifikuan këtë qasje si mënyrën më të efektshme, e cila kur kombinohet me angazhimin publik të funksionarëve të lartë, i bën qeveritë të raportojnë ndaj donatorëve dhe shoqërisë civile në përgjithësi.

#### *Mjedisi për njerëzit në Harkun Dinarik*

Duke u mbështetur në pikat e forta të Deklaratës së Përbashkët 'Fitorja e madhe për Harkun Dinarik' (shih pikën 5b më lart), IUCN, WWF dhe SNV nxitën një projekt tre-vjeçar (2009–2012), që titullohej "Mbështetja e komuniteteve rurale dhe e peizazheve tradicionale përmes fuqizimit të qeverisjes në zonat e mbrojtura ndërkufitare të Harkut Dinarik."<sup>22</sup>

Projekti gjithashtu titullohej "Mjedisi për njerëzit e Harkut Dinarik" dhe mbështetej nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës. Ai 'u projektua që të promovonte vlerat natyrore dhe kulturore të zonës duke përmirësuar jetesën e popullsisë vendase, përmes bashkëpunimit më të mirë rajonal dhe fuqizimit të qeverisjes mjedisore'<sup>23</sup>. Në këtë kontekst, janë zhvilluar shumë aktivitete nga tre organizatat partnere të projektit, i cili përfshin edhe zonat e mbrojtura në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Malin e Zi dhe Serbi. Objektivat kryesorë të projektit janë nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm; ngritja e kapaciteteve të komuniteteve vendore dhe rritja e dialogut ndërkufitar në rajon, përmes pjesëmarrjes së aktorëve; dhe integrimi i aktiviteteve të planit të veprimit në një kornizë më të gjerë evropiane

22 <http://www.iucn.org/about/union/secretariat/offices/europe/places/belgrade/projects/?6330/Environment-for-People-in-the-Dinaric-Arc>

23 *Ibid.*

për ruajtjen e natyrës.<sup>24</sup> Politikat kryesore dhe planet e veprimit si Brezi i Gjelbër, *Countdown 2010* dhe *Natura 2000* u promovuan tek aktorët vendorë dhe rajonalë si mjete për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe atyre mjedisore në rajonin e Harkut Dinarik. Shumica e elementëve të projektit ishte marrë nga përvojat e mëparshme të IHDsë. E rëndësishme është se zbatimi i tij furnizon 'biznesin e partnerëve' me 'oksigjen', meqë ofron më shumë burime për aktivitetet tradicionale, kulturore dhe natyrore të ruajtjes. Së fundi, ai ofron mundësi unike për organizimin e takimeve të mëdha dhe përfshirjen e një numri të madh aktorësh.



© IUCN / Boris Erg

*Programi ndërkufitar i zhvillimit rural Prokletije/Bjeshkët e Namuna*

Me lehtësimin e SNVsë, një pjesë e veçantë e projektit "Mjedisi për njerëzit e Harkut Dinarik" iu dedikua zhvillimit të aktiviteteve ndërkufitare për Malet *Prokletije/Bjeshkët e Namuna*, një rajon i largët që ndahet mes Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi. Infrastruktura e papërshtatshme, mungesa e investimeve e sipërmarrjes dhe mungesa e planifikimit afatgjatë në mirëpërdorimin e tokës kanë sjellë krijimin e ndjenjës së harresës, emigrimin masiv dhe braktisjen rurale. Për të bërë të njohura nevojat e rajonit dhe shihthe vazhdimësinë në të ardhmen, një grup ekspertësh në fushën e planifikimit u takua me shumë organizata dhe individë nga i gjithë rajoni dhe realizoi kërkime në dokumentat publikë dhe botimet rajonale.

Objektivi kryesor i këtyre aktiviteteve ishte përmirësimi i kushteve social-ekonomike të njerëzve në këtë rajon, përmes përfshirjes së elementëve të rëndësishëm ekologjikë ndër-shtetërorë dhe të ndërtimit të paqes. Projekti *Prokletije* ofroi një mundësi unike jo vetëm përmes ndikimit pozitiv transformues në jetën e disa prej njerëzve më të varfër në Evropë, por gjithashtu edhe në kontributin afatgjatë për një nga 'perlat më të ruajtura ekologjike' të rajonit. Kjo nismë

krijoi përfitime konkrete për paqen e komuniteteve që jetonin të ndara si pasojë e konflikteve dhe krijoi një model bashkëpunimi e zhvillimi ndërkufitar.

### **Cili do jetë skenari për të ardhmen e IHDsë: "Degradimi' apo përmirësimi"?**

Pas gjashtë vitesh takime të rregullta dyvjeçare, të mbajtura në vende të ndryshme dhe të organizuara me rotacion nga anëtarët e ndryshëm të nismës, komuniteti i IHDsë u përball me atë që mund të quhet 'frika e zgjerimit'. Në takimin e tretë të organizuar së fundi në Malin e Zi në nëntor 2010, u zhvillua një diskutim intensiv për identifikimin e anëve të forta dhe të dobta të platformës, për të gjetur rrugën më të mirë që do të çonte në ecjen përpara. Ndërsa numri i pjesëmarrësve në nismë ka vijuar të rritet, të njëjtët elementë që gjithmonë njiheshin si avantazhet e IHDsë si p.sh interesat e përbashkëta të vërteta të ruajtjes së natyrës dhe kulturës ('shpirti' i IHDsë), mungesa e angazhimeve zyrtare, kapaciteti për mobilizimin e burimeve sipas veprimtarive të përbashkëta lobues, janë kthyer shpejt në kufizime të platformës së zhvillimit.

Diskutimi përfundoi duke përcaktuar skenarët e mundshëm të së ardhmes për IHDnë. I pari është që të zvogëlohet ambicja dhe nisma të mbahet në kufijtë e një platforme mirë-funksionuese bashkëpunimi. E dyta është që të 'përmirësohet' puna në drejtim të krijimit të një organizimi zyrtar me strukturimin e duhur, e cila të mund të përballlet me kompleksitetin në rritje të numrit të madh të anëtarëve dhe aktiviteteve. Pjesëmarrësit arritën në konsensusin që takimi i radhës i IHDsë do t'i kushtohet posaçërisht çështjeve të qeverisjes së brendshme.

24 Për detaje të mëtejshme shih <http://www.dinaricarc.net/project.html>.

# 5. Liqenet e Prespës – Aty ku fiton Diplomacia e Gjelbër

Aleksandar Ivanovski<sup>1</sup>

## Gjeografia e zonës

Rajoni i dy liqeneve, që i bashkon bukuria natyrore, shtrihet mes tre vendeve që kanë status ekonomik, ndërgjegjësim dhe politika të ndryshme mjedisore, por që ndajnë një ideologji të shprehur për mbrojtjen dhe menaxhimin e integruar të ekosistemit mjedisor. Pellgu i Liqeneve të Prespës

izolim relativ të florës dhe faunës në lartësitë e mëdha të vargmaleve rrethuese, të cilat shërbyen si vendstrehimi gjatë periudhës së Pleistocenit (periudha e akullnajave).

Sipërfaqja e përgjithshme e basenit të Prespës është rreth 1,600 km<sup>2</sup>, 62% e së cilës shtrihet në Maqedoni, 17% në Shqipëri dhe 21% në Greqi. Perla shqiptare e Liqenit të Prespës është Parku Kombëtar i Prespës prej 13,500 ha (shpallur më 1999), i cili shtrihet nga masivi i Malit të Thatë në



© Aleksandar Ivanovski

shtrihet mes Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë dhe përfshin liqenin e madh dhe të vogël të Prespës, së bashku me tributarët e përhershëm ose të përkohshëm që ushqejnë dy liqenet. Shumëllojshmëria i formave gjeomorfologjike, hidrologjia e dallueshme dhe biodiversiteti unik e bëjnë basenin e Liqeneve të Prespës një trashëgimi superiore, që mbart vlera me rëndësi të jashtëzakonshme. Baseni i Prespës ka një ansambël unik llojesh dhe habitatesh, i cili pasqyron përshtatjen e florës dhe faunës ndaj tabanit të ndryshëm gjeologjik të secilit varg malor (kryesisht silikate dhe gur gëlqeror), llojeve të ndryshme të tokës, lartësisë mbi nivelin e detit (850 – 2641 m) dhe ndikimit të klimës mesdhetare dhe asaj kontinentale. Ai gjithashtu reflekton izolimin e florës dhe faunës ujore të liqenit, gjatë 12 milionë viteve të fundit, dhe

jug, për të kaptuar në lindje pjesën fundore të kufirit shqiptar në Prespën e Vogël me Greqinë. Parku Kombëtar i Prespës në Shqipëri dhe Parku Kombëtar *Galičica* në Maqedoni janë pjesë e të njëjtit masiv malor. Në pjesën maqedonase të Prespës ndodhen tre zona të mbrojtura: Parku Kombëtar *Galičica*, i shpallur më 1958, Parku Kombëtar *Pelister*, i shpallur më 1948, me strukturë menaxhuese të plotë dhe operacionale; Zonën e Ruajtjes Strikt të Natyrës së *Ezeranit*, e shpallur më 1996, pa strukturë aktive menaxhimi dhe që momentalisht është në proces rivlerësimi dhe rishpalljeje. Në 1974, në anën greke u shpall Pylli Kombëtar i Prespës, i cili u ndoq me shpalljen e Parkut Kombëtar të Prespës më 2009 dhe u përqendrua në pjesën tokësore të Prespës greke, për të mbrojtur sipërfaqen e pellgut ujëmbledhës të basenit të Prespës së Madhe dhe asaj të Vogël. Për më tepër, sipas Konventës Ramsar, baseni si një i tërë, i Liqeneve të Prespës,

<sup>1</sup> Specialist projekti, PNUD, Maqedoni.

konsiderohet Ligatinë e Rëndësisë Ndërkombëtare. Ruajtja e këtij ekosistemi hap shtegun për bashkëpunim trepalësh dhe zhvillimin e marrëveshjeve që shërbejnë si mjet për diplomacinë e gjelbërt.

Në basenin e Liqenit të Prespës jetojnë 29,343 banorë: 57% e popullsisë jeton në Maqedoni në Bashkinë e Resenit, 36% jetojnë në Shqipëri në Komunitat e Liqenasit dhe Progrit, dhe pjesa e mbetur 7% jeton në Greqi në Bashkinë e Prespës. Burimi kryesor i të ardhurave dhe sektori më i rëndësishëm prodhues është bujqësia. Rreth 75% e krahut total të punës në basenin e Prespës merren me bujqësi.

### **Momentet kryesore në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar**

Procesi i bashkëpunimit ndërkufitar në basenin e Prespës filloi në 2 shkurt 2000, kur kryeministrat e Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë nënshkruan një Deklaratë të Përbashkët në fshatin *Aghios Germanos*. Deklarata për krijimin e Parkut Kombëtar të Prespës thotë se "Liqenet e Prespës dhe pellgu ujëmbledhës rrethues janë unikë për gjeomorfologjinë, begatinë ekologjike dhe biodiversitetin e tyre, që i jep rajonit një rëndësi të madhe ndërkombëtare. Ruajtja dhe mbrojtja e një ekosistemi të kësaj rëndësie jo vetëm që i bën natyrës një shërbim, por edhe krijon mundësitë për zhvillim ekonomik të zonave fqinje në tre vendet." Deklarata i shpall Liqenet e Prespës dhe pellgun ujëmbledhës përreth si Parkun e Prespës dhe shënon rastin e parë të përpjekjeve për shpalljen e një zone të mbrojtur ndërkufitare, në Evropën Juglindore. Rezoluta e Deklaratës premtonte "rritjen e bashkëpunimit për çështjet mjedisore, mes autoriteteve kompetente të tre vendeve që lagen nga liqenet. Në këtë kontekst duhen marrë në konsideratë veprimtaritë e përbashkëta me qëllim që të ruhen dhe mbrohen vlerat unike ekologjike të Parkut të Prespës, të parandalohen ose sprapsen shkaqet që çojnë në degradimin e habitateve, të eksplorojnë metodat e duhura menaxhuese për përdorimin e qëndrueshëm të ujit të Liqeneve të Prespës, duke mos kursehen përpjekjet për ta kthyer Parkun e Prespës në një model për llojin e tij dhe një referencë shtesë për paqen dhe bashkëpunimin mes vendeve tona". Nisma që udhëhoqi Deklaratën e Kryeministrave ishte e natyrës nga lart-poshtë, ku fillimisht, pjesëmarrja e aktorëve vendorë në këtë vendimarrje, ishte shumë e kufizuar. (Bogdanović 2007). Deklarata hodhi me sukses themelet për një pjesë të konsiderueshme të punës ndërkufitare që vijoi më pas.

Në 2002, pas nënshkrimit të marrëveshjes së Prespës, tre ministrat përgjegjës për mjedisin të vendeve respektive krijuan Komitetin për Koordinimin e Parkut të Prespës (*në angl.:* PPCC), si entitet pa autoritet detyrues ligjor, anëtarët e të cilit caktoheshin nga tre ministrat. Anëtarësia e PPCCsë përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të renditura më

poshtë, nga secili vend: Ministrinë përgjegjëse për mjedisin, OJQtë, qeveria vendore dhe një vëzhgues i përhershëm monitorues i MedWet<sup>2</sup>. Pengesat kryesore të funksionimit të PPCC janë se tre qeveritë nuk kanë angazhim politik për të mbështetur PPCCnë dhe se vendimet e PPCCsë shërbejnë më shumë si këshilla, se sa si angazhime ligjore të detyrueshme për tre vendet. Sekretariati i PPCCsë u krijua nga tre OJQ, një nga çdo vend, dhe mori mbështetje të fuqishme nga WWF Greqi, që financoi Shoqatën për Mbrojtjen e Prespës, ku u vendos Sekretariati.

Diplomacia e gjelbër në rajonin e Prespës është e orientuar drejt dy objektivave kryesore. Njëri është shfrytëzimi i mjedisit për të lehtësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të caktuara politike mes tre vendeve, ndërsa i dyti është për përdorimin e mjeteve politike në funksion të zgjidhjes së çështjeve mjedisore mes tre vendeve (Ivanovski 2010). Aktualisht, diplomacia e jashtme mes Greqisë dhe Maqedonisë është kyçur me një çelës të ndryshkur për shkak të 15 viteve mosmarrëveshje në lidhje me emrin. Prespa është territori ku luhen të gjitha lojrat politike dhe motori kryesor lëvizës është mjedisi. Mekanizmi që nxiti fillimet e bashkëpunimit trepalësh, ishte nënshkrimi në 2010 i Marrëveshjes Trepalëshe për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Zonës në Parkun e Prespës, me rastin e përvjetorit të dhjetë të Parkut të Prespës. Me autorizimin e qeverive përkatëse, marrëveshja u nënshkrua nga tre ministrat përgjegjës për mjedisin në Shqipëri, Maqedoni dhe Greqi. Marrëveshja e çliruar nga politika, ofron angazhimin ligjor të vendeve për të mbrojtur këtë perlë të Ballkanit. Ajo ka shtruar në mënyrë të qartë përpara rrugën për punën në mbrojtjen mjedisore të ekosistemeve ujore dhe tokësore dhe nxitjen e vullnetit politik për bashkëpunim mes Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë.

### **Përfitimet dhe sfidat**

Në vitin 2000, para se të fillonte kjo nismë, praktikat e paqëndrueshme të menaxhimit të burimeve si: përdorimi i ujit dhe praktikat bujqësore të përdorimit të tokës, pyjeve dhe peshkimit dështuan që të ruanin dhe rivendosnin ekuilibrat natyrorë në ekosistemin e Liqeneve Ndërkufitare të Prespës. Njohuritë, përvojat dhe barrierat motivuese pengonin aftësinë e njerëzve për të mësuar, kuptuar dhe përshtatur praktika të reja. Përdorimi i praktikave të vjetra, ndarja e papërshtatshme e tokës dhe përdorimi i ujit, ishin pengesë për aktorët që të gjenin zgjidhje efektive dhe praktike të problemeve. Si rezultat i tyre kërcënoheshin të zhdukeshin ose degradoheshin habitate të rëndësishme, të kërcënoheshin lloje me rëndësi globale dhe aktorët ishin të papërgatitur për të menaxhuar dinamikën e ndryshimeve të vazhdueshme të ekosistemit ujor në Liqenet e Prespës. Nisma ndërkufitare solli shumë ndryshime.

<sup>2</sup> Nisma Mesdhetare e Lagunave [www.medwet.org](http://www.medwet.org)

Një nga arritjet që shënoi bashkëpunimi ndërkuftar ishte krijimi në vitin 2002 i "Planit Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Parkut të Prespës", si hap i parë për zhvillimin e vizionit të përbashkët të punës, për ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të basenit të Prespës. Më specifikisht, qëllimi i Planit Strategjik të Veprimit<sup>3</sup> ishte të lehtësonte diskutimin për të ardhmen e bashkëpunimit dhe të shpjegonte në mënyrë sa më të qartë Nismat institucionale, ekonomike, menaxhuese dhe procedurat që duheshin ndërmarrë për të siguruar përbushjen e objektivave mjedisore (Shoqata për Mbrojtjen e Prespës *et al.* 2002). Megjithatë ka munguar angazhimi zyrtar i qeverive apo agjencive financuese ndaj planit, anëtarët e PPCC-së kanë ndjekur në mënyrë aktive zbatueshmërinë e aktiviteteve individuale që përmban plani.

Kjo nismë tërhoqi shumë donatorë ndërkombëtarë, të cilët kanalizuan burime për infrastrukturën, studimet tematike e shkencore dhe aktivitetet që forconin më tej bashkëpunimin ndërkuftar. Donatorët më aktivë në rajon janë MedWet, Banka KFW për Zhvillim, SDC, SIDA, NATO, SNV, GEF, dhe PUND. Në 2006, pas disa vitesh përgatitje filloi puna për zbatimin e Projektit UNDP-GEF "Menaxhimi i integruar i ekosistemeve në basenin e Liqeneve të Prespës, në Shqipëri, Maqedoni dhe Greqi", që njihet në rajon më shumë si Projekti Ndërkuftar i Prespës. Projekti ndërthur tre komponentë ekzekutivë, komponentin ndërkuftar, kombëtar shqiptar dhe komponentët maqedonas. Partneri grek është Shoqata Joqeveritare Shkencore për Mbrojtjen e Prespës. Objektivi kryesor i Projektit Ndërkuftar të Prespës është të katalizojë përshtatjen dhe zbatimin e ndërhyrjeve menaxhuese në ekosistem për të arritur integrim të objektivave ekologjike, sociale dhe ekonomike. Ky objektivi është në linjë me ruajtjen e biodiversitetit global dhe parandalimin apo zvogëlimin e ndotjes. Mirëqenia e ekosistemit të basenit të Prespës mund të ruhet dhe mirëmbahet duke ndryshuar praktikën prodhuese në këtë rajon. Kjo është në linjë me strategjinë e projektit për përfshirjen e objektivave dhe përparësive të menaxhimit të ekosistemit në politikën dhe praktikën e sektorit prodhues. Projekti synon të forcojë kapacitetet në rivendosjen e mirëqenies të ekosistemeve dhe ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, fillimisht në nivel vendor duke pilotuar qasje të orientuara drejt ekosistemeve dhe deri në planifikimin hapësinor, menaxhimin e përdorimit të ujit, bujqësinë dhe menaxhimin e pyjeve e peshkimit, menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe ato të ruajtjes (PUND/GEF 1997).

Rezultati më i rëndësishëm që pritët prej këtij projekti është se duke shtrirë themelet e bashkëpunimit për basenin e Prespës në nivel kombëtar, bashkëpunimi ndërkuftar për

menaxhimin dhe ruajtjen e burimeve të forcohet duke fuqizuar institucionin ndërkuftar ekzistues dhe duke pilotuar aktivitete të ruajtjes së natyrës dhe menaxhimit ndërkuftar.

Zhvillimet kryesore që kanë kontribuar më shumë drejt bashkëpunimit efektiv trepalësh, janë si më poshtë:

#### *Zhvillimi i sistemit ndërkuftar të monitorimit*

Ky është një aktivitet i përbashkët i Projektit (PUND-GEF) Ndërkuftar të Prespës, Shoqatës për Mbrojtjen e Prespës dhe Tour de Vallat<sup>4</sup>. Sistemi monitorues përfshin monitorimin e përdorimit të tokës, cilësisë dhe sasisë së ujit, pyjeve dhe habitateve të tjera tokësore, shpendve, peshqve dhe peshkimit, habitateve ujore dhe vegjetacionit. Projekti Ndërkuftar i Prespës parashikon zhvillimin e një sistemi ndërkuftar të monitorimit përmes koordinimit të Grupit të Punës për Ruajtjen dhe Monitorimin (MCWG). Përgjegjësia kryesore e MCWG është të udhëheqë zhvillimin e sistemeve ndërkuftare të monitorimit që bazohen në mirëkuptimin mes palëve, në përputhje me parimet dhe praktikën më të mira ekzistuese dhe të japë mendime në lidhje me komponentët e tjerë shkencorë të Projektit Ndërkuftar të Prespës. Tour du Vallat luan një rol teknik në zhvillimin e sistemit ndërkuftar të monitorimit.

#### *Menaxhimi ndërkuftar i ujërave*

Në vitin 2008 u krye një vlerësim i situatës në lidhje me menaxhimin e ujërave në tre vendet. Procesi i menaxhimit ndërkuftar të ujit në Prespë mori më tepër vlerë përmes përshkallëzimit të bashkëpunimit nga dypalësh Greqi – Komisioni Shqiptar i Ujit, në tre-palësh me përfshirjen edhe të Maqedonisë. Ky mund të konsiderohet një kontribut i rëndësishëm i Projektit të Prespës në mbështetjen e procesit ose ndikimin në planifikimin në nivelin e lartë të vendimmarrjes për sa i përket menaxhimit të ujërave. Projekti synon krijimin e një sistemi të rregullt takimesh mes grupit të punës për Menaxhimin e Ujit të Prespës.

#### *Burimet peshkore dhe peshkimi ndërkuftar – plani ruajtës dhe menaxhues*

Për të ndihmuar krijimin e një plani ndërkuftar për menaxhimin e burimeve peshkore dhe peshkimit u zhvillua analiza e situatës dhe u dhanë propozime në lidhje me hapat që duhen marrë më tej. Parashikohet që hapat e propozuar të diskutohen dhe miratohen nga ministrinë përkatëse të tre vendeve, me qëllim që të ndërmerret zbatimi konkret i tyre.

<sup>3</sup> [http://www.prespark.org/files/contentImages/file/Strategic\\_Action\\_Plan\\_2003\\_Executive\\_Summary.pdf](http://www.prespark.org/files/contentImages/file/Strategic_Action_Plan_2003_Executive_Summary.pdf)

<sup>4</sup> Qendër kërkimore për ruajtjen e ligatinave mesdhetare që ndodhet në Francë.



*Analiza e diagnostikimit ndërkufitar dhe procesi i planifikimit të veprimeve strategjike*

Puna për Analizën e Diagnostikimit Ndërkufitar (ADN)<sup>5</sup> dhe Procesi për Planin Strategjik të Veprimit (PSV) pothuajse ka përfunduar. Projekti i Prespës po punon për përditësimin e vizionit strategjik për basenin e Liqenit të Prespës dhe të PSVsë përmes zbatimit të analizës diagnostikuese ndërkufitare. Raporti i ADN-së është diskutuar me aktorët kryesorë dhe ka përfunduar puna për finalizimin e tij. Pritet që PSV të përshtatet, miratohet dhe përfundohet nga tre qeveritë.

### **Mësimet e nxjerra dhe parashikimi për të ardhmen**

Pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe për Mbrojtjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Parkut të Prespës mes Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë në shkurt 2010, tre vendet janë në procesin e ratifikimit të marrëveshjes në parlamentet përkatëse. Për krijimin e trupës ndërkufitare të menaxhimit ose Komitetit për Menaxhimin e Parkut të Prespës, janë caktuar tre përfaqësues nga secili vend. Anëtarët e Komitetit përfshijnë përfaqësues të qeverive të cdo vendi (ministritë përgjegjëse për mjedisin, qeveritë vendore, bashkitë e rajoneve që lagen nga liqenet) dhe OJQtë. Sapo të përfundojë miratimi i marrëveshjes nga tre vendet, Komiteti Menaxhues i Parkut të Prespës do të zyrtarizojë ekzistencën e tij dhe punën e bërë deri më tani.

Klisheja politike e bërjes së gjërave në tryezën e rrumbullakët të diskutimeve diplomatike duhet të zgjidhet vetëm për çështjet që kërkojnë aftësi të shkëlqyera profesionale. Diplomacia e gjelbër po fiton duke hapur rrugë për punët që duhen kryer për mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit, deri në fund (Broadhead 2002) dhe po hap dyert e zgjidhjes për mosmarrëveshjet politike të nivelit të lartë. Nisma ndërkufitare për mbrojtjen e mjedisit në basenin e Liqenit të Prespës ka shtruar rrugën për mbrojtjen mjedisore në Liqenin e Prespës dhe atë të bashkëpunimit me politikën skrupuloze, përmes kufijve. Niveli i diskutimit duhet të jetë lidhur me situata dhe alternativa pozitive, megjithëse në rastin ideal, arritjet e diplomacisë shkojnë edhe më përtej. Ajo arrin të krijojë sinergji për përfitimet mjedisore, bashkëpunimin politik dhe çfarë është më e rëndësishmja, krijon besimin (Du Nann 1997). Besimi mes tre vendeve vazhdon të shërbejë si një magnet tërheqës për donatorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët i kanalizojnë burimet e tyre për një bashkëpunimin edhe më të fortë mes Maqedonisë, Shqipërisë dhe Greqisë, në basenin e Liqeneve të Prespës.

### *Pikat e përbashkëta të takimit në komunikimin ndërkufitar*

Përveç hartimit të dy faqeve të internetit për PPCC ([www.prespa.org](http://www.prespa.org)) dhe për projektin e Prespës (<http://prespa.iwlearn.org/>), është përgatitur edhe një seri materialesh të tjera komunikuese. Mjetet e komunikimit dhe Strategjia për Edukimin dhe Ndërgjegjësimin Publik në lidhje me PPCC shënojnë arritjen e njërit prej momenteve më të rëndësishme të procesit.

### *Procesi ndërkufitar i njohjen dhe menaxhimin e llojeve dhe habitateve*

Projekti Ndërkufitar i Prespës synon fuqizimin e shumëllojshmërisë biologjike përmes përmirësimit të aktivitetit monitorues dhe kërkues me fokus të qartë, me qëllim që zonat e mbrojtura në Prespë të shërbejnë si vendstrehim efektiv për biodiversitetin. Në këtë aspekt, është njoftuar edhe një nismë për identifikimin e llojeve dhe habitateve ndërkufitare. Qëllimi i saj është që të merren masat paraprake për ruajtjen e llojeve dhe habitateve kryesore dhe të punohet drejt zhvillimit të planeve të veprimit për llojet dhe habitatet e përfshira.

<sup>5</sup> <http://prespa.iwlearn.org/>.

# 6. Bashkëpunimi në Arktik – Parku tre-palësh Pasvik-Inari

Marina Trusova<sup>1</sup>

## Gjeografia e zonës

Rajoni Pasvik-Inari, zona ku takohen kufijtë e Finlandës, Norvegjisë dhe Rusisë është unik në shumë aspekte. Lugina e lumit Pasvik shtrihet nga lumi Linar drejt detit Barents dhe formon një habitat të favorshëm për shumë lloje të ndryshme të botës bimore dhe shtazore. Disa prej këtyre llojeve janë në limitet e fundit të ekzistencës së tyre në këtë zonë.



© Parku trepalësh i Pasvik Inari

Lumi Pasvik dhe bota e egër përfaqësojnë një gjenden në anën veriperëndimore të zonës së pyllit verior të tajgës, me shtrirje drejt veriut nga pylli subalpine me *Betula pubescens*. Lumi rrethohet nga kënetat e mëdha dhe një pyll i vazhduar me pisha, që ndërpritet nga moçale dhe liqene të vogla. Ai mbulon një zonë të gjerë mes liqenit Inari dhe Rezervës Natyrore të Shtetit Pasvik, në Rusi (Pasvik Zapovednik).

Kushtet klimatike të Evropës Veriore janë të ashpra për bimësinë, kafshët dhe njerëzit. Vera është e shkurtër dhe dimri zgjat shumë muaj.

E përbashkëta mes tre vendeve, në këtë zonë, është gjuha dhe natyra. Ky rajon i thellë i Arktikut është banuar shumë kohë më parë nga finlandezët, norvegjezët, rusët dhe indigjenët Sami të këtij rajoni. Sistemi ujor ka qenë në shekuj një burim i rëndësishëm jetese për banorët vendas. Peshkimi dhe gjuetia e shpendëve ujorë, blegtoria e drerit dhe bujqësia përfaqësojnë burimet kryesore të jetesës. Lumi ishte gjithashtu një rrugë e rëndësishme transporti për tregjet pranë detit Barents.

Rajoni me rëndësi historike i Pasvik-Inarit është një pikë takimi për kulturat e ndryshme. Për shekuj me rradhë, kjo zonë është banuar nga njerëzit Sami. Që në fillimet e mesjetës, në zonë janë vendosur edhe finlandezët, norvegjezët dhe rusët. Megjithatë kulturat e ndryshme kanë bashkëzotuar dhe kanë mësuar shumë nga njëra tjetra, ato kanë ruajtur traditat e tyre të ndryshme.

Ngjarjet e mëvonshme historike si nënshkrimi i traktateve ndërkombëtare për krijimin e kufijve kombëtarë, zbulimin dhe nxjerrjen e depozitave të bakrit dhe nikelit, ndërtimin e shtatë hidrocentraleve për prodhimin e energjisë elektrike (HEC) në lumin Pas dhe Lufta e Iltë Botërore, sollën ndryshime graduale në rajonin Pasvik-Inari. Këto ngjarje s'kishin si të mos ndikonin në popullsinë vendase dhe menaxhimin natyror. Kjo zonë ndërkufitare njihet në gjithë botën si një vend i qetë, plot me shpendë dhe peshq. Megjithatë, pranë kufijve kombëtarë (Nikel dhe Kirkenes) kryejnë aktivitetin e tyre disa miniera, kompanitë e hidrocentraleve të prodhimit të energjisë (HEC) që po zgjerojnë biznesin, fermat e gjedhëve dhe shpendëve, blegtoria e drerëve dhe rojet kufitare të rajonit. Megjithatë, popullsia vendase praktikon ende peshkimin, gjuetinë dhe mbledhjen e frytave të pyllit, aktiviteti njerëzor ka ndikuar shumë mbi natyrën. Shfrytëzimi i burimeve natyrore është rritur, sikundër dhe degradimi i mjedisit, për shkak të shtimit të aktivitetit industrial dhe transportit.

Për të ruajtur madhësinë e këtyre territoreve të egra, në tre vendet fqinje janë shpallur disa zona të mbrojtura. Në ditët e sotme, ofrohet mbrojtje për një zonë të madhe bashkëpunimi tre-palësh, që shtrihet ndërmjet tre kufijve kombëtarë dhe përbëhet nga Zona e Egër *Vätsäri* në Finlandë (1,550 km<sup>2</sup>); Parku Kombëtar *Øvre Pasvik* (119 km<sup>2</sup>), Zona e Mbrojtjes së Peizazhit *Øvre Pasvik* (54.2 km<sup>2</sup>) dhe Rezerva e Parkut *Pasvik* në Norvegji (19.1 km<sup>2</sup>); dhe *Pasvik Zapovednik* në Rusi (14,700 km<sup>2</sup>).

<sup>1</sup> Nën-drejtor i "Ecological Enlightenment", Rezerva Natyrore Shtetërore e Pasvik (Pasvik Zapovednik), Rusi

## Momentet kryesore të zhvillimit historik

Në 1978, pjesa norvegjeze e liqenit *Höyhenjärvi (Fjærvann)*, si dhe pjesa e lumit *Pasvik* u propozuan si rezervë natyrore, për shkak të vlerave të madha natyrore. Në 1989, kur Rusia dhe Norvegjia nënshkruan marrëveshjen e parë dypalëshe për çështjet e mjedisit, lindi ideja për krijimin e një rezerve të përbashkët natyrore Rusi – Norvegji. Ideja u diskutua në një takim mes Guvernatorit të Kontesë Finnmark dhe Komitetit të Mjedisit në Murmansk. Më vonë, autoritetet më të larta në dy vendet dhanë miratimin e tyre për vazhdimin e punës rreth një propozimi konkret, i cili u mbështet nga Komisioni i përbashkët norvegjezo-rus për Çështjet e Mjedisit. Pas inspektimit të parë norvegjezo-rus të zonës, më 1990, ekspertët rusë propozuan që në rezervë të përfshiheshin pjesë të mëdha pylli që shtriheshin në bregun perëndimor të lumit *Pasvik*, duke e rritur sipërfaqen me një hapësirë shumë më të madhe se thjesht lumi *Höyhenjärvi (Fjærvann)* i pjesës ruse. Inspektimi i parë i përbashkët norvegjezo-rus u ndoq nga disa takime dhe monitorime shpendësh.

Marrëveshja mes Norvegjisë dhe Ruisë e vitit 1990, e shihte mbrojtjen e natyrës në zonat kufitare në një perspektivë më të gjerë, dhe konsideronte edhe Finlandën si një partner shumë të rëndësishëm. Në 1991, autoritetet mjedisore nga Rusia, Norvegjia dhe Finlanda u takuan fillimisht në Kirkenes dhe sërish më pas në Nikel. Konkluzioni i takimeve ishte se tre vendet duhej të bashkëpunonin për mbrojtjen dhe menaxhimin e natyrës në rajonin e *Pasvik Inarit* në nivel vendor. Për më tepër, palët synonin të siguronin mbrojtjen e një zone të madhe të padëmtuar, si njësi të vetme. Në po të njëjtin vit u krijua në Finlandë Zona e Egër e *Vätsärit*, me Aktin Kombëtar të Botës së Egër.

Që nga 1991, janë mbajtur takime vjetore trepalëshe për menaxhimin e natyrës dhe mbrojtjen e rajonit *Pasvik-Inari* me pjesëmarrjen e: Zydrës së Guvernatorit të Kontesë Finnmark dhe Drejtorisë për Menaxhimin e Natyrës të Norvegjisë; *Metsähallitus* (Shërbimit të Trashëgimisë Natyrore, Lapland), Ministrisë së Mjedisit dhe Qendrës Rajonale të Mjedisit të Finlandës; dhe Komitetit Shtetëror për Mjedisin, Komitetit për Burimet Natyrore dhe Administrimin të *Pasvik Zapovednik* të Ruisë. Dy marrëveshje ndërqeveritare në fushën e mbrojtjes së natyrës (Finlandë-Rusi në Prill 1992 dhe Norvegji–Rusi në Shtator 1992) shërbyen si sfond për bashkëpunimin e mëvonshëm trepalësh.

Rezerva Natyrore *Pasvik /Pasvik Zapovednik* u themelua formalisht më 16 Korrik 1992 duke u mbështetur në rezolutën e miratuar nga qeveria ruse, ndërsa pjesa norvegjeze e Rezervës Natyrore *Pasvik* u shpall zyrtarisht më 15 Tetor 1993, përmes një akti ligjor. Për t'i dalluar dy pjesët e parkut nga njëra tjetra, pjesa ruse quhet *Pasvik Zapovednik* dhe ajo norvegjeze si Rezerva Natyrore

*Pasvik*. Në 1996, pjesa norvegjeze mori statusin Ramsar të mbrojtjes ndërkombëtare, për shkak të faunës së pasur dhe karakteristike të shpendëve të ujit. Pjesa ruse e zonës gjithashtu është propozuar për statusin Ramsar.

Më 1999, bashkitë e *Pechenga, Inari* dhe *Sør-Varanger* u përfshinë në bashkëpunimin trepalësh më të qëndrueshëm. Rajonet e këtyre bashkive përcaktojnë kufijtë aktual të zonës së bashkëpunimit trepalësh. Pjesëmarrësit në takimin trepalësh të 2002 vendosën të promovonin një zonë të mbrojtur të përbashkët mes tre palëve në *Pasvik-Inari*, e cila mund të shpallej duke lidhur zonat e mbrojtura fqinje, që ishin krijuar tashmë. Një grup pune e zhvilloi më tej këtë ide. Në 2003, Parku Kombëtar *Øvre Pasvik* u zgjerua dhe u krijua zona e Peizazhit të Mbrojtur *Øvre Pasvik*. Përfundimisht, në po të njëjtin vit, u shpall zona e mbrojtur e vazhduar natyrore, që fillonte në Finlandë, kalonte përmes Norvegjisë, e shtrihet deri në Rusi.

## Përfitimet dhe sfidat

Nga marsi 2006 deri në janar 2008, u realizua planifikimi i një projekti të përbashkët në kuadër të financimeve të BE-së (Interreg IIIA, Programi i Fqinjësisë të Kolarktikut Verior/ Programi Tacis) për zonën *Pasvik-Inari*. Ideja u përkrah nga Këshilli Barenc i Mjedisit përmes deklaratave të 2003, 2005 dhe 2007. Projekti bënte thirrje për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe turizmin e qëndrueshëm natyror, në zonën *Inari-Pasvik*, e cila kishte si qëllim krijimin e një baze më të qëndrueshme për bashkëpunimin trepalësh. Gjatë projektit, u krijuan lehtësi për turizmin natyror dhe u formuan grupe të ndryshme interesi. Intensifikimi i bashkëpunimit për monitorimin e natyrës çoi në testimin e metodave të harmonizuara të monitorimit. Përveç kësaj, u zhvilluan materiale të plota informuese për zonën. U arrit të krijohej një bashkëpunim efektiv, i cili ishte me rëndësi që Parku Ndërkufitar të merrte statusin EUROPARK dhe të sigurohej bashkëpunimi afatgjatë dhe i nivelit të lartë në mbrojtjen dhe menaxhimin e parkut *Pasvik-Inari*.

Gjatë viteve të bashkëpunimit u zhvilluan gradualisht ide nga palët respektive. Për evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta të bashkëpunimit u përdor Analiza SWOT (Adams 2005). Përmes përcaktimit të rreziqeve dhe dobësive, u bë i mundur identifikimi i fushave të punës ku nevojitej ndërhyrje e mëtejshme.

Gjatë zbatimit të projektit, partnerët zhvilluan disa dokumente të përbashkëta, si Marrëveshja e Bashkëpunimit, Plani i Veprimit dhe Rregullorja Udhëzuese për Bashkëpunim. Në janar 2008, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Shërbimeve të Trashëgimisë Natyrore të Laplandit për *Metshällitus* (Finlandë), Rezervës Shtetërore të Natyrës *Pasvik Zapovednik* (Rusi) dhe Guvernatorit të Kontesë Finnmark.

Marrëveshja identifikoi fushat kryesore të bashkëpunimit dhe organizatat e përfshira në këtë bashkëpunim.

Zbatimi Planit të Veprimit u hartua në pajtim të plotë me vizionin e pranuar nga autoriteti vendim-marrës i këtij bashkëpunimi, Bordi Këshillimor i krijuar në vitin 2008. Bordi Këshillimor përbëhet nga përfaqësuesit e partnerëve kryesorë dhe të autoriteteve rajonale dhe vendore të tre vendeve. Në takimet e Bordit Këshillimor marrin pjesë gjithashtu rojet kufitare, kompanitë prodhuese, operatorët në fushën e turizmit dhe aktorë të tjerë.

Plani i Veprimit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Turizmin e Qëndrueshëm Natyror në zonën *Pasvik-Inari* shërben si themel për bashkëpunimin ndërkombëtar trepalësh, vizionin e pranuar në mënyrë të ndërsjelltë, objektivat e bashkëpunimit për të ardhmen dhe strategjitë e përbashkëta në arritjen e qëllimeve të caktuara. Gjithashtu, Plani i Veprimit përfshin informacione të natyrave të ndryshme në lidhje me kulturën, historinë, legjislacionin, përdorimin e tokës dhe menaxhimin, nivelet e mbrojtjes së natyrës nga vendet dhe legjislacionin kombëtar kufitar në tre vendet. Njohja e tyre nevojitet për planifikimin e veprimeve të përbashkëta.

Përmeshja praktike e bashkëpunimit trepalësh në rajonin *Pasvik-Inari* bazohet në strategjitë dhe funksionet e formuluar në Parimet dhe Planin e Veprimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit Natyror në Pasvik-Inari. Këto përfaqësojnë fusha të ndryshme partneriteti mes palëve.

Bashkëpunimi në veprimtaritë kërkuese dhe monitoruese përfaqësohet nga disa projekte monitoruese që janë zbatuar në ato zona. Në to, palët partnere të projektit kanë pasur si fokus kryesor pune, harmonizimin e metodave monitoruese për llojet kryesore si ariu i murrmë, (*Ursus arctos*), shqiponja e malit (*Aquila chrysaetos*), shpendët e ujit dhe milingonat. Për monitorimin e ariut të murrmë, partnerët kanë përdorur një metodë të re, që merr dhe analizon materialin gjenetik, përmes kurthit të qimeve. Kampionet e marra të qimeve u analizuan dhe u krahasuan me të dhënat e grumbulluara nga veprimtaritë e mëparshme monitoruese. Ato dhanë informacion të rëndësishëm rreth popullatave të ariut të murrmë në zonën *Pasvik-Inari*. Gjithashtu, partnerët realizojnë çdo vit monitorimin e shpendëve.

Partnerët kontribuojnë në përmirësimin e komunikimit dhe të infrastrukturës mes vendeve. Mes Finlandës dhe Norvegjisë është krijuar edhe një shteg alpin, i cili quhet Shtegu i Egër *Pilola*, me të gjitha lehtësirat e duhura (shenja sinjalizuese gjatë shtegut, tabela informacioni, shylla orientuese, vende për zjarr). Ceremonia e hapjes së Shtegut Alpin u ndoq nga përfaqësuesit e parkut tre-palësh *Pasvik-Inari*, përfaqësuesit e autoriteteve vendore dhe rajonale, dhe sipërmarrësit në fushën e turizmit të tre vendeve. Lehtësirat

që ju ofrohen vizitorëve mirëmbahen në mënyrë të rregullt. Gjithashtu, partnerët bashkëpunojnë për projektin e Muzeut të Hapur në Natyrë, i cili gjendet në ishullin kufitar Varlam të *Pasvik Zapovednik* në Rusi. Ishulli Varlam është një vend ku organizohen rregullisht festivale ndërkombëtare, festime të ndryshme dhe mbledhje apo takime mes ekspertësh.




Figura 6.1. Harta e parkut të Pasvik Inari

Edukimi mjedisor promovohet përmes mbështetjes së projekteve për fëmijët e shkollave, si 'Shkolla Mjedisore Barenç' në *Rajakoski*, 'Fenologjia e Kalotës së Veriut' dhe përmes publikimit të materialeve, si p.sh loja që zhvillon kujtesën, e titulluar 'Shpendët e Pasvikut', e cila shpërndahet e botuar në tre gjuhë.

Broshura 'Shkëmbimi i natyrës dhe historisë së Pasvik-Inarit' u përgatit bashkërisht nga partnerët e projektit, për të rritur popullaritetin e zonës në publik. Ajo shpërndahet në aktivitete të ndryshme, konferenca dhe seminare, etj.

Parku trepalësh Pasvik-Inari ka stemë të përbashkët dhe faqen në internet<sup>2</sup> me informacion në katër gjuhë: Norvegjisht, Finlandisht, Rusisht dhe Anglisht. Për përditësimin e faqes është përgjegjëse zyra e Guvernatorit të Kontesë Finnmark, ndërsa partnerët rusë dhe finlandezë përcjellin informacionet më të reja për të.

Për të forcuar bashkëpunimin trepalësh, partnerët aplikuan për certifikatën "Parku Ndërkufitar – në Ndjekje të Projektimit të Natyrës", e cila ju dha parkut trepalësh Pasvik-Inari nga Federata EUROPAC në vitin 2008. Certifikata krijon mundësi të reja për bashkëpunimin në fushën e menaxhimit natyror dhe rrit mundësitë për turizmin natyror. Ajo i jep parkut mundësinë të ruajë dhe mbrojë natyrën e tokës së vet, për brezat që do të vijnë. Certifikata rrit reputacionin e punës së partnerëve dhe të profilit të zonës Pasvik-Inari.

2 [www.pasvik-inari.net](http://www.pasvik-inari.net)

Mes partnerëve ekzistojnë kontakte të shumta me karakter jozyrtar me rëndësi për bashkëpunimin e frytshëm. Në vitin 2008 u festua bashkërisht 15 vjetori i Rezervës Natyrore Pasvik dhe Pasvik Zapovednik, ku u kalua kufiri mes tyre në Lumin Pasvik. Skuadra trepalëshe e skiatorëve të Pasvik-Inari prezantoi zonën e përbashkët të mbrojtur gjatë "Takimit miqësor të skive të Barentit". Ky takim i përvitshëm skish zhvillohet duke përshkuar kufijtë kombëtarë të tre vendeve.

## Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen

Përsa i përket përcaktimit të pikave të forta të bashkëpunimit, qëndrimi i partnerëve është i njëjtë. Jetëgjatësia shihet si një nga pikat e forta dhe më të rëndësishme të bashkëpunimit. Njerëzit njihen me njëri tjetrin dhe vlerësojnë ekspertizën e partnerëve të tjerë. Tradita e krijuar me takimet e përvitshme shërben si bazë e qëndrueshme për vazhdimësinë e punës në të ardhmen. Gjithashtu, dobësitë e brendshme njihen prej partnerëve, të cilët janë të ndërgjegjshëm për ndryshimet në legjislacion, menaxhimin e zonave natyrore të mbrojtura dhe mungesën e standardeve në lidhje me masat kufizuese, që janë specifike për secilin vend. Tashmë njihen dallimet që ekzistojnë në mënyrën e menaxhimit të projekteve dhe nevoja për financime nga burime të jashtme. Shkëmbimi i brendshëm i informacionit ndikohet nga kuptimi shpesh jo i njëjtë, pasi gjuha e komunikimit mes tre vendeve është e ndryshme, ndërkohë ndihet nevoja për t'i kushtuar më shumë vëmendje informacionit të jashtëm. Megjithatë, interesi në rritje për bashkëpunimin në nivelin vendor dhe përfshirja e grupeve vendase të interesit, konsiderohet një burim i madh.

Sipas një sondazhi (*Metsähallitus Natural Heritage Service Lapland et al. 2008*), mënyrat për zhvillimin e bashkëpunimit janë të shumta. Vlerat natyrore dhe historike të botës së

egër, përbëjnë një mundësi të jashtëzakonshme. Veçanërisht në Rusi, ekzistojnë mundësi të shumta bashkëpunimi në të ardhmen. Por, pengesa kryesore për zhvillimin dhe bashkëpunimin më të sigurt është pamundësia për të parashikuar lidhur me politikën për turizmin në zonën kufitare. Konflikti mes grupeve të ndryshme të interesit është i mundshëm, megjithëse partnerët besojnë se ky problem mund të shmanget përmes shpërndarjes së informacionit dhe përfshirjes së grupeve vendase. Lidhjet e telekomunikacionit dhe të transportit mes vendeve, dhe aksesit në disa zona mbeten një problem i pazgjidhur, pasi në kufirin rus kërkohet që të huajt të pajisen me vizë për të hyrë në Rusi, ndërsa qytetarëve rusë iu nevojitet një leje e veçantë, për të vizituar zonën kufitare. Gjithashtu, ekziston nevoja të hapen rrugë të reja dhe bëhen ndryshime në formalitetet e kalimit të kufirit.

Takimi vjetor i Bordit Këshillimor të parkut trepalësh Pasvik-Inari u zhvillua në Finlandë në 2010. Pjesëmarrësit pranuan ndryshimet në strukturën e punës për të ardhmen dhe identifikuan veprimtaritë kryesore të planit të punës për vitin 2011. Vendet planifikojnë të hartojnë bashkërisht Listën e Kuqe dhe të vazhdojnë monitorimin afatgjatë të ariut të murrmë. Është parashikuar edhe një tur pilot turistik i përbashkët i tre vendeve. Partnerët po punojnë që të paraqesin për financim një projekt të ri për turizmin dhe edukimin mjedisor në Programin Koloartik ENPI CBC 2007-2013.

Në 17 Shkurt 2010, Ministrinë e Mjedisit të Finlandës, Norvegjisë dhe Rusesë nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për një planifikim të integruar të veprimtarive në *Brezin e Gjellbër të Fenoscandia* si pjesë e Nismës Evropiane të Brezit të Gjellbër. Gjithashtu Memorandumi konsiderohet dokument për planifikimin e zhvillimit të ardhshëm të bashkëpunimit Pasvik-Inari.



# 7. Karpitet Lindore: E para Rezervë e Biosferës tre-palëshe në botë, sipas UNESCOs

Zbigniew Niewiadomski<sup>1</sup>

## 1. Gjeografia e zonës

Rezerva e Biosferës e Karpateve Lindore (në anglis: ECBR) është rezerva e parë tre-palëshe ndërkuftare në botë, që ka përcaktuar Programi UNESCO MAB, e cila përfshin Poloninë, Republikën Sllovaqe dhe Ukrainën. Nga sa kujtojnë më të

2005). Për momentin ECBR është e vetmja zonë e mbrojtur e Maleve Karpate që prej 2004ës përbën kufijtë e jashtëm të Bashkimit Evropian dhe ato të zonës Shengen (prej vitit 2007).

Zona e ECBR (me koordinata gjeografike nga 48°53' deri në 49°22'V; 22°02' në 23°00'L) shtrihet në pikën e takimit të kufijve shtetërorë të tre vendeve, ku ana e kufirit mes Polonisë dhe Sllovakisë formon një ndarje të pjesshme



© Zbigniew Niewiadomski

vjetrit, gjatë historisë, kufijtë shtetërorë të këtij rajoni kanë ndryshuar shpesh, megjithëse në të kaluarën zona të caktuara të ECBR-së i përkisnin gjashtë apo shtatë vendeve të ndryshme. Ajo është një ndër zonat e pakta në Evropë ku natyra ka pushtuar sipërfaqe të mëdha, që dikur menaxhoheshin dhe ishin të mbipopulluara, por që u braktisën më vonë për shkak të operacioneve ushtarake të Luftës së Dytë Botërore në vitet 1939 deri në 1947. Pas humbjes së dhjetëra mijëra jetëve në konfliktet etnike të viteve 1940 dhe ndarjes së mëvonshme që pësuan kufijtë, për shkak të regjimit komunist, ECBR u kthye në një zonë ku bashkëpunimi ndërkuftar ndihmoi kombet të ndërtonin marrëdhënie fqinjësie të mirë. (Niewiadomski

kontinentale të Evropës, duke veçuar pellgjet ujëmbledhës të Detit Baltik dhe Detit të Zi. ECBR mbron burimet e dy lumenjve të mëdhenj, *Dniester* dhe *San*. Ajo përfshin një zonë prej 213,212 ha, nga e cila 53.4% shtrihet në Poloni, 19.1% në Republikën Sllovaqe dhe 27.5% në Ukrainë. Kjo zonë malore me një lartësi që varion nga 210 m deri në 1,346 metra mbi nivelin e detit, është shumë e pyllëzuar (varësisht nën-zonës: nga 52% deri 67% në anën ukrainase dhe deri në 80% në anën polake dhe sllovaqe). ECBR përfshin pyje prej ahu dhe bredhi, ose vetëm prej bredhi, me trungje të vjetra drurësh (Breymer and Noble 1996), disa prej të cilave mbrohen që prej 1728<sup>2</sup>. Në vitin 2006 ato u përfshinë në Listën e

<sup>1</sup> Konsulent i Lartë, UNEP, Vienë.

<sup>2</sup> Një prej tre zonave që autoritetet vendore/bashkiake kanë klasifikuar si "Pyll i mbrojtur ahu dhe bredhi nën *Riaba Skala*".

Trashëgimisë Botërore, si 'Pyje të lashtë bredhi të zonës së karpateve të Trashëgimisë Botërore. Kjo është një zonë natyrore ndërkufitare. Një fenomen tjetër dallues i peizazhit është prania e livadheve nën alpine, që shtrihen mbi kufirin e sipërm të pyllit. ECBR është një prej vend-strehimeve më të rëndësishme për kafshët e mëdha të Habitave të Lashta të Evropës, që strehon ende në ditët e sotme popullatat e kafshëve të mëdha mishngrënëse, si p.sh ariu i murrmë, ujku, rriqebulli, macja e egër; të barngrënësveve mëdhenj si dreri i kuq dhe bizoni evropian i futur rishtazi në zonë, kastori dhe kali primitiv i races *Hutzul*, etj. Gjithashtu, zona mbart trashëgimi të pasur kulturore siç janë punime të gdhendura në dru, që daton në 1645 ose treni pyjor me shina të ngushta, i ndërtuar në shekullin e 19të. Në 1998, Këshilli i Evropës ju dorëzoi të dy parqeve të ECBRsë, Diplomën Evropiane "për rolin e shquar në mirëmenaxhimin e zonave të mbrojtura, e me vlera të veçanta natyrore". Pjesa më e madhe e ECBR në Karpate përbën një prej zonave më të mëdha dhe më të rëndësishme të Natura 2000.

Dendësia e popullsisë në rajone të ndryshme të ECBR ndryshon, duke filluar nga sipërfaqe pak të populluara dhe me lloje të mëdha e të egra, në pjesën polake, deri në rajone relativisht të populluara, në pjesën ukrainase (UNESCO 2000), me fusha të kultivuara, livadhe sane dhe kullota. Në pjesën ukrainase, pylltaria përbën aktivitetin kryesor ekonomik, ndërsa në pjesën polake, shërbimet ndaj turistëve po bëhen gjithnjë e më shumë një burim i rëndësishëm të ardhurash. Blektoria kufizohet në rritjen e gjedhit dhe dhenve dhe fermat e vogla, ku përdoren modelet tradicionale të shfrytëzimit të tokës.

Bashkëpunimi ndërkufitar në ECBR duhej të ngrihej mbi sjelljen armiqësore që solli Lufta e Dytë Botërore, periudhë gjatë së cilës (1941 – 1944) nazistët shfrytëzuan aspiratat e ukrainasve për sovranitet dhe i nxitën ata drejt asgjësimit të çifutëve dhe polakëve. Në 1944, regjimet komuniste polake dhe ruse u hakmorrën ndaj tyre duke përzënë nga territoret përkatëse gjithë banorët me origjinë ukrainase, gjë e cila vazhdoi deri në mesin e vitit 1947. Pjesa polake u kthye në një 'zonë të ndaluar' e të shkretët e të pabanuar. Megjithatë, marrëdhëniet polako-silovake kanë qenë gjithnjë miqësore, ndërsa konteksti politik i bashkëpunimit me Ukrainën u bë i favorshëm në vitin 1991, kur Polonia ishte e para që njohu pavarësinë e saj dhe kur më vonë zhvilloi një partneritet strategjik që kishte si objektiv nxitjen e afrimit të Ukrainës me BE-në.

Në fakt, ECBR është një rrjet që përfshin gjashtë zona të mbrojtura fqinje, tre parqe kombëtare (Kategoria e II-të e IUCN-së) dhe tre peizazhe natyrore (IUCN Kategoria V): Parku Kombëtar *Bieszczady* (i shpallur më 1973 me 29,202 ha), Parku i Peizazhit të Lumit *San* (i shpallur më 1992 me 33,480 ha) dhe Parku i Peizazhit *Cisna-Wetlina* (i shpallur më 1992

me 51,165 ha) gjenden në Poloni; Parku Kombëtar *Poloniny* (i shpallur më 1997; 29,805 ha) dhe zona e tij tampone prej 10,973 ha gjenden në Republikën e Sllovake; ndërsa Parku Kombëtar *Natyror Uzhanskyi* (i shpallur më 1999 me 39,159 ha) dhe Parku Rajonal i Peizazhit *Nadsyanskyi* (i shpallur më 1998; 19,428 ha) gjenden në Ukrainë. Partnerët kryesorë që çuan në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar në ECBR, ishin administratat e zonave të mbrojtura. Megjithatë, sipas legjislacionit kombëtar, vetëm dy parqe kombëtare (*Bieszczady* dhe *Uzhanskyi*, që përfshijnë 32% të zonës së ECBR) kanë të drejta ekskluzive menaxhimi dhe pronësie mbi tokën, (përfshi pyjet) brenda kufijve të tyre. Ato janë të pajisura me personel dhe buxhete të mjaftueshme. Pjesa e mbetur e zonave të mbrojtura (katër zona) nuk i menaxhojnë territoret e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë shumë më pak personel dhe buxhet, gjë që kufizon kapacitetet e tyre operacionale dhe kapacitetet për bashkëpunim. Një tjetër partner i rëndësishëm për bashkëpunimin ndërkufitar ishte Fondacioni për Ruajtjen e Biodiversitetit të Karpateve Lindore (ECBC), i cili deri në 2007 jepte jo vetëm mbështetje financiare, por nxiste edhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta brenda ECBRsë. Partnerët e tjerë të përfshirë në bashkëpunim ishin institucionet shkencore, administratat e pyjeve, njësitë lokale të vetëqeverisjes dhe OJQtë.

### Momentet kryesore të zhvillimit historik

Rajoni ndërkufitar i ECBR, si thesar natyror që ndahet mes disa vendeve, duhet të konsiderohet një njësi e vetme, koherente e me praktika të harmonizuara menaxhimi. Vizioni për krijimin e një zone ndërkufitare të mbrojtur, me rëndësi ndërkombëtare, ishte zanafilla që motivoi zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar në ECBR dhe lobingun e përbashkët në 1990, për zgjerimin e zonave ekzistuese të mbrojtura dhe krijimin e zonave të reja në rajon. Një tjetër sfidë që intensifikoi bashkëpunimin ishte anëtarësimi në 2004 i Polonisë dhe Republikës së Sllovake në BE. Bordi i Fondacionit të ECBCsë kuptoi se vendet e reja anëtare duhej të përgatiteshin për zbatimin në zonat e tyre të ECBRsë sipas konceptit Natura 2000, ndërkohë që të dy zonat e tjera të mbrojtura në anën ukrainase, nuk mund të ishin të përfshira apo të përfitonin nga zgjerimi i BE-së. Që nga 2003, aktivitetet e përbashkëta janë përqendruar në ngritjen e kapaciteteve për partnerët ukrainas, me qëllim që të lehtësohet bashkëpunimi dhe përfshirja e tyre në këtë bashkëpunim.

Në maj 1991, tre zonat e mbrojtura fqinje, Parku Kombëtar *Bieszczady* (PL), Zona<sup>3</sup> e Peizazhit të Mbrojtur *Vychodne Kapaty* (SK) dhe Autoriteti<sup>4</sup> Pyjor *Zakarpates* (UA) nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, e cila u konfirmua më pas

3 Pjesa e Karpateve *Vychodne Karpaty* PLA u integrua në Parkun Kombëtar të *Poloniny* ose të zonës së tij tampone, dhe u emërtua rezervë e biosferës, ndërsa pjesa e mbetur e Karpateve *Vychodne* është territor fqinj me EBCR.

4 Përgjegjës për Rezervën e Peizazhit *Stuzhitsa*, i cili më vonë u bë pjesë e Parkut Natyror Kombëtar *Uzhanskyi*.

nga Protokollin trepalësh i bashkëpunimit, për krijimin e rezervës ndërkombëtare të biosferës në Karpitet Lindore, e nënshkruar nga Ministrat përkatës të Mjedisit në shtator 1991. Në nëntor 1992, UNESCO i përcaktoi Karpitet Lindore, Polako-Slllovaqe si Rezervë e Biosferës e *Beskidit Lindor*, ndërsa Rezerva e Peizazhit *Stuzhitsa* në Ukrainë, mori një emërtim të veçantë, në 1993. Fondacioni i përbashkët i ECBC u regjistrua në Zvicër në 1995 dhe në 1996 shpalli programin e parë të granteve të vogla për OJQtë dhe komunitetet vendore. Në dhjetor 1998, UNESCO e emërtoi Rezervën e Biosferës të Karpateve Lindore, si rezervën e parë biosferike tre-palëshe në botë. Në 2001, Fondacioni i ECBCsë hapi zyrën e parë përfaqësuese në Poloni dhe në 2002 caktoi koordinatoren për Republikën Slllovaqe dhe Ukrainën. Në 2003, Fondacioni i ECBCsë mbledhi për të parën herë, menaxherët dhe ekspertët e gjithë zonave të ECBCsë dhe në 2004 shpalli programin e bashkëpunimit ndërkufitar të granteve të vogla dhe ndërmorri nismën për mbledhjen e grupit të parë të punës së ekspertëve për ECBC. Turbulenca politike e vitit 2006 në Poloni, çoi në ndryshime të personelit të parqeve dhe ndryshimin e qasjes ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar. Në të njëjtin vit, Fondacioni i ECBCsë i pezulloi programet e tij dhe e mbylli zyrën në rajon. Që nga 2007, bashkëpunimi në ECBC është kufizuar në mbajtjen e një konference të përvitshme shkencore në anën polake.

Fillimisht, bashkëpunimi ndërkufitar në ECBC u bazua në marrëveshjet zyrtare, përfshi Protokollin ndërministror të 1991, Marrëveshjen trepalëshe të 1992 dhe Shënimet e Mirëkuptimit të 1993, të cilat krijuan Fondacionin e ECBCsë me qëllim që të mbështetnin financiarisht aktivitetet e përbashkëta. Megjithatë, bashkëpunimi ndërkufitar në ECBC u zhvillua më tej, kryesisht për shkak të marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit mes menaxherëve të zonave të mbrojtura dhe kërkuesve shkencorë nga tre vendet.

## Përfitimet dhe sfidat

ECBC mund të përshkruhet si 'rajoni ndërkufitar i dallimeve' (Niewiadomski 2006a), një konglomerat i përbërë nga katër nënrajone të ndara nga kurrize malore dhe kufij shtetërorë, ku secili prej tyre ka një histori, gjuhë, kulturë, popullsi, fat, dendësi, tendencë demografike, strukturë pronësie mbi tokën, model të përdorimit të tokës dhe mbrojtje natyrore të ndryshme, si dhe modele të ndryshme të menaxhimit të pyjeve, praktikave bujqësore, zhvillimit ekonomik, punësimit dhe nivelit të mirëqenies. Këta faktorë çojnë automatikisht në zhvillimin e përparësive të ndryshme të ruajtjes së natyrës në cdo shtet. Për më tepër, kompetencat e ndryshme ligjore të administrimit të zonave të mbrojtura, të kombinuara me nivelet e ndryshme të financimit, kanë sjellë papërputhshmëri në kapacitetet e zonave të mbrojtura, madhësinë e personelit, kualifikimin dhe aftësitë profesionale dhe në motivimin e tyre për aktivitete të përbashkëta, gjë e

cila përbën një pengesë shtesë për bashkëpunimin mes tyre. Një sfidë tjetër që paraqitet në lidhje me bashkëpunimin është madhësia e ECBC (2,132 km<sup>2</sup>), së cilës i shtohet një rrjet i pazhvilluar rrugësh dhe kalimesh kufitare dhe regjimi i vizave në perimetrimin e zonës Shengen. Kjo është edhe arsyeja pse kontaktet personale mes administratës së dy zonave fqinje (*Bieszczady* dhe *Uzhanskyi*) janë të rralla, pavarësisht distancës së shkurtër ajrore prej 26 km mes zyrave qendrore. Para 2007tës, vajtja në parkun partner kërkonte të përshkohej një distancë prej 348 km në rrugë tokësore dhe të kalohej përmes pikave të kontrollit shtetëror të kufijve në tre vendet dhe nënshtrimin të kontrolleve të shumta të policisë në pikat kufitare ku prisnin turma të mëdha njerëzish. Për rrjedhojë, udhëtimi për të kaluar në secilin prej drejtimeve, merrte një ditë të plotë. Sidoqoftë, nga viti 2007, pjesëmarrja e partnerëve ukrainas në takimet e përbashkëta, është vështirësuar shumë, për shkak të regjimit të vizave Shengen që zbatohet në dy vendet e tjera partnere.

Efekti i shpejtë që pritej të ndodhte, si pasojë e emërimit ndërkombëtar në kuadër të Programit UNESCO-MAB, ishte zhvillimi i rrjetit të zonave të mbrojtura në rajon. Fillimisht, tre zonat e mbrojtura e nisën bashkëpunimin në këtë rajon kufitar që në vitin 1991 kur zinte vetëm 58,853 ha. Vizioni i përbashkët për krijimin e një zone të mbrojtur ndërkufitare, me rëndësi ndërkombëtare ishte motivues për autoritetet përgjegjëse të ruajtjes së natyrës në tre vendet, që të zgjeronin zonat ekzistuese të mbrojtura, të rrisnin statusin e tyre ligjor të mbrojtjes dhe të krijonin zona të reja në rajon. Që nga maji 1990, kur në takimin e UNESCOs në Kiev, u paraqit propozimi për krijimin e një rezerve të përbashkët të biosferës mes tre palëve, madhësia e zonave në mbrojtjen ligjore të ECBCsë aktuale u rrit nga 15,710 ha në 113,847 ha në anën polake dhe nga 2,542 ha në 58,587 ha në anën ukrainase. Në ditët e sotme, Parku Kombëtar Natyror *Uzhanskyi*, që përbën rajonin juglindor të ECBCsë, është i katërti më i madh mes pesëmbëdhjetë zonave të mëdha të mbrojtura në Karpitet ukrainase. Në 2010, ECBC përfshinte një zonë prej 213,212 ha, pothuajse katër herë më e madhe se sipërfaqja që zinte zona e mbrojtur në vitin 1991 dhe është rezerva malore më e madhe e biosferës në Evropë, jashtë Federatës Ruse.

Konferencat e përvitshme shkencore që mbahen në Poloni, prej vitit 1992, lehtësojnë shkëmbimin e informacionit dhe të rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në tre vendet e ECBCsë. Ato shërbejnë edhe për të përhapur përvojën e mirë dhe për të përshtatur planet menaxhuese të parkut përmes përdorimit të GIS.

Emërtimi i rezervës së parë trepalëshe, biosferike tërhoqi vëmendjen e donatorëve. ECBC është e vetmja zonë evropiane, ndërkufitare e mbrojtur, që ka një mjet të veçantë financimi për mbështetjen e bashkëpunimit ndërkufitar, një fond joqeveritar besimi, rajonal mjedisor, i krijuar për

të mbështetur marrëveshjen trepalëshe mes Polonisë, Republikës Sllovaqe dhe Ukrainës, me theks ndarjen e përgjegjësiave mes tre vendeve të përfshira në mbrojtjen e burimeve natyrore të këtij rajoni.

Fondacioni i përbashkët për Ruajtjen e Biodiversitetit të Karpateve Lindore u regjistrua në Zvicër në 1995, si 'vendi i katërt dhe neutral' me objektiv statutor *'nxitjen, organizimin, realizimin dhe promovimin e aktiviteteve që i shërbejnë biodiversitetit të përgjithshëm të zonës malore të Karpateve Lindore'* (ECBC 1994). Kapitali fillestar i Fondacionit, prej US\$ 600,000 u dhurua nga Fondi Global për Mjedisin Banka Botërore, dhe Fondacioni MacArthur si një lloj 'farë', për të nxitur mbështetjen e donatorëve të tjerë të mundshëm, përfshi edhe qeveritë e tre vendeve përkatëse.

Fondacioni i ECBC ishte një mekanizëm unik për financimin e përbashkët dhe i vetmi burim i gatshëm mbështetje për bashkëpunimin ndërkufitar në ECBR, i cili arriti të gjeneronte mundësi financimi shtesë nga burime të tjera. Nga 1996 deri në 2006, Fondacioni i ECBC mbështeti 32 projekte të vogla, që u zbatuan në ECBR nga OJQtë vendore, autoritetet e zonave të mbrojtura dhe autoritetet komunitare. Për më tepër, me qëllim që të mbështetej bashkëpunimi mes tre vendeve të përfshira, fondacioni zbatoi tre projekte të përbashkëta trepalëshe.

Projektet e mbështetura nga Fondacioni ECBC, për ECBR-në, kishin në fokus:

- ruajtjen e biodiversitetit, krijimin e zonave të reja të mbrojtura, menaxhimin e zonave të mbrojtura;
- ruajtjen e trashëgimisë historike dhe kulturore;
- punën kërkimore, krijimin e inventarëve burimorë, hartëzim dhe zonim funksional, krijimin e bazave dixhitale të të dhënave;
- ndërtimin e kapaciteteve teknike për zonat e mbrojtura;
- workshope, trajnime dhe udhëtime studimore për menaxherët, personelin dhe banorët e zonave të mbrojtura;
- edukimin mjedisor dhe rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit, marrëdhëniet me publikun dhe infrastrukturën;
- zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, të rrugëve dhe infrastrukturës turistike.

Vendi kryesor përfitues ishte Ukraina, e cila mori më shumë se 44% të totalit të mbështetjes që u dha nga Fondacioni ECBC, për gjithë rajonin ndërkufitar. Ndiha financiare që ofroi Fondacioni për zbatimin e inventarëve të biodiversitetit, krijimin e hartave të zonës dhe ndarjen funksionale të saj në zona, ishin shumë të rëndësishme për përfshirjen në vitin 1998 të Ukrainës në ECBR, si palë e tretë partnere dhe më pas për ngritjen e kapaciteteve në zonat ukrainase të mbrojtura, në funksion të bashkëpunimit me partnerët sllovakë dhe

polakë. Fondacioni financoi blerjen e pajisjeve moderne të zyrës dhe softwarëve për administrimin e parkut, si dhe mjete (p.sh njësi GPS) për shërbime në terren, lehtësoi shkëmbimin e përvojave me parqet kombëtare dhe të peizazheve në zonat fqinje përtej kufijve, mbështeti zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm duke financuar zhvillimin e infrastrukturës dhe kalimeve për vizitorë, mbështeti fushata mjedisore për komunitetin dhe lehtësoi krijimin e marrëdhënieve të punës me operatorë të huaj në fushën e turizmit, të cilat krijuan motivimin e duhur ekonomik për bashkëpunim mes komuniteteve vendase dhe administratorëve të parkut.

Po aq i rëndësishëm ishte roli i Fondacionit ECBC, si i vetmi organizëm ligjor për zhvillimin e një vizioni të përbashkët për Karpitet Lindore dhe promovimin e koordinimit e bashkëpunimit ndërkufitar. Gjatë 'workshopit' konsultues rajonal, që u mbajt në shtator 2003, Fondacioni i ECBCsë mbledhi për herë të parë, menaxherët dhe ekspertët e tre zonave të mbrojtura që bënë pjesë në ECBR të identifikonin përparësitë më të ngutshme të bashkëpunimit. Në 2004, Fondacioni mori përsipër dhe mbështeti punën për tre grupet e përbashkëta tematike të punës, me qëllim që partnerët nga tre vendet të mund të fitonin njohuritë dhe aftësitë, që përçonte zbatimin dhe shtjellimin e 'planeve të përbashkëta ndërkufitare' dhe detajimi i propozimeve për projekte të përbashkëta ruajtëse për botën e egër, bimët dhe pyjet.

Fondacioni ECBC krijoi një faqe të përbashkët interneti, zhvilloi botime të përbashkëta, harta dhe broshura në të gjitha gjuhët lokale duke njehsuar paraqitjen e tyre, në funksion të krijimit të një identiteti të përbashkët. Me qëllim ofrimin e mjeteve të duhura për planin e përbashkët menaxhues të zonës, Fondacioni i ECBCsë prodhoi hartën e parë të përbashkët dixhitale për gjithë zonën e ECBRsë.

Megjithëse u themelua në 'vendin e katërt neutral', si entitet ligjor zviceran, ECBCsë nuk i lejohej të merrte financime as nga Burimet Evropiane të fondeve dhe as nga grantet e EEA/Norvegji që jepeshin në kuadër të Kontributit Zviceran për Zgjerimin e BEsë. Për këtë arsye, në 2006 Bordi i ECBRsë vendosi të krijonte një fondacion tjetër përfitues në Poloni. Procedurat ligjore për mbylljen e Fondacionit në Zvicër dhe transferimin e kapitaleve tek fondacioni përfitues në Poloni nuk kanë përfunduar akoma.

## **Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen**

Mësimi kryesor i nxjerrë në ECBR është se 'çelësi i vërtetë i suksesit' dhe asetet e pazëvendësueshme për çdo lloj bashkëpunimi, pavarësisht objektit të tij, janë njerëzit që përfshihen në aktivitetet e përbashkëta dhe entuziazmi i tyre për t'i bërë gjërat së bashku. Edhe një marrëveshje zyrtare e nivelit të lartë nuk mundet e vetme, të nxisë bashkëpunim të suksesshëm ndërkufitar. Pak pritjet të ndodhë nëse nuk



ka shpirt bashkëpunimi mes partnerëve, mungojnë stimujt praktikë të bashkëpunimit ose mirëkuptimit për përfitimet e mundshme dhe nëse mungon interesi për të kuptuar dhe respektuar kushtet dhe kulturën e ndryshme të secilit partner. Bashkëpunimi i suksesshëm ndërkuftar në lidhje me çështjet e shumëllojshmërisë biologjike kërkon edhe përshtatjen e 'sjelljeve me mendësi të reja' duke e menduar zonën si një eko-rajon ndërkuftar natyror, të vetëm dhe koherent.

Hapi i parë i nevojshëm për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkuftar është që të identifikohen bashkërisht përparësitë dhe të merren vendime në lidhje me veprimet më të volitshme dhe më urgjente të bashkëpunimit, përmes konsultimit me një rang të gjerë aktorësh, në secilën anë të kufirit.

Një tjetër konkluzion është se bashkëpunimi ndërkuftar nuk mund të zhvillohet pa një udhëheqje vizionare dhe pa një kuadër të pranuar pune për koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta. Një 'strukturë e tillë qeverisëse' mund të krijohet duke u bazuar në marrëveshjet zyrtare. Protokollin trepalësh i nënshkruar nga ministrat në 1991, emëroi Këshillin Koordinues të ECBRsë, i cili nuk është pajisur kurrë me buxhet që të mund të ushtrojë të gjitha funksionet e veta, për rrjedhojë nuk ka mundur të bëhet operacional. Këshilli Koordinues është takuar vetëm tre herë mes fundit të 1991 dhe pranverës së 1994. Trupa e tij këshilluese, Këshilli Ndërkombëtar Shkencor i ECBR nuk është mbledhur asnjeherë, dhe përfundimisht, është hequr dorë nga kjo ide. Në vitin 1995, i ballafaquar me mungesën e kornizave të mësipërme, Fondacioni i ECBC mori përsipër funksionin e strukturës koordinuese për aktivitetet ndërkuftare dhe luajti rolin e forumit në të cilin aktorët e ECBRsë nga tre vendet mund të takoheshin dhe të diskutonin çështjet e tyre të menaxhimit. Në Raportin e UNESCOs cilësohej qartë se 'Fondacioni mbetet i vetmi organizëm i krijuar

ligjor, për konsultime dhe bashkëpunim trepalësh' (Jardin et al. 2003). Ky shembull provon se çdo strukturë kolektive shumëkombëshe ose strukturë tjetër që është ngarkuar për të koordinuar bashkëpunimin ndërkuftar, duhet t'i përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe t'i kalohet buxheti i nevojshëm për zbatimin e detyrave.

Për arsye të kuptueshme, bashkëpunimi ndërkuftar nuk mund të zhvillohet pa financime. Megjithatë, bashkëpunimi që zhvillohet vetëm në baza projektesh nuk mund të jetë i volitshëm në terma afatgjata kohe, pasi afati për përfundimin e projektit mund të kthehet në 'afat përfundimtar' për bashkëpunim mes partnerëve. Krijimi i një fondi mjedisor besimi si p.sh Fondacioni ECBC, është një nga mundësitë e realizueshme (Niewiadomski 2006b). Sipas raportit të ekspertëve të Bankës Botërore në 1998, '*natyra trepalëshe e këtij fondi, si mekanizëm që me ndihmën e komitetit të vet koordinues, mbështet në mënyrë paralele marrëveshjen trepalëshe të ruajtjes, është unik në nxitjen e bashkëpunimit teknik*' (Lusigi dhe Norris 1998). Sidoqoftë, këto fonde duhet të shoqërohen me procedura që në fillim të procesit, përndryshe mund të mos bëhen kurrë funksionale. Gjithashtu, raporti i Bankës Botërore cilëson se '*mësimi kryesor që duhet nxjerrë është se një fond besimi ka nevojë për një nivel- prag kapitali (në këtë rast, një donacion nga 3-5 milionë dollarë) për të arritur masën kritike*' (Lusigi dhe Norris 1998).

Duhet të vihet në dukje se të tre vendet e përfshira janë pjesë e Konventës Kuadër për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Karpateve (Kiev) (UNEP 2003) dhe kanë nënshkruar së fundi Protokollin tematik të Ruajtjes dhe Përdorimit të Qëndrueshëm të Shumëllojshmërisë Biologjike dhe të Peizazheve (Bukuresht, 2008). Megjithatë, deri tani këto marrëveshje nuk kanë pasur ndonjë efekt të drejtpërdrejtë në bashkëpunimin ndërkuftar të ECBR.

## 8. 8000 Vjet që kalojmë kufijtë – *Neusiedler See / Fertő-Tó*

Katharina Diehl<sup>1</sup> and Alois Lang<sup>2</sup>

### Gjeografia e zonës

Ekosistemi i Detit<sup>3</sup> të *Fertő-Neusiedler* gjendet në skajin më perëndimor të një unaze stepash të kripura liqenore, përgjatë Euroazisë. Stepa e cekët liqenore, më pak se 2m e thellë është trupi më i kripur ujan në Evropë, që mbulon një sipërfaqe rreth 315 km<sup>2</sup>. Ajo është rreth 13,000 vjecare dhe në fazë të vonë të suksesionit (Herzig dhe Dokulil 2001). Qindra vitet e

Gjetjet që i përkasin Periudhave të Gurit dhe Bronxit, na tregojnë se zona që rrethon Lumin *Neusiedl* ishte e banueshme rreth 8,000 vite më parë. Zbulimet arkeologjike provojnë se civilizimet pasuese kishin lidhje kulturore dhe tregëtare dhe komunikimin përmes rrugëve të shkëmbimit tregëtar, që kalonin në pjesën jug-perëndimore të liqenit, si p.sh Rruga Amber, e cila lidhte Detin Adriatik me atë Baltik. Po ashtu, dërgimi i bagëtive për kullotje mund të gjurmohet deri në lashtësi. Edhe vreshtat janë krijuar që në periudhën e Keltëve dhe Romanëve. Që nga viti 1950 e deri në 1970, sipërfaqja e



© Autoriteti i Parkut Kombëtar të Neusiedler See

përdorimit të vazhdueshëm të tokës kanë krijuar një peisazh që është veçanërisht i ndryshëm në paraqitjen e tij. Kjo shumëllojshmëri është shkaktuar si rezultat i ndryshimeve graduale të lartësisë dhe metodave të shumta tradicionale, të përdorimit të tokës. Sot, zona ligatinore është park kombëtar ndërkuftar prej rreth 300 km<sup>2</sup>, që shtrihet mes Hungarisë dhe Austrisë. Ai gjendet në pjesën më perëndimore të Basenit Karpatian, në lindje të Alpeve Austriake. Mënyra e vendosjes së peisazhit të liqenit, popullatat e zogjve dhe ekzistenca e shumë biotopeve në një zonë relativisht të vogël, janë vlerat më të rëndësishme natyrore të këtij mjedisi.

kultivuar me vreshta arriti shtrirjen më të madhe, sidomos në zonën e *Seewinkel*, madje u përhap edhe në pjesë që tradicionalisht dominoheshin nga kullota të mëdha dhe livadhe të thatë e të lagësht. Prerja e kallamave rezulton të jetë forma më e vonë e përdorimit tradicional të tokës, pas përhapjes së madhe që mori përdorimi i kallamishteve në shekullin 16të.

Kjo zonë ka qenë gjithmonë një rajon tipik kuftar, për shkak të formacionit gjeografik dhe gjeologjik të saj, si zonë tranzitore mes Rrafshëve Karpatiane dhe Maleve të Alpeve. Për shkak të efekteve të ndryshme klimatike – kontinentale, nën-Mesdhetare dhe alpine – ajo përbën edhe një pikë takimi për kufijtë e florës dhe të faunës. Gjithashtu, përbërja etnike e popullsisë dëshmon për një shumëllojshmëri të lartë prej ndikimeve etnike gjermane, sllave, (kryesisht kroate), dhe Finno-Ugriane-Altaike (hungareze).

<sup>1</sup> Ekolog peisazhi, Qendra për Kërkime të Peisazhit Bujqësor të Leibnicit, Gjermani.

<sup>2</sup> Përgjegjës për Marrdhëniet me Publikun, Parku Kombëtar i Neusiedler See, Austri.

<sup>3</sup> Gjermanisht: *Neusiedler See*, Hungarisht: *Fertő-Tó*, Anglisht: Liqeni *Neusiedl*.

Qëndrueshmëria e marrdhënieve të pronësisë mbi tokën ka pasur ndikim të madh në vazhdimësinë e modeleve të përdorimit të tokës. Madje dhe përmbysjet social-ekonomike të viteve pas viteve 1918 dhe 1945, kur fisnikëria u zëvendësua pjesërisht nga sektori publik, nuk kanë sjellë ndryshime të këtij modeli. Kjo ka bërë të mundur ruajtjen e strukturave social – ekonomike, e për rrjedhojë edhe të ekuilibrit mes përdorimit të tokës dhe mjedisit natyror.

Izolimi i vërtetë filloi me krijimin e “Perdes së Hekurt” pas Luftës së Dytë Botërore. Gjatë Revolucionit Hungarez të vitit 1956 dhe përpara se kjo pjesë e kufirit të ruheje sigurt përgjatë shumë prej viteve që do të pasonin, shumë hungarezë përdorën kallamishet dhe liqenin e cekët, në përpjekjet e tyre të rrezikshme për t’u arratisur drejt perëndimit. Ishte pjesa jugperëndimore e bregut të liqenit, mes *Fertőrákos* (ose *Kroisbach*) dhe *St. Margarethen*, ku qindra pjesëmarrës të një pikniku mbarë evropian nga Gjermania Lindore, prishën rrethimin e telave me gjemba dhe e rihapën kufirin në gusht 1989. Popullsia në pjesën austriake e mbështeti ndryshimin, duke i mirëpritur ata qindra njerëz që kaluan kufirin (Natur & Land 1993).

### Momentet kryesore të zhvillimit historik

Bashkëpunimi ndërkufitar për ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e ujrave filloi në vitet 1950 (Fersch dhe Lang 2006). Nevoja për bashkëpunim lindi si pasojë e dinamikave natyrore të stepave liqenore. Menaxhimi ndërkufitar i ujrave ishte vendimtar për parandalimin e përmytjeve, çështjeve të bujqësisë dhe zhvillimit dhe turizmit (Fersch dhe Lang 2006). Në 1955, mes Hungarisë dhe Austrisë zbatohesh një regjim menaxhimi ndërkufitar, me takime të rregullta dypalëshe për ujrë ndërkufitare, si Liqeni *Neusiedl* dhe disa lumenj te vegjël. Këto takime çuan në nënshkrimin e përbashkët të Traktatit mbi Rregulloren e Menaxhimit të Ujrave në Zonën Kufitare dhe krijimin e një komisioni dypalësh të menaxhimit të ujit për Liqenin *Neusiedl*. Disa vite më vonë, bashkëpunimi për ruajtjen e natyrës u shtri edhe në nivelin shkencor (Natur & Land 1993).

Përpjekja e parë e shoqërisë civile për bashkëpunimin ndërkufitar ndodhi në fund të viteve 1970të, kur Shoqata austriake për Ruajtjen e Natyrës (OeNB) krijoi kontakte me autoritetet rajonale hungareze të ruajtjes së natyrës. Një nga rezultatet e këtij shkëmbimi ishte shpallja në vitin 1977 zonë e mbrojtur e peisazhit në anën hungareze të kufirit, e cila i bashkëngjitej zonës së mbrojtur të peisazhit në anën austriake të kufirit, e shpallur si e tillë që në vitin 1965.

Në vitin 1987, ndërkohë që Hungaria ishte akoma pjesë e sistemit socialist, dy vendet vendosën bashkërisht të mirëprisnin organizimin e evenimentit EXPO 1995, në qytetet e Vienës dhe Budapestit. Në fazën e planifikimit të

EXPOs, ideja e krijimit të një parku kombëtar që shtrihej në dy shtete me sisteme të ndryshme politike konsiderohej pjesa më tërheqëse e këtij koncepti. Megjithatë EXPO nuk arriti kurrë të realizohej, ideja për krijimin e një parku ndërkufitar u përkrah dhe, në fund, ishte një prej atyre pak pjesëve të këtij koncepti që mbijetoi dhe u bë realitet. Kur Hungaria hoqi kufizimet në zonën e kufirit me Austrinë në gusht 1989, dukej se kishte ardhur koha e duhur për të vënë në zbatim idenë e një kampi kombëtar ndërkufitar.

Procesi për planifikimin e parkut filloi me krijimin e një komisioni dypalësh, që përbëhej nga ekspertë të vendeve, ku përfshiheshin në mënyrë respektive të gjithë aktorët e nivelit vendor. Në Austri, kjo do të thoshte integrim i më shumë se një mijë familjeve në shtatë fshatra, të cilët ishin dhe vazhdojnë të jenë pronarët e rreth 100 km<sup>2</sup> të zonës së parkut kombëtar. Për këtë arsye u krye një vlerësim i sipërfaqeve të propozuara bazuar në vlerën aktuale bujqësore të tokës. Negociatat me pronarët zgjatën për rreth 4 vjet dhe u mbështetën në mënyrë konstruktive nga Dhoma e Bujqësisë. Më në fund, më 1992 u nënshkruan kontratat e masës së kompensimit për pronarët e tokave (Natur & Land 1993).

Në Hungari, faza e parë e shpalljes së parkut u krye në toka me pronësi shtetërore sipas ligjit të vitit 1991. Në prill të vitit 1994 u mbajt një ceremoni e përbashkët, për të demonstruar karakterin ndërkufitar të kësaj zone të mbrojtur. Kryeministrat e Hungarisë dhe Austrisë, Boross dhe Vranitszsky, deklaruan vullnetin e tyre për intensifikimin e bashkëpunimit në ruajtjen e natyrës (Natur & Land 1993). Aktiviteti u zhvillua në kufirin shtetëror pranë zonës qendrore të parkut të ri kombëtar.

Që nga 1965, e gjithë sipërfaqja në anën austriake të kufirit konsiderohet peisazh i mbrojtur natyror dhe që nga 1983, sipas Konventës Ramsar, zona është klasifikuar Rezervë Lagunore. Në 1977, UNESCO e shpalli basenin e liqenit, Rezervë të Biosferës. Që nga 1977, pjesa hungareze e liqenit dhe lagunat përreth saj konsiderohen peisazhe të mbrojtura natyrore, dhe prej vitit 1989 Zonë Ramsar dhe Rezervë e Biosferës që mbrohet nga UNESCO (Natur & Land 1993). Në vitet 1970të, natyra ndërkombëtare e ruajtjes në dy anët e Liqenit *Neusiedl See/Fertő - Tó*, përkatësisht Rezervë e Biosferës dhe Zonë Ramsar, çuan në nevojën për njëtrajtësimin e planeve hapsinore të zonës, përmes aktiviteteve të shkëmbimit dhe të dhënave shkencore.

Akti i vitit 1992 për Parkun Kombëtar në pjesën austriake, përfshin krijimin e një Komisioni të përbashkët të parkut kombëtar austro–hungarez, për harmonizimin e zhvillimit të parqeve në dy vendet. Komisioni u ngrit në vitin 1988 dhe funksionoi gjatë fazës së planifikimit të parkut. Me krijimin e parkut, misioni i Komisionit u përmbush, dhe ai mund të ishte shpërbërë, por të dy palët ranë dakort të vazhdonin bashkëpunimin dhe ta mbanin Komisionin, i cili mund të

diskutonte mbi hapat e rëndësishëm që duheshin ndërmarrë dhe bashkëpunimin për të ardhmen. Komisioni vepron në bazë të Aktit për Parkun Kombëtar në Austri dhe Direktivës së Parkut Kombëtar të Ministrisë së Mjedisit në Hungari. Ai udhëhiqet nga dy drejtorët respektivë të parkut dhe përfshin përfaqësues nga dy vendet (Fersch dhe Lang 2006). Në dhjetor të vitit 2001, zona e *Fertő-Tó/Neusiedler* u shpall Zonë e Trashëgimisë Botërore, që mbrohet nga UNESCO.

Në 2004, Hungaria u bë pjesë e Bashkimit Evropian. 'Era' e re solli emërtimin e ri të zonave, sipas NATURA 2000, e cila mbulon gjithë parkun kombëtar. Ekzistenca e përcaktimeve paralele për zonat e mbrojtura, ka zvogëluar kanosjet që i shkaktohen natyrës nga përdorimi i paqëndrueshëm apo planet afatshkurtra të investimit. Me anëtarësimin e Hungarisë në Traktatin Shengen në Dhjetor të 2007ës, u hoq kontrolli i kufijve dhe u mbyllën pikat e kontrollit kufitar. Kjo krijoi një hapësirë të gjerë mundësish në bashkëpunimin e përditshëm (p.sh programe edukimi, infrastrukture për trafikun e pamotorizuar, etj.).

## Përfitimet dhe sfidat

Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkuftar në vitet 1980të zbehu rreziqet e zhvillimit të paqëndrueshëm në sektorin e turizmit, urbanizimit, bujqësisë dhe infrastrukturës rrugore. Që nga ajo kohë, është shënuar një progres i dukshëm në mbrojtjen e mjedisit në pjesën hungareze të kufirit (p.sh trajtimi i ujërave të ndotura), i cili bazohet gjerësisht në përvojat pozitive të pjesës austriake.

Përjashtimi i zonave të rëndësishme nga përdorimi i tyre për qëllime ekonomike, është zbatuar në mënyrë të efektshme në të dy anët e kufirit, ku secili prej parqeve kombëtare respekton procedurat e veta administrative. Restaurimi i ekosistemit në pjesën hungareze luajti një rol të rëndësishëm në aspektet menaxhuese të parkut (Kohler 2004). Ruajtja e zonave të padëmtuara është një sfidë meqë përbëhen nga peizazhe të lashta kulturore (p.sh rreth liqeneve), që do të thotë se duhet të mirëmbahen përmes vazhdimësisë së formave tradicionale të përdorimit të tokës. Stimulimi i këtyre metodave është detyra kryesore e autoriteteve të parkut. Personeli i parkut kombëtar në anën hungareze të zonës është përgjegjës për përdorimin e tokës sipas objektivave të menaxhimit ruajtës/konservues. Ana austriake lejon përdorimin e tokës në baza kontraktuale, por detyron vetëm përdorimin e tokës që sjell përfitime për ruajtjen dhe konservimin.

Ndërthurja e interesave kombëtare me administrimin ndërkuftar të zonës nuk ka krijuar ndonjë vështirësi dhe të dy vendet zbatojnë kuadrin e tyre ligjor dhe administrativ për arritjen e qëllimeve të parkut. Në vend që të hartohet një plan i përbashkët menaxhimi, është rënë dakort që mes personelit të parqeve kombëtare të ketë bashkëpunim të vazhdueshëm

në të gjithë sektorët me interes të përbashkët si menaxhimi i peizazhit kulturor në zonën e ruajtur, menaxhimi i vizitorëve, edukimi mbi natyrën dhe marrëdhëniet me publikun dhe shkëmbimi i të dhënave për qëllime studimi dhe kërkimi, inventarizimi dhe monitorimi, etj.

Dekada e shkuar ka treguar se ndryshimet mes kornizave ligjore mund të tejkalohen, nëse palët shprehin vullnet të qartë për kontribut konstruktiv në grup dhe gjatë punës së përditshme. Megjithëse metodat që duheshin zbatuar nga dy palët për ruajtjen dhe restaurimin e ekosistemeve ishin të njëjtat, sfondi logjistik, ligjor dhe strukturor ishte dhe vazhdon të jetë shumë i ndryshëm. Situata e sotme dëshmon për një bashkëpunim nga më të suksesshmit mes dy drejtorive të parkut dhe pjesës dërmuese të komuniteteve vendore. Certifikata e parë EUROPARK 'për mbrojtjen e zonave ndërkuftare dhe bashkëpunimin e suksesshëm ndërkuftar në drejtim të ruajtjes dhe konservimit të natyrës' ju është dorëzuar dy drejtorëve në vitin 2003 për përpjekjet e bëra që nga themelimi i parkut kombëtar (Natur & Land 1993). Pas përfundimit të një vlerësimi, një certifikatë e ngjashme është dorëzuar sërish në 2010.

Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit në nivel EUREGIO (Rajonet evropiane ndërkuftare me fokus ekonomik dhe shoqëror), mes autoriteteve të parkut kombëtar dhe emërtimi i tij - Zonë e Trashëgimisë Botërore, shmang problematika që mund t'i kanosen burimeve natyrore në çdo anë të kufirit. Shembujt pozitivë përfshijnë informimin përmes Grupit të Punës EUREGIO, për një projekt minerar në Hungari në 2003, i cili shkaktoi protesta nga ana e palës austriake; në 2004 kërkesat për një rrugë ndërkuftare bicikletash afër zonës natyrore të parkut kombëtar u hodhën poshtë nga të dy Drejtoritë; në 2006 planet për ngritjen e një impianti të trajtimit të mbetjeve në pjesën jugore të rajonit brenda kufirit austriak, shkaktuan protesta në dy anët e kufirit.

Planifikimi i Zonës Ndërkuftare të Trashëgimisë Botërore u mbështet në marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e krijuar më parë. Për të zhvilluar një plan të përbashkët menaxhimi, u krijuan grupe pune me përfshirjen e të gjithë aktorëve të rëndësishëm. Objektivat dhe rezultatet e pritshme iu komunikuan publikut përmes një serie të mirëorganizuar konferencash. Aktualisht, aktorët që veprojnë në zonën e Trashëgimisë Botërore organizohen veçmas në secilin vend, përmes shoqatave të Trashëgimisë Botërore. Që nga 2010, Liqeni *Fertő/Neusiedler* është një nga 15 vendet e Trashëgimisë Botërore që gjendet i përfshirë në listën globale të Trashëgimisë Botërore, për vlerat e tij të mëdha natyrore<sup>4</sup>.

Një aspekt që nuk duhet nënvleftësuar është mbështetja e përbashkët e palëve në punën e medias dhe marrëdhëniet me publikun, për rolin që ato luajnë në lehtësimin e bashkëpunimit

<sup>4</sup> Megjithëse ky është peizazh kulturor, pasuritë e Trashëgimisë Botërore kanë vlera të mëdha natyrore dhe po kështu u vlerësua edhe nga IUCN.

ndërkufitar. Në rastin e Liqenit *Neusiedler*, interesi në lidhje me çështjet ndërkufitare dhe marrëdhënia e tyre me mediat është lehtësuar nga Fondacioni për Bashkëpunim EUREGIO krijuar në 1998, i rajonit austriak të *Burgenlandit* dhe i konteve hungareze të *Győr-Moson-Sopron, Vas, dhe Zala*. Që në atë kohë mediat rajonale e kanë intensifikuar bashkëpunimin ndërkufitar. Në kuadër të veprimtarive të përbashkëta EUREGIO, grupet e punës së ekspertëve takohen rregullisht. Kjo ka sjellë një interesim të madh nga ana e mediave për çështje që lidhen me parkun dhe projektet ndërkufitare të bashkëpunimit (Fersch dhe Lang 2006).

Të dy partnerët janë mjaft aktivë në ngritjen e fondeve për nismat ndërkufitare, si p.sh. projekti i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian për zhvillimin e trafikut në zonat e ndjeshme natyrore, i cili u udhëhoq nga ministrat respektivë në Vienë dhe Budapest. Një prej arritjeve të projektit ishte anija me energji diellore me një kapacitet maksimal prej 20 pasagjerësh, e cila shërben për ekskursione në liqen dhe për qëllime edukative e marrëdhënie me publikun.

Ruajtja e natyrës ka provuar se është një mekanizëm i mirë për nxitjen dhe intensifikimin e bashkëpunimit ndërkufitar. Krahasuar me sektorët e tjerë, këtu thuajse nuk ekziston rreziku i keqkuptimeve dhe padyshim aktorët janë të përqendruar në përfitimet ekonomike të gjithësecilit. Tashmë parqet kombëtare konsiderojnë detyrë të tyre nxitjen e identitetit rajonal ndërkufitar, që bazohet në burimet natyrore. Ai mund të arrihet vetëm nëse sigurohet përfshirja (qoftë edhe e pjesshme) në proces e gjithë sektorëve të shoqërisë në nivelin vendor. Në këtë kontekst, barriera gjuhësore ende mbetet e pakapërcyer. Në kuadër të një projekti dypalësh, në dimrin e vitit 2010, gazeta e parkut kombëtar e quajtur *Geschnatter* në Austri filloi të dalë edhe në anën hungareze me emrin *Kocsagtoll* (pupla e çafkës) në 60,000 kopje.

Sot është plotësisht e mundur që të shkëmbehen njohuritë, përvojat madje dhe infrastruktura në çdo kohë. Në dy anët e kufirit zhvillohen programe edukuese për vizitorët. Në 2010 u botua për herë të parë një program dygjuhësh për vizitorët, i cili ofronte këshilla në gjuhën gjermane për udhëtimin e vizitorëve në pjesën hungareze dhe në gjuhën hungareze për udhëtimin e tyre në pjesën austriake. Mbështetja e përbashkët që është marrë nga qendrat e vizitorëve të parkut kombëtar (*Illmitz* në Austri dhe *Fertőújlak* në Hungari), për konferenca ndërkombëtare, vizita të përfaqësuesve të shtypit, ose udhëtime studimore tregon qartë se këto dy parqe kombëtare janë pjesë e të njëjtës zonë lagunore.

## Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen

Procedura për krijimin e strukturave në dy anët e kufirit, që sot njihet gjerësisht si praktika më e mirë për ruajtjen ndërkufitare të natyrës, nuk mund të shihet vetëm si një

proces administrativ. Për të krijuar parkun që ekziston sot, janë dashur vite të tëra zhvillimesh dhe negociatash.

Nismat private dhe përpjekjet e organizatave ndërkombëtare shtrinë themelet për krijimin e parkut kombëtar, jo vetëm në sensin politik. Mund të thuhet se pa mbështetjen e shumë njerëzve që ruajtën zonat e caktuara nga përdorimi intensiv të tokës, territori i parkut nuk do të kishte shtrirjen dhe vlerën që ka sot. Zona e parkut kombëtar përfshin shumë prej zonave, dikur të dhëna me qera nga WWF Austri, ose të mbrojtura nga fondet private.

Organizatat joqeveritare patën rëndësi të veçantë gjatë procesit administrativ të krijimit të parkut. Ato ushtruan ndikimin e tyre në përcaktimin e kriterëve për kategoritë e zonave të mbrojtura, dhe ushtruan presion mbi autoritetet për të bërë zonimin e sipërfaqes duke përdorur modelet ekzistuese të menaxhimit, si bazë për procesin zbatues.

Në Austri, roli që pjesëmarrja e publikut luan në nivel vendor është shumë i madh, për shkak se parku është krijuar mbi pronë private. Kjo siguron një shkallë të lartë interesimi në lidhje me atë çka ndodh në park dhe për veprimtarinë e autoritetit përkatës të parkut, përmes nxitjes së diskutimeve dhe përfshirjes pjesëmarrëse të publikut nga gjithë zonat rrethuese.

Në Hungari, nuk është toleruar pothuajse asnjë aktivitet njerëzor për shkak të karakterit ushtarak të zonës përgjatë bregut të liqenit. Pjesa më e madhe e tokës ishte dhe vazhdon të jetë në pronësi të shtetit. Vetëm familjet që mbetën pronarë toke deri në 1948 kishin të drejtë të kërkonin kthimin e ish-pronës së tyre (Kirchberger dhe Karpati 2006).

Rëndësia e vlerësimit të ndikimit mjedisor të pavarur dhe rigoroz dhe studimet shkencore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve janë vlerësuar shumë të rëndësishme sidomos në nivelin menaxhues. Për sa i përket diskutimit në publik të çështjeve me ndjeshmëri, studimet shkencore duhet të 'përkthehen' në mënyrë sa më të qartë dhe të kujdesshme për të shmangur keqkuptimet.

Mund të thuhet se ky park kombëtar ndërkufitar u planifikua dhe u krijua nga aktorët e nivelit bazë. Mbështetja që i dhanë parkut aktorët kryesorë në nivelin vendor çoi në një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të dukshëm mes politikanëve vendorë në dy anët. Bashkëpunimi i ngritur në këtë nivel ka rezultuar si parakushti i një pune të suksesshme në ruajtjen dhe konservimin ndërkufitar të natyrës.

# 9. Praktikrat e mira të bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërkuftar – Rezerva Biosferike e *Krkonoše/Karkonosze*

Hana Petrikova<sup>1</sup>

## 1. Gjeografia e zonës

Malet *Krkonoše/Karkonosze*<sup>2</sup> i përkasin Sudeteve, një vargu të përbashkët malesh që ndajnë mes tyre Republika Çeke, Polonia dhe Gjermania. Ky është vargmali më i lartë në Republikën Çeke (400–1,602 m) dhe krijon një segment të konsiderueshëm kufitar në Evropën Qendrore, pasi shtrihet 40 km përgjatë kufirit verilindor të Republikës Çeke dhe atij

Zona njihet për biodiversitetin e lartë në të katër brezat e vegjetacionit që shtrihen në lartësi, nga zona nënkodrinore në atë alpine. Malet përbëjnë një ishull ekologjik të ekosistemeve arktike dhe alpine, homologët e të cilëve mund të gjenden në Alpe dhe në veriperëndim të Skandinavisë (Jeník 2000). Vlerat kryesore janë ekosistemet malore: tundra unike arktik-alpine, torfat moçalore nën-arktike, ekosistemet nën-alpine e alpine dhe livadhet e pasura me lule. Peizazhi është rimodeluar për shkak të vendbanimeve të ndërtuara nga njerëzit dhe përdorimit të tokës për shekuj me radhë.



© Hana Petrikova

jugperëndimor të Polonisë. Maja më e lartë është *Sněžka*<sup>3</sup> me një lartësi 1,602 m mbi nivelin e detit. Lumi i Elbës (në çekisht: *Labe*) buron në anën çeke. I tërë masivi malor mbulon një sipërfaqe prej 63,900 ha, nga të cilat 45,400 ha shtrihen në anën çeke dhe 18,500 ha në anën polake. Sipërfaqe të gjera malesh, që shtrihen në dy anët e kufirit janë klasifikuar si parqe kombëtare: Parku Kombëtar *Krkonoše* i Republikës Çeke (54,969 ha) dhe Parku Kombëtar *Karkonosze* në Poloni (16,841 ha, së bashku me zonat mbrojtëse të tij). I gjithë territori paraqet një Zonë të Veçantë të Mbrojtur për zogjtë dhe një Zonë të Veçantë të Ruajtjes për habitatet dhe llojet e tjera të *Natura 2000*.

Në të gjenden shumë livadhe malore, një rrjet i dendur shtëpish alpine dhe infrastrukturë e mjaftueshme turistike dhe sportesh dimërore. Ndotja e ajrit që arriti kulmin në fillim të viteve 1980, ka shkaktuar dëmtime masive të sipërfaqeve të tëra me pyje dhe bredha, në dy anët e maleve.

Malet *Krkonoše* janë një destinacion turistik, mjaft popullor për alpinistët dhe skiatorët. Numri i përgjithshëm i vizitorëve arrin çdo vit në 6-8 milionë në pjesën çeke dhe 2,5 - 3 milionë në pjesën polake. Gjatësia totale e shtigjeve të shkelura nga turistët tejkalon 700 km<sup>4</sup>.

Që nga shekulli 14të, malet kanë qenë nën ndikimin e kulturave të ndryshme. Për breza me radhë, së bashku me banorët çekë, u vendosën edhe shumë gjermanë. Pas Luftës

<sup>1</sup> Menaxher, Shoqata Njeriu dhe Krkonose, Republika çeke.

<sup>2</sup> Çekisht: *Krkonoše*; Polonisht: *Karkonosze*.

<sup>3</sup> Polonisht: *Śnieżka*.

<sup>4</sup> Shiko: <http://www.krnap.cz>.



## Përfitimet dhe sfidat

Marrëveshja çeko-polake e bashkëpunimit që u nënshkrua në 1996 ka nxitur bashkëpunimin ndërkuftar mes sektorëve, në mënyrë më të zgjeruar dhe intensive. Përveç bashkëpunimit tradicional të kërkimit shkencor, janë realizuar aktivitete të ndryshme ndërkuftare dhe ndër-sektoriale për të bashkërenduar ruajtjen e natyrës me zhvillimin social-ekonomik të rajonit. Ato përfshijnë forume çeko-polake, me përfaqësues të shumë sektorëve ku diskutohet mbi çështje të interesit të përbashkët, si; Mundësitë dhe kufizimet e zhvillimit të mëtejshëm të *Krkonoše*—faktorët ekologjikë dhe social-ekonomikë, 'Vizioni për zhvillimin e qëndrueshëm në *Krkonoše*', 'Indikatorët e zhvillimit të qëndrueshëm', 'Planifikimi territorial-shkëmbim përvojë', etj. Përqendrimi i përpjekjeve kryesore është orientuar në mbështetjen e komunikimit dhe të mirëkuptimit reciprok mes punonjësve shkencorë dhe ruajtësve të natyrës, në një anë, dhe mes përfaqësuesve nga institucione dhe sektorë të ndryshëm, si autoritetet vendore, shërbimet turistike, fermat, OJQtë dhe komunitetet vendore që ushtrojnë ndikimin në zhvillimin e mëtejshëm të maleve *Krkonoše*. Shkëmbimi i informacionit dhe opinioneve mes komuniteteve përtej kufijve, ku njerëzit kanë mendime të ngjashme mbi ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin ekonomik, ka qenë veçanërisht i suksesshëm dhe frymëzues (Petrikova dhe Raj 2006).

Rezerva ndërkuftare e Biosferës ka luajtur rolin kryesor në fushën e kërkimit, monitorimit, edukimit dhe trajnimit. Aktivitetet e përbashkëta shkencore në *Krkonoše* përfshijnë njehsimin e bazave të dhënave të GIS, botimin e Atlasit çeko-polak për shpendët që follenizojnë në këtë zonë (Flousek dhe Gramsz 1999), listën e drurëve të zhdukur dhe Listën e Kuqe të bimëve enëzore (Štursa et al. 2009) ku shpjegohet statusi aktual i bimëve enëzore dhe arsyet kryesore për rënien e numrit të tyre në dy anët e maleve *Krkonoše*. Që nga viti 1992, mes dy parqeve po zhvillohet një nismë e përbashkët për GIS, si mjet i rëndësishëm për menaxhimin e integruar dhe koordinimin e aktiviteteve në rajon. Qëllimi kryesor i projektit është që ta shohë zonën *Krkonoše* të Polonisë dhe Çekisë, si një zonë të vetme dhe të pandashme. Të gjitha shtresat e integruara të informacionit do të jenë të aksesueshme në një server të ri (MapServer)<sup>9</sup>.

Një nga tiparet e vecanta të konceptit të TBR është qasja ndërdisiplinore e dimensionit social-ekonomik. Momentalisht, ekziston një numër i madh të dhënash cilësore për natyrën e *Krkonoše* dhe faktorët antropogjenikë që ndikojnë mbi zonën, siç është ndikimi i ndotjes së ajrit, por ka mungesë të dhënash dhe njohurish për çështjet social-ekonomike. Njohuritë mbi kufijtë e kapaciteteve mbajtëse të zonës ose fluksin e vizitorëve janë shumë të rëndësishme për vendimmarrjet kryesore. Në këtë mënyrë parqet do të bëhen shkas për nxitjen e veprimtarive të kërkimit social-ekonomik

dhe monitorimin e projekteve për ruajtjen e natyrës. Projektet do të shfrytëzojnë treguesit për monitorimin dhe vlerësimin e ndryshimeve afatgjata mjedisore, sociale dhe ekonomike në parqet kombëtare dhe Rezervën e Biosferës.

Për shumë vjet, malet *Krkonoše* kanë qenë një arenë mosmarrëveshesh për çështjet ekologjike. Komunitetet, administratashitetore dhe sektori i biznesit kanë kundërshtuar ndërhyrje në përfitimin më të mirë të rajonit, duke u përpjekur të gjejnë argumente bindëse, por që në shumicën e rasteve mbështesnin interesat e tyre personale. Në disa raste, këto kundërshti u kthyen pothuajse në një ritual. Akoma edhe sot, duket qartë se palët në konflikt nuk janë "ekologjistë fundamentalistë" apo "shkelës të përhershëm të natyrës". Në të vërtetë, ata janë njerëz me një interes të përbashkët afatgjatë investues, ruajtës të natyrës dhe përfaqësues të komunitetit – dhe të gjithë dëshirojnë dhe kanë nevojë që njerëzit të jenë të kënaqur me cilësinë e jetës dhe mirëmbajtjen e natyrës (Flousek and Plamínek, 2007).

Ajo që mungon është një kornizë pune në formën e një dokumenti social-ekonomik, që do të shërbejë si udhëzues për vendimmarrjen operacionale në sektorët shtetërorë dhe publikë, i cili duhet të respektohet nga njerëzit vendas, ekspertët dhe zhvilluesit.

Në 2008, Bordi Këshillimor i Parkut Kombëtar të Çekisë, Shoqata e Komuniteteve *Krkonoše* dhe OJQtë lokale krijuan një grup shumësektorial pune që të përgatiste një dokument rreth vizionit për malet *Krkonoše*. Me grupin u bashkuan edhe përfaqësues polakë. Grupi i punës kishte si synim të zhvillonte një dokument që do të ishte i pranueshëm për shumicën e banorëve, vizitorëve të *Krkonoše* dhe administratorëve të Parqeve Kombëtare të Polonisë dhe Çekisë. Draft dokumenti social-ekonomik-mjedisor u zhvillua duke u mbështetur në shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke u bazuar në përgjigjet e pyetësorëve që u shpërndanë gjerësisht në takimet e organizuara dhe në komentet mbi tekstin e draftit dokumentit, etj. Dokumenti i punës titullohet "Vizioni *Krkonoše* 2050 – Një miqësi mes njerëzve dhe maleve" është dorëzuar së fundi për miratim, pranë komuniteteve dhe aktorëve kryesorë, në formën e një memorandumi. 'Vizioni' nuk do të jetë dokument me fuqi ligjore. Pranimi dhe respektimi afatgjatë i parimeve të tij do të konsiderohen një angazhim moral për të gjithë aktorët.

Tashmë vërehen ndryshime në qendrimet e administratës së parqeve kombëtare dhe komuniteteve. Komunitetet ndiejnë se administratat e parqeve kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre dogmatike dhe armiqtësia mes tyre është zhdukur. Kjo ka ndodhur si rezultat i takimeve të përbashkëta, kryesisht takimet e bordeve, ku marrin pjesë edhe përfaqësues nga komuniteti. Duke punuar së bashku ata kanë vlerësuar fushat me interes të përbashkët dhe kanë bërë një përcaktim më të kujdesshëm të kufijve territorialë. Zonimi i ri është duke u

<sup>9</sup> Shiko: <http://mapserv.krnapp.cz/mapserv/php/maps.php> and <http://www.kpnmap.pl/pl/gis,105>.

përgatitur dhe do të ndihmojë në bashkëpunimin më të mirë mes administratave të parqeve, komuniteteve dhe vizitorëve.

### Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen

Vazhdimësia e aktiviteteve të TBR, cilësia e tyre dhe platforma e ndryshme e komunikimit janë shumë të rëndësishme për bashkëpunimin e suksesshëm. Kjo kërkon ekzistencën e një strukture të përhershme, p.sh të një sekretariati të përhershëm koordinues, me role dhe përgjegjësi të përcaktuara mirë, fondet e duhura dhe kohën e nevojshme për zbatim. Trupa bashkërenduese duhet të jetë e aftë të përballë dhe të tejkalojë faktin se liderët dhe përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme ndryshojnë shpesh dhe herë pas here duhen ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me partnerë të rinj.

Përveç faktit se Këshilli çeko-polak për Rezervën e Biosferës të *Krkonoše/Karkonosze* është përpjekur që në fillim t'i mbajë të ndërthurura komunikimin dhe bashkëpunimin ndërkufitar mes sektorëve, duket se gjithnjë ka ekzistuar tendenca dhe preferenca për të punuar vetëm me partnerë nga të njëjtët sektorë, që flasin të njëjtën gjuhë profesionale. Janë arritur marrëveshje dhe projekte të reja mes komuniteteve individuale, shkollave, parqeve, muzeve, organizatave turistike, qendrave të informacionit, etj. Megjithatë, Rezerva

dypalëshe e Biosferës është konceptuar në mënyrë të atillë që partnerët të bëhen bashkë dhe të komunikojnë, diskutojnë dhe të zhvillojnë një vizion të përbashkët. Puna për të ndërlidhur shumë sektorë dhe forume me aktorë të ndryshëm, kërkon shumë më tepër përpjekje dhe përgatitje nga ana e organizatave.

Duket se një plan i përbashkët menaxhimi nuk është me leverdi për këtë Rezervë dypalëshe të Biosferës. Administratorët dhe menaxherët e zonave të mbrojtura çeke dhe polake, janë të detyruar t'i shtjellojnë planet e tyre të menaxhimit në përputhje me ligjet e ndryshme që ekzistojnë në secilin vend, të cilat kontrollohen nga autoritetet më të larta respektive (ministritë). Për këtë arsye, duhet të flasim më shumë për një politikë të përbashkët menaxhimi, masa të përbashkëta, aktivitete, projekte, inventarë, kërkim, monitorim, gjithashtu edhe edukim të përbashkët, të cilat përbëjnë kornizën më të përshtatshme të bashkëpunimit në këtë Rezervë ndërkufitare të Biosferës.

Ekziston shqetësimi i përbashkët se shpesh herë rezultatet e kërkimit shkencor nuk përfshihen në vendimet menaxhuese. Përveç popullarizimit të punës kërkuese, një vëmendje akoma më e madhe duhet t'i kushtohet shkencave sociale dhe qasjes ndërdisiplinore.



Foto prej Jan Groh

# 10. Zhvillimi përkrah natyrës, me parkun trepalësh: Goričko-Raab-Őrség

Stanka Dešnik<sup>1</sup> and Gregor Domanjko<sup>2</sup>

## 1. Gjeografia e zonës

Parku natyror trepalësh i Goričko-Raab-Őrség shtrihet në qendër të Evropës, përgjatë ish-gardhit të Perdes së Hekurt, në kufi me Slloveninë, Austrinë dhe Hungarinë. Ideja për krijimin e parkut lindi në fillim të viteve 1990, në disa takime në vitin 1989 që kishin si qëllim zhvillimin e një vizioni për zonën, pas rënies së Perdes së Hekurt. Parku Natyror<sup>3</sup> Goričko<sup>4</sup> (Slloveni)



© K. Malačič

mbrohet me Aktin Slloven për Ruajtjen e Natyrës dhe sipas IUCN klasifikohet në kategorinë e V të menaxhimit të zonave të mbrojtura. Parku Kombëtar *Őrség* (kategoria e II sipas IUCN) në Hungari mbrohet sipas Ligjit Hungarez, ndërsa Parku Kombëtar *Raab* në Austri mbrohet sipas Ligjit të Burgenlandit dhe nuk klasifikohet në asnjërin prej kategorive të IUCN-së. I gjithë parku trepalësh zë një sipërfaqe prej 105,200 ha.

Qëkurse Sllovenia dhe Hungaria u bënë pjesë e Bashkimit Evropian në 2004, më shumë se 96% e Parkut Natyror të Goričkos dhe i gjithë Parku Natyror *Őrség* u bënë pjesë e Natura 2000 (Tabela 1), ndërsa Parku Natyror i *Raab* nuk përfshihet në klasifikimet e Natura 2000. Zona e Natura 2000 që gjendet në Goričko shtrihet në kufi me Austrinë dhe lidhet me zonën Natura 2000 të *Styrias Jugore*, duke i ofruar mbrojtje këtij peizazhi kodrinor, që është streha e shpendit shumë të kërcënuar *Coracias garullus*.

Gjeografikisht, parku trepalësh përfshin peizazhet e ulëta kodrinore të pjesës perëndimore të rrafshit Panonian, mes lumenjve Raba, Krka dhe Ledava. Në rajonin tripalësh të parkut, kodrat më të larta gjenden në pjesën perëndimore duke u bërë më të ulëta dhe më të rrafshëta në drejtim të lindjes. Toka është kryesisht ranore, dhe më e ndryshueshme në kufijtë perëndimorë ku gjenden shkëmbinj me moshë të ndryshme gjeografike, që përfshijnë fosilet e guackave

relike të detit Panonian. Gjithshtu gjenden karboniferet permiane të shtufës dhe shkëmbinjve (prej hiri vullkanik) të Gradit, që janë krijuar 2-3 milion vite më parë, si pasojë e aktivitetit vullkanik në rajonin *Styria* të Austrisë. Toka e butë ranore është shpërlarë nga shirat që kanë rënë për mijëra vjet dhe erozioni i ujit ka krijuar një peizazh të harmonishëm gjeomorfologjik me shumë kodra të vogla.

Për shkak të gjeomorfologjisë specifike, rrjetit të lumenjve dhe përrenjve të vegjël, tokës acide të shpërlarë nga ujërat, shirave

të pakët (600–800 mm në vit) dhe erozionit të lartë të shkaktuar prej stuhive, etj, bujqësia nuk ka qenë kurrë shumë fitimprurëse në këtë rajon. Popullsia e rajonit zhvilloi ferma që mbulonin kryesisht nevojat e fermerëve, të cilat ishin të mjaftueshme për mbijetesë deri në periudhën e zhvillimit industrial. Të tre rajonet kufitare përballeshin me të njëjtat probleme zhvillimi, si moshë e vjetër dhe e pa arsimuar e popullsisë, ferma kryesisht të vogla pa perspektivë për të ardhmen, fusha të braktisura, mungesën e përhapjes së industrisë dhe infrastrukturës, distancat e gjata nga qendrat kombëtare, peizazhe të papopulluara me një shkallë të lartë të migrimit të krahut të punës dhe një numër i madh shtëpish të braktisura.

Deri në Luftën e Parë Botërore, i gjithë rajoni ishte nën Mbretërinë e Hungarisë për më tepër se një mijë vjet. Pas aktit të pajtimit që solli Traktati Trianon i Paqes, në 1920, mes Austrisë, Hungarisë dhe Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve u krijuan kufij të rinj. Pas Luftës së Dytë Botërore, kufiri mes Hungarisë dhe Sllovenisë (pjesë e Ish-Jugosllavisë) mbrohej në anën hungareze, nga një rrip 40 m i gjerë telash me gjemba, fushash të minuara, kullash vrojtimi dhe rojesh kufitare. Pas revolucionit hungarez (1956), instalimet kufizuese të kufijve me Jugosllavinë u çmontuan pjesërisht, ndonëse kalimi i kufirit vazhdonte përsëri të ishte shumë i kontrolluar.

Kufiri mes Hungarisë dhe Austrisë neutrale filloi të ruhej disi pas vitit 1956. Më vonë kufiri në anën hungareze mbrohej deri në 1965 nga tela me gjemba 60 m të gjerë, fusha pjesërisht të minuara dhe nga një rrugë për shërbime kufitare me kulla vrojtimi, që shtrihej përgjatë brezit kufitar. Rreth 2-3 km nga

<sup>1</sup> Këshilltar i Lartë për Mbrojtjen e Natyrës, Instituti Publik i Parkut Kombëtar të Goričko, Slloveni.

<sup>2</sup> Kordinator projekti, Instituti Publik i Parkut Kombëtar të Goričko, Slloveni.

<sup>3</sup> Gjithashtu referohet si Parku i Peizazhit Goričko.

<sup>4</sup> <http://www.park-goricko.org/>

vija kufitare shtrihej një gardh dyfish telash me gjemba me sistem elektrik alarmi dhe një brez i punuar toke 8-10 m i gjerë, për të mbajtur gjurmët e të arratisurve. Zona mes kufirit dhe gardhit dyfish të telave quhej ' brezi kufitar', në të cilin edhe banorët afër tij mund të shkelnin vetëm pasi të kishin marrë lejen zyrtare.

Në gusht të 1989, pikniku Pan-Evropian dhe hapja pas një muaji e kufirit mes Hungarisë dhe Austrisë, shënuan fillimet e rënies së Perdes së Hekurt. Që nga krijimi i kufirit lindor Shengen në dhjetor 2007, kufiri mes Sllovenisë, Austrisë dhe Hungarisë kalohet lirisht.

një shtim i partneritetit mes sektorëve përkatës, në nivelet vendore, kombëtare dhe ndërkufitare. Ky partneritet përfshin bashkitë, ministritë, institucionet kërkimore, fondacionet, shkollat universitetet dhe OJQ-të.

Bashkëpunimi ndërkufitar ishte shumë i rëndësishëm për krijimin e parkut trepalësh. Në të shkuarën, nuk ishte kryer asnjë lloj studimi mbi gjendjen e natyrës në zonën e Goričkos dhe nuk kishte asnjë propozim për ta shpallur atë peizazh të mbrojtur. Në anën hungareze, propozimi për ta shpallur peizazhin "zonë të mbrojtur", ishte paraqitur që në 1976. Për shkak të izolimit të gjatë mes vendeve, ishin ruajtur vlerat e jashtëzakonshme

|                        | Parku Natyror Goričko  | Parku Natyror Raab          | Parku Kombëtar Órség                                     | Totali  |
|------------------------|--|-----------------------------|--|---------|
| Shteti                 | Slloveni   | Austri                      | Hungari  |         |
| Shpallur më            | 2003   | 1998                        | 2002   |         |
| Vendi i Autoritetit    | Grad   | Jennersdorf                 | Öriszentpéter  |         |
| Punonjësit (viti 2010) | 11 të rregullt + 2 projekti + 1 fondi social i BE-së + 7 shërbimi publik | 1.5 i rregullt + 1 projekti | 35 të rregullt + 3 projekti + 5 për periudhë të shkurtër |         |
| Zona (ha)              | 46,200   | 15,000                      | 44,000   | 105,200 |
| Kategoria e IUCN       | V  | asnjë                       | II   |         |
| Natura 2000            | 96%  | asnjë                       | 100%   |         |
| Nr. i banorëve         | 25,000   | 10,000                      | 16,000   | 51,000  |

Table 10.1 Krahasimi i fakteve mes tre parqeve

## Momentet kryesore të zhvillimit historik

Momentet kryesore deri në shpalljen e Parkut Kombëtar Goričko-Raab-Órség, në 2003 ishin:

- 27 maj 1989: kryetarët e bashkive *Körmend* (Hungari), *Murska Sobota* (Jugosllavia e atëhershme, sot Slloveni) dhe *Fürstenfeld* (Austri) u takuan në trekëndëshin kufitar mes Ish-Jugosllavisë, Hungarisë dhe Austrisë dhe vendosën një gur që në mënyrë simbolike përfaqësonte marrëveshjen e arritur mes tyre, në lidhje me të ardhmen e zhvillimit dhe paqes;
- 1992: lindi ideja për krijimin e Parkut Natyror ndërkufitar trepalësh Raab-Órség-Goričko;
- 1995: u nënshkrua në Vienë programi AT-HU-SLO i Bashkëpunimit Ndërkufitar (CBC);
- 12 shtator 1998: Në bazë të rregullores së qeverisë, u krijua Parku Natyror i Raabit, në Austri;
- 8 mars 2002: Kryeministri hungarez, Viktor Orban deklaroi Órségun si Park Kombëtar;
- 9 tetor 2003: Qeveria sllovene deklaroi Goričkon si Park Natyror.

Partnerët kryesorë që u përfshinë në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar ishin autoritetet menaxhuese të tre parqeve dhe të bashkive respektive. Gjatë zbatimit të aktivitetëve në kuadër të projekteve të ndryshme, vihet re

të natyrës dhe peizazhit në të tre anët e kufijve. Me qëllim mbrojtjen e mëtejshme të këtyre vlerave, shtrohej nevoja për bashkëpunim ndërkombëtar në shkëmbimin e të dhënave, teknikave dhe metodave të kërkimit.

Pas krijimit në vitin 2003 të tre parqeve, u vazhdua të punohej për menaxhimin trepalësh të parkut, si një rajon i tërë dhe i vetëm natyror dhe peizazhit, për shkak të regjimeve të ndryshme të mbrojtjes që ekziston në tre vendet. Për këtë arsye u hartua një Memorandum Mirëkuptimi që përshkruante detyrat e tre partnerëve. Dokumenti është shkruar në tre gjuhë dhe versioni i parë i tij u nënshkrua publikisht më 21 maj 2006 në *Windisch-Minihof* (Austri) me rastin e festimit të Ditës Evropiane të Parqeve. Më 24 maj 2009, në *Öriszentpéter* (Hungari), u nënshkrua Marrëveshja e rinovuar e Partneritetit.

## Përfitimet dhe sfidat

Historiaekrijimit të parkut trepalësh bazohet në bashkëpunimin ndërkufitar. Një nga përfitimet kryesore të bashkëpunimit ndërkufitar në rajon është mundësia për të zbatuar programe të përbashkëta të bashkëpunimit ndërkufitar, që mbështeten financiarisht nga BE. Ky bashkëpunim lehtëson zhvillimin e një vizioni të përbashkët që ndihmon mbrojtjen në mënyrë më të integruar të natyrës dhe peizazheve në tre vendet.

Bashkëpunimi ndërkufitar lehtëson shkëmbimin e përvojave dhe të ideve mes njerëzve përtej kufijve në nivel zyrtar edhe atë jozyrtar, duke ndikuar gjithashtu në krijimin e besimit tek njerëzit. Një përfitim tjetër i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkufitar është se njerëzve të arsimuar u jepet mundësia të punojnë dhe qëndrojnë në rajon. Megjithatë, e ardhmja mbetet sfidë për hartimin e një plani të përbashkët ndërkufitar menaxhimi që integron qëllimet për mbrojtjen e natyrës dhe të peizazheve, me zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit dhe mirëqenien e komuniteteve vendore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak të statusit dhe kapaciteteve të ndryshme të zonave të mbrojtura dhe nevojës për të vepruar në përputhje me kërkesat e rrejtit Natura 2000 dhe me politikën e tjera të BE-së. Një sfidë tjetër që shtrihet e ardhmja e bashkëpunimit ndërkufitar lidhet me planifikimin hapësinor dhe urban të bashkive në zonat kufitare, së bashku me vlerësimin dhe monitorimin e shkallës së tyre të ndikimit në mjedis. Sipas Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së, kjo është një detyrë e domosdoshme, veçanërisht në kufijtë lumorë. Me qëllim që të arrihet përmbushja e qëllimeve të përmendura më lart, në memorandumun e mirëkuptimit mes parqeve u radakort për objektivat e mëposhtëm:

- të punohet së bashku për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave natyrore dhe kulturore;
- të planifikohen dhe organizohen ngjarje të përbashkëta dhe aktivitete turistike;
- të hartohen në mënyrë të përbashkët materialet për botim, faqet e internetit dhe promovimet e tjera të përbashkëta për parkun;
- të nxitet edukimi në lidhje me natyrën, mbrojtjen e mjedisit, shkollat mjedisore dhe pyjore;
- të mirëmbahet restaurimi i habitateve;
- të bashkëpunohet me nismën evropiane të Brezit të Gjelbër<sup>5</sup>.

Memorandumi i Mirëkuptimit identifikoi aktivitetet specifike më poshtë:

- prezantimi i qëllimeve të përbashkëta të rajonit të parkut në nivel vendor, rajonal dhe BE;
- përfshirja e popullsisë vendase dhe OJQve në mbrojtjen aktive të natyrës;
- përfshirja e njerëzve në zhvillimin e turizmit dhe rritja e ndërgjegjësimit publik rreth vlerave rajonale;
- ruajtja dhe transmetimi i traditave sociale dhe etnike, shkëmbimi i përvojave në lidhje me format tradicionale të bujqësisë, ekonomisë dhe punës tradicionale artizanale, në bashkëpunim me popullsinë vendase;
- ruajtja e vlerave të përbashkëta të peizazheve me arkitekturë tipike folklorike dhe mbledhja e materialit dokumentar;
- prezantimi i ruajtjes dhe mbrojtjes së peizazheve në programet zhvillimore;

- dhënia e mbështetjes reciproke në përgatitjen e projekteve dhe dorëzimin e projekteve të aplikimit në përgjigje të thirrjeve që shpallen nga qeveritë dhe BEja;
- përfshirja në studime për popullatat e peshkut në lumenjtë ndërkufitare;
- përfshirja në punën kërkimore dhe mbikqyrjen e popullatës së lundëzës (*Lutra lutra*),
- realizimi i aktiviteteve të përbashkëta monitoruese mbi ndikimin e mundshëm të Qendrës së djegjes së mbetjeve afër *Monošter/St. Gothard* (kufiri HU-AT), nëse qeveria austriake merr vendim për ta ndërtuar.

Për zbatimin e qëllimeve të partneritetit, përveç zhvillimit të planeve të përbashkëta të menaxhimit dhe krijimit të një autoriteti trepalësh për drejtimin e parkut, parashikohet edhe ngritja e përbashkët e fondeve. Për shkak të pranisë së peizazheve të ruajtura kulturore dhe trashëgimisë kulturore, ekzistojnë plane për t'i dhënë zonës statusin Trashëgimisë Kulturore të UNESCOs.

### Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen

Për shkak të historisë tonë të përbashkët si pasojë e Luftës së Ftohtë, nuk ishte e lehtë të arriheshin kontakte me fqinjët. Fillimisht, gjuha ishte një problem, i cili sidoqoftë u kapërcye dhe zvogëloi barrierat e komunikimit përmes zhvillimit të trajnimeve në gjuhën angleze. Vizitat e rregullta, takimet dhe asistencën e përfituar nga partnerët kryesorë dhe ekspertët e vendeve të tjera, lehtësuan progresin e shpejtë në përdorimin e gjuhës. Kjo ishte gjithashtu e rëndësishme, në kushtet kur të gjitha thirrjet për projekte dhe aplikime në kuadër të CBC (bashkëpunimit ndërkufitar) kërkonin që përgatitja e tyre të bëhej në anglisht.

Përmes bashkëpunimit ndërkufitar, e sidomos projekteve ndërkufitare, ishte më e lehtë të mësohej si të komunikohesh dhe si të realizohej zbatimi i projekteve të financuara nga publiku. Përmes tij, u mësua rreth historisë së përbashkët në të gjitha anët e kufirit.

Bashkëpunimi ynë ndërkufitar dhe përmes kufijve në rreth 20 vite është një bazë e mirë për vazhdimësinë e punës në kuadër të mbrojtjes së natyrës dhe stabilitetit të ekosistemeve, me projekte dhe aktivitete të tjera në shkallë të vogël dhe të madhe. Përmbushja e qëllimeve të përbashkëta, që përbën edhe platformën e parkut trepalësh, ka rëndësi për zbatimin e aktiviteteve që cilëson Marrëveshja e Partneritetit. Në vazhdojmë të kërkojmë burime më të qëndrueshme financiare dhe dëshirojmë një shpërndarje më të balancuar të numrit të punonjësve në park. Bashkëpunimi në të ardhmen, që bazohet në përvojat e mëparshme dhe në një rrejt të gjerë partneriteti, është siguria më e mirë për zhvillimin të qëndrueshëm, të drejtë nga pikëpamja sociale dhe ekonomike, të shëndetshëm dhe miqësor ndaj natyrës.

<sup>5</sup> <http://www.greenbelteurope.eu/>

# 11. Zemra e Egër e Evropës – Përgjegjësi për Evropën

Zdenka Křenová<sup>1</sup> and Hans Kiener<sup>2</sup>

## Gjeografia e zonës

Pylli Bavarez dhe Parqet Kombëtare *Šumava* (PB&PKŠ/ose ang. BF&ŠNP) ndodhen mes Pragës (Republika Çeke) dhe Mynihut (Bavari, Gjermani), rreth 180 km larg secilit prej

(*Tetrao urogallus*), Bufi i Uraleve (*Strix uralensis*), Qukapiku me tre gishtërinj (*Picoides tridactylus*) dhe lloje të tjera të zonës jugperëndimore, që luajnë një rol të rëndësishëm për pyllin e dendur, që dominon këtë pjesë të kontinentit. I vendosur në një zonë prej më shumë se 90,000 ha, BF&ŠNP përfaqëson një shembull të zonës malore të Evropës Qendrore dhe një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Evropës. Parqet kanë kufi të përbashkët mjaft të gjatë, që



© Andreas Ebert

kryeqyteteve. Një zinxhir malesh, ngrihet mu në zemër të Evropës, përgjatë kufirit çeko-bavarez. Më shumë se dy milionë hektarë të pyjeve bavareze dhe atyre *Šumava* kanë mbetur thuajse fare të paprekura nga infrastruktura rrugore dhe nuk ka vendbanime të mëdha. Të vendosura në qendër të kësaj zone, me majat më të larta të maleve *Rachel* (1,453 m) dhe *Plechý* (1,379 m), PB&PKŠ përbëjnë një peizazh të dendur drurësh me bukuri madhështore, me lumenj me ujë si kristali, kënetat të paprekura, shkurretat, pyje dhe kullota të braktisura në lartësitë e mëdha. Ky pyll, që ndryshe quhet *Silva Gabreta*, është unik për shkak të përmasave dhe kushteve thuajse plotësisht natyrore. Ai është i fundit që ka mbetur nga "Pylli Hercinian i Romanëve"; vendbanim dhe strehë për shumë lloje të rrezikuara bimësh dhe kafshësh. Në të gjenden shumë elementë të pyllit verior, si Gjeli i egër

nxjerr në pah rëndësinë e çështjeve ndërkufitare lidhur me ruajtjen, korridoret ekologjike dhe ndërlidhjet mes zonave.

Qëllimet menaxhuese të parqeve kombëtare nuk janë sqaruar ende në tërë aspektet përbërëse. Kur parlamenti bavarez votoi unanimisht krijimin e Parkut Kombëtar të Pyllit të Bavarisë (PKPB/BFNP ang.) në 1969, i pari i këtij lloji në Gjermani, u mendua se projekti për shpalljen e tij do të sillte shumë shpejt të ardhurat e nevojshme për popullsinë vendase. Kjo do të kryhej përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe mbështetjes së turizmit në këtë zonë të varfër, që shtrihet mbrapa Perdes së Hekurt. Menjëherë pas rënies së Perdes së Hekurt në 1991, i njëjti arsyetim nxiti edhe shpalljen e Parkut Kombëtar (PK) të *Šumavës*.

Pas krijimit të parqeve kombëtare, turizmi në komunitetet rurale rreth parqeve është zhvilluar ndjeshëm. Me një fillim modest, parku është kthyer në shtyllë mbështetëse për punësimin dhe nxjerrjen e të ardhurat. Sipas një studimi të

<sup>1</sup> Asistent Profesor, Fakulteti i e Shkencave, Universiteti i Bohemisë së Jugut dhe ish Kryetari i Departamentit të Kërkimit dhe Mbrojtjes së Natyrës, Parku Kombëtar i *Šumavës*, Republika Çeke.

<sup>2</sup> Drejtues i Departamentit të Mbrojtjes dhe Manaxhimit të Vizitorëve, Parku Kombëtar i Pyllit të Bavarisë, Gjermani.

kohëve të fundit (Job et al. 2007), PKPB është një komponent i rëndësishëm i ekonomisë rajonale<sup>3</sup>. Me 760 000 vizitorë në vit, PKPB është zona më tërheqëse dhe më e frekuentuar e rajonit. Përqindja që PKPBja i jep turizmit të zonës është ekuivalente me<sup>4</sup> punësimin e 940 njerëzve dhe të një numri shtesë prej 200 vendesh me kohë të plotë pune në administratën e parkut kombëtar. Rezultate të ngjashme mund të vihen re edhe në PKŠ, megjithëse të dhënat e sakta numerike mungojnë.

## Arritjet kryesore në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar

Planet për të mbrojtur këtë peizazh të madh pyjor datojnë që në fillimet e shekullit të 20të, megjithëse nuk mundën të zbatoheshin kurrë për shkak të dy Luftërave Botërore dhe më pas, për shkak të Perdes së Hekurt, e cila ndau për një gjysëm shekulli (1945 - 1990), blloqet politike të pushtetit dhe mjedisin njerëzor dhe natyror të Evropës.

Dëshirat e vjetra u plotësuan së paku pjesërisht, me shpalljen në vitin 1969 të PKPBsë, i cili në atë kohë kishte një shtrirje prej 13000 ha sipërfaqe toke. Në 1991, Republika Çeke vendosi që pjesët më me vlerë të malit *Šumava* t'i bënte pjesë të Parkut Kombëtar. Përcaktimi prej 68.500 ha i PKŠ ishte një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një zone të madhe ndërkufitare të mbrojtur, me rëndësi ndërkombëtare. Në gusht 1997, me mbështetjen e parlamentit bavarez, PKPB u zgjerua me rreth 11 000 ha të tjera shtesë, duke krijuar një mundësi unike për ruajtjen e më shumë se 90 000 ha tokë. Kështu, parku përbën një peizazh natyror dhe strehë ekologjike të pakonkureshme në gjithë Evropën Qendrore.

Të dy parqet kombëtare së bashku përbëjnë zonën më të madhe të mbrojtur ndërkufitare në Evropën Qendrore dhe formojnë zonën më të madh tokësore të Natura 2000, në secilin prej vendeve.

Partnerët kryesorë të përfshirë në bashkëpunimin mes BF&ŠNP janë: Ministria e Mjedisit në Republikën Çeke, Ministria e Mjedisit dhe Shëndetit Publik në shtetin e Bavarisë, autoritetet e Parkut Kombëtar *Šumava* dhe autoritetet e Parkut Kombëtar të Pyllit Bavarez. Me një lloj entuziazmi të madh mes palëve, dy autoritetet e parqeve vendosën që prej vitit 1991 një bashkëpunim praktik, ndonëse jozyrtar. Që nga 1999, bashkëpunimi ndërkufitar është bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit mes PKŠ dhe PKPB për menaxhimin përkatës të parqeve, i cili u nënshkrua nga ministrant respektivë. Ndërkohë, u nënshkruan edhe disa dokumente shtesë, p.sh për menaxhimin e parkut dhe

komunikimin ndërkufitar. Në 2009, të dy parqet ranë dakort me udhëzimet e përbashkëta të menaxhimit për zonën e egër ndërkufitare. Dy parqet kanë qenë partnerë zyrtarë të disa projekteve të financuara nga BE (Interreg, Leader dhe Fondi Gjermano-Çek i të Ardhmes).

## Përfitimet dhe sfidat

Me qëllim që të arrihen objektivat e përbashkëta në lidhje këtë zonë të integruar, bashkëpunimi ndërkufitar është fokusuar kryesisht në pikat e mëposhtme:

### *Qendra e parë e përbashkët e informimit*

Qendra e informimit u ndërtua në *Bučina*, që është një prej pikave kryesore të hyrjes në PKŠ nga PKPB. Ky ishte edhe projekti i parë i përbashkët mes dy rajoneve. Në të paraqiten koncepti i parkut kombëtar në dy gjuhë, historiku i zonave të mbrojtura, vargu i peizazheve, rregulloret e parkut kombëtar, etj. Për më tepër aty paraqiten edhe mundësitë që ofron parku për vizitorët.

### *Sistemi i transportit publik ndërkufitar*

Në 1996, me futjen e sistemit publik të transportit, dy parqet kombëtare morën më tepër vlerë si zona pushimi dhe shplohjeje. Në pjesën e Bavarisë, autobusët iriq'funksionojnë që nga maji i 1996ës, duke lidhur të gjitha zonat dhe lehtësitë e rëndësishme për vizitorët, me qytetet dhe fshatrat përreth. Në po të njëjtin vit, u krijua sistemi i transportit publik edhe në PKŠ. Të dy shërbimet e transportit përdorin autobusë që punojnë me gaz natyror ose biokarburante. Shërbimet e transportit publik janë në dy gjuhë dhe të bashkërenduara.

### *Stacioni i trenit në kufirin historik i që kalon nëpër qendrën ndërkufitare të informimit*

Pasi përfundoi përrurimi ceremonial i restaurimit të stacionit hekurudhor në kufirin historik, nga dy ish-ministrat e shtetit, Miller (Bavari) dhe Kužvart (Republika Çeke), në *Bayerisch Eisenstein/Alžbětín*, u hap një zyrë ndërkufitare informimi, e cila jep informacion për dy parqet kombëtare, Peizazhin e Mbrojtur *Šumava* dhe Parkun Kombëtar të Pyllit Bavarez.

### *Koordinimi dhe trajnimi i shërbimit të rojtarëve të parkut*

Shërbimi i rojtarëve të parkut koordinohet rregullisht me takime në të dy anët e kufirit. Përveç dhënies të trajnimeve profesionale, për rojet organizohen edhe kurse të përbashkëta për të rritur shkallën e tyre të njohjes dhe për t'i ndihmuar të kuptojnë historinë dhe kulturën e vendit fqinj. Gjithashtu, për t'ju ardhur në ndihmë, është përgatitur edhe një manual reference me faktet dhe informacionet më të rëndësishme për dy anët e parkut, në formën e një libërthi dore dy gjuhësh.

<sup>3</sup> Përmbledhja në gjuhën angleze gjendet në internet në: [http://www.nationalpark-bayerischer-wald.de/detail/veroeffentlichung/publikationen/d\\_berichte/doc/en\\_studie\\_job\\_kurz\\_ba.pdf](http://www.nationalpark-bayerischer-wald.de/detail/veroeffentlichung/publikationen/d_berichte/doc/en_studie_job_kurz_ba.pdf)

<sup>4</sup> M.q.s. shumica e punëve në sektorin turistik janë sezonale, shifrat e dhëna paraqesin një përlogaritje të barazvlefshme me punësimin me kohë të plotë, gjatë gjithë vitit.

### *Prezantimi i suksesshëm i bufit të Uraleve*

Njëzet e pesë vjet përvojë kanë treguar se përpjekjet për prezantimin e bufit të Uraleve kanë ecur shumë përpara, falë vendimit për të nxitur projekte të ngjashme, jo vetëm në zonën e PKŠ por edhe në pyjet e Austrisë që gjenden pranë tij. Ky është një parakusht bazë për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të këtij lloji përmes programit ndërkombëtar të menaxhimit (Müller et al. 2007).

### *Monitorimi me GPS i rriqebullit dhe përdorimi i telemetrisë për drerët*

Projekti i përbashkët më i suksesshëm i kërkimit është *monitorimi me GPS i rriqebullit dhe i përdorimi i telemetrisë për drerët*. Fokusi kryesor i punës në vitet që do vijjnë do të jetë investigimi/vëzhgimi ndërkufitar mbi mënyrën se si rriqebulli i përdor habitatet e tij, brenda territorit të aktivitetit jetësor në Bavarinë Lindore dhe përcaktimi i rolit të llojeve në ekosistemet e pyjeve malore (marrëdhëniet dre-rriqebull, grabitqar-pre) në dy anët e kufirit. Qëllimi është që të rrisë nivelin e kërkimit në lidhje me rriqebullin, bazuar në rezultatet e telemetrisë së drerit përmes satelitëve.

### *Restaurimi i habitateve të shqetësuara prej aktivitetit antropogjenik*

Në verën e 2005, natyrës në qendër të dy parqeve iu kthye një kanal artificial drenazhimi që shtrihej në zonën moçalore përgjatë kufirit shtetëror.

### *Programet për të rinjtë si roje parku, kampet rinore ndërkombëtare dhe forumi rinor çeko-gjerman,*

Në kuadër të një fushate ndërkufitare, disa herë në të kaluarën, por edhe së fundmi në 2010, të rinjve nga rajoni çeko-gjerman i Parkut Kombëtar ju është dhënë mundësia, që së bashku me të rinj nga Parku Sakson i Zvicrës dhe Parqet Kombëtare të Šumavës dhe Bohemisë, të eksplorojnë PB&PKŠ.

### *Plani i menaxhimit Natura 2000*

PB&PKŠ është pjesë e një peizazhi natyror uniform që nuk ka lidhje me kufijtë politikë. Masat ideale për mbrojtjen e habitateve dhe llojeve të rralla e të rrezikuara duhet të hartohen në shkallë të gjerë dhe në kontekstin ndërkufitar. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, autoritetet e dy parqeve kombëtare kanë punuar së bashku në kuadër të projektit të BEsë (Interreg III A) për krijimin e planeve menaxhuese Natura 2000, duke përfshirë bashkërendimin ndërkufitar. Në shtator 2007, në kuadër të po këtij projekti është botuar broshura dy gjuhëshe me titull: *Europas Wildes Herz–Divoké Srdce Evropy* (Zemra e egër e Evropës), (Hußlein dhe Kiener 2007).

### *Projekti "Zemra e egër e Evropës"*

Në PB&PKŠ, atje ku më parë Perdja e Hekurt ndante njerëzit dhe natyrën, po rizgjohej bota e egër. Pyjet po rriten përsëri

si në kohët e lashta, plotësisht nën pushtetin e natyrës. Krahas përgatitjes së projekteve ndërkufitare të kërkimit dhe monitorimit, dhe projektit për krijimin e një qendre trajnimi dhe kërkimi, udhëzimet për menaxhimin uniform të pjesës qendrore të parkut ku ka ndodhur bashkimi (zona e projektit është 13,060 ha), kërkojnë edhe planifikimin e tureve shëtitëse nëpër zonat e egra, organizimin e shëtitjeve me guidë, etj.

Projekti (Meyer et al. 2009) është prezantuar bashkërisht në disa konferenca ndërkombëtare, dhe së fundi edhe në Kongresin Botëror të Botës së Egër (WILD9) në Merida, Meksikë (dhjetor 2009).

Është e qartë se në dekadën e parë të bashkëpunimit (që nga krijimi i PKŠ), shumë veprimtari ndodhën spontanisht si lehtësimi dygjuhësh i informacionit, shkëmbimet mes studentëve dhe bashkëpunimet mes rojeve të parkut në dy anët e kufirit. Pas nënshkrimit të memorandumit në vitin 1999, filloi bashkëpunimi ndërkufitar, i cili kishte si fokus kryesor çështjen e ruajtjes së natyrës<sup>5</sup>.

Pas 20 vitesh bashkëpunim ndërkufitar (Ahokumpu dhe Šolar 2009) supozohet se janë arritur shumë rezultate pozitive që flasin për anët e forta të këtij bashkëpunimi dhe që sjellin përfitime të mëdha për zonën ndërkufitare. Ndër to mund të përmendim zonat e "Natura 2000" dhe menaxhimin e tyre, të kuptuarit e rëndësisë që ka perspektiva ndërkufitare e mbrojtjes së natyrës si dhe kërkimi, puna e përbashkët të rojeve të parkut, programet për të rinjtë dhe ato të edukimit mjedisor. Nënpunësit e parkut, partnerët vendorë, OJQtë, trajnerët dhe vullnetarët nga dy vendet janë përfshirë në shumë aktivitete të përbashkëta, siç janë projektet me karakter profesional dhe aktivitetet e ndryshme kulturore.

Dobësitë kryesore të bashkëpunimit kanë të bëjnë me dallimet që ekzistojnë mes rajoneve përta i përket zhvillimit ekonomik, barrierave gjuhësore dhe ligjeve e politikave të ndryshme. Pavarësisht sigurisë në dhënie e financimeve, ka një asimetri të dukshme në lidhje me to. Fatkeqësisht, strategjia e menaxhimit të PKŠ ende nuk është qëndrueshme. Turbulencat politike dhe presioni prej zhvillimit janë kërcënime serioze për PKŠ dhe bashkëpunimin ndërkufitar.

Bashkëpunimi ndërkufitar na ndihmon çdo ditë të kuptojmë më mirë modelet apo tendencën e proceseve natyrore dhe të popullsisë njerëzore në tokën tonë të përbashkët.

Sfida më e madhe që shtrihet koha është respekti i rregullave të natyrës dhe lirimimi prej kufijve në mendjen tonë. Ne besojmë se falë bashkëpunimit të përditshëm mund të përmirësojmë jo vetëm njohjen e gjuhës, por edhe mirëkuptimin dhe

<sup>5</sup> Tregjuhësh (anglisht, çekisht, gjermanisht) faqe interneti janë të disponueshme: [www.npsumava.cz](http://www.npsumava.cz) (faqja gjermane është duke u përgatitur), [www.nationalpark-bayerischer-wald.de](http://www.nationalpark-bayerischer-wald.de); [www.wildheartofeurope.eu](http://www.wildheartofeurope.eu).

respektin tonë për shumëllojshmërinë natyrore dhe atë njerëzore. Vetëm në sajë të këtij mirëkuptimi mund të ndajmë mes nesh përgjegjësitë për trashëgiminë tonë të përbashkët.

Nga pikëpamja politike, na duhet të punojmë për harmonizimin e kuadrit ligjor dhe njehsimin e aspekteve menaxhuese të zonës sonë të përbashkët. Nevoja për një mirëkuptim publik lidhur me misionin e parqeve kombëtare dhe mbrojtjen e botës së egër kërkon që të përmirësohen edhe aftësitë tona të komunikimit.

### Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen

Gjatë këtyre 20 viteve të bashkëpunimit, kemi nxjerrë shumë mësim, përfshi disa mësimet specifike që na i ka dhënë natyra dhe bashkëjetesa mes njerëzve.

Në janar 2007 stuhia e erës Kyrill dha një mesazh të qartë në lidhje me menaxhimin e pyjeve (Kiener and Křenová 2009). Gjatë dekadave të fundit janë zbatuar strategji të ndryshme për menaxhimin e pyjeve përgjatë kufijve. Programi që lufton brumbullin e pemëve (*Ips typographus*) dhe prerja e drurëve të infektuar ishte ende një praktikë standarde për menaxhimin e pyjeve në Çeki, ndonëse ishte rënë dakort për ta ndaluar këtë praktikë në përputhje me strategjitë jondërhyrëse për PKPB. Pas stuhisë së fortë që shkuli nga rrënjët mijëra drurë dhe dëmtoi rëndë pyjet malorë me bredha u hap një diskutim i gjatë mbi menaxhimin e duhur të pyjeve në PKŠ. Si pasojë e stuhisë, u dëmtuan rëndë veçanërisht zabelet e hapura, ku para shumë vitesh ishte kryer prerja aktive e pemëve të infektuara nga ky insekt. Ky u bë një mësim i mirë. Gjendja në pjesën e sipërme të maleve përgjatë kufirit çeko-bavarez kishte një rëndësi të veçantë dhe shtronte nevojën për koordinimin dhe menaxhimin e suksesshëm. Një vit pasi hyri në fuqi Traktati Shengen, u paraqit një mundësi tjetër, e cila lejoi udhëtimin e lirë të njerëzve përmes kufijve të Evropës. Për t'ju paraprirë kërkesave që mund të vinin nga komunitetet vendore dhe turizmi, administratat e PB&PKŠ u mblodhën bashkë për të përgatitur një udhëzues të përbashkët menaxhimi për Zembrën e Egër të Evropës, pjesën qendrore të parqeve kombëtare (Křenová and Kiener 2009). Në sajë të bashkëpunimit, në qershor 2009 u arrit hartimi i sistemit të përbashkët gjurmues për botën e egër, i cili u miratua zyrtarisht dhe dërgua për botim.

Ngritja e qendrës së re të kërkimit dhe trajnimit Silva Gabreta u bë në një ish-bazë ushtarake në Kvilda, fshat në qendër të PKŠ. Aty ku deri vetëm para 20 vitesh, ushtarët mbronin gardhet e Perdes së Hekurt, kërkuesit dhe studentët nga universitetet çeke e gjermane dhe nga institucione të tjera filluan të vizitonin dhe banonin në zonë. Interesi dhe entuziazmi i të rinjve zëvendësoi ankthin e luftës dhe regjimit ushtarak. Vizitorët, njerëzit vendas dhe fëmijët e shkollave mirëpritën ngrohtësisht në Qendrën e Trajnimit dhe Kërkimit

për të takuar kërkuesit shkencorë dhe për të pasur përvoja të reja me natyrën e egër dhe projektet e kërkimit që zbatohen në zonë.

Çdo vit e më tepër, njerëzit po ndjekin natyrën dhe kalojnë kufijtë (tokësorë dhe ata të mendjes). Gjithnjë e më tepër, bashkëpunimi ynë po bëhet më i fortë dhe më i afërt. Platforma e Qendrës së Trajnimit dhe Kërkimit do të na japë të gjithëve mundësinë të bëhemi pjesë e Evropës së Re, ku gjërat e mira për natyrën kuptohen si gjëra të mira për njerëzit dhe anasjelltas.



# 12. Lumi Thaja– që lidh Parqet Kombëtare *Thayatal* dhe *Podyjí*

Robert Brunner<sup>1</sup>

## Gjeografia e zonës

Parqet Kombëtare *Thayatal* dhe *Podyjí* gjenden rreth 100 km në veri të Vjenës dhe 150 km në juglindje të Pragës. Parku Kombëtar *Thayatal* i Austrisë mbulon një sipërfaqe prej 1 330 ha, nga e cila 1260 ha është zonë<sup>2</sup> natyrore dhe 70 ha është zonë natyrore ku lejohet veprimtaria menaxhuese për

vetëm 10 km. Parku Kombëtar *Podyjí* shtrihet anash lumit, mes Vranovit dhe Znojmo, përgjatë një segmenti lumor 45 km të gjatë. Vendbanimi i vetëm në anën austriake të Parkut Kombëtar *Thayatal* është Hardegg. Me një popullsi prej 80 banorësh, bashkia kadastrale e Hardeggut është më e vogla në Austri.

Parqet Kombëtare *Thayatal* dhe *Podyjí* ndahen nga kufij të qartë klimatikë. Ndërsa pjesa lindore ndikohet nga klima e



© Marek Neffe

mbrojtjen e ekosistemeve. Parku Kombëtar *Podyjí* i Republikës Çeke, mbulon një sipërfaqe 6620 ha, nga e cila 2220 ha përfaqëson zonën I<sup>3</sup> (zemrën e parkut), 2260 ha zonën II<sup>4</sup> (zonën e ruajtjes) dhe 1780 ha zonën III<sup>5</sup> (zonën rrethuese).

Lumi Thaja përbën kufirin e përbashkët mes parqeve, gjatësia e të cilit është mbi 25 km. Por për shkak të gjarpërimeve të tij të shumta, distanca në vijë të drejtë e kufijve lumorë<sup>6</sup> është

thëtë Panoniane, pjesa malore dominohet nga klima e lagësht Atlantike. Kjo është arsyeja përse në parqet kombëtare gjejmë të shpërndarë florën dhe faunën evropiane kontinentale dhe atë qendrore. Magjia e *Thayatalit* afër Hardegg qëndron pikërisht në shumëllojshmërinë e madhe të bimëve, në një zonë të vogël. Flora ndryshon vazhdimisht përgjatë buzëve tejet gjarpëruese të lumit, po edhe prej faktorëve gjeologjikë të habitateve (Roetzel 2005). Deri më tani, në dy parqet kombëtare, janë përcaktuar 1288 lloje bimësh, ndërkohë që në të gjithë Austrinë njihen rreth 2950 lloje bimësh.

Arsyet që ndikuan në krijimin e dy parqeve kombëtare ishin të ndryshme. Parku Kombëtar *Podyjí* u krijua në 1991, menjëherë pas rënies së Perdes së Hekurt në një sipërfaqe toke që zotërohej nga shteti. Ndërsa Parku Kombëtar *Thayatal* u krijua në 1999, mbi një sipërfaqe private toke. Kjo ishte

1 Drejtor, Parku Kombëtar *Thayatal*, Austri.

2 Zona natyrore është një zonë ku nuk lejohen ndërhyrje nga dora e njeriut. Në disa legjislativione është ekuivalente me zonën qendrore.

3 Natyra në këtë zonë është lënë në gjendje të egër dhe çdo lloj aktiviteti njerëzor është i ndaluar.

4 Qëllimi i menaxhimit të zonës është që të arrihen kushte thujse natyrore të pyjeve dhe të mirëmbahen shoqërimet bimore pa pyje, në gjendjen e dëshiruar.

5 Zona rrethuese është zona më e ndikuar nga aktiviteti njerëzor, gjithashtu mbulon sipërfaqe bujqësore rreth fshatrave *Lukov* dhe *Čížov*, vendbanimet dhe aktivitetet që zhvillohen në to.

6 Distanca në vijë të drejtë është drejtëza që bashkon dy pika.

edhe arsyeja përse krijimi i parkut në pjesën austriake mori më tepër kohë. Pronarët austriakë të tokës u kompensuan sipas përcaktimeve që detyronte ligji për parqet kombëtare. Në Republikën Çeke, procesi për ri-privatizimin e tokës publike vazhdon ende.

Për më shumë se 40 vjet, kufiri mes Austrisë dhe ish-Çekosllovakisë ishte pjesë e Perdes së Hekurt. Kalimi në zonën mes kufijve shtetërorë, të përshkuar mes përmes nga lumi Thaja, si dhe në infrastrukturën kufitare të ndërtuar mbi një rrip 2-3 km të gjerë toke, ishte i ndaluar. Ndaj natyra mbeti e paprekur për dekada me rradhë. Prania e ekosistemeve të pashqetësuar në zonën e kufirit ishte argumenti më i mirë për krijimin e parkut kombëtar në *Thaya*.

### Momentet kryesore të zhvillimit historik

Lartësia e dy parqeve e arrin pikën e saj më të ulët në mes të lumit Thaja. Çdo masë menaxhuese që merret në njërën anë, prek lehtësisht edhe tjetrën, ndaj kërkohet që praktikat për menaxhimin e ekosistemit të lumit, rregullat e lojës dhe të zhvillimit të infrastrukturës për vizitorët të harmonizohen mirë mes tyre. Kur Çekosllovakia planifikoi ndërtimin e një hidrocentrali pak kilometra mbi *Znjomo* në 1984, qytetarët austriakë kundërshtuan dhe bënë të mundur që të hiqej dorë nga projekti. Edhe gjatë periudhës kur ushtrohej kontroll i rreptë mbi kufijtë, ambientalistët austriakë kishin arritur të bashkëpunonin me kolegët e tyre nga Republika Çeke (Çekosllovakia e atëhershme), duke dhënë shembujt e parë të bashkëpunimit ndërkufitar. Në 1988, autoritetet austriake vendosën ta shpallnin zonën rezervë natyrore, e cila më pas u bë pjesë e Parkut Kombëtar *Thayatal*. Menjëherë pas krijimit të tij, dy ministrat e shtetit përgjegjës për mjedisin dhe Guvernatori i Austrisë së Poshtme, nënshkruan një Deklaratë Bashkëpunimi mes dy parqeve kombëtare. Deklarata u pasua nga dokumente të tjera, siç ishte Marrëveshja mbi "Parimet Kryesore të Menaxhimit të Parkut Kombëtar dhe Shkëmbimin e të Dhënave". Parqet krijuan bashkëpunime për menaxhimin e lumit, përmes Komisionit dypalësh Austro-Çek për ujërat kufitare.

Sot, bashkëpunimi ndërkufitar bazohet në një marrëveshje dypalëshe. Komisioni i Parkut Kombëtar *Thayatal*, u krijua në vitin 2000 dhe përbëhet nga përfaqësues të dy ministrave të mjedisit, anëtarë të autoriteteve vendore, drejtuesit e Këshillave Kombëtarë të dy Parqeve dhe nga drejtorët e parqeve. Komisioni funksionon mbi bazën e rregullave të brendshme dhe takohet rregullisht, të paktën një herë në vit, me kërkesë të anëtarëve të tij. Ai merret kryesisht me masat dhe projektet në interes dypalësh. Parqet e kanë kuptuar vlerën që siguron bashkëpunimi lidhur me përfitimin e fondeve nga BE. Në fakt, aksesin në fondet rajonale nuk do të kishte qenë i mundur pa ndihmesën e një partneri ndërkombëtar.

Shoqatat rajonale të turizmit bashkëpunojnë aktivisht, ndërsa nismat dypalëshe private fokusohen kryesisht në projektet kulturore dhe edukuese. Të dy parqet vendosën të kryenin një vlerësim të bashkëpunimit ndërkufitar, që u zbatua në 2007 nga EUROPARC. Ekspertët konfirmuan se bashkëpunimi ishte në linjë me kriteret e përcaktuara nga EUROPARC dhe i dorëzuan të dy parqeve nga një certifikatë. Përveç kësaj, dy parqet kishin marrë nga Këshilli i Evropës, Diplomën Evropiane, përkatësisht (CK) në 2000 dhe (A) në 2003.

### Përfitimet dhe sfidat

Tipari kryesor i dy parqeve është lugina e lumit Thaja, e cila copëtohet deri në 150 m thellësi nga masive shkëmbinjsh grani Bohemian. Menaxhimi i ekosistemit mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse mbështetet në parime të njëjta dhe merr në konsideratë interesat e partnerit në anën tjetër të kufirit.

Ka mjaft shembuj bashkëpunimesh ndërkufitare, më shumë apo më pak të suksesshëm, që mund të ilustronë situatën specifike në *Thayatal*. Lloji i administrimit të parqeve në dy anët e kufirit është i ndryshëm, fakt që nuk e lehtëson bashkëpunimin mes tyre. Administrata e Parkut Kombëtar Çek raporton direkt në Ministrinë e Mjedisit, ndërsa Parku Austriak administrohet nga një kompani private me përgjegjësi të kufizuara.

#### *Menaxhimi i kufirit lumor*

Megjithëse seksioni i lumit në parqe është 45 km i gjatë dhe mesatarisht 30 m i gjerë, lugina e lumit Thaja është një nga ekosistemet më kryesore të dy parqeve. Në pjesën e sipërme të lumit, jashtë segmentit kufitar, ndodhet hidrocentrali i Vranovit, i cili është ndërtuar që në vitin 1935. Që atëherë, sistemi për prodhimin e energjisë, që funksionon vetëm kur arrihet niveli maksimal i ujit, ka shkaktuar një ndikim të madh në ekosistemin e lumit. Rrjedha jo natyrore e ujërave shumë të ftohtë të lumit kalon në dy parqet shqetëson ekosistemet deri katër herë në ditë. Gjatë operacioneve të shfrytëzimit, shpejtësia e rrjedhës së lumit mund të shkojë deri në 45 m<sup>3</sup>/sek, por në periudhën mes dy lëshimeve, prurja e ujit është më pak se 1 m<sup>3</sup>/sek.

Në bashkëpunim me Komisionin dypalësh Çeko-Austriak për Ujërat Kufitare, pronarin e hidrocentralit dhe autoritetet çeke të menaxhimit të ujërave, parqet argumentuan nevojën për rritjen e prurjes minimale në një nivel më të lartë (Helesic dhe Kubicek 1999), duke e çuar deri në 2.6 m<sup>3</sup>/sek. Përmirësimet e tjera janë akoma në proces diskutimi. Po punohet për një projekt dypalësh në lidhje me riprodhimin e burimeve peshkore lokale dhe po diskutohet çështja e barrierave që pengojnë kalimin e peshqve migratorë, në përputhje me Direktivën Kuadër të BE-së për ujërat.

Një nga sfidat më të mëdha për menaxhimin e parkut kombëtar është aktiviteti çlodhës i peshkimit në park. Deri tani, kufizimet kryesore janë ushtruar vetëm në pjesën austriake. Megjithatë është arritur një lloj harmonizimi mes rregulloreve të administrimit në dy parqet, por nuk është kartuar ende ndonjë rregullore për gjithë zonën e parkut. Administrata në anën austriake është zotëruese e të drejtave të peshkimit, të cilat e lejojnë atë të përcaktojë rregullore të rrepta. Administrata e parkut çek nuk ka marrë akoma të drejtat e peshkimit në lumin Thaja.

#### Pyjet e Parqeve Kombëtare

Të dy parqet e lumit Thaja janë kryesisht parqe pyjore. Më shumë se 85% e zonës është e mbuluar me pyje gjetherënës, me disa lloje drurësh koniferë që janë sjellë dhe mbjellë në pyjet për shfrytëzim komercial (Wrbka et al. 2010). Menaxhimi i pyjeve në dy vendet është i ndryshëm. Autoritetet çeke të parkut mbjellin pemë, të cilat shërbejnë si gardh për të mbrojtur pyllin ndaj dëmtimeve që shkakton bota e egër, si p.sh drerët, ndërsa administrata e parkut austriak beson në ripërtëritjen natyrore të drurëve gjethëgjërë pa ndërhyrjen e njeriut.

#### Vizitorët

Një park ndërkufitar është tërheqës për vizitorët. Përveç bukurisë natyrore të zonës së mbrojtur, një faktor tjetër motivues që tërheq vëmendjen e turistëve, është mundësia për të vizituar një vend tjetër. Sipas rekomandimeve të IUCN-së, kategoria e II-të e zonave të mbrojtura (të dy parqet klasifikohen si të tillë) krijojnë mundësi për t'u çlodhur, kaluar kohën e lirë dhe edukuar (Dudley 2008). Kur u krijua Parku Kombëtar *Thayatal* në 1999, ishte e qartë se zhvillimi i një turizmi miqësor ndaj mjedisit duhej të ecte paralelisht me zhvillimin e shoqatave të turizmit dhe bizneseve turistike. Situata në Republikën Çeke është e ndryshme. P.sh në Znojmo, që ka një popullsi prej rreth 40,000 banorë, Parku Kombëtar *Podyjí* funksionon edhe si zonë për çlodhje për komunitetin, duke krijuar kështu presion mbi natyrën. Planet austriake për të shmangur presionin e vizitorëve duke ndërtuar shtigje të tjera për ngjitje në mal, përfshirë edhe një urë të varur mbi lumë, nuk janë marrë parasysh nga partneri çek.

#### Financimet e huaja

Të dy parqet përfitojnë nga financimi i projekteve ndërkufitare të BE-së. Deri tani janë zbatuar disa projekte dhe të tjerë janë akoma në proces. Një nga projektet më kryesore ishte ndërtimi i Qendrës së Informimit të Parkut Kombëtar *Thayatal-Podyjí*. Qendra e informimit, e përruruar në 2003 në Hardegg (Austri), ofron një ekspozitë dhe informacion në tre gjuhë (gjermanisht, çekisht dhe anglisht) mbi përbërjen e biodiversitetit dhe të peizazhit të dy parqeve kombëtare.

Aktualisht me bashkëfinancimin e Fondit Evropian të Bashkëpunimit Territorial, po zbatohet një projekt kërkimi në lidhje me ekosistemet, biodiversitetin dhe llojet e rralla, duke përfshirë macen e egër, e cila u zbulua rishtaz në pjesën austriake të parkut, pasi ishte deklaruar e zhdukur prej më shumë se 30 vitesh. Pa financimin shtesë të BE-së, parqet kombëtare nuk do të ishin në gjendje të zbatonin detyrat e tyre efektivisht nga pikëpamja e kohës dhe kostove, veçanërisht po të merren parasysh shkurtimeve në buxhet dhe ato të personelit.

Parqet në *Thayatal* u krijuan në kohë të ndryshme dhe nën rrethanat e ndryshme. Parku Kombëtar *Podyjí* u krijua menjëherë pas rënies së Perdes së Hekurt, ndërkohë që diskutimet për krijimin e Parkut Kombëtar *Thayatal* të Austrisë zgjatën mbi gjashtë vjet. Pak vite më parë, gjykatat e vlerësuesve në të dy vendet e vlerësuan bashkëpunimin ndërkufitar përmes disa projekteve duke e deklaruar atë shumë të suksesshëm dhe model pune për projekte të përbashkëta. Megjithatë, në dy parqet ekzistojnë akoma pritshmëri dhe sisteme të ndryshme menaxhimi. Një nga detyrat më të rëndësishme për partnerët në të dy parqet është të diskutojnë rreth ndryshimeve dhe të gjejnë zgjidhje për to.

#### Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen

Bashkëpunimi i efektshëm ndërkufitar varet nga vullneti i mirë dhe mundësitë që ofrojnë partnerët, si dhe nga kuadri ligjor që paraqesin autoritetet e vendeve përkatëse. Parqet ndërkufitare në gjithë botën gjenden akoma nën administrimin e dy apo më shumë autoriteteve. Ka vetëm pak shembuj ku parqet administrohen nga një autoritet i vetëm ndërkufitar, ndonëse ky duhej të ishte modeli praktik më i mirë për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe më efektiv nga pikëpamja e kostove. Megjithatë, ky model mbetet akoma një vizion i së ardhmes. (IUCN/WCPA 1999).

Kemi parë se mbështetja e institucioneve të tjera ose strukturave administrative mund të jetë shumë e dobishme në zgjidhjen e problemeve, siç ka ndodhur në Parkun *Thayatal*. Në të, bashkëpunimi me Komisionin Çeko-Austriak për ujërat ndërkufitare, u bë e mundur të zvogëlohej ndikimi negativ ose dëmi i Vranovit në ekosistemin e lumit. Autoritetet vendore të menaxhimit të ujërave kanë ndihmuar në zhvillimin e diskutimeve për trungjet e vdekura të drurëve dhe mundësinë e rënies së tyre në lumë, për të shmangur problemet që mund të shkaktohen nga lëvizja e tyre bashkë me rrjedhën. Për këtë çështje është ngritur edhe një sistem monitorimi. Një bashkëpunim i tillë mund të ndihmojë të tejkalohen diskutimet e vështira.

Parqet malore, kufijtë e të cilëve kalojnë nëpër pika me lartësi mbi nivelin e detit mund të kenë një problematikë krejt tjetër. Ndërsa parqet që shtrihen në ultësira dhe përshkohen nga

lumenj, liqene apo dete kanë nevojë për menaxhim të qartë dhe të përbashkët. Është e kuptueshme se zonat ndërkufitare të mbrojtjes duhet të kenë një plan shumë të detajuar menaxhimi dhe ta zbatojnë bashkërisht atë (Brunner 2000).

Asnjë progres nuk mund të arrihet pa mbështetjen e autoriteteve dhe politikanëve përkatës. Kjo është e

nevojshme në rastin e mbështetjes financiare, veçanërisht nga fondet e BEsë. Mbrojtja e natyrës nuk është vetëm detyrë e vendeve të caktuara, por edhe e mbarë shoqërisë.

Bashkëpunimi ndërkufitar për mbrojtjen e natyrës është një sfidë. Përveç përfitimeve për natyrën, ai mund të çojë në arritjen e mirëkuptimit mes njerëzve dhe shteteve.



© Parku Kombëtar Thoyatal/D.Manhart

# 13. Bashkëpunimi Ndërsektorial për Ruajtjen e Shpendëve – OJQja “Balkani i Gjelbër” dhe Drejtoria Bullgare e Policisë Kufitare

Dimitar Popov<sup>1</sup>

të kombinuar të tre rajoneve biogeografike: Mesdhetar, Kontinental dhe Irano-Turanean.

## Gjeografia e zonës

Zonat e Malit të *Rodopit Lindor*, Malit *Sakar* dhe lartësive *Derventski* gjenden në pjesën juglindore të Bullgarisë dhe gjenden ndërmjet kufijve shtetërorë mes Bullgarisë, Turqisë dhe Greqisë. Malet janë pjesë e Brezit të Gjelbër të Evropës

Zona strehon një biodiversitet të jashtëzakonshëm dhe konsiderohet një prej zonave më të ‘nxehta’ në Evropë. Ajo ka rëndësi të veçantë për ruajtjen e shumë llojeve që përbëjnë shqetësim evropian dhe global, siç është shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*) – 90% e gjithë popullatës



© Dobromir Dobrinov / Green Balkans NGO

Juglindore. Sipërfaqja kryesore e pjesës bullgare të maleve është 670,446 ha.

Mali *Sakari*, lartësitë *Derventski* dhe *Rodopi Lindor* janë male të ulëta (me lartësi mesatare 300-400 m mbi nivelin e detit), me terren të thyer që formohet nga shtretërit e poshtëm të tre lumenjve më të mëdhenj që burojnë në pjesën bullgare - *Maritsa*<sup>2</sup>, *Tundzha* dhe *Arda*. Klima është kontinentale me elemente mesdhetare. Zonat janë shpyllëzuar ndjeshëm dhe kanë sipërfaqe të gjera livadhesh, kullotash dhe toka të punueshme shumë të copëzuara. Më së shumti, ruhen pyjet gjethegjere dhe ato konifere, së bashku me lëndinat dhe terrenet që janë vështirë të shkelen. Shumëllojshmëria e madhe e llojeve në këto zona është rrjedhojë e ndikimit

bullgare strehohet në zonë, Shkaba e zeze (*Aegypius monachus*) – 100% e popullatës së Ballkanit jeton në zonë, Kali i qyqes (*Neophron percnopterus*) – 70% e popullatës bullgare (Nankinov 2004), Skifteri kthetraverdhë (*Falco naumanni*) – për sa dimë, Bullgaria është vendndodhja e fundit e foleve të këtij lloji; Breshka greke (*Testudo graeca*) dhe Breshka e zakonshme e tokës (*Testudo hermanni*), Breshkujzë (*Emys orbicularis*) dhe Breshka e Ballkanit (*Mauremys rivulata*) – me popullatat më vitale që gjenden në Bullgari (Petrov 1997). Zona është me rëndësi të madhe për ruajtjen e popullatave të llojeve të tjera, si Shqiponja e vogël e rosave (*Aquila pomarina*), Shqiponja gjarpërngrenëse (*Circaetus gallicus*), Huta e zeze bishtgërshërë (*Milvus migrans*), Huta bishtbardhë (*Buteo rufinus*) dhe Lejleku i zi (*Ciconia nigra*). Në këtë zonë mund të gjenden shumë lloje

<sup>1</sup> Kordinator Projekti, OJF Ballkani i gjelbërt, Bullgari.

<sup>2</sup> Turqisht: *Meric*, Greqisht: *Evro*.

habitatesh<sup>3</sup>, lloje të rëndësishme kafshësh<sup>4</sup> dhe lloje bimore të rralla dhe endemike<sup>5</sup>, që përfshihen në listat e direktivës së BEsë për Habitatet.

Gjatë Luftës së Ftohtë, kalimi i kufizuar i njerëzve në zonën e kufirit, ka ndikuar në zhvillimin e ulët shoqëror dhe ekonomik të saj. Gjatë këtyre viteve shumë prej fshatrave dhe qyteteve kanë humbur pjesë të popullsisë së tyre, për shkak të migrimit në zonat që gjenden në brendësi të vendit, aty ku industria është më e zhvilluar dhe krijon vende të reja pune dhe ku lëvizja nuk është e vështirë. Aktiviteti kryesor ekonomik, që zhvillohet në territorin përgjatë kufirit, është bujqësia. Forma e organizmit të këtij sektori është me ferma kolektive që zotërojnë qindra krerë dele, lopë dhe derra. Kulturat kryesore të zonës, qenë drithërat (gruri dhe elbi), vreshtat dhe duhani. Në qendrat vendore (Svilengrad, Ivailovgrad, Bolyarovo) aktiviteti ekonomik iu shtua edhe industria e lehtë (tekstile, e veshjeve, makinerive të vogla, etj.). Struktura sociale pati një ndikim të madh nga prania e reparteve të mëdha ushtarake, në të cilat u vendosën ushtarakët dhe familjet e tyre.

Pas ngjarjeve politike të shekullit të 20të situata social ekonomike ka ndryshuar ndjeshëm. Prishja e fermave kolektive dhe e industrive të vogla shkaktoi një valë tjetër migrimi të banorëve vendas. Anëtarësimi i Bullgarisë në NATO dhe më pas, zvogëlimi drastik i ushtrisë, çoi në mbylljen e të gjitha reparteve ushtarake në rajon duke shkaktuar lëvizje të mëtejshme demografike. Sot, zona e 'kufirit' është e hapur për të gjithë biznesmenët. Bujqësia mbetet ende aktiviteti kryesor ekonomik dhe shumë nga tokat e braktisura dhe kullotat natyrore janë kthyer në toka që punohen intensivisht dhe mbështeten nga subvencionet kombëtare dhe ato të PKB të BEsë. Një ndikim tjetër negativ mbi botën e egër vjen nga propozimet për zhvillimin e investimeve në zonë, si: impjantet e prodhimit të energjisë me anë të erës, nxjerrja e gurit dhe zhavorrit, impiantet me energji diellore dhe hidrike.

Zona ka një histori të gjatë, duke qenë se është një pikë takimi mes dy kontinenteve me kultura të ndryshme (Evropa dhe Azia) dhe dy besimeve (Kristianizmi dhe Islamizmi). Përveç kësaj, zona gjendet brenda të ashtuquajturës "Perde e Hekurt" – ish kufiri mes dy blloqeve ideologjike, që gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20të, e ndau Evropën për 40 vjet: lindja komuniste (vendet e Traktatit të Varshavës) dhe kapitalizmi perëndimor (vendet e NATOs). Bullgaria ishte pjesë e bllokut të parë, ndërsa fqinjët e

saj Turqia dhe Greqia i takonin të dytë. Si rezultat i kësaj situatë politike (deri në 1990) zona ishte krejtësisht e izoluar, përse i përket zhvillimit ekonomik dhe lëvizjes së njerëzve, që pengohej thuajse plotësisht. Kufijtë ruheshin rreptësisht nga ushtria, si gjatë ditës edhe natës, e cila përdorte mjete të ndryshme si tela me gjemba, rrethime me sinjalizim elektrik, rripa të punuar toke përgjatë kufirit, roje me qen, kulla vrojtimi, etj., një pjesë e këtyre strukturave ekzistonte ende, ndonëse nuk përdoret. Në pjesën bullgare, përgjatë kufirit, ishte shpallur e ashtuquajtura 'Zonë kufitare', e cila përfshinte një rrip toke prej 30 km. Njerëzve brenda vendit nuk ju lejohej të shkëlqenin në atë zonë dhe ju kërkohesh një leje e posaçme – 'fletë e hapur'. Ky fakt ka kontribuar në ruajtjen e natyrës e peisazhit të virgjër dhe të traditave në popullsitë vendase, duke kursyer ndjeshëm burimet natyrore. Sot mund të provohet lehtësisht se zonat mbartin një shumëllojshmëri të pasur biologjike dhe peizazhe natyrore, për shkak të lejimit të kufizuar të kalimit në zonë në të shkuarën.

### Momentet kryesore të zhvillimit ekonomik

Grupi i OJQsë 'Ballkani i Gjelbër' e filloi bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar, përkatësisht – Drejtorinë Rajonale të Policisë së Kufirit, Elhovo (përgjegjëse për ruajtjen e kufirit bulgaro-turk) dhe Stacionin e Policisë Kufitare Ivailovgrad (përgjegjës për ruajtjen e kufirit bullgaro-grek), njëherësh me punën për ruajtjen e shqiponjës perandorake dhe të shkabës (Nikolov et al. 1998). Kjo ndodhi para se kërkuesit shkencorë dhe studentët e biologjisë nga Plovdivi dhe Stara Zagora, të cilët kishin interes të madh për ruajtjen e shpendëve, të krijonin më 1988, OJQnë 'Ballkani i Gjelbër'.

Në vitet 1980, njëri prej themeluesve të "Ballkanit të Gjelbër" punonte në Akademinë Bullgare të Shkencave në rajonin Sakar. Gjatë eksplorimeve në rajon, së bashku me anëtarë të tjerë të "Ballkanit të Gjelbër" dhe me ndihmën e njerëzve të zonës, bëri një zbulim të habitshëm në lidhje me popullatat e shqiponjës perandorake. Përpara këtij zbulimi, në Bullgari, njihesh vetëm një fole e këtij lloji në malin *Sredna Gora* të Bullgarisë Qendrore (Michev and Petrov 1985). Por rripi prej 30 km përgjatë kufirit bullgaro – turk, nuk mund të kalohej përpara rënies së "Perdes së Hekurt", që të mund të hapte rrugën e eksplorimeve të tjera të botës së egër. Puna për ruajtjen kërkon që të kryhen vizita të rregullta dhe prani e vazhdueshme në zonën e kufirit.

OJQja "Ballkani i Gjelbër" filloi punën me programin e ruajtjes së shqiponjës perandorake, në fund të viteve 1980. Aktivitetet përfshinin: studime dhe monitorime të rregullta të të gjitha foleve të njohura; ekspedita për lokalizimin e vendndodhjes së foleve të reja të shqiponjës perandorake dhe studimin e zonave të përshtatshme për ushqyerjen; ruajtjen dhe monitorimin e foleve që rrezikoheshin gjatë periudhës së riprodhimit, mbjelljen e pemëve, vendosjen e foleve artificiale, zhvillimin e propozimeve për zonat e reja të mbrojtura dhe përfshirjen e habitateve të kësaj shqiponje në Rrjetin Ekologjik NATURA 2000;

3 6210 Kullota të thata gjysmë natyrore të substrateve gëlqerore (*Festuco-Brometalia*) (\* vende të rëndësishme për orkidet), 62A0 Livadhe të thata të Mesdheut Lindor (*Scorzoneratalia villosae*), 91M0 Pyjet panonianë të zonës ballkanike të liris, 91AA Pyjet lindorë të liris të bardhë, 92A0 Brezat pyjorë të *Salix alba* dhe *Populus alba*, 6510 Livadhet me bar të thatë të zonave të ulta (*Alopecurus pratensis*, *Sanguisorba officinalis*), 6220 Pseudo –stepa të gjelbërta dhe bimë njëvjeçare të *Thero-Brachypodietea*, 91E0 Pyjet aluvialë me *Alnus glutinosa* dhe *Fraxinus excelsior* (*Alno-Padion*, *Alnion incanae*, *Salicion albae*) (Kavrakova 2009)

4 E.g.: *Spermophilus citellus*, *Canis lupus*, *Felix silvestris*, *Lutra lutra*, *Myotis emarginatus*, *Rhinolophus hipposideros*, *Bombina bombina*, *Triturus karelinii*, *Elaphe quatuorlineata*. (Popov 2003)

5 E.g.: *Verbascum purpureum*, *Aegilops dichasians*, *Fritillaria pontica*, *Ophrys cornuta*, *Anthemis rumelica*, *Himantoglossum caprinum*.

Ndjekjen e shqiptonjave perandorake me radio dhe transmetues GPS për të gjurmuar lëvizjet e tyre dhe migrimin.

Një zbulim tjetër i rëndësishëm u bë në malin e Rodopit Lindor, ku më 1993 u realizua mbarështimi i parë i suksesshëm për 100 vitet e fundit, i Shkabës së zezë në Bullgari (Marin et al. 1998). Bashkëpunimi i parë me Policinë e Kufirit lejoi mbarështimin jo të rregullt të shkabave, në afërsi të Madzharovos, përgjatë lumit Arda. Programi i "Ballkanit të Gjelbër" për ruajtjen e shkabës ka filluar të zbatohet që në vitin 1991 dhe përfshin aktivitetet e mëposhtme; studimin e habitateve dhe rajoneve të përshtatshme për ruajtjen dhe ripopullimin e shkabave; krijimin e "restorantit të shkabës"<sup>6</sup> në Rodopin Lindor (fshati Pelevun, Bashkia Ivailovgrad); vendosjen e foleve artificiale; fushata kundër përdorimit të ushqimeve helmuese; aktivitete të përbashkëta radio-telemetrie me WWF Greqi për Shkabën e zezë, në zonën kufitare të Rodopit Lindor. Gjatë viteve këto programe kanë gjetur mbështetje financiare në donatorë të ndryshëm, ku përfshihen: Shoqata e Zoologjisë Frankfurt, DBU dhe EuroNatur (Gjermani), PTES (Mbretëria e Bashkuar), dhe EAF (Hollandë). Aktualisht këto aktivitete po zbatohen nga "Ballkani i Gjelbër" në kuadër të projektit "Masa ruajtëse për lloje të caktuara që përfshihen në Direktivën e BE-së për Shpendët – Falkoi i vogël, Shkaba e zezë, dhe Shqiptonja perandorake, në habitatet e tyre kryesore në Bullgari" me mbështetjen financiare të Fondit Evropian Rajonal të Zhvillimit të Republikës së Bullgarisë dhe Bashkimit Evropian dhe Buxhetit Bullgar të Shtetit, përmes Programit Operacional për Mjedisin, 2007-2013<sup>7</sup>.

Nga sa jepet më lart, është e qartë se shumë prej aktiviteteve janë realizuar në terren dhe kërkonin akses në "Zonën Kufitare". Deri më 1997 kufiri ruhej nga forcat/trupat e rregullta të ushtrisë së kufirit, që përgjithësisht ishin djem të rinj që kryenin shërbimin ushtarak dhe rreshterë e oficerë profesionistë. Përveç kësaj, në zonë kishte shumë reparte dhe objekte të ushtrisë bullgare. Në 1997, u krijua një strukturë profesionale në Ministrinë e Brendshme – Drejtoria Kryesore e Policisë së Kufirit, që është përgjegjëse për ruajtjen e kufirit kombëtar. Bashkëpunimi mes "Ballkanit të Gjelbër" dhe Policisë Bullgare të Kufirit bazohet në vullnetin e mirë dhe respektin reciprok të palëve, me një formë jo zyrtare.

## Përfitimet dhe sfidat

Partneriteti mes "Ballkanit të Gjelbër" dhe Policisë së Kufirit në rajonin kufitar që ndan Bullgarinë nga Turqia dhe Greqia, është një shembull i mirë bashkëpunimi mes aktorëve që vijnë nga sektorë të ndryshëm dhe kanë objektiva të ndryshme. Pavarësisht faktit se dy palët zbatojnë qëllime që janë deri diku të ndryshme, ndërveprimi i tyre në nivel rajonal dhe zbatimi me sukses i fushatës sensibilizuese ka krijuar një partneritet

premtues, prej të cilit përfitojnë dy nga shpendët më të rrallë të Evropës – Shqiptonja perandorake dhe Shkaba e zezë.

Programi ruajtës i "Ballkanit të Gjelbër" për Shqiptonjën perandorake nuk do të kishte qenë kaq i efektshëm pa mbështetjen dhe ndihmën e Policisë Kufitare që vepron në rajon. Roli i marrëdhënieve të mira mes OJQ "Ballkani i Gjelbër" dhe Policisë së Kufirit në vendosjen e foleve të reja dhe zënien e territoreve nga shqiptonjat, është shumë i madh. Disa nga transektet e sotme kanë qenë në zonën e rrethuar me tela me gjemba. Studimet në zonë bëhen me lejen dhe mbështetjen e Policisë Kufitare. Shkëmbimi i rregullt i informacionit sipas vëzhgimeve të kryera në dy anët e kufirit ka shërbyer si burim për identifikimin e çifteve të reja dhe të territoreve të zëna prej tyre. Në këtë proces, ruajtësit luajnë rolin e mësuesve për oficerët e policisë kufitare duke ofruar njohuri për identifikimin e shpendëve dhe përdorimin e njohurive gjatë aktivitetit të tyre të patrullimit. Informacioni që ju jepet ekspertëve përdoret për të studiuar sjelljen e shpendëve dhe vendndodhjen e zonave të riprodhimit. Këto eksplorime u ndoqën nga suksese të mëtejshme, p.sh kufiri bullgaro – turk është kthyer tashmë në vendin e vetëm të Shqiptonjave të fundit perandorake që kanë mbetur në Bullgari. Foletë dhe territoret e zëna prej tyre gjenden të vendosura pikërisht në vijën e kufirit, në të dy anët e tij – shpendët nuk kanë nevojë për kontroll pashaportë! Vitet e fundit, grupi i "Ballkanit të Gjelbër" bëri dy studime të territoreve në anën tjetër të kufirit me Turqinë. Prej tyre u provua se popullata e Shqiptonjës perandorake (foletë dhe territoret e tyre) janë përhapur në të dy anët e kufirit.

Që nga 1990, ekipi i "Ballkanit të Gjelbër" filloi të realizonte vëzhgimin e foleve dhe ushqyerjen shtesë të tyre, gjatë sezonit të riprodhimit. Është provuar se shqetësimi që shkaktojnë njerëzit gjatë periudhës së inkubimit është një prej arsyeve kryesore që pengon mbarështimin e Shqiptonjës perandorake. Përgjithësisht, detyra kryesore e rojeve vullnetare është që të shikojnë dhe parandalojnë cdo lloj shqetësimi; dhe në rast nevojë, të kërkojnë mbështetje nga autoritetet mjedisore, pylltarët dhe kryebashkiakët lokalë. Gradualisht Policia e Kufirit është kthyer në partnerin kryesor dhe më aktiv të projektit përsa i përket rasteve të shqetësimit. Arsyet për këtë janë disa: si p.sh veprimi i menjëhershëm për cdo informacion të marrë dhe prania e vazhdueshme në zonë; interesi i drejtpërdrejtë për mirëqenien e botës së egër, në përgjithësi dhe shqiptonjave, në veçanti – të cilat përfaqësojnë simbolin e rajonit; largësia nga rajonet e autoriteteve të tjera, etj. Me kalimin e viteve, është forcuar lidhja mes Policisë Kufitare dhe ekspertëve e vullnetarëve që ruajnë dhe monitorojnë foletë e Shqiptonjave perandorake.

Në këtë mënyrë, rojet e foleve dhe policia kufitare u bënë kolegë që mbështesin punën e njëri-tjetrit. Rojet e foleve kërkojnë ndihmën e Policisë së Kufirit në rast se shpendët shqetësohen dhe, mundet të informojnë policinë për shkeljet të kufirit.

Shqetësimi i punonjësve të Policisë së Kufirit në lidhje me ecurinë e Shqiptonjave perandorake reflektohet në pyetjet që ata bëjnë,

<sup>6</sup> Restoranti Shkaba – Restoranti i shkabës është një vend ku jepet mish i freskët dhe i pahelmuar dhe/ose të brenshmet e bagëtive shtëpiake ose të gjitarëve të tjerë të egër për të ushqyer shkabat dhe shpendët e tjerë.

<sup>7</sup> Më shumë informacion për projektin mund të gjeni në: <http://www.greenbalkans.org/birdsofprey/opus/>

si p.sh: “Si po ecin shqiponjat?; Sa zogj kanë?; etj., si dhe në mbështetjen që ofrojnë në rastet kur shpendët shqetësohen qoftë edhe nga kafshët e tjera. Në 2006, një fole Shqiponjash perandorake u prish pas një stuhie ku u vra njëri nga zogjtë, por tjetri mbijetoi, megjithëse me pelvis të thyer. Vëzhguesit e foleve e raportuan rastin dhe me ndihmën e Policisë Kufitare e shpëtuan zogun e plagosur duke e transportuar në Qendrën e “Ballkanit të Gjelbër” në Stara Zagora. Pasi shpendi u trajtua me sukses, ishte gati të lihej i lirë, por Policët e Kufirit insistuan të lëshohej në zonën ku ishte gjetur. Ata dukeshin të kënaqur që ishin të pranishëm në momentin kur shpendi u lëshua të fluturonte i lirë në natyrë dhe e ndoqën fluturimin e tij pas lëshimit.

Ekspertët e “Ballkanit të Gjelbër” kanë nevojë ta vizitojnë shpesh zonën për të shoqëruar të huaj, donatorë, partnerë, grupe vëzhguesish për shpendët, etj. Mbështetja që ka dhënë Policia e Kufirit gjatë këtyre vizitave ka qenë gjithmonë mbresëlënëse për vizitorët e huaj dhe jo rastësisht ka tërhequr vëmendjen e mediave të huaja. Në 2006, Fondacioni EuroNatur i Gjermanisë organizoi një vizitë studimore në Bullgari, për një grup gazetarësh gjermanë që të bënin mbulim mediatik të pjesës bullgare të Brezit të Gjelbër Evropian. Historia e ruajtjes së Shqiponjës perandorake që bazohet në partneritetin mes OJQ “Ballkani i Gjelbër” dhe Policisë së Kufirit u pa me mjaft interes. Në gazetën “Berliner Zeitung” u botua një artikull me titull “Një aleancë për Shqiponjën perandorake” i cili përqendrohej në aleancën mbresëlënëse për mbrojtjen e Shqiponjës perandorake. Një nga revistat më popullore në Gjermani, “natur + kosmos”, gjithashtu e vlerësoi rrefimin si emocionues dhe shkroi një artikull të gjatë për pjesën bullgare

të Brezit të Gjelbër Evropian të titulluar “Mbrojtja e Policisë për shqiponjat”, kushtuar bashkëpunimit me policinë e kufirit. Në 2008, një ekip prodhimi filmash nga Mbretëria e Bashkuar përgatiti një dokumentar për Brezin e Gjelbër Evropian të titulluar “Perdja e hekurt – Fjongoja e jetës”. Ai vendosi që në të njëjtën trajtesë të paraqiste edhe Brezin e Gjelbër të Evropës Juglindore. Mbështetja që dha policia e kufirit në dy rastet ishte shumë e madhe për të hyrë në territor edhe për shqetësimet lidhur me ruajtjen e Shqiponjës perandorake. Mënyra e jashtëzakonshme dhe jo tradicionale e ruajtjes së natyrës tërhoqën me të vërtetë interesin e mediave.

Bashkëpunimi i ngritur në Rodopin Lindor krijon përfitime për ruajtjen e shkabave dhe sidomos të Shkabës së zezë. Një nga hapat e parë të rëndësishëm dhe të shenjtë për llojet në Ballkan, ishte zhvillimi dhe zbatimi i një fushate për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit. Stacioni i Policisë Kufitare në Ivailovgrad e mbështeti fushatën dhe vuri një tabelë informuese në njërin prej pikave të kontrollit kufitar. Pas krijimit të ‘restorantit të shkabave’ filloi grumbullimi i rregullt i kafshëve të ngordhura. Për zbatimin e kësaj skeme kujdesej koordinatori lokal në fshatin Pelevun. Për faktin se ishte ajo zonë, ai kishte marrëdhënie të mira me komunitetin vendas, përfshirë edhe Policinë e Kufirit. ‘Operacioni - Restoranti i Shkabave’ ka sjellë përfitime për banorët vendas dhe për shpendët që konsumojnë mish të ngordhur. Funkionimi i kësaj nisme bazohet në dorëzimin vullnetar të kafshëve të ngordhura. Policia e Kufirit ka ndihmuar në promovimin e saj në komunitet. Përveç kësaj, ata kanë dhënë informacion të vlefshëm prej vëzhgimit të fluturimit dhe ushqyerjes



së shkabave e shpendëve të tjerë grabitqarë. Më vonë, u zbatua edhe një projekt i përbashkët ndërkufitar për radio-telemetrinë e Shkabës së zezë nga kërkues bullgarë dhe grekë. Gjatë zbatimit të tij, Policia e Kufirit provoi se ishte një partner i vlefshëm që siguronte akses dhe këshillim për çështje të rëndësishme në punën kërkimore – një domosdoshmëri për dedektimin e zogjve të etiketuar. Njëri nga stacionet telemetrike ishte vendosur nën njërën prej kullave të vrojtimit në anën e rrethimit të vjetër të kufirit.

### Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen

Vitet e bashkëpunimit mes OJQ "Ballkani i Gjellbër" dhe Njësisë të Drejtorisë së Policisë Kufitare përgjatë kufirit bullgar me Turqinë dhe Greqinë, kanë rezultuar efektive për shkak të komunikimit të shkëlqyer dhe respektit reciprok për përpjekjet e njëri tjetrit. Historia e suksesshme e ruajtjes së Shqiponjës perandorake në Malin Sakar dhe lartësitë Derventski nuk do të kishte qenë e tillë nëse dy palët nuk do të udhëhiqeshin nga të njëjtat parime. Komunikimi efektiv është arsyeja kryesore se Shqiponja perandorake vlerësohet nga Policia Kufitare si simbol i rajonit. Historia emocionuese e 'Mjeshtres së stuhive' thuhet të zhdukur, e cila ka arritur të gjejë strehë në një zonë të thellë e të pakalueshme është vendoset përballë imazhit negativ të Perdes së Hekurt me rrethimet me tela me gjemba dhe drita në kërkim të shkelësve të kufirit.

Partneriteti i suksesshëm i krijuar në ruajtjen e shkabave në Rodopin Lindor nuk do të kishte qenë i mundur pa ndërgjegjësimin aktiv dhe fushatat informuese. Në fillim, njerëzit vendas, përfshirë edhe Policinë Kufitare, e kuptonin punën e aktivistëve të ruajtjes si diçka të paqartë. Pasi kuptuan përfitimet e saj – kursimin e shpenzimeve të transportit dhe djegien e kafshëve të ngordhura, rritjen e popullaritetit të zonës si vend i shenjtë natyror – komuniteti vendor filloi ta mbështesë dhe të shprehë interesim për këtë punë. Policia Kufitare ka provuar se është një partner i besueshëm dhe i rëndësishëm në gjithë këtë proces.

Pas anëtarësimit të Bullgarisë në BE, kufiri greko-bullgar nuk ruhet më aq fort dhe Policia Kufitare nuk është thuhet e pranishme në zonë. Në anën tjetër, kufiri bullgaro – turk po merr rëndësi më të madhe për rolin e tij si kufi i jashtëm për BE-në. Kjo rrit nevojën për bashkëpunimin e mëtejshëm dhe më aktiv mes OJQ "Ballkani i Gjellbër" dhe Policisë Kufitare në Malin Sakar dhe lartësitë Derventski për ruajtjen e Shqiponjës perandorake.

Shënim: Autori dëshiron të shprehë mirënjohjen e tij për Drejtorinë Rajonale të Policisë Kufitare - Elhovo dhe Stacionin Kufitar të Policisë Ivailovgrad për mbështetjen e tyre të vazhdueshme gjatë punës së bërë në këtë rajon dhe Zj. Lora Lubenova, Zëdhënëse e Drejtorisë së Policisë Kufitare, për redaktimin që i bëri këtij rasti studimor.



# 14. Jablanica-Shebenik: Duke punuar për krijimin e një zone ndërkuftare të mbrojtur për rrëqebullin në Ballkan

Annette Spangenberg<sup>1</sup>, Spase Shumka<sup>2</sup>, Gjorgji Ivanov<sup>3</sup>

## Gjeografia e zonës

Malet *Jablanica* dhe *Shebenik* gjenden respektivisht, në veriperëndim të Liqeneve të Ohrit dhe Prespës. Mali *Jablanica* shënon kufirin jugor mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, ndërsa mali *Shebenik* është tërësisht brenda kufirit shqiptar

është e përbërë nga guri gëlqeror. Origjina karstike vërehet nga prania e disa burimeve ujore, ku mes tyre shquhen më tepër burimet e *Vevčanit* në Maqedoni. Pjesa më e madhe e përbërjes gjeologjike të Malit të Shebenikut është e përbërë prej serpentinesh.

Shpatet e Jablanica-Shebenikut dominohen nga pyje. Peizazhi në lartësitë nga 600 m deri 1,300 m, karakterizohet nga pyje me lisa termofilë dhe shkozë orientale. Pyjet prej



© MIES

dhe formon një vargmal, paralel me *Jablanicën*. Pjesa shqiptare e Jablanica-Shebenikut dominohet nga maja të larta me lartësi që variojnë nga 300 m deri në 2,262 m (Rreshpa është maja më e lartë e Shebenikut). Maja më e lartë në anën maqedonase është *Crn Kamen* (2,257 m), ndërsa pika më e lartë është *Strižek* (2,233 m). Të dy malet e Jablanicës dhe Shebenikut njihen për shumëllojshmërinë e formave shkëmbore akullnajore e rreth-akullanjore dhe liqene akullnajorë. Një pjesë e konsiderueshme e Jablanicës

ahu mbulojnë shpatet që gjenden në lartësitë nga 1,300 m deri në 1,800 m. Kullotat alpine dhe subalpine që shtrihen mbi brezin pyjor, përdoren kryesisht si kullota malore në lartësi (MES 2006, PPNEA 2006).

Popullsia vendase e këtyre zonave malore i ka përdorur burimet natyrore (kryesisht lëndën drusore) të zonës, për shekuj me radhë. Pjesët që janë shfrytëzuar më shumë në anën maqedonase është brezi pyjor i lisit. Sot, pyjet më të ruajtur të lisit gjenden në grykat e pjesës veriore të Jablanicës, për shkak të relievit të ashpër. Edhe pyjet e ahut janë prerë, me përjashtim të pyjeve subalpine të lisit. Megjithatë prerja

<sup>1</sup> Menaxher projekti, Euronatur, Gjermani.

<sup>2</sup> Drejtor Ekzekutiv, Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, (PPNEA).

<sup>3</sup> Ndihmës projekti, Shoqata maqedonase e ekologëve (MES).

e mirëfilltë e drurëve pothuajse nuk ekziston, duke bërë që pyjet e lisit në pjesën maqedonase të ruajnë pamjen e tyre natyrore. Më parë, livadhet mbi vijën e kufirit të sipërm të pyllit përdorshin si kullota verore për delet. Megjithëse ende kanë mbetur disa ferma që merren me blegtorinë e deleve, kullotja e bagëtisë në livadhet malore është zvogëluar ndjeshëm.

Panorama në anën shqiptare është krejt ndryshe. Izolimi i vendit për shkak të regjimit komunist çoi në menaxhimin e keq dhe mbishfrytëzimin e burimeve natyrore të vendit, përfshirë edhe pyjet e Jablanica-Shebenikut. Vetëm në lartësitë e mëdha të maleve janë ruajtur edhe të paprekura disa parcela pyjore, pasi nuk lejohej kalimi për shkak të afërsisë së kufirit shtetëror. Në fillim të viteve 90, gjatë viteve të tranzicionit që sollën ndryshimet politike në vend, pas rënies së Perdes së Hekurt, u bë e mundur shkelja e zonave kufitare. Për shkak të administrimit të dobët dhe paaftësisë për të zbatuar ligjet, ndodhi një valë e dytë dëmsh në pyje, ku grupe të organizuara njerëzish përfituan nga kjo situatë duke prerë ilegalisht e në mënyrë masive drurët. Gjatë kësaj periudhe u shkatërruan shumë prej pyjeve të ahut deri atëherë të paprekura, përfshirë edhe një pjesë pyjesh në malin e Shebenikut. Sikurse kullotat në Maqedoni, kullotat alpine dhe subalpine në anën shqiptare të maleve përdoren më pak se në të shkuarën, për shkak se bagëtitë preferohet të mbahen në zonat afër fshatrave. Kjo ka çuar në shfrytëzimin e mëtejshëm të brezit të pyjeve të ahut, duke penguar rigjenerimin natyror të pyjeve. Megjithëse shfrytëzimi i pyjeve të lisit vazhdon, dhe në shumë raste është i paligjshëm, malet në pjesën e Jablanica-Shebenikut janë ruajtur mirë, në krahasim me rajonet e tjera malore të Shqipërisë. Pas rënies së Perdes së Hekurt, u pa qartë se zona kufitare përfaqësonte një brez të gjelbër. Për këtë arsye kjo zonë u përfshi në Planet e Veprimit dhe Strategjitë e Biodiversitetit të dy palëve, shqiptare dhe maqedonase. Në to deklarohet se zona maqedonase duhej të merrte statusin e Parkut Kombëtar deri në vitin 2006 (Ministri i Mjedisit dhe e Planifikimit Fizik në Republikën e Maqedonisë 2003), dhe zona në pjesën shqiptare do të bëhej pjesë e Rrjetit të Propozuar të Zonave Përfaqësuese të Mbrojtura (Bego dhe Koni 1999). Në këtë kontekst, u përmend edhe termi 'zonë e mbrojtur ndërkuftare'. Përveç kësaj mali i Jablanicës tregohet si pjesë e Brezit të Gjelbër Maqedonas në Hartën Maqedonase të Brezit të Gjelbër<sup>4</sup>. Meqë konsiderohet perlë e Evropës JugLindore, masivi Jablanica-Shebenik është pjesë integrale e Nismës së Brezit të Gjelbër në Evropë.

## Momentet kryesore të zhvillimit historik

Rrethanat që nxitën bashkëpunimin ndërkuftar në zonën e Jablanica-Shebenikut mbështeteshin në supozimin se vargjet malore të saj ishin habitate të rriqebullit të Ballkanit.

(*Lynx lynx martinoi*), një lloj me prejardhje nga rriqebulli euroaziatik (*Lynx lynx*). Me një popullsi të përafërt prej më pak se 100 individë, rriqebulli i Ballkanit konsiderohet si popullata autoktone më e kërcënuar në Evropë. Shpërndarja aktuale e rriqebullit ballkanik është kufizuar në zonën jugperëndimore të Ballkanit, meqë zonat kufitare mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, krijojnë në pjesën veriore dalje për në Kosovë dhe Mal të Zi. Ky lloj ka mbijetuar meqë zona mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë shkelej shumë pak. Duke ndjerë nevojën për mbrojtjen e rriqebullit të Ballkanit dhe të biodiversitetit në tërësi, për zonën e Jablanica-Shebenikut, si dhe për të shtruar rrugën drejt bashkëpunimit të mundshëm ndërkuftar mes pjesëve të Jablanica-Shebenikut në të dy anët e kufirit, në vitin 2005 u nxit zbatimi i projektit "Brezi i Gjelbër i Ballkanit si një korridor ekologjik për ujkun, ariun dhe rriqebullin". Projekti u mbështet financiarisht nga Agjencia Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës dhe u zbatua bashkërisht nga EuroNatur dhe organizata partnere vendore: *Shoqata Ekologjike Maqedonase (MES)* dhe *Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)*. Partnerët mblodhën të dhëna lidhur me florën dhe faunën dhe vlera të tjera natyrore e kulturore të maleve të Jablanica-Shebenikut për të përgatitur dokumentet teknike për shpalljen e zonave të mbrojtura. Përmes diskutimeve të ngushta mes OJQve partnere në Shqipëri dhe Maqedoni u përgatitën harta me sugjerime dhe zonime të rajoneve që propozoheshin për mbrojtje, me qëllim që të sigurohej ndarje uniforme e zonave në dy anët e kufirit (Figura 14.1). Për këtë u realizuan konsultime të rregullta me autoritetet kombëtare në dy ministritë përkatëse dhe popullsitë vendase. Ndërsa zona u përfshi në Strategjinë e Biodiversitetit dhe Planin e Veprimit të Maqedonisë dhe Shqipërisë dhe u arrit të sigurohej mbështetja politike e nevojshme për projektin.

Në vitin 2006, EuroNatur, KORA, MES dhe PPNEA lobuan për nënshkrimin nga ministritë maqedonase dhe shqiptare të Memorandumit të Mirëkuptimit për mbrojtjen e rriqebullit të Ballkanit. Nisma dështoi për shkak se mungonte mbështetja për ta çuar çështjen në vëmendjen e qeverive.

Pak para se të përfundonte projekti në 2007, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë u dorëzuan dokumentet teknike dhe harta e zonave. Dorëzimi i dokumenteve për Maqedoninë u shty me kërkesën për tu përmirësuar dokumentet teknike.

Vazhdimi i punës në Jablanica-Shebenik u bë i mundur në kuadër të Programit të Ndihmës për rriqebullin e Ballkanit, që u zbatua nga të njëjtët partnerë dhe organizata zvicerane e ekspertëve për mishngrënësit e mëdhenj, KORA, me mbështetjen financiare të Fondacionit Zviceran MAVA për Ruajtjen e Natyrës. Raporti mbi vlerat natyrore të Malit Jablanica u përmirësua dhe u shtuan përpjekjet lobuese në nivelet vendore dhe kombëtare të dy vendeve. Më në

<sup>4</sup> <http://www.eea.europa.eu/soer/countries/mk/nature-protection-and-biodiversity-state>

fund, në maj 2008 u shënua sukcesi i parë i projektit, kur qeveria shqiptare shpalli Parkun Kombëtar të Shebenik-Jablanicës me një sipërfaqe 340 km<sup>2</sup>. Megjithëse raportet për pjesën maqedonase u përmirësuan dhe u dorëzuan zyrtarisht gjysmën e dytë të vitit 2009, krahas diskutimeve të përbashkëta që u zhvilluan me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik dhe sigurimit të mbështetjes nga ana e ministrisë, shpallja e parkut kombëtar në Maqedoni nuk është arritur akoma dhe propozimi vazhdon të jetë në pritje.

E vetmja rrugë për të krijuar një zonë të mbrojtur e koherente, me një sistem mbrojtjeje të njëjtë, që merr në konsideratë vlerat natyrore të sistemit malor dhe nevojën e llojeve që popullojnë zonën, më tepër se kufijtë shtetërorë, është vendosja e bashkëpunimit ndërkufitar. Nisma u mbështet fuqishëm nga OJQtë vendore (MES, PPNEA) dhe fondacioni ndërkombëtar për ruajtjen e natyrës EuroNatur (i vendosur në Gjermani) dhe vazhdon të nxisë bashkëpunimin që lindi gjatë punës së përbashkët në Jablanica-Shebenik.

### **Përfitimet dhe sfidat**

Bashkëpunimi ndërkufitar në zonën e Jablanica-Shebenikut ka funksionuar vetëm në nivel jo-qeveritar dhe përmes nismave jozyrtare. Megjithatë, partnerët e përfshirë ndajnë një vizion të përbashkët në lidhje me mbrojtjen e zonës në të ardhmen, për gjithë vargmalin pavarësisht kufijve, duke krijuar një

zonë të mbrojtur me sipërfaqe rreth 500 km<sup>2</sup>. Bashkëpunimi i ngushtë që u ndërtua gjatë zhvillimit të konceptit për zonimin e sipërfaqeve të mbrojtura natyrore, krijoi një bazë të rëndësishme për kthimin e vizionit në realitet. Gjatë punës intensive në zonë, u krijuan kontakte me popullsitë vendase në dy anët e kufirit, popullsitë shqiptare dhe maqedonase, dhe u siguria mbështetja e aktorëve të duhur në nivel vendor. Ata shohin mundësitë ekonomike që bashkëpunimi kufitar mund të krijojë në të ardhmen, psh përmes turizmit natyror, etj. Megjithatë, ekzistojnë akoma disa pengesa që duhen kapërcyer që zona e mbrojtur natyrore të bëhet burim të ardhurash për popullsitë vendase. Për faktin se parku është shpallur në anën shqiptare dhe është akoma pezull në anën maqedonase, sfida më e madhe në këtë moment është shpallja e parkut kombëtar edhe nga pala maqedonase. Kur të jenë shpallur të dy parqet kombëtare, sfida e radhës do të jetë zhvillimi i organizmave administrative të tij në dy anët, të cilat janë mjaft të rëndësishëm për përmbushjen e vizionit dhe mbrojtjen e zonës ndërkufitare të Jablanica-Shebenikut.

Në qershor 2008, nën kujdesin e Programit për rriqebullin e Ballkanit (faza e I-rë), partnerët shqiptarë, maqedonas dhe EuroNatura zhvilluan draftin e Strategjisë për Ruajtjen e rriqebullit të Ballkanit. Strategjia bën thirrje për krijimin e zonave të mbrojtura në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Biodiversitetin dhe Planin e Veprimit, Rrjetin Emerald, Natura 2000 dhe Nismën e Brezit të Gjelbër, me theks kryesor



të vendosur në nevojat për metapopullatat e këtij lloji (Grupi Strategjik për rriqebullin e Ballkanit 2008). Krijimi i Parkut Kombëtar Jablanica në Maqedoni vlerësohet si objektiv i rëndësishëm, ndërsa përcaktimi i Parkut Kombëtar Shebenik-Jablanica nuk përfshihej në strategji, meqë ai ishte shpallur më parë se të hartohej kjo strategji. Strategjia shërbeu si bazë për zhvillimin e Planeve Kombëtare të Veprimit. Meqenëse Strategjia dhe Planet Lokale të Veprimit nuk janë miratuar akoma nga autoritetet e qeverive në vendet përkatëse, lobimi nga OJQtë do të vazhdojë.

Përkundër këtij sfondi, një nga aspektet më të rëndësishme të punës është të punohet me popullsitë vendase në dy anët e kufirit, që të sigurohet mbështetje e vazhdueshme për mbrojtjen ndërkufitare të segmentit malor. Ajo përfshin zbatimin në shkallë të vogël të projekteve ndërkufitare. Për shembull, EuroNatur, MES dhe PPNEA punuan së bashku për krijimin e një shtegu të ngjites në mal, që kalonte përmes dy anëve të Jablanica-Shebenik, nëpër disa prej majave të kurrizit malor ndërkufitar. Maja e *Krstecit* konsiderohet si traversa kryesore, pasi këtu ekzistonin gjurmë të kalimit ndërkufitar në të shkuarën. Banorët vendas u përfshinë në punimet për pastrimin dhe vënien e shenjave të kalimit, për vendosjen e shenjave dhe tabelave informuese. Për kryebashkiakët dhe përfaqësuesit e autoriteteve pyjore të rajonit Shebenik-Jablanica, u organizua një vizitë ditore, ku palët patën mundësinë të takonin njëra - tjetrën. Vizita e 'shkëmbimit' hodhi bazat e diskutimeve që u zhvilluan për të ardhmen e këtij vargmali.

MES, PPNEA dhe EuroNatura do të vazhdojnë të llobojnë për shpalljen e zonës Park Kombëtar në Maqedoni dhe për krijimin e një strukture administrative për parkun në Shqipëri. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i punës me projektin dhe partnerët është të kontribuohet për zhvillimin e planeve menaxhuese për zonën në të ardhmen.

## **Mësimet e nxjerra dhe perspektiva për të ardhmen**

Me qëllim që të shmangen vështirësitë që mund të shfaqen në fazat e mëvonshme, procesi i zonimit u zhvillua bashkërisht, si për parkun kombëtar ekzistues në Shqipëri dhe atë që do të krijohet në të ardhmen në Maqedoni. Zona përfitoi nga qasja pjesëmarrëse dhe e dobishme e popullsisë vendase, me të cilat u zhvilluan konsultime mbi çështjet e kufijve dhe zonimit të parqeve të ardhshme kombëtare. Procesi krijoi besim mes aktorëve të ndryshëm dhe pranimin nga ana e popullsisë vendase të idesë për shpalljen e këtyre zonave si parqe kombëtare. Kjo merr veçanërisht rëndësi, meqë në anën maqedonase nuk ka ende një park kombëtar dhe se strukturat administrative në anën shqiptare mungojnë. Për pasojë, mbrojtja aktuale e vargmalit të Jablanica-Shebenikut varet pak a shumë nga vullneti i mirë i popullsisë vendase deri në krijimin e strukturave respektive në dy vendet.

Një arsye pse u zgjodh të punohej me Jablanica-Shebenikun për krijimin e një zone ndërkufitare të mbrojtur ishte supozimi se përpjekja do të mbështetej fuqimisht nga autoritetet qeveritare, pasi kështu cilësohej në Strategjitë Kombëtare të Biodiversitetit dhe Planin e Veprimit. Në përgjithësi ky supozim mbetet i vlefshëm. Por një nga mësimet e gjatë zbatimit të projektit është se me kohën, interesat edhe fokusi i punës së qeverive ndryshojnë. Bazuar në këtë mësim, vazhdimësia e punës në zonat përkatëse merr rëndësi të vecantë, që të mos çënohet besueshmëria e nismës dhe pranimi i saj nga njerëzit e zonës, pavarësisht mungesës së mbështetjes politike.

Deklarimi i zonës së mbrojtur nuk shoqërohet domosdoshmërisht me krijimin e autoriteteve përkatëse. Për rrjedhojë, lobimi në nivel vendor dhe përfshirja në të e njerëzve lokalë, duhet të vazhdojë.

Pavarësisht pengesave që ndeshen në punën për krijimin e zonës ndërkufitare të mbrojtur Jablanica-Shebenik, si pjesë e Brezit të Gjellbër Evropian JugLindor<sup>5</sup>, aktivitetet e zbatuara deri më tani mund të konsiderohen shumë të suksesshme, veçanërisht po të merret në konsideratë koha e shkurtër që ka kaluar që nga aktiviteti i parë në vitin 2005. Bazuar në sukseset e arritura deri më tani, të gjithë partnerët do të vazhdojnë përpjekjet e përbashkëta që synojnë ta kthejnë vizionin për një zonë ndërkufitare të mbrojtur, në realitet.

<sup>5</sup> Gjithashtu referohet si Brezi i Gjellbër Ballkanik

# 15. Ndikimi Ekonomik Rajonal i Parkut Kombëtar të Pyllit Bavarez

Hubert Job<sup>1</sup>, Marius Mayer<sup>1</sup>, Manuel Woltering<sup>1</sup>, Martin Müller<sup>2</sup>, Bernhard Harrer<sup>3</sup>, Daniel Metzler<sup>4</sup>

## 1. Hyrje

Parqet kombëtare janë instrument parësor për ruajtjen në shkallë të gjerë të zonave natyrore. Tradicionalisht, fenomenet natyrore dhe bukuritë e vecanta kanë qenë arsye për të shpallur zona të caktuara si parqe kombëtare. Sot, arsyet ekologjike siç është ruajtja e biodiversitetit, luajnë një rol vendimtar. Parqet kombëtare përmbajnë ekosisteme me dinamika të tërësisht unike, ose më thjesht, "ekosisteme ku natyra ndjek rrjedhën e vet". Në Evropën Qendrore shumë të populluar me histori të gjatë kulturore dhe për pasojë me një peizazh me ndikim të fortë antropologjik kjo është një detyrë e vështirë. Parqet kombëtare perceptohen shpesh si faktorë kufizues për zhvillimin e rajonit për shkak të kufizimeve që imponojnë. Kufizimet hapësinore të përdorimit dhe kufizimet ekonomike që i shoqëruen çojnë shpesh në mungesën e mirëkuptimit nga ana e popullsisë dhe politikanëve vendas. Një faktor tjetër natyror që shqetëson ekosistemet e pyllit bavarez është edhe brumbuli *Ips typographus*. Kjo ngre pikëpyetje lidhur me menaxhimin e parkut natyror dhe perceptimin e vizitorëve mbi peizazhin e ndryshuar të pyllit. Për rrjedhojë, ndërlikon debatet, shpeshherë tepër emocionale që zhvillohen në zone, për vlerat dhe degradimin e parqeve natyrore. Përveç kësaj, qëllimi për ruajtjen e natyrës përmes parqeve kombëtare është që të ofrojnë vlera të vërteta, si p.sh botën e egër të pa shqetësuar në kushte natyrore, e cila mund të shfrytëzohet nga industria e turizmit. Parqet natyrore dhe tërheqja që ofrojnë, përfaqësojnë një produkt të mirë, që gjendet rrallë për shkak të numrit të vogël të 'furnizuesve' në treg (vetëm 14 parqe kombëtare në Gjermani). Për shkak të mbrojtjes me ligj, ata janë të papërsëritshëm dhe nuk mund të transferohen ose imitohen. Prandaj, parqet kombëtare përbëjnë një veçori të dallueshme të turizmit natyror në shumë vende. Megjithatë, parqet kombëtare në Gjermani jo gjithnjë i shfrytëzojnë në masën e duhur veçoritë e tyre unike për qëllime turistike.

Në kontekstin e përdorimit të parqeve kombëtare për qëllime turistike në periferinë të Bavarisë së Poshtme (*Niederbayern*), me infrastrukture të dobët në këtë drejtim, dis apyjetet që shtjellon studimi<sup>5</sup> janë si më poshtë:

- Sa i rëndësishëm është turizmi si faktor ekonomik dhe mundësi punësimi?
- Nga pikëpamja e kosto-përfitim, cila është lidhja mes 'burimeve' të dhëna nga ana e qeverisë për parkun me rezultatet e arritura?
- A janë njohur ose përdorur sa duhet nga marketingu turistik potencialet e 'parqeve natyrore të shpallura në fillim'?
- Çfarë ndërveprimesh ekonomike ekzistojnë mes bizneseve individuale në rrethinat e parkut kombëtar dhe cili është përfitimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i tyre, si rezultat i pranisë së zonës së mbrojtur?
- A përbëjnë vizitorët e parkut fqinj *Šumava* (Republika Çeke) një grup të mundshëm të synuar për Parkun Kombëtar të Pyllit Bavarez. A mundet që të arrihet ky grup i synuar përmes një bashkëpunimi më të fortë mes parqeve në fushën e turizmit?

## 2. Metodat

Metodat shpjegohen më me hollësi në versionin e plotë të raportit. Për këtë arsye, më poshtë do të gjeni vetëm një pamje të përgjithshme të studimit të realizuar:

- Me qëllim që të vëzhgohet numri dhe shpërndarja e vizitorëve në Parkun Kombëtar të Pyllit të Bavarisë gjatë 2007, u bë numërimi i vizitorëve dhe u realizuan intervista në 22 ditë (ditë jave dhe fundjava) në dimër, verë, dhe sezona jashtë pikut turistik. U realizuan intervista të shkurtra rreth vendit nga vinin dhe llojit të akomodimit me 11,140 persona. Prej tyre, 1,190 prej tyre u intervistuan më në detaje lidhur me sjelljen të tyre për të shpenzuar dhe motivimin për të udhëtuar.
- Sipërmarrjeve në kontetë e *Freyung-Grafenau* dhe *Regen* ju kërkua të mbushnin një pyetësor të shkruar. Për të siguruar përfaqësim sa më të mirë, kampionet u morën duke përdorur procesin e shtresëzimit me zgjedhje të rastit. Me kuotën e përshtatur të mostrës për çdo industri, u postuan rreth 1,832 pyetësorë përgjatë periudhës korrik – tetor 2007. Nga pyetësorët e shpërndarë, 197 pyetësorë u grumbulluan të plotësuar, numër i barabartë me një përqindje kthimi prej 10.8%.

## 3. Numri vizitorëve

Harta (15.1) e zonës ku u zhvillua studimi përfshin kontetë e *Freyung-Grafenau* dhe të *Regenit*. Figura 15.1 tregon tendencën e qëndrimit me fjetje në rajon prej 1980, krahasuar me tendencën për gjithë rajonin e Bavarisë dhe të komponentes të turizmit në qytete, të zhvilluar fuqishëm.

1 Julius-Maximilians-Universität Würzburg.

2 Goethe-Universität Frankfurt am Main.

3 dwif-consulting e.V.

4 TNS Infratest GmbH.

5 Ky dokument është përmbledhje e studimit të titulluar *Die Destination Nationalpark Bayerischer Wald als regionaler Wirtschaftsfaktor*: një version i shkurtër i tij në gjuhën angleze mund të shkarkohet në adresën: [http://www.nationalpark-bayerischer-wald.de/detail/veroeffentlichung/publikationen/d\\_berichte/doc/en\\_studie\\_job-kurz\\_ba.pdf](http://www.nationalpark-bayerischer-wald.de/detail/veroeffentlichung/publikationen/d_berichte/doc/en_studie_job-kurz_ba.pdf)




Figura 15.1: Grafiku i qëndrimit me fjetje në zonën e studiuar dhe në zonat e tjera për efekt krahasimi  
Burimi: Ilustrim i yni, përshtatur nga LfStaD 2008

Me një numër të përgjithshëm prej 760,000 vizitorësh në 2007, Parku Kombëtar është destinacioni më i vizituar në rajon me pothuajse trefishin e vizitorëve të kompleksit të skive Mt. Arber. Një studim i mëparshëm vlerëson se numri i vizitorëve të parkut në 1881 ishte 1.3 deri 1.4 milion njerëz.


Që nga fillimi i viteve 1980, nuk janë bërë numërime sistematike në bazë vjetore të vizitorëve që kanë frekuentuar gjithë zonën. Në studim, shifrat e kuotuar bazohen në përlllogaritjet e administratës së parkut kombëtar. Për këtë arsye do të ishte e gabuar të arrihej në konkluzionin se, përgjatë viteve, interesi i turistëve për Parkun Kombëtar të Pyllit të Bavarisë ka rënë.

Numërimi i vizitorëve nga qendrat e vizitorëve Hans-Eisenmann-Haus dhe Haus zur Wildnis (që u hapën në 2006), ofrojnë një bazë më të besueshme krahasimi. Në 1982, qendra Hans-Eisenmann-Haus u vizitua nga 211,000 njerëz dhe në 2007 rreth 255,000 vizitorë.

Sipas sondazhit tonë të 2007, përqendrimi më i madh i vizitorëve është rreth zonave parësore turistike (qendrat e vizitorëve dhe parqet e botës së egër), ndërsa pjesa tjetër e vizitorëve shpërndahet gjerësisht nëpër të gjithë zonën e mbrojtur. Duke pasur parasysh përqendrimin e turistëve në qendrat e vizitorëve dhe numrin e tyre në raportimin më të fundit, numri i referuar prej më shumë se 1 milion vizitorë, qoftë i tanishëm apo i dikurshëm, nuk është i saktë.


67% e numrit të përgjithshëm të vizitorëve qëndrojnë me natë fjetjeje (rreth 511,000 vizitorë). Pjesa e mbetur rreth 33% (afërsisht 249,000 vizitorë) janë vizitorë ditorë. Ndryshimet sezonale të numrit të vizitorëve konfirmojnë natyrën

sezonale të frekuentimit të rajonit: shumica e vizitorëve vijnë në sezonin e verës dhe dimrit, më pak vizitorë në periudhën jashtë pikut turistik. Megjithatë ka disa përjashtime nga ky rregull, për shembull gjatë pushimeve të Pashkëve dhe atyre të vjeshtës. Numri më i madh i vizitorëve në sezonin e verës regjistrohet në muajin korrik.



Harta 15.1: Zona e vëzhguar e pylli bavarez dhe intensiteti turistik i komuniteteve të tij

Shumica e vizitorëve vijnë nga Gjermania. Vetëm 3.9% vijnë nga vende të tjera (Harta 15.2), kryesisht nga vendet fqinje si Republika Çeke, Austria ose Holanda. Vendqendrimi kryesor për rreth 28% të anketuarve është zona me kod postar nr. 94, dmth zona përreth parkut kombëtar, një tregues se shumica dërrmuese e vizitorëve janë vizitorë ditorë.4. Importance of the national park brand in the Bavarian Forest



Harta 15.2: Vizitorët në Parkun Kombëtar të Pyllit Bavarez

#### 4. Rëndësia që ka marka e Parkut Kombëtar të Pyllit Bavarez

Varësisht lidhjes/shkallës së pëlqimit që kanë për parkun kombëtar, vizitorët e tij ndahen në dy grupe: vizitorë me shkallë të lartë pëlqimi (45.8%) dhe vizitorë të tjerë (54.2%) (Fig. 2).

Sipas numrit total të vizitorëve në 2007 dhe nga struktura e vizitorëve të parkut mund të nxirret grafiku i mëposhtëm i shpërndarjes së vizitorëve që kanë lidhje të veçantë me parkun dhe vizitorëve të tjerë, si dhe përqindjet respektive të vizitorëve ditorë dhe vizitorëve me natë fjetje (Fig. 3). Pothuajse gjysma e turistëve janë të motivuar të vizitojnë rajonin për shkak të Parkut Kombëtar. Kjo flet për pozicionin e parapëlqyer të Parkut Kombëtar të Pyllit të Bavarisë si destinacion turistik gjerman. Krahasuar me të tjerët, kjo e dhënë është një rezultat pozitiv për Parkun Kombëtar të Pyllit të Bavarisë për faktin se gjendet i shtrirë mes dy parqesh të tjera: Parku Kombëtar *Müritz* (43.7%) dhe Parku Kombëtar i *Berchtesgadenit* (10.1%).

Vetëm 57.3% e të anketuarve në Parkun Kombëtar të *Berchtesgaden* ju përgjigjën saktë pyetjes mbi statusin ligjor të ruajtjes së zonës. Në *Müritz*, numri i tyre arrinte në 76.7%, ndërsa për Pyllin Bavarez përqindja e të anketuarve që ju përgjigjën pyetjes shkonte deri në 86.1 %.




Fig. 15.3: Strukturë e vizitorëve të Parkut Kombëtar të Pyllit Bavarez  
Burimi: Studim i yni i 2007tës

Përqindja e vizitorëve që kanë shkallë të lartë pëlqimi për Parkun Kombëtar *Müritz*, i cili është 20 vjet më i ri, është pak më e ulët se përqindja e të njëjtit grupim për Pyllin e Bavarisë. Arsyeja kryesore për këtë është prania për një kohë më të gjatë e tregut turistik në Pyllin bavarez. Kështu që për shkak të veçantive të tjera tërheqëse të pranishme në zonë, edhe po të mos ishte Parku Kombëtar, ajo do të ishte në listën e destinacioneve të mundshme të vizitorëve kur të merreshin vendime për të udhëtuar. Së dyti, intervistat me sipërmarrësit në fushën e turizmit (pronarët e bizneseve turistike) tregojnë se identifikimi i popullsisë vendase me Parkun e Pyllit Bavarez është më i vogël se ajo në rajonin *Müritz*.




Figura 15.2: Tërheqja ndaj markës "Park Kombëtar"<sup>6</sup>  
Burimi: Studimi yni i 2007tës

Roli që luan statusi i ruajtjes së parkut kombëtar, në vendimet e vizitorëve për të udhëtuar në këtë rajon, është shumë i ndryshëm. Shumica e të anketuarve (54.7%) kanë zgjedhur dy kategoritë kryesore të përgjigjeve, përkatësisht: "parku kombëtar ishte një arsye e fortë për këtë vizitë" dhe "...ishte arsyeja kryesore për vizitën". Është me interes të përmendet se parku kombëtar ka një domethënie më të madhe për vizitorët me natë qëndrimi, se sa për vizitorët ditorë. Sidoqoftë duhet vënë në dukje se përqindja e vizitorëve që kanë një pëlqim të veçantë për parkun nuk është shumë e kënaqshme.

Pavarësisht faktit se parku kombëtar ka ekzistuar në këtë rajon prej katër dekadash dhe interesit të turistëve për zonat e mbrojtura, ai luan një rol relativisht të vogël në marketingun e bizneseve që ju përgjigjën sondazhit. (Fig. 4).

Parku kombëtar ka rëndësi të ngjashme me atë të *Berchtesgaden* dhe shumë më pak rëndësi se Parku Kombëtar *Müritz* (Fig. 15.5).

Megjithatë ekzistojnë dallime rajonale të rëndësishme mes pjesës së parkut kombëtar në kontenë *Freyung-Grafenau* dhe zonës periferike në kontenë *Regen*. Përqindja e të anketuarve në parkun e shpallur në fillim (95%), që besojnë se parku luante një rol të rëndësishëm në marketingun e bizneseve të

6 Përqindja e turistëve që kanë lidhje të fortë me parkun i referohet numrit total të vizitorëve. Në përqindjet e dhëna nuk përfshihen vizitorët që nuk e dinë statusin e ruajtjes së rajonit (13.9%) ose të parkut kombëtar (2.6%).




Fig. 15.4: Roli i parkut kombëtar në vendimin për të vizituar zonën  
Burimi: Job/Metzler/Vogt 2003, Job et al. 2005, kërkim i yni i 2007tës

tyre, është më e lartë se e atyre që u intervistuan në Parkun Kombëtar të Müritz (85 %). Sidoqoftë, roli që luan Parku Kombëtar i Pyllit Bavarez është më pak i rëndësishëm (42%) krahasuar me Parkun Kombëtar të Berchtesgadenit (76%).

Mbetet ende shumë punë për t'u bërë sidomos në rastet ku vihen re probleme lidhur me marketingun e brendshëm, pasi ofruesit e shërbimeve të akomodimit (kryesisht në zonën periferike) nuk promovojnë sa duhet Parkun Kombëtar tek mysafirët e tyre. Së fundi, Shoqata e Turizmit të Bavarisë Lindore ka ndërmarrë një fushatë më intensive për të promovuar Parkun Kombëtar me qëllimin që bizneset vendase të njohin më mirë vlerën e kësaj mundësie të pashfrytëzuar sa duhet. Përsa i përket marketimit të zonës në rajonet jashtë saj, ka mungesë të produkteve turistike, që janë specifike për parkun dhe sipas kërkesave të tregut. Përveç kësaj, menaxhimi i turizmit me anën e një departamenti ri, që nuk ekzistonte më parë, duhet të luajë një rol më të rëndësishëm në administrimin e Parkut Kombëtar.

Në përgjithësi hendeku i madh mes vizitorëve që kanë dijeni mbi statusin e zonës së mbrojtur (86.1% e vizitorëve e njohin Parkun Kombëtar) dhe atyre që kanë statusin e parkut si arsye kryesore për ta vizituar atë (45.8%) paraqet një problem mjaft të madh komunikimi nga ana




Fig. 15.5: Shpërndarja e të anekuarve për përgjigjen "Parku kombëtar luan një rol të rëndësishëm në marketingun tim" sipas zonave  
Burimi: Job et al. 2004a,b dhe studimi ynë i 2007-tës

e marketingut turistik. Kjo kritikë i drejtohet kryesisht bizneseve rajonale të akomodimit dhe gastronomisë dhe jo administrimit të parkut apo Shoqatës Turistike të Bavarisë Lindore.

## 5. Ndikimi ekonomik rajonal i turizmit në Parkun Kombëtar të Pyllit Bavarez

Turistët në Parkun Kombëtar të Pyllit Bavarez shpenzojnë mesatarisht një shumë ditore prej 38.70 EUR për person. Megjithatë, duhet bërë dallimi mes vizitorëve ditore dhe atyre më fjetje.

### 5.1 Vizitorët ditore

- Shpenzimi ditore i vizitorëve që kanë simpati për parkun është rreth 11.40 EUR për person. 64% e kësaj shume shpenzohet për ushqim, 25% për blerje dhe 11% për shpenzime të tjera.
- Shpenzimi ditore për person, i vizitorëve të tjerë/zakonshtëm është 9.30 EUR, nga e cila 69% shpenzohet për ushqim, 19% për blerje dhe 12% për shpenzime të tjera.

Struktura e mëposhtme e shpenzimeve (Fig. 6) është nxjerrë nga numri total i vizitorëve ditore të parkut kombëtar.

|  | Parku Kombëtar Berchtesgaden | Parku Kombëtar i Pyllit Bavarez | Parku Kombëtar Müritz |
|--|------------------------------|---------------------------------|-----------------------|
| Numri i vizitorëve   | 114,000 (1,129,000*)         | 350,000 (760,000*)              | 167,000 (390,000*)    |
| Ø shpenzimi ditore për person  | 44.27 EUR                    | 38.70 EUR                       | 33.80 EUR             |
| Shpenzimet bruto të turistëve  | 9.3 milion EUR**             | 13.5 milion EUR                 | 5.6 milion EUR        |
| Të ardhurat direkte  | 3.1 milion EUR               | 4.3 milion EUR                  | 1.9 milion EUR        |
| Të ardhurat e tërthorta  | 1.5 milion EUR               | 2.2 milion EUR                  | 0.9 milion EUR        |
| Të ardhurat në total   | 4.6 milion EUR               | 6.5 milion EUR                  | 2.8 milion EUR        |
| Ekuivalenti i të ardhurave   | 206 persona                  | 456 persona                     | 261 persona           |
| *të gjithë vizitorët e parkut kombëtar   |                              |                                 |                       |
| **Metoda të ndryshme llogaritje për shkak të metodave të ndryshme të sondazhit |                              |                                 |                       |

Tabla 15.1: Përmbledhje e ndikimit ekonomik të vizitorëve me shkallë të lartë pëlqimi për parkunSource: Job/Metzler/  
Burimi: Job/Metzler/Vogt 2003; Job et al. 2005; studim i yni i 2007

|                              | Numri i vizitorëve | Shpenzimet ditore në EUR | Shpenzimi bruto turistëve në milion EUR |
|------------------------------|--------------------|--------------------------|---|
| Vizitorët që pëlqejnë parkun | 350,000            |                          | 13.5                                    |
| Vizitorët ditore             | 100,000            | x 11.40                  | 1.1                                     |
| Vizitorët me fjetje          | 250,000            | x 49.60                  | 12.4                                    |
| Vizitorët e tjerë            | 410,000            |                          | 14.3                                    |
| Vizitorët ditore             | 151,000            | x 9.30                   | 1.4                                     |
| Vizitorët me fjetje          | 259,000            | x 49.60                  | 12.9                                    |

Tabela 15.2: Shpenzimi bruto i turistëve në Parkun Kombëtar të Pyllit Bavarez  
Burimi: Studim i yni i 2007

Shuma që vizitorët ditore shpenzojnë në parkun e Pyllit Bavarez është shumë më e ulët se sa mesatarja ditore prej 28 EUR për një gjerman. Ka shumë arsye pse ekziston një diferencë e tillë.




Fig. 15.6: Shpërndarja e shpenzimeve për vizitorët ditore  
Burimi: Studimi ynë i 2007

Vizitorët ditore që u intervistuan në Parkun Kombëtar, nuk përfshijnë vetëm vizitorët klasikë, por edhe një përqindje mjaft të madhe të banorëve vendas, të cilët e shpenzojnë kohën e lirë në mjediset rreth parkut. Naryrisht, shpenzimi i tyre është i ulët, sepse ata konsumojnë pak ose aspak gjatë veprimtarive të tyre nëpër park. Ky fakt evidentohet lehtë nga përqindja e lartë e vizitorëve ditore të Parkut Kombëtar, të cilët pothuajse nuk shpenzojnë fare, apo deri në një të tretën e mesatares ditore për gjerman.

Vlen të përmendet se shuma që përgjithësisht shpenzojnë vizitorët ditore varet nga lloji i aktivitetit që kryejnë. Ngjitja në mal është një aktivitet shumë popullor, i cili njihet tradicionalisht si aktivitet ku njerëzit tentojnë të shpenzojnë pak. Mundësitë e ndryshme që mund të ofrohen për konsum varen nga sa natyrale është zona: sa më natyrore të jetë zona aq më pak para shpenzohen në park. Kjo situatë ndodh përgjithësisht për të gjitha parqet kombëtare. Kjo shpjegon dallimin e sjelljes për të shpenzuar, krahasuar me rajone të tjera më urbane, të cilat ndikojnë mjaft në vlerën e mesatares së shpenzimit për gjermanët. Ky informacion shpjegon shpenzimin krahasimisht të vogël të vizitorëve ditore në Parkun Kombëtar të Pyllit të Bavarisë. Ata e vizitojnë parkun veçanërisht për të shijuar natyrën dhe jo për të shpenzuar.

## 5.2 Vizitorët me fjetje

Vizitorët me fjetje të parkut shpenzojnë një mesatare ditore prej 49.60 EUR për person, e cila është përsëri shumë më e ulët se mesatarja gjermane për person (93.30 EUR). Niveli i shpenzimeve ndikohet shumë nga lloji i akomodimit të zgjedhur, e për rrjedhojë edhe nga struktura e akomodimit që ofron zona. Por ka shumë arsye që shpjegojnë mesataren e ulët të këtij shpenzimi:

- Parku Kombëtar ndodhet në një zonë rurale me infrastrukturë të dobët, ku dominojnë mundësi jo të kushtueshme akomodimi, krahasuar me akomodimin në qytete. Hotelet e kushtueshme janë të rralla.
- Vizitorët e parkut tentojnë të zgjedhin më tepër akomodimin privat ose apartamente pushimesh (me më pak se 9 shtretër), krahasuar me hotelet. Shpenzimi mesatar ditore i këtij akomodimi, jokomercial, me më pak se 9 shtretër është vetëm 48.30 EUR, qartazi më i vogël se shpenzimi ditore në akomodimet komerciale.

Në rastin e Pyllit të Bavarisë, diferencimi i vizitorëve me fjetje nga vizitorët që kanë shkallë të lartë pëlqimi për parkun, ose nga vizitorët e tjerë nuk është i dallueshëm. Të dy grupet shpenzojnë 49.60 EUR për person në ditë. Megjithatë, mund të vihen re variacione të lehta të sektorëve të ndryshëm ekonomikë që përfitojnë nga mysafirët:

- Tek vizitorët me shkallë të lartë pëlqimi për parkun, 71% e shpenzimeve shkon për akomodim dhe ushqime, 22% në sektorin e tregëtisë dhe 7% në shërbime të tjera.
- Vizitorët e tjerë/të zakonshëm shpenzojnë diçka më shumë për akomodim dhe ushqime (75%) dhe më pak në sektorin e tregëtisë (18%). Si më lart, vetëm 7% shpenzohet për shërbime të tjera.

Figura e mëposhtme ilustron strukturën e shpenzimeve që realizojnë vizitorët me fjetje në Parkun e Pyllit të Bavarisë (Fig. 15.7).

Shpenzimi ditore i vizitorëve në Parkun Kombëtar të Pyllit Bavarez, krahasuar me Parkun *Berchtesgaden* dhe Parkun *Müriz*, qëndron diku në mes (Table 15.1).




Figura 15.7: Shpërndarja e shpenzimeve për vizitorët me fjetje Burimi: Studimi ynë i 2007

### 5.3 Shpenzimet bruto të turistëve

Shpenzimi bruto i turistëve llogaritet duke shumëzuar shpenzimin ditor të një turisti me numrin e ditëve që vizitorët kanë qëndruar në park. Çdo vit, vizitorët e parkut realizojnë një shpenzim vjetor bruto prej 27.8 milion EUR. 13.5 milion e kësaj shume ose 49% e saj, i takon vizitorëve që kanë shkallë të lartë tërheqje/pëlqimi për parkun dhe 14.3 milion EUR vizitorëve të tjerë. Tendanca e dallimit mes këtyre dy grupeve jepet në Tabelën 15.2.

Shpenzimi neto i turistëve llogaritet duke i zbritur shpenzimit përkatës bruto, vlerën e TVSHsë. Totali i TVSHsë për gjithë vizitorët në Parkun Kombëtar të Pyllit Bavarez është 3.8 milion EUR. Nëse kjo shumë, i zbritet shpenzimit bruto të turistëve prej 27.8 milion EUR, shpenzimi neto i mbetur është 24 milion EUR.

### 5.4 Efektet në punësim: ekuivalenti i të ardhurave

Për të llogaritur ekuivalentin e të ardhurave, siç është numri ekuivalent i të punësuarve me kohë të plotë, që nxirret nga totali i të ardhurave të realizuara, nevojiten disa parametra. Për të llogaritur mesataren e të ardhurave totale për person duhet numri i banorëve të komunitetit dhe të ardhurat e tyre në total, e cila është e barabartë me 14,387 EUR. Për të llogaritur ekuivalentin e të ardhurave, pjestojmë vlerën e shtuar që gjenerohet nga vizitorët e parkut me mesataren e të ardhurave totale për person. Diferenca mes vizitorëve që pëjqejnë parkun nga vizitorët e tjerë bëhet përmes rezultateve më poshtë:

Vizitorë që kanë pëlqim për parkun:

6.56 milion EUR : 14,387 EUR = 456 persona

Vizitorë të tjerë:

6.95 milion EUR : 14,387 EUR = 483 persona

Kjo tregon se vizitorët e parkut gjenerojnë një të ardhur ekuivalente me të ardhurat e 393 personave, plotësisht nga turizmi në parkun kombëtar.

Sidoqoftë, kjo vlerë është thjesht një përlogaritje, pasi duket se nga turizmi varet të paktën pjesërisht jetesa e më shumë njerëzve. Kjo mund të shpjegohet me faktin se ata që janë të punësuar në sektorin e turizmit, ndodh që:

- jetojnë vetëm pjesërisht me të ardhurat prej turizmit (p.sh dhënia me qera e apartamenteve), dhe
- nuk janë të punësuar me kohë të plotë (p.sh pozicione pune me kohë të pjeshme, punësim sezonal, punë e përkohëshme).

Megjithatë është e qartë se turizmi, si një mënyrë punësimi, ka më tepër rëndësi se shifrat matematikore të përlogaritura më lart. Të ardhurat që gjenerohen nga turizmi në Parkun Kombëtar të Pyllit të Bavarisë kanë ndikim rajonal të rëndësishëm në këtë rajon periferik dhe me infrastrukturë të dobët të Bavarisë. Nëse të ardhurat e të gjithë vizitorëve të parkut vlerësohen në 13.5 milion EUR, ato janë në vlerë absolute sa dyfishi i të ardhurave që gjenerohen në kompleksin e skive të Malit Arber. Kjo tregon se të dyja, si turizmi i parkut që bazohet në vlerat natyrore, edhe infrastruktura që bazohet në format e të tjera të turizmit janë produkte të rëndësishme turistike për zonën dhe reciprokisht ekskluzive për të njëjtin destinacion.

## 6. Domethënia ekonomike e turizmit në rajon

Rezultatet e studimit në lidhje me ndikimin ekonomik rajonal që krijon turizmi i parkut duhet të interpretohen në mënyrë korrekte duke vlerësuar mardhënien e tyre (pra të rezultateve) me ndikimin e plotë ekonomik të turizmit në zonën ku kryhet studimi, përmes vëzhgimit të bizneseve turistike dhe joturistike. Ndikimi ekonomik është 11.1% për kontetë *Freyung-Grafenau* dhe *Regen* dhe 13.2% për komunitetet turistike që janë më afër hyrjes së parkut. Kjo përqindje përfshin vlerën e shtuar për industrinë e ushqimit dhe të akomodimit, përqindjet përkatëse të bizneseve nga sektorët kulturorë, sportivë, të pushimit, artizanalë, të tregëtisë dhe shërbimeve të tjera, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë bëjnë qarkullimin e parasë nga turistët dhe bizneset turistike. Studimi ka marrë gjithashtu në konsideratë edhe efektet e tërthorta të investimeve të nxitura në zonë si pasojë e turizmit.

Nëse vlera e shtuar që gjeneron turizmi në parkun kombëtar, krahasohet me vlerën totale të shtuar të turizmit në rajon, del qartë se 10% e vlerës së shtuar për komunitetin që banon në hyrje të parkut, gjenerohet nga vizitorët që kanë shumë pëlqim për parkun, pra nga një e pesta e të gjithë vizitorëve të parkut. Siç pritet, rëndësia e turizmit në zonën e parkut zvogëlohet nëse vlera e shtuar vëzhgohet e ndarë në nivel konteje: vetëm 2 deri në 4.5 % të vlerës së shtuar të turizmit në gjithë zonën vijnë nga Parku Kombëtar.




Figura 15.8: Shumëfishimi i të ardhurave nga turizmi në kontetë e Freyung-Grafenau dhe Regenit  
Burimi: Studimi ynë i 2007

Industria e turizmit nuk është e vetmja që përfiton prej aktivitetit turistik në rajon. Tërthorazi, bizneset turistike (që ndihmojnë me shtimin e burimeve, investimet në rajon) dhe efektet e shkaktuara (pagat dhe rrogat e të punësuarve në sektorin e turizmit) rrisin vlerën e shtuar të turizmit në rajon, përmes faktorëve 1.38 (efekt vetëm i tërthortë), 1.53 (duke marrë në konsideratë investimet e nxitura nga turizmi) dhe 1.79 (përfshi efektet e krijuara nga pagat) (Fig. 15.8).

Kjo nënkupton se çdo Euro e shpenzuar në rajon sjell deri në 1.79 EUR vlerë të shtuar, pra edhe për rajonin. Kështu lidhjet e burimeve të ndërmjetme krijojnë një të ardhur shtesë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga 38 cent në 79 cent për çdo Euro të shpenzuar në shërbimet turistike. Këto shumëfisha zvogëlohen lehtë në komunitetet që banojnë në periferi të parkut, për shkak të shumëllojshmërisë së kufizuar të ekonomisë në këto zona të vogla. Nëse numri total i njerëzve të punësuar në sektorin e turizmit, krahasohet me 456 personat që parashikohet se mbulon turizmi i parkut, marrin rezultatet e mëposhtme: 3.5% e të punësuarve në sektorin turizmit, nga kontetë Regen dhe Freyung-Grafenau

varen nga turizmi që krijon Parku Kombëtar. Kur vëzhgohet kategoria e komunitetit në hyrje të parkut, kjo shifër rritet në 13.5%. Nëse merret në konsideratë vetëm numri i njerëzve që merren me akomodim dhe shërbim ushqimor, ky numër shkon në 14.2%. Kjo provon se turizmi i Parkut Kombëtar është një faktor i rëndësishëm për punësimin në rajon. Vlen gjithashtu të përmendet se në administratën e parku janë të punësuar më shumë se 200 persona.

## 7. Destinacioni ndërkufitar – Parku Kombëtar Šumava dhe Parku Kombëtar i Pyllit të Bavarisë?

Mbetet ende shumë rrugë për t'u bërë para se të krijohet një destinacion turistik i përbashkët ndërkufitar mes dy parqeve kombëtare Šumava (Republika Çeke) dhe Pyllit Bavarez. Aktualisht, mundësitë e bashkëpunimit mes industrive përkatëse të turizmit nuk po shfrytëzohen plotësisht dhe gjithashtu nuk po përkrahen nga turistët.

Parku Kombëtar Šumava është destinacion tërheqës pushimi që pret më shumë se një milion vizitorë në vit, përgjithësisht vendas, të cilët e vizitojnë Šumavën më shumë se një herë. Megjithatë, ende nuk shfrytëzohen potencialet e turistëve që vijnë për Pyllin Bavarez. Më shumë se gjysma e vizitorëve të Šumavës nga Republika Çeke nuk kanë qenë asnjëherë në Pyllin Bavarez.

Potenciali që mbart ky grup i synuar vizitorësh vërehet në përgjigjet që i japin pyetjes: Nëse janë të interesuar të vizitojnë Pyllin e Bavarisë? Pak më shumë se gjysma e turistëve të Šumava u përgjigjën se do të ishin padyshim të interesuar të vizitonin Parkun Kombëtar. 90% e turistëve që e kishin vizituar parkun kombëtar thanë se do të ktheheshin sërish në Pyllin e Bavarisë. Me qëllim që të tërhiqen vizitorë të rinj, kërkohet një rrjetëzim më i mirë i turizmit (edhe gjuhësor) dhe një rrjetë më i mirë kalimesh dhe rrugësh transporti mes dy zonave. Kur Republika Çeke u pranua në marrëveshjen Shengen në 2008të, puna për përcaktimin e kërkesave ligjore kishte përfunduar. Këto duhet të shërbejë si shtysë për ndryshime në drejtimin e përcaktuar më lart.

# 16. Përfitimet e bashkëpunimit ndërkuftar në fushën e ruajtjes dhe konservimit të natyrës

Maja Vasilijević<sup>1</sup>

## Hyrje

Nxitja e bashkëpunimit ndërkuftar<sup>2</sup>, në nisma që kanë të bëjnë me ruajtjen e natyrës është një zgjedhje, një vendim i pavarur i palëve të interesuara që të punojnë bashkërisht drejt përbushjes së rezultateve të caktuara. Prakticienët

Nuk duhet nënvleftësuar fakti se siguria ekonomike dhe qëndrueshmëria janë një prej forcave shtytëse të botës në ditët e sotme. Menaxherët e zonave të mbrojtura ndeshen shpesh me problemet e financimit dhe të qëndrueshmërisë. Por në botë, ekzistojnë shumë shembuj, ku për shkak të karakterit ndërkuftar të ruajtjes, zonat e mbrojtura kanë gjeneruar financime shtesë, si përmes projekteve të zakonshme ashtu edhe përmes fondeve të krijuara nga sponsorizimet e partnerëve të ndryshëm. Në



© Maja Vasilijević

e zonave të mbrojtura dhe ekspertët e përfshirë në punë ndërkuftare e vënë theksin shpesh në vështirësitë e shumta që mund të pengojnë aksionin ndërkuftar dhe që mund të jenë shumë komplekse dhe të vështira për t'u tejkaluar. Në të vërtetë, për menaxhimin e zonave të mbrojtura është më e lehtë nëse punohet sipas një modeli, që njihet dhe ekziston në njërin nga vendet, për të evituar përfshirjen e strukturave të ndryshme organizative të vendit fqinj, politikave e ndryshme, apo kultura të ndryshme. Natyrisht, nëse përfitimet e bashkëpunimit ndërkuftar nuk shprehen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për gjithë palët e interesuara, bashkëpunimi mund të mos jetë i suksesshëm.

kontekstin evropian, skemat<sup>3</sup> e financimit të BEsë, bëjnë thirrje për bashkëpunim ndërkuftar dhe i nxisin vendet të thellojnë bashkëpunimin mes tyre në interes të natyrës dhe mjedisit. Bashkëpunimi ndërkuftar mes vendeve mundëson profilizimin e lartë të zonave të mbrojtura, lehtëson emërtimet ndërkombëtare (si Rezervat<sup>4</sup> e Biosferës që mbrohen nga UNESCO) dhe tërheq vëmendjen e donatorëve (Mittermeier et al. 2005; Hamilton et al. 1996). Kjo nga ana e saj, mund të rrisë dhe sigurojë entuziazëm afatgjatë për çështje që kanë të bëjnë me zonat e mbrojtura, siç është përfshirja e tyre në nisma të reja, të përbashkëta ndërkuftare. Faktori ekonomik i bashkëpunimit ndërkuftar paraqet përfitime të mëtejshme në drejtim të fuqizimit dhe

<sup>1</sup> Drejtues i Grupit të Ekspertëve për Mbrojtjen Ndërkuftare të IUCN WPCA, Kroaci.

<sup>2</sup> Në këtë dokument, fjala 'ndërkuftare' ju referohet vetëm zonave që përshkojnë një apo më shumë vende, duke përjashtuar njësitë ndër-shtetërore.

<sup>3</sup> Psh Instrument për Vendet Kandidate për Anëtarësim në BE (IPA) i Komisionit Evropian, i cili ka një komponent të veçantë përsa i përket bashkëpunimit ndërkuftar.

<sup>4</sup> Në lidhje me përfitimet që sjellin Rezervat e Biosferës ndërkuftare shiko rastet studimore: *Karpatet Lindore; Krkonosë/Karkonosze*.

përmbushjes së 'misionit bazë', që është ruajtja e natyrës e shoqëruar me shërbimet e ekosistemit dhe vlerat kulturore.

Zonat e ruajtura ndërkuftare ZRN (në angl.: TBCA)<sup>5</sup> janë të një rëndësie në rritje, për shkak të mbrojtjes në shkallë të gjerë dhe mirëmbajtjes që ju ofrohet ekosistemeve komplekse, krahasuar me rezultatin që mund të arrihet në një zonë të mbrojtur, por të veçuar, që nuk ka karakter ndërkuftar. Megjithë kompleksitetin që paraqesin, përpjekjet dhe planet vepruese për ruajtjen e natyrës mund të sjellin shumë përfitime, nëse kombinohen mes vendeve.

ZNRtë (TBAs) bëjnë të mundur komunikimin mes punonjësve të zonave të mbrojtura, zyrtarëve, autoriteteve të larta shtetërore dhe popullsisë vendore të dy ose më shumë vendeve. Në ditët e sotme, kur dialogu ndër-kulturor, toleranca mes njerëzve dhe paqja ndërkombëtare janë nevoja me rëndësi kritike, bashkëpunimi ndërkuftar për ruajtjen e natyrës duhet parë si mundësi, që i bën këto elementë të zbatueshëm në praktikë. Në të vërtetë, ruajtja ndërkuftare mund të shërbejë si mjet për zgjidhjen e konflikteve ushtarake dhe politike, siç ishte shembulli mes Ekuadorit dhe Perusë, ku marrëveshja e paqes kishte në listën e saj, krijimin e një korridori të ruajtjes të emërtuar me termin *Cordillera del Condor* (Mittermeier et al. 2006).

Në këtë dokument do të njiheni me disa prej sfidave dhe vështirësive që ndeshin palët e interesuara kur përipiqen të nxisin dhe zbatojnë ruajtjen e zonave ndërkuftare. Ai do të shqyrtojë edhe përfitimet më të zakonshme që sjell puna në bashkëpunimin ndërkuftar për natyrën. Kapitujt e mëparshëm vënë theksin tek disa prej tyre dhe i cilësojnë si nisma ndërkuftare në Evropë.

## Sfidat e ruajtjes ndërkuftare

Kur flasim për menaxhimin e zonave ndërkuftare të ruajtjes, nënkuptojmë bashkëpunimin mes palëve, i cili përbën karakteristikën kryesore të ruajtjes së këtyre zonave. Bashkëpunimi mund të shtrihet, prej nivelit të mos ekzistencës, në komunikimin, konsultimin, bashkëveprimin ose koordinim planifikimiin, deri në nivelin më të lartë që është bashkëpunimi i plotë (Zbicz 1999). Në këtë kuptim, niveli minimal i kërkuar që një zonë të konsiderohet ZRN, është ekzistenca e disa formave të komunikimit dhe shkëmbimi i informacionit mes zonave të mbrojtura, të përtej kufijve. Koordinimi i bashkëpunimit sipas çdonjërit prej niveleve të përmendura më lart, është pak a shumë një sfidë, pasi ndeshet me shumë pengesa që ndeshen në zbatim. Për të gjitha nivelet e bashkë-menaxhimit<sup>6</sup> (që referohet

shpesh si menaxhim bashkëpunues), ka një ndarje të caktuar të përgjegjësive, me qëllim që të arrihen gjithë rezultatet e mundshme që gjeneron vendimmarrja dhe menaxhimi i përbashkët. Ky nuk është një qëllim që mund të arrihet lehtë.

Integrimi i ruajtjes së dy apo më shumë zonave të mbrojtura përtej kufijve ndërkombëtarë, nënkupton sigurimin e mbështetjes së nevojshme politike dhe/ose mbështetjen e menaxherëve në zonat e mbrojtura, të cilët gjenden në pozicionin më të favorshëm për të arritur qëllimet e aktiviteteve të ruajtjes, në terren. Indiferenca politike dhe mungesa e angazhimit mund të pengojë marrjen e nismave ndërkuftare. Megjithatë, edhe kur ka vullnet politik nga të gjitha anët, marrëveshje të nivelit të lartë, ose qëndrime të përbashkëta, nuk mund të garantohet suksesi i ZRNve. Ka shumë elementë, si politikë, socialë, ekonomikë dhe ligjorë që ndikojnë në funksionimin e ZRNve. Ndryshimet në legjisllacion dhe politika mund të zvogëlojnë efektivitetin e një ZRNje, gjë e cila nënkupton nevojën për të harmonizuar normat në lidhje me çështje shumë të rëndësishme siç janë, emigrimi dhe doganat, ose ndalimi i veprimtarive të gjuetisë së paligjshme (Tamburelli 2007). Hamilton et al. (1996) vë në dukje disa prej sfidave që ndeshen më shpesh gjatë nxitjes së nismave ndërkuftare; si ndryshimet kulturore dhe fetare, çështjet e gjuhës, nivelet e ndryshme të zhvillimit ekonomik, zbatim më i ngadaltë se masat e 'zakonshme' të ruajtjes, terreni i vështirë, etj.

Zonat e mbrojtura në vendet fqinje mund të ofrojnë burime jo të njëjta në raport me masat e përcaktuara të mbrojtjes, gjë e cila mund të krijojë tensione mes parqeve (Sandwith and Besançon 2010). Koordinimi i ruajtjes/konservimit përmes kufijve është i shtrenjtë dhe kërkon përpjekje koordinuese shtesë. Dallimet që ekzistojnë në nivelet e standardeve profesionale mes zonave të mbrojtura mund të jenë një faktor kufizues dhe mund të demotivojnë përfshirjen e personelit në bashkëpunimin ndërkuftar. Po ashtu, kapacitetet janë shpesh herë një faktor shtrëngues. Nëse strukturat kombëtare janë të dobëta, ato mund të mos jenë të afta të krijojnë ZRN të suksesshme.

Qëllimet ekologjike duhet të jenë të përputhshme me pritshmëritë e popullsisë vendore që jetojnë përreth zonave të ruajtjes (ZRN). Mungesa e komunikimit dhe e drejtimit të duhur mund të rezultojë në mungesën e mbështetjes nga ana e komuniteteve vendore për atë nismë. Po t'i shtojmë komunikimit jo-eficient edhe tërësinë e vështirësive të lartpërmendura, që pengojnë realizimin e nismave ndërkuftare të ruajtjes, Niewiadomski (kapitulli 7) paralajmëron një mori sfidash, si; qëllime dhe fusha të paprekura bashkëpunimi, njohje e pamjaftueshme e përfitimeve reciproke, mungesë mirëkuptimi ndaj kushteve operacionale dhe mungesën e shpirtit të bashkëpunimit mes partnerëve.

Sfidat janë të shumëfishta dhe lista e tyre mund të jetë shumë e gjatë. Megjithatë, vendet dhe menaxherët e zonave të mbrojtura,

<sup>5</sup> Për qëllimet e këtij dokumenti, me zona/nisma ndërkuftare të ruajtjes referohen të gjitha llojet e praktikave ndërkuftare të ruajtjes, siç sugjeron IUCN WCPA (Sandwith et al. 2006): Zonat e mbrojtura ndërkuftare, parqet për paqe dhe pushim zonat e ruajtura dhe të zhvilluara ndërkuftare, si dhe korridoret migruese ndërkuftare.

<sup>6</sup> Përcaktuar nga IUCN (1997) si "partneritet në të cilin agjencitë qeveritare, komunitetet vendore dhe përdoruesit e burimeve, organizatat joqeveritare dhe aktorët e tjerë ndërmjetësojnë, në përshtatje me kontekstin aktual, autoritetin dhe përgjegjësinë për menaxhimin e një zone të caktuar ose të një tërësie burimesh"

po kuptojnë gjithnjë e më shumë rëndësinë dhe potencialin që mbartin nismat ndërkufitare të ruajtjes. Vlen të thuhet se zbatimimi i tyre nuk ka qenë asnjëherë kaq i përhapur sa sot.

## **Përfitimet kryesore të bashkëpunimit ndërkufitar në ruajtjen e natyrës**

*"Ne i shohim zonat e mbrojtura si dhënësia përfitimesh përtej kufijsh – përtej kufijve të tyre në hartë, përtej kufijve shtetërore, që përshkojnë shoqëritë, gjinitë dhe brezat" (IUCN 2003).* Ky ishte mesazhi që shpërndanë 3000 pjesëmarrësit e ftuar në Kongresin e V të IUCN-së për Parqet Botërore, që u mbajt në Durban të Afrikës së Jugut, në vitin 2003. Kjo ishte një periudhë kur roli i zonave të mbrojtura në përmbushjen e objektivave të zhvillimit social, ekonomik, përkrah atyre të biodiversitetit, filloi të merrte më tepër vëmendje dhe të promovohet. Ky përkufizim është veçanërisht i rëndësishëm për zonat e ruajtura ndërkufitare, pasi përbën një model të përshtatshëm të praktikave të ruajtjes së natyrës, që kombinon përmbushjen e objektivave sociale, ekonomike me promovimin e paqes dhe të sigurisë. Nismat ndërkufitare të ruajtjes kapërcejnë kufijtë ndërkombëtarë dhe përfshijnë nivele të ndryshme, sektorë dhe aktorë, janë në pozicionin e duhur për t'i integruar këto objektiva dhe për të ofruar përfitime reciproke. Megjithatë, ZNAtë nuk ofrojnë gjithmonë një mekanizëm të sigurt suksesi. Shpesh, zbatimi i tyre është i gjatë, me gjithë mundësitë që mund të krijojnë në arritjen e një bashkëpunimi me përfitime të ndryshme të ndërlydhura. Seksionet më poshtë paraqesin një panoramë të përfitimeve më të zakonshme që krijohen si rezultat i nismave ndërkufitare, disa prej të cilave janë përmendur në rastet studimore të kapitujve të mëparshëm.

### *Përfitimet ekologjike*

ZNRTë janë përgjithësisht territore më të mëdha se zonat e veçuara të mbrojtura dhe zakonisht krijojnë lidhje mes habitateve që gjenden përtej kufijve. Siç na ka treguar biologjia ruajtëse dhe biogeografia<sup>7</sup> ishullore, të pasurit e një zone të madhe të mbrojtur konsiderohet me më tepër vlerë për ruajtjen e biodiversitetit, se sa të pasurit e disa të tillave me madhësi të vogël. Krijimi i lidhjeve, sidomos përmes kufijve ndërkombëtarë dhe mbrojtja e mirëmbajtja e tyre nuk është detyrë e lehtë për t'u kryer, po të merren parasysh kërcënimet që ju shkaktohen habitateve, tendencat për ta copëzuar natyrën dhe faktorët politikë. Duke lidhur natyrën me peizazhet, ZNRTë ndihmojnë për migrimin e llojeve, sidomos të kafshëve me numër të madh.

Migrimi i pa shqetësuar i llojeve krijon kushte për shkëmbim më të madh gjenetik mes tyre dhe më pak izolim. Gjithashtu, ai

ka domethënie sociale, përse i përket konflikteve njerëz/kafshë në parandalimin e shkatërrimit të habitateve të krijuara nga llojet e ndryshme (McCallum 2011). ZNRTë mund të zvogëlojnë rrezikun e humbjeve që mund t'u shkaktohen popullatave dhe t'i mbajnë ato të shëndetshme, përmes masave të përbashkëta dhe të koordinuara ndërkufitare (Hamilton et al. 1996). Për më tepër, siç thotë Hamilton (2008), zonat e mëdha të mbrojtura si ZNRTë, që mbajnë nën ruajtje habitate të pasura me karbon të lidhur, ju krijojnë ekosistemeve mundësinë që të jenë më elastike dhe të përshtaten më mirë ndaj ndryshimeve klimatike.

Bashkëpunimi përmes kufijve politikë shoqërohet me një tërësi përparësi në menaxhim që rezultojnë në ruajtjen më të efektshme të biodiversitetit. Menaxhimi i llojeve invazive, masat për kontrollin e insekteve dhe sëmundjeve, të gjuetisë pa leje ose tregëtimit të jashtëligjshëm të llojeve, japin më shumë rezultat kur koordinohen bashkërisht nga palët përtej kufijve (Hamilton et al. 1996). Gjithashtu, bashkëpunimi ndërkufitar lehtëson programet e përbashkëta të restaurimit, futjen e llojeve dhe menaxhimin e botës së egër.

Kombinimi i përpjekjeve mes vendeve mund të zvogëlojë shpenzimet, p.sh nëse ndahen mes vendeve kostot e pajisjeve të kushtueshme (siç janë mjetet e patrullimit ajror) dhe të infrastrukturës, dhe mund të gjenerojë përfitime në përdorimin e burimeve njerëzore, përmes patrullimit dhe kërkimit të përbashkët, apo aktiviteteve të shpëtimit në brezat kufitare. Programet e përbashkëta mund të shmangin mbivendosjen, rrisin mundësitë e financimit, rrisin bagazhin e aftësive dhe nxisin krijimtarinë dinamike në zgjidhjen e problemeve, si dhe mund të çojnë në standardizimin e metodave monitoruese (Mittermeier et al. 2005, Hamilton et al. 1996). Zakonisht, shkëmbimi i përvojave menaxhuese të ruajtjes, përmirëson metodat e përdorura dhe nxit zbatimin e praktikave të mira. Në disa raste, ky lloj shkëmbimi ndikon në përmirësimin e marrëdhënieve shoqërore dhe ndërton besimin mes partnerëve, i cili është shumë i rëndësishëm për funksionimin dhe të ardhmen e bashkëpunimit.

Një prej përfitimeve më të mëdha ekologjike që mund të krijohen, është kur palët arrijnë të zhvillojnë dhe zbatojnë në mënyrë të suksesshme strategjitë e harmonizuara të ruajtjes. Kjo nuk është e mundur pa përcaktimin e objektivave të përbashkët, planin e veprimtari për ruajtje të kujdesshme dhe mbi të gjitha pa vizionin e pranuar reciprokisht për zonën specifike. Procesi që udhëheq harmonizimin e veprimtarive të ruajtjes mund të jetë shumë i gjatë, dinamik, kompleks dhe i vështirë. Palët që arrijnë në 'pikën' ku zbatimi i strategjisë së përbashkët bëhet i mundur, janë në të vërtetë, zbatuesit e një nisme të suksesshme ndërkufitare.

### *Përfitimet politike*

Nisma e parë ndërkufitare e ruajtjes daton në vitin 1924 kur qeveritë e Polonisë dhe Çekoslovakisë (tani Republika Çeke) nënshkruan një aneks të Protokollit të Karkovit, i cili parashikonte

<sup>7</sup> Teoria e zhvilluar nga MacArthur dhe Wilson në 1967 që parashikon numrin e specieve në 'ishuj', p.sh habitatat e rrethuara nga zona të papërshtatshme për speciet; aplikohet në biologjinë ruajtëse/konservuese dhe bazohet në supozimin se një zonë e madhe e mbrojtur mund të mbajë më shumë lloje se shumë zona të tilla, por të vogla. Për t'u njohur me një shembull mbi këtë teori vizitoni: <http://www.nps.gov/archive/glac/resources/bio4.htm>.

krijimin e një zone të mbrojtur ndërkufitare. Megjithëse e para në Evropë (shpallur në 1932), kjo nuk ishte zona e parë ndërkufitare e mbrojtur, në botë. Disa muaj më parë, po më 1932, Kanadaja dhe SHBAja krijuan Parkun Ndërkombëtar të Paqes të *Waterton-Glacier* duke dhënë një shembull të bashkëpunimit ndërkufitar për nismat që do të ndërmerreshin në të ardhmen. Kjo zonë në veçanti, përmendet shpesh në literaturë si shembulli i zonës së mbrojtur ndërkufitare, ku palët e interesuara festuan marrëdhëniet e mira historike dhe vendosën të ndajnë angazhimet e tyre për trashëgiminë dhe burimet e përbashkëta natyrore. Jo gjithmonë ndodh kështu, pasi nismat ndërkufitare gjenden shpesh në zona të ndjeshme politikisht, që ose janë përballur në të shkuarën me ndonjë konflikt të armatosur apo përballën me armiqësi të së tashmes. Në rastin e dytë, ZNRtë përdoren si bazë për gjetjen e rrugës së mesme në zgjidhjen e konflikteve, pasi ruajtja e natyrës konsiderohet shpesh si terren neutral.

Nisma Evropiane Brezi i Gjelbër (Greenbelt) është një shembull bashkëpunimi për rindërtimin ruajtës të natyrës, pas grindjeve politike. Megjithëse promovuesit e ruajtjes së natyrës në disa vende janë përpjekur të punojnë së bashku, entuziazmi i vërtetë në fushën e komunikimit dhe të bashkëpunimit filloi pas rënies së Perdes së Hekurt. Siç është përmendur edhe më parë, Ekuadori dhe Peruja e përfshinë bashkëpunimin për ruajtjen e natyrës në marrëveshjen e paqes që nënshkruan mes tyre. Literatura e sotme tregon shumë shembuj të nismave ndërkufitare (përgjithësisht Parqe për Paqe) që kontribuojnë në ndërtimin e paqes dhe të sigurisë.<sup>8</sup> Politikisht, nismat ndërkufitare të ruajtjes së natyrës ofrojnë mundësi për stabilitet rajonal, siç është rasti i Evropës Juglindore që përfshin Nisma e Harkut Dinarik<sup>9</sup>. *"Paqes Rajonale dhe bashkëpunimit ndërkombëtar mund t'i jepet një kontribut i madh përmes krijimit të zonave ndërkufitare, të cilat promovojnë ruajtjen e biodiversitetit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe kulturore"* (IUCN dhe Fondacioni i Parqeve të Paqes 1997).

Përfshirja e qeverive (p.sh përmes nënshkrimit të traktateve dypalëshe dhe shumëpalëshe për ZNR të caktuara) ose e autoriteteve të nivelit të lartë si ministritë (p.sh me memorandume bashkëpunimi) zakonisht konsiderohet si vlerë që i shtohet bashkëpunimit ndërkufitar në një zonë të caktuar. Marrëveshje të tilla të nivelit të lartë dhe marrëdhëniet e mira politike me jashtë mund të nxisin ose përshpejtojnë nismat në terren. Megjithatë, ato nuk janë gjithmonë të mjaftueshme dhe nuk kanë ndonjë kuptim të veçantë për sa ndodh në ZNR. Për më tepër, përfshirja e niveleve të larta të qeverisjes mund të çojë në ushtrimin e fortë të ndikimit dhe kontrollit, që nuk është në interesin më të mirë të niveleve vendore (van der Linde et al. 2001). Për këte arsye bashkëpunimi në nivel vendor mes agjencive/menaxherëve të zonave të mbrojtura dhe përfshirja e

komuniteteve vendore dhe e shoqërisë civile mund të sigurojë sukses më afatgjatë të një nisme. Menaxherët krijojnë shpesh kontakte dhe bashkëpunim jozyrtar kur adresojnë aspekte të caktuara të menaxhimit të zonës, ose ofrojnë përfaqësim në bordet e njëri-tjetrit, apo gjëra të ngjashme. E gjithë kjo është e rëndësishme për të ndërtuar marrëdhënie besimi mes palëve.

Megjithatë, vendimet më kritike përgjithësisht përfshijnë nivelet e larta të qeverisjes. Kjo është edhe arsyeja pse vullneti politik, angazhimi afatgjatë dhe qeverisja e mirë janë të rëndësishme për suksesin e një ZNRje.

#### *Përfitimet sociale*

ZNRtë përfshijnë kufijtë e krijuar politikisht, që në shumë raste kanë ndarë komunitete dhe familje. Bashkëpunimi i mirë përmes kufijve mund të lehtësojë qarkullimin njerëzor, përmes taksave më të 'buta' doganore dhe krijimit të rregulloreve në fushën e emigracionit, si dhe mund të ribashkojë familjet. Shumë shpesh, ZNRtë janë vende ku organizohen veprimtari shoqërore, ku ndodh grumbullimi i njerëzve, ku ndërtohen miqësi, organizohen lojra për zonat e mbrojtura, promovohen dhe tregëtohen produkte bujqësore vendore, e të tjera të ngjashme. Këto janë veprimtari të rëndësishme përsa i përket njohjes me kulturën e vendit fqinj, gjuhën dhe historinë dhe së fundmi janë veprimtari që rrisin entuziazmin e bashkëpunimit. Nismat ndërkufitare rrisin dhe forcojnë mundësitë për trajnimin e rojeve kufitare dhe ngritjen e moralit të punonjësve në zonat e mbrojtura (Hamilton et al. 1996).

Sot zonat e mbrojtura promovohen si 'parqe me njerëz', kështu që çdo zonë e mbrojtur përfshirë edhe ato ndërkufitare mbështetin qasjet pjesëmarrëse në planifikimin dhe menaxhimin (apo vendimmarrjen) e veprimtarive. Gjithashtu, ato ofrojnë mbështetje për komunitetet vendore, përmes përfitimeve që krijon menaxhimi i zonës së mbrojtur dhe shërbimeve mjedisore që jep zona, duke mbajtur gjithnjë parasysh parimet e qëndrueshmërisë dhe të ekuilibrit ekologjik. Interesat ekologjike, sociale, kulturore, ekonomike, politike dhe institucionale mund të ndryshojnë dhe mund të jenë kontradiktore. Ajo që i bën të dallueshme ZNR-të nga zonat e tjera të mbrojtura, është se palët e përfshira në ZNR kërkojnë të arrijnë objektiva të përbashkët, jo vetëm përmes sektorëve dhe përfshirjes së aktorëve të ndryshëm, por gjithashtu përmes kufijve ndërkombëtarë, me qëllim që të mund të përfshijë brenda saj gjithë ekosistemin.

Natyrisht, bashkëpunimi përmes kufijve rrit kompleksitetin e aktorëve, të çështjeve problematike dhe të zgjidhjeve të mundshme. Komunikimi mes sektorëve (p.sh me policinë e kufirit, fermerët, kompanitë turistike) mund të shoqërohet me shumë rezultate pozitive në ruajtjen e natyrës dhe zhvillimit vendor. Konfliktet mbi burimet natyrore mund të adresohen në mënyrë efektive dhe të lehtësohen përmes qasjesh ndërkufitare (Hamilton et al. 1996).

<sup>8</sup> Për shembull, shih: Ali, S. H. (2007) *Paret e Paqes. Ruajtja dhe Zgjidhja e Konfliktit, Shtypi MIT, Kembrixh, Masacusetts, Londër, Angli*; ose: Braack, L., Sandwith, T., Peddle, D., Petermann, T. (2006) *Konsiderata për Sigurinë në Planifikim, Menaxhimin dhe Planifikimin e Zonave Ndërkufitare të Ruajtura, IUCN, Gland, Zvicër dhe Kembrixh, UK*.  
<sup>9</sup> Shih kapitullin 4 të këtij publikimi.

Përsa i përket turizmit, hapja e kufijve dhe prezantimi i përbashkët i ZNRsë si një njësi e 'vetme', me simbolikë të njëjtë, me panele informuese dygjuhëshe ose shumëgjuhëshe dhe materiale promovuese, si dhe ekzistenca e qendrave të përbashkëta të informacionit krijojnë një perceptim të veçantë në lidhje me zonën. Turistët jo vetëm që mund të përjetojnë vizitën në dy apomë shumë vende njëherësh, por mund edhe të pajisen me një këndvështrim pozitiv mbi zonën e paraqitur, si një trashëgimi e përbashkët, për të cilën vendet ndajnë përgjegjësi mes tyre. Pothuajse për të gjitha rastet studimore që paraqiten në kapitujt vijues, theksi vihet në bashkëpunimin e fortë të aktiviteteve promovuese.

### **Përfitimi ekonomik dhe arritja e përfitimeve ekologjike, sociale dhe politike**

Në shumë raste në botë, territoret pranë kufijve janë zona të prapambetura nga pikëpamja ekonomike për shkak të largësisë (dhe kontrollit) nga qeveria qendrore, infrastrukturës së zhvilluar në mënyrë të pamjaftueshme për turizëm natyror, armiqësisë politike ndaj vendeve fqinje, ose arsye të tjera. ZNRtë ofrojnë mundësi për zhvillim ekonomik të zonave kufitare, veçanërisht përmes zhvillimit të turizmit. Turizmi natyror paraqet globalisht rreth 20 % të udhëtimit ndërkombëtar dhe po rritet me ritme shumë më të shpejta sesa sektori i turizmit në përgjithësi (Mittermeier et al. 2006). Ai ofron mundësi të mëdha për vendin dhe komunitetet vendore, por vetëm nëse zhvillimi i tij planifikohet dhe zbatohet me kujdes.

Bashkëpunimi i suksesshëm mes vendeve në ZNR, promovimi i përbashkët i zonës dhe paraqitja e saj si një 'e vetme' tërheq jo vetëm turistët, por edhe donatorët. ZNRtë nuk mund të varen për një kohë të gjatë nga financimet e huaja. Shpesh, donatorët e mëdhenj ndërkombëtarë investojnë me fonde të konsiderueshme projekte të caktuara, dhe kur ato përfundojnë, situata kthehet në pikën ku ishte para se të sigurohej financim nga donatori. Nëse palët e përfshira në ZNR nuk ndejnë 'pronësi' mbi të dhe nuk e ndejnë nevojën e përfitimeve nga procesi, ajo nuk ka gjasa të jetë e suksesshme. Krijimi i fondeve speciale të përbashkëta apo i buxheteve të financuara nga qeveritë dhe/ apo sektori privat ose ndonjë donator tjetër i interesuar, është një mundësi për të siguruar qëndrueshmëri financiare për zonën. Paratë e ngritura nga fondi mund të përdoren për projekte të përbashkëta kërkimi, për zhvillimin e hartave, trajnimin e personelit, seminare të përbashkëta, etj. Ndarja e të ardhurave që gjenerohen është gjithashtu me rëndësi (p.sh vendosja e tarifave të njëjta hyrëse në kufi nga palët partnere). Me qëllim që të sigurohet funksionimi i mirë i zonës, duhet që buxhetet dhe mekanizmat e rregullt menaxhues të ZNRsë, të integrohen me kohën që shpenzon personeli për mbarëvajtjen e saj.

### **Konkluzion**

Bashkëpunimi ndërkufitar për ruajtjen e natyrës ofron shumë mundësi. Përgjithësisht, bashkëpunimi është një sfidë, ndaj

krahas identifikimit të fushave të përbashkëta të interesit (p.sh kërkimi, monitorimi i biodiversitetit, menaxhimi i vizitorëve) duhet të ekzistojë edhe vullneti i mirë mes palëve. Përvoja ka treguar se besimi mes partnerëve, udhëheqja efiçente me personel të dedikuar dhe lojtarë entuziastë siguron suksesin e nismave ndërkufitare. ZNR funksionon në disa nivele të cilat duhet të integrohen mirë me qëllim që të sigurojnë shpërndarjen e drejtë dhe të duhur të përfitimeve. Pavarësisht nëse ZNR gjenerojnë avantazhe sociale, politike, apo të ndonjë lloji tjetër, thelbi i ekzistencës së tyre, është ruajtja e natyrës dhe e biodiversitetit. Sigurisht që nuk duhen injoruar apo nënvleftësuar përfitimet e tjera që mund të krijohen, përveç atyre ekologjike, pasi menaxhimi i zonave të mbrojtura është i pamundur pa përfshirjen e njerëzve vendorë ose pa përfitimet për ata. Zonat e mbrojtura nuk janë ishuj të izoluar, por duhen parë të integruara me sistemet ekologjike dhe sistemet rajonale dhe ndërkombëtare. Marrëdhëniet diplomatike mes vendeve mund të ndikojnë pozitivisht në një nismë të tillë. ZNRtë si habitate të mëdha e të vazhduara mbrojnë biodiversitetin dhe lehtësojnë dialogun mes personelit të secilës prej palëve të interesuara dhe të komuniteteve vendore. Krijimi i mundësive ekonomike, nxitja e marrëdhënieve të mira politike mes vendeve fqinje dhe kontributi në drejtim të paqes janë një aset i vlefshëm i përpjekjeve globale për të siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe të shërbimeve të saj, për brezat që do të vijnë.



## Referenca

- Adams, J. (2005). Analyse Your Company Using SWOTs, *Supply House Times* 48(7): 26-28.
- Ahokumpu, A. and Šolar, M. (2009). Verification Report for the Bavarian Forest National Park, Germany & Šumava National Park, Czech Republic on the application for the EUROPARC certificate: Transboundary Parks – Following Nature's Design. *Ms. Depon In: Grafenau*.
- Balkan Lynx Strategic Group. (2008). Strategy for the Conservation of the Balkan Lynx in Macedonia and Albania. Results from the Strategic Planning Workshop for the Conservation of the Balkan Lynx, Peshtani, Macedonia, 3-4 June 2008 (Draft).
- Bego, F. and Koni, M. (1999). Biodiversity Strategy and Action Plan. National Environmental Agency (NEA) & Global Environmental Facility (GEF), Tirana.
- Bogdanović, S. (2007). Prespa Park Coordination Committee, Technical assessment report, Novi Sad, Serbia.
- Breymeyer, A. and Noble, R. (1996). *Biodiversity Conservation in Transboundary Protected Areas*, National Research Council, National Academy Press, Washington, DC, USA.
- Broadhead, L.A. (2002). *International Environmental Politics; The Limits of Green Diplomacy*. Lynne Reinner Publishers, USA, 2002.
- Brunner, R. (1996). Parks for Life: Transboundary Protected Areas in Europe. Final Report, IUCN (IUCN/WCPA Parks for Life Coordination Office), Ljubljana, Slovenia.
- Brunner, R. (2000). Transfrontier Cooperation in Europe. In: Proceedings of the EUROPARC Federation 1999 General Assembly and Conference. Grafenau.
- CenTouris (Eds.) (2008). Befragung tschechischer Urlaubs- und Tagesgäste im Nationalpark Šumava 2007, unveröffentlichter Endbericht. Passau.
- Conference proceedings. (1997). *Parks for Peace*. International Conference on Transboundary Protected Areas as a Vehicle for International Co-operation, 16-18 September 1997, Somerset West, South Africa.
- Convention on Biological Diversity. (2004). *Programme of Work on Protected Areas*, <<http://www.cbd.int>>. Accessed on 14 January 2011.
- Dudley, N. (Ed.) (2008). *Guidelines for Applying Protected Area Management Categories*. Gland, Switzerland: IUCN.
- Du Nann, W.D. (1997). Flowering of Green Diplomacy. Peace and Conflict: *Journal of Peace Psychology*, 3(2): 213–215.
- ECBC. (1994). The Foundation for the Eastern Carpathian Biodiversity Conservation - Deed of Foundation.
- Engel, J.S. and del-Palacio, I. (2009). Global Networks of Clusters of Innovation: Accelerating the Innovation Process. *Business Horizons* (2009) 52, 493–503.
- European Environment Agency. (2003). Europe's Environment: The Third Assessment. Environmental Assessment Report No 10. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities, p. 231.
- Hannemann, T. and Job, H. (2003). Destination „Deutsche Nationalparke“ als touristische Marke. *Tourism Review* 58(2): 6–17.
- Harrer, B. (2004). *Wintertourismus in Bayern und die Wertschöpfung durch die Bergbahnen – am Beispiel von vier Orten*. In: Maschke, J. (Eds.). *Jahrbuch für Fremdenverkehr*. München, Germany: dwif-Consulting GmbH, pp. 128–143
- Helesic, J. and Kubicek, F. (Ed.) (1999). Hydrobiology of the Dyje River in the National Park Podyjí, Czech Republic. *Folia Biologica* 102: 138 p.
- Herzig, A. and Dokulil, M. (2001). Neusiedler See – Ein Steppensee in Europa, In: Dokulil, M., Hamm, A. and Kohl, J-G. (Eds.), *Ökologie und Schutz von Seen*, Facultas UTB.
- Fersch, A. and Lang, A. (2006). Between the Alps and the Pusztas: A Trans-boundary National Park Shared by Hungary and Austria, In: Terry, A., Ullrich, K. and Riecken U. (Eds.), *The Green Belt of Europe: From Vision to Reality*, Gland, Switzerland: IUCN.
- Flousek, J. and Gramsz, B. (1999). *Atlas of breeding birds in the Krkonoše Mts. (Czech Republic/Poland) in 1991–1994*. Vrchlabí: Správa Krkonošského národního parku, 424 pp.
- Flousek, J. and Plamínek, J. (2007). Vize Krkonoš. In: Flousek, J., Hartmanová, O., Štursa, J. and Potocki, J. (Eds.) *Krkonoše - Příroda, Historie, Život*. p. 815–816. Prague: Baset.
- Hamilton, L. (2008). How Can Biosphere Reserve Managers Address the Impacts of Climate Change and Global Warming on Biodiversity? An Overview of Some Global Efforts. A paper presented at the conference Mauvais temps pour la nature? Schlechtes wetter für die natur? Fischbach bei Dahm, Germany, 21–22 October 2008.
- Hamilton, L.S., Mackay, J.C., Worboys, G.L., Jones, R.A. and Manson, G.B. (1996). *Transborder Protected Area Cooperation*, IUCN/Australian Alps National Parks.
- Hußlein, M. and Kiener, H. (Eds.) (2007). *Natura 2000 – Europas wildes Herz / Divoké Srdce Evropy*, bilingual brochure. Grafenau/Vimperk.
- IUCN. (1997). Resolutions and Recommendations, World Conservation Congress, Montreal, Canada, 13–23 October 1996.
- IUCN. (2003). *The Durban Accord*. Vth IUCN World Parks Congress, Durban, South Africa, 12–13 September 2003.
- IUCN and Peace Parks Foundation. (1997). Conference proceedings. Parks for Peace. International Conference on Transboundary Protected Areas as a Vehicle for International Co-operation, 16-18 September 1997, Somerset West, South Africa.
- IUCN/WCPA. (1999). Parks for Life. Transboundary Protected Areas in Europe. Ljubljana.
- IUCN/WCPA. (2010). *Next Steps: Convention on Biological Diversity Programme of Work on Protected Areas*. Gland, Switzerland.
- Ivanovski, A. (2010). Trilateral Ecosystem Management Cooperation Driving Mechanism in the Lakes Prespa Basin, Balwois International Conference on Water and Information Systems, Ohrid, Macedonia.
- Jardin, M., Fall, J., and Thiry, E. (2003). *Five Transboundary Biosphere Reserves in Europe*. Biosphere Reserves Technical Notes. UNESCO, Paris.
- Jeník, J. (2000). Geographical and Ecological Identity of the Giant Mountains. *Opera Concorctica* 37: 12–19.
- Job, H. (Ed.) (2008). *Die Destination Nationalpark Bayerischer Wald als regionaler Wirtschaftsfaktor*. Wissenschaftliche Reihe, Sonderheft. Grafenau, Germany: Nationalpark Bayerischer Wald.

- Job, H., Harrer, B., Metzler, D. and Hajizadeh-Alamdary, D. (2005). *Ökonomische Effekte von Großschutzgebieten*. BfN-Skripten (135) Selbstverlag, Bonn-Bad Godesberg.
- Job, H., Metzler, D., Müller, M. and Mayer, M. (2004a). The contribution of small and medium tourism enterprises to regional economic development – a comparison between two German national park regions. In: Keller, P. and Bieger, T. (Eds.). *The future of small and medium sized enterprises in tourism*. 54th Congress 2004 of the International Association of Scientific Experts in Tourism, pp. 55–75. St. Gallen.
- Job, H., Metzler, D., Hajizadeh-Alamdary, D., Rodrian, P. and Woltering, M. (2004b). Regional Economic Impacts of Sustainable Tourism in Protected Areas. In: Rulle, M. (Ed.). *Recent Trends in Tourism – the Baltic and the World*, Greifswalder Beiträge zur Regional-, Freizeit- und Tourismusforschung 15, p. 141–156. Greifswald.
- Job, H., Metzler, D. and Vogt, L. (2003). Inwertsetzung alpiner Nationalparks. Eine regionalwirtschaftliche Analyse des Tourismus im Alpenpark Berchtesgaden. *Münchner Studien zur Sozial- und Wirtschaftsgeographie* 43. Kallmünz.
- Karivalo, L. and Butorin, A. (2006). The Fennoscandian Green Belt. In: Terry, A., Ullrich, K. and Riecken, U. (Eds.). *The Green Belt of Europe: From Vision to Reality*. IUCN, Gland, Switzerland and Cambridge, UK.
- Kavrakova, V., Dimova, D., Dimitrov, M., Tsonev, R., Belev, T. and Rakovska, K. (2009). Manual for identification of habitats of European importance in Bulgaria. WWF-DCP, Green Balkans, Sofia.
- Kiener, H. and Křenová, Z. (2009). Europe's Wild Heart and Lecture after Kyrill. In: Husslein, M., Kiener, H., Křenová, Z. and Šolar, M. (Eds.) *The appropriateness of non-intervention management for protected areas and Natura 2000 sites*. Srni Conference Report. Grafenau/Vimperk 2009. pp 24-27.
- Kirchberger, K. and Karpati, L. (2006). The Development of Cooperation and Land Use around Lake Neusiedl/Fertő, In: Terry, A., Ullrich, K. and Riecken, U. (Eds.), *The Green Belt of Europe: From Vision to Reality*, Gland, Switzerland: IUCN, supra note 6, pp. 101–109.
- Kohler, B. (2004). The Development of a Joint Education Strategy for the Neusiedler See Seewinkel/Fertő-Hanság Region – Introduction and Background. Proceedings of Management of Transboundary Ramsar Sites – Changes and Challenges Conference, Illmitz, Austria, 18–19 November 2004, WWF Austria.
- Kortelainen, J. (2010). The European Green Belt as a Form of Environmental Governance. In: KRIHS Special Report 2010, Korean Research Institute for Human Settlements, Volume 15.
- Křenová, Z. and Kiener, H. (2009). Společné jádrové území Národních parků Šumava a Bavorský les – Divoké srdce Evropy / Gemeinsamer Kernbereich der Nationalparke Šumava und Bayerischer Wald – Europas wildes Herz (bilingual common guidelines). Grafenau/Vimperk.
- Lombard, A.T., Cowling, R.M., Vlok, J.H.J. and Fabricius, C. (2010). Designing Conservation Corridors in Production Landscapes: Assessment Methods, Implementation Issues, and Lessons Learnt. *Ecology & Society* 15(3): 7. <http://www.ecologyandsociety.org/vol15/iss3/art7/>.
- Lusigi, W. and Norris, R. (1998). *The Draft Site Visit Report*, World Bank, Internal document, Washington, D.C., USA.
- Marin, S., Rogev, A., Christov, I. and Sarov, M. (1998). New observations and nesting of the Black vulture (*Aegypius monachus*) in Bulgaria. In: Tewes, E., Sanchez, J. J., Heredia, B., & Bijleveld van Lexmond, M. (Eds.). *The Black Vulture in South Eastern Europe*, BVCF/FZG, Palma de Mallorca.
- McCallum, J. (2011). *Ecological Case for Transboundary Conservation*, <<http://www.tbpa.net>>.
- MES. (2006). Case Study Jablanica-Mali e Shebenikut. Final Report of the project "Balkan Green Belt as Ecological Corridor for Wolf, Bear and Lynx".
- Metsähallitus Natural Heritage Service Lapland, Sami Museum and Northern Lapland Nature Centre Siida, Office of the Finnmark County Governor, Pasvik State Nature Reserve (Pasvik Zapovednik). (2008). Action Plan for Nature Protection and Sustainable Nature Tourism in Pasvik-Inari Area, Part A, Annex 5.
- Meyer, T., Kiener, H. and Křenová, Z. (2009). Wild Heart of Europe. *International Journal of Wilderness* 15(3): 33–40.
- Michev, T. and Petrov, T. (1985). Imperial eagle, *Aquila heliaca* Savigny, 1809. in Red Data Book of Bulgaria, vol. 2, BAS, Sofia.
- Ministry of Environment and Physical Planning of the Republic of Macedonia. (2003). Biodiversity and Action Plan of the Republic of Macedonia.
- Ministry of Environment Republic of Korea. (2005). Green Korea 2005. Towards the Harmonization of Human and the Nature. International Affairs Office of the Ministry of Environment, Seoul, Republic of Korea.
- Ministry of the Environment of the Republic of Finland, Ministry of the Environment of the Kingdom of Norway and Ministry of Natural Resources and Environment of the Russian Federation. (2010). Memorandum of Understanding between the Ministry of the Environment of the Republic of Finland, the Ministry of the Environment of the Kingdom of Norway and the Ministry of Natural Resources and Environment of the Russian Federation on cooperation on the development of the Green Belt of Fennoscandia.
- Mittermeier, R.A., Kormos, C.F., Mittermeier, C.G., Robles Gil, P., Sandwith, T. and Besançon, C. (2005). *Transboundary Conservation. A New Vision for Protected Areas*. CEMEX-Agrupación Sierra Madre-Conservation International, Mexico.
- Müller, J., Scherzinger, W. and Moning, C. (2007). European Ural Owl workshop. National Park Proceedings, Issue 8. Grafenau.
- Nankinov, D., Dutsov, Al., Nikolov, B., Borisov, B., Stoyanov, G., Gradev, G., Georgiev, D., Popov, D., Domuschiev, D., Kirov, D., Tilova, E., Nikolov, I., Ivanov, I., Dichev, K., Popov, K., Karaivanov, N., Todorov, N., Shurulinkov, P., Stanchev, R., Aleksov, R., Tzonev, R., Ivanov, S., Marin, S., Staikov, S., Nikolov, S., Dalakchieva, S. and Nikolov, Hr. (2004). *Breeding totals of the avifauna in Bulgaria*. Green Balkans, Plovdiv.
- Natur & Land. (1993). *Schritt für Schritt zum Nationalpark Neusiedler See – Seewinkel*, Eine Festschrift des ÖNB zur Gründung des Nationalparkes Neusiedler See – Seewinkel; Natur & Land, 79. Jahrgang, Sonderheft zu 3-4/1993, Salzburg.
- Niewiadomski, Z. (2005). The first trilateral UNESCO-MaB Biosphere Reserve the East Carpathians In, KFEM, *Conservation and Sustainable Management of the DMZ and Surrounding Areas - 2005 Ecocity International Symposium*. Korean Federation for Environmental Movements, Seoul, Republic of Korea, pp. 157 - 176.

- Niewiadomski, Z. (2006a). The first trilateral UNESCO-MaB Biosphere Reserve the East Carpathians, In: Stein, R., Heil, P. and Tuček, L. (Eds.) *Proceedings of the 2004 International Conference and Expert Workshop of Transboundary Biosphere Reserves: Following-up on Seville+5*, Naturpark Pfälzerwald/Parc Régional des Vosges du Nord, Lambrecht, Germany / La Petite-Pierre, France, pp. 26–35.
- Niewiadomski, Z. (2006b). Sustainable financing of Biosphere Reserves, In: EUROMAB Austria. Meeting of the EuroMAB Biosphere Reserve Coordinators and Managers. Austrian Commission for UNESCO, Wien, Austria, pp. 92-94.
- Nikolov, H., Gruev, B., Delipavlov, D., Gramatikov, D., Daraktchiev, A., Stojanov, A., Ivanova, T., Petrov, B. and Tzvetkov, P. (1998). Report of the Green Balkans Movement on the Bulgarian National Biological Diversity Conservation Strategy in Bulgaria's Biological Diversity: Conservation Status and Needs Assessment, Volumes I and II. Curt Meine, ed. Washington, D. C.: Biodiversity Support Program.
- Petrikova, H. and Raj, A. (2006). The Krkonoše/Karkonosze TBR (Czech Republic/Poland). In: Stein R., Heil P., Tuček, L. (Eds.) *Proceedings of the 2004 International Conference and Expert Workshop of Transboundary Biosphere Reserves: Following-up on Seville +5*, Naturpark Pfälzerwald/Parc Régional des Vosges du Nord, Lambrech/La Petite-Pierre.
- Petrikova, H. (1990). The Cooperation between the Czech and Polish National Parks in the Krkonoše Mts. In: Valdrè, G. (Ed.) *Conference Proceedings: National parks on Borderlines, East-West Co-operation*, FNNPE-IUCN-CEDIP, Polinuro, Italy, p. 21–24.
- Petrikova, H. (2003). The Krkonoše/Karkonosze Biosphere Reserve: Experience and Challenges in the Changing Region. In: Parviainen, J., Lovén, L. and Pitkanen, M. (Eds.) *Augmenta: Koli Border Forum – Seminar 2003*, Koli National Park, p. 152–158.
- Petrov, B. (2004). The herpetofauna (*Amphibia* and *Reptilia*) of the Eastern Rhodopes (Bulgaria and Greece). In Beron P. and Popov A. (Eds.) *Biodiversity of Bulgaria. 2. Biodiversity of Eastern Rhodopes (Bulgaria and Greece)*. Pensoft & Nat. Mus. Natur. Hist., Sofia.
- Phillips, A. (2003). A New Paradigm for Protected Areas. *World Conservation. The IUCN Bulletin* 2: 6–7. IUCN, Gland, Switzerland.
- Plachter, H. (2005). The World Heritage Convention of UNESCO - A Flagship of the Global Nature Conservation Strategy, UNU Global Seminar Series, Inaugural Shimane-Yamaguchi Session, Yamaguchi, Japan.
- Popov, V. and Sedefchev, A. (2003). *Mammals in Bulgaria*. Vitosha Nature Park Directorate, Sofia.
- PPNEA. (2006). Biodiversity values and conservation of Jablanica-Shebeniku. Final Report of the project "Balkan Green Belt as Ecological Corridor for Wolf, Bear and Lynx".
- Roetzler, R. (2005). Geologische Karte der Nationalparks Thayatal und Podyjí. *Geologische Bundesanstalt*, 92p.
- Sandwith, T. and Besançon, C. (2010). Making Peace: Protected Areas Contributing to Conflict Resolution. In: Stolton, S. and Dudley, N. (Eds.), *Arguments for Protection. Multiple benefits for conservation and use*. UK and USA: Earthscan.
- Sandwith, T., Lockwood, M. and Gurung, C. (2006). Linking the Landscape. In: Lockwood, M., Worboys, G. and Kothari, A. (Eds.). *Managing Protected Areas: A Global Guide*, UK and USA: Earthscan.
- Sandwith, T., Shine, C., Hamilton, L. and Sheppard, D. (2001). *Transboundary Protected Areas for Peace and Co-operation*. IUCN, Gland, Switzerland and Cambridge, UK.
- Society for the Protection of Prespa (SPP), WWF Greece, Protection and Preservation of Natural Environment in Albania (PPNEA) and Macedonian Alliance for Prespa (MAP). (2002). Strategic Action Plan (SAP) for the Sustainable Development of the Prespa Park.
- Štursa, J., Kwiatkowski, P., Harčaryk, J., Zahradníková, J. and Krahulec, F. (2009). Black and Red List of Vascular Plants of the Krkonoše/Karkonosze Mts. (Western Sudetes CZ, PL). *Opera Corcontica* 46: 67–104. <[http://opera.krnep.cz/\\_pdf/46/Stursa.pdf](http://opera.krnep.cz/_pdf/46/Stursa.pdf)>.
- Tamburelli, G. (2007). Notes on the Legal Framework for the Sustainable Management of Transboundary Protected Areas. In, Tamburelli, G. (Ed.) *Biodiversity Conservation and Protected Areas. The Italian and Ukrainian Legislation*. Milano: Giuffrè Editore.
- Terry, A., Ullrich, K. and Riecken, U. (2006). *The Green Belt of Europe: From Vision to Reality*. IUCN, Gland, Switzerland and Cambridge, UK.
- UNDP/GEF. (1997). Prespa Park Integrated Ecosystem Management of the Prespa Lakes Basin in Albania, Macedonia and Greece, UNDP/GEF Project Document, Resen, Republic of Macedonia.
- UNEP. (2003). *Framework Convention on the Protection and Sustainable Development of the Carpathians*. <<http://www.carpathianconvention.org>>. Accessed on 24 January 2011.
- UNEP WCMC. (2007). *Global List of Transboundary Protected Areas*, <<http://www.tbpa.net>>. Accessed on 24 January 2011.
- UNESCO. (2000). *Biosphere Reserves on Borders*. National UNESCO-MAB Committee of Poland, Warsaw.
- United Nations Conference on Environment and Development. (1992). Rio Declaration on Environment and Development. UN Doc. A/CONF.151/26 (vol. I); 31 ILM 874 (1992).
- van der Linde, H., Oglethorpe, J., Sandwith, T., Snelson, D. and Tessema, Y. (with contributions from Anada Tiéga and Thomas Price). (2001). *Beyond Boundaries: Transboundary Natural Resource Management in Sub-Saharan Africa*. Washington, D.C., USA: Biodiversity Support Program.
- Wrbka, Th., Zmelik, K., Schmitzberger, I. and Thurner, B. (2010). Die Vegetation der Wälder, Wiesen und Trockenrasen des Nationalparks Thayatal – ein erster Überblick. In: *Wissenschaftliche Mitteilungen des Niederösterreichischen Landesmuseums*, 468p.
- Zbicz, D. (1999). Transboundary Cooperation between Internationally Adjoining Protected Areas. In, Harmon, D. (Ed.), *On the Frontiers of Conservation*. Hanckock, Michigan, USA: George Wright Society.
- Zunckel, K. (2007). The Maloti Drakensberg Transfrontier Conservation and Development Programme: A Cooperative Initiative between Lesotho and South Africa. Presented at the Peace, Parks, and Partnership Conference, Waterton Lakes National Park, Alberta, Canada, 9–12 September 2007.



**INTERNATIONAL UNION FOR  
CONSERVATION OF NATURE**

PROGRAMME OFFICE  
FOR SOUTH-EASTERN EUROPE  
Dr. Ivana Ribara 91  
11070 Belgrade, Serbia  
see@iucn.org  
tel +381 11 2272 411  
fax +381 11 2272 531  
[www.iucn.org](http://www.iucn.org)

